

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 50

BESIM BOKSHI

VARIA

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSIVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXXXV
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 50

BESIM BOKSHI

VARIA

Approved for publication at the meeting of the Section of Linguistics and Literature,
held on October 7th, 2013, after review by
academician Rexhep Ismajli and academician Idriz Ajeti.

Editor: Academician Mehmet Kraja, Secretary of Linguistics and Literature Section.



PRISHTINA
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 50

BESIM BOKSHI

VARIA

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
mbajtur më 7 tetor 2013, në bazë të recensioneve të
akademik Rexhep Ismajlit dhe akademik Idriz Ajetit.

Redaktor: Akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Copyright © ASHAK

Muhamedijes, shoqes sime të jetës.

PARATHËNIE

Në këtë vëllim nën titullin *I. Çështje albanistike* janë përmbledhur kumtesat e mbajtura në konferenca e tryeza shkencore:

- a) *Emrat e ditëve të javës - dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes,*
- b) *Vështrim krahasues i sistemit rasor të “Mesharit” me tipat e tjerë të sistemit rasor të shqipes,*
- c) *Një sistemim i parafjalëve të shqipe (e pakumtuar),*
- ç) *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe,*
- d) *E folmja e arbnesëve të Zarës në veprën e Idriz Ajetit,*
- dh) *Trajtimi i relikteve gjuhësore nga Selman Riza,*
- e) *Për theksin e shqipes dhe për lëvizjen e hershme të tij,*
- ë) *Për parashtesat e shqipes standarde,*
- f) *Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë,*
- g) *Nga bisedat në Beograd*

Në pjesën II. *Çështje ballkanistike* janë paraqitur trajtesat:

- a) *Format e futurit të shqipes në përqasje me ato të gjuhëve ballkanike,*
- b) *Rasat gjinore-dhanore në gjuhët ballkanike,*
- c) *Rimarrja e kundrinave në gjuhët ballkanike,*
- ç) *Theksi dinamik dhe gjatësia e zanoreve në gjuhët ballkanike.*

Brenda pjesës III. *Për disa personalitete akademike* janë shënuar fjalët:

për *Cimochowski*,

në 80-vjetorin e lindjes së *Shaban Demirajt*,

për *Selman Rizën* në 100-vjetorin e lindjes,

në promovimin e veprës së *Idriz Ajetit*,
për *Eqrem Çabejn* shkurtimisht,
për *Rexhep Ismajlin*,
në 70-vjetorin e lindjes së *Fehmi Aganit*,
në 90-vjetorin e lindjes së *Mark Krasniqit*,
për *Jashar Rexhepagiqin* në 80-vjetorin e lindjes,
për *Ali Podrimjen*,
për *Pajazit Nushin*,
për *Din Mehmetin*,
për *Bardhyl Çaushin*,
për *Qamil Gexhën*,

Shënim Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zotit Gudar Beqiraj.

Në pjesën IV. *Fjalë përshëndetëse e falënderuese* janë shënuar fjalët e thëna nëpër konferenca e tryeza shkencor në emër të Akademisë si nënkryetar dhe kryetar i saj. Kjo pjesë përmbillet me intervistën e gazetarit Mehmet Emërllahu, botuar në “Rilindja” më 16 qershor 1990 dhe në veprën e tij *Nyja kosovare*.

Në fund kam paraqitur mendimet e mia për disa ndryshime që mendoj se duhet të bëhen në drejtshkrimin e shqipes standarde në drejtim të përforcimit të parimit fonetik, d.m.th. në drejtim të përfrimit të formës së shkruar me shqiptimin dhe në disa pika morfologjike që bëjnë presion që të hyjnë në shqipen standarde në funksion të begatimit e të lehtësimit të shprehjes, d.m.th. në përlehtësimin e përdorimit më të përgjithësuar të saj.

I. ÇËSHITJE ALBANISTIKE

EMRAT E DITËVE TË JAVËS

dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes

Përfitim e emrave të ditëve të javës ne e kemi trajtuar shkurtimisht në veprën *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike* (1984) në kuadër të shqyrtimit të pozitës së nyjës shquese. Këtë temë po e rimarrim për të shënuar përpjekjet e studiuesve për të sqaruar origjinën e emrave *e enjte*, *e premtë* dhe për të zbrëthyer nga forma e emrave të ditëve të javës elementet e një strukture të lashtë të sintagmës nominale e të fleksionit emëror brenda kohës së huazimeve të vjetra nga latinishtja.

Për emrat e ditëve të javës në gjuhën shqipe Gustav Meyer-i është shprehur se *e martë*, *e mërkurë*, *e shtunë* janë emra të huazuar nga latinishtja dhe *e diel*, *e hënë* - të përkthyer nga kjo gjuhë, ndërsa emrat *e enjte*, *e premtë* i konsideroi të pasqaruara. E. Çabej ka shënuar se “që në periodën e vonë të ndikimit romak, gjuha popullore ka lentuar (krijuar) emrat e ditëve të javës (*ditë*) *e diel*, *d. e hënë*, *d. e premtë* pas lat. *dies solis*, *dies lunae*, *dies Veneris*, ndërsa *e martë*, *e mërkurë*, *e shtunë* i mori prej latinishtes dhe tek *e enjte* ruajti një emër vendi të lashtë”.¹

Shihet se shqipja për emrat e ditëve të javës nga latinishtja ka preferuar kalkimin, d.m.th. përkthimin (Diell, Hënë), ndërsa ka huazuar kur përkthimi nuk ka qenë i mundur (Mart, Mërkur, Saturn). Duket se është i drejtë mendimi që shqipja nuk i ka huazuar si emra të përveçëm, por i ka marrë përmes shënimit të ditëve të javës: dita e *Martit*, dita e *Mërkurit* si dita e *Diellit*, dita e *Hënës*, pa ditur se ç’është Marti, Merkuri e Saturni.

E enjte, *e premtë* nuk i janë nënshtruar ndikimit të latinishtes për t’u zëvendësuar nga emrat përkatës të kësaj gjuhe. Para ndikimit të latinishtes a do të ketë pasur shqipja emra të tjerë të ditëve të javës, prej të cilëve të kenë mbetur vetëm *e enjtja* dhe *e premtja*? Ruajtja e këtyre emrave pa u zëvendësuar nga emrat e latinishtes tregon se shqipja ende nuk i kishte krijuar emrat e ditëve të javës, kështu që emrat e ditëve nga latinishtja nuk

¹ *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, f. 118.

zëvendësuan emra të shqipes, sepse zëvendësimi do t'i kishte përfshirë edhe emrat *e enjte*, *e premtë*. Nga ana tjetër këta emra nuk mund të jenë krijuar pas huazimit të emrave të tjerë, që të konsiderohen zëvendësues të emrave nga latinishtja, por do të jenë më të lashtë se krijimi i ditëve të javës në gjuhën shqipe. Do të duhej të kenë qenë emra shenjtërisht në ekuivalencë me emrat e latinishtes Jovi (Jupiteri) e Venus (Veneris), për t'u konsideruar të përkthyer si *e Hëna*, *e Diela*, siç mendojnë disa studiues, apo do të kenë shënuar ditë jashtë vargut të ditëve të javës, siç mendojnë disa të tjerë. Çfarë do të ketë qenë ajo që këta emra i bëri shënues të emrave të ditëve të javës në kohën kur të gjithë të tjerët po huazoheshin nga latinishtja. Ç'ishte ai kuptim i fuqishëm që nuk la të zëvendësohesin nga emrat latinë më vonë? Një përgjigje na e jep Ndre Mjeda. Ai shënoi se shqipja ka pasur vetëm emrat e dy ditëve: emrin e ditës së parë të muajit (të hënës së re) *e premtë* dhe emrin e ditës së fundit të muajit (para hënës së re) *e enjte*. Kur grekët e latinët krijuan "hepdomas", përkatësisht "septimana" që "doshin me thënë një rresht shtatë ditësh, jo si pjesë mojit, por si rrjedhje shtatë ditësh" e "Kur ká hî edhè nder vënde tona këjo e dame, kena mârrë êmnat e ditvet prei latinishtes, qi mâ e shuma ishin êmnat e rrokullojsvet të diellit, si në "e Shtunë", "e Martë", "e Mërkurë" e tui perkthye dy tjera: "e Dielle" e "e Hanë", por tui mbajtë atò dy êmna qi kishte moji edhë perpara, do me thënë "*e enjte*" e "*e premtë*".²

Këto shënime të Mjedës për përcaktimin e prejardhjes së emrave të ditëve *e enjte*, *e premtë* kanë nevojë të plotësohen me arsyetimin e kalimit të tyre nga emra që kanë shënuar ditë të caktuara të muajit në emra të dy ditëve të javës, gjë që nuk ndodhi në latinishten ku *kalendat*, *nonat* e *idet* nuk u bënë shënues të ditëve të javës.

Në gjuhën latine java ka filluar nga *e shtuna* dhe ka përfunduar me *të premtën*: 1. *Dies Saturni*, 2. *Dies Solis*, 3. *Dies Lunae*, 4. *Dies Martis*, 5. *Dies Mercurii*, 6. *Dies Jovis*, 7. *Dies Veneris*.³ Këto shënime të Mjedës sugjerojnë që në gjuhën shqipe java të ketë filluar me ditën *e premtë* e të ketë përfunduar me ditën *e enjte*, duke gjetur kështu arsyen e kalimit të

² Leka, IV, 1932, f.351.

³ Shih M. Skubić, *Uvod u romansku lingvistiku*, Novi Sad, 1990, f. 95.

këtyre nga shënimi i ditës së parë e të mbramë të muajit në ditë të parë e të mbramë të javës.

Emrat *e shtunë* dhe *e djelë* tregojnë se huazimi nga latinishtja ishte bërë kur *saturni dies* e *solis dies* nuk ishin zëvendësuar ende nga *sabati* e *dominica* që u sollën nga krishterimi. Emrat e planeteve ishin te romakët emra zotësh, që domethënë se me ta u shënuan ditët e javës para krishterimit, në zëvendësim të *kalendeve*, të *noneve* e të *ideve*. Është shënuar se formimi i ditëve të javës nga emrat e planeteve ishte bërë zotërues që në përfundim të kohës së Republikës së Romës.⁴ Edhe emri *javë*, që, sipas E. Hamp-it rrjedh nga fjala greke *ἑβδομάδα* – hebdomada⁵ ka hyrë në gjuhën shqipe, sipas shumë gjuhëtarëve, përmes latinishtes, d.m.th. se koncepti i javës ishte krijuar në gjuhën shqipe para se latinishtja ta zëvendësonte me emrin *septimana*. Këto e bëjnë të dyshimtë mendimin e Çabejt që emrat e ditëve të javës nga latinishtja të jenë marrë “në periodën e vonë të ndikimit romak”.

Në bazë të këtyre që u thanë mund të përfundohet së paku se etimologjitë e propozuara, që i trajtojnë këto dy ditë origjinalisht si shënuese të ditëve të javës janë të paqëndrueshme.

Emrat *e enjte*, *e premte*, që me formën e tyre dallohen nga emrat e tjerë të javës, janë trajtuar nga shumë studiues, të cilët kanë dhënë mendime të ndryshme për origjinën e tyre.

Dh. Kamarda, që ka shënuar se *e enjte* dhe *e premte* janë të një etimologjie të errët, ka shfaqur mendimin për origjinën e tyre. Ai është shprehur se “*ε ἦντια* duhet të shënojë *lulësinë* (la fiorita) apo *ditën e luleve* në qoftë se i referohet fjalës *enda* (apo *enta*) dhe *end-ja* (lule), por duke iu referuar fjalës *entos*, *endon* dhe fjalës shqipe *ende* (khs. br-enda = per-enda) do të shënonte mesin e javës si në gjermanisht *Mittwoch* për të mërkurën”. Këtu do të mund të përmendej edhe shembulli *sreda* nga disa gjuhë sllave. Për *të premten* shënoi: “emri *ε πρήμπτ-εα, -εja* mund të ketë lidhje me

⁴ Shih M. Skubić, vep. e cit., f. 95.

⁵ Shih E. Hamp, *Fjala javë, reduktimi i saj fonetik dhe sintaksa* në Gjurmime albanologjike, SSHF, VIII, 1978, ff. 121-129 dhe në veprën e tij *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, 2007, ff. 363-372.

avestishten **πρήμιε** *mbrëmë, mbrëmja e kaluar*, prej nga duket se rrjedh folja *premt-o-je* apo *premt-o-je, unë bëj gati, përgatit*, pothuajse *e bej në vigjile* e pastaj edhe *premt-oj ...*. Por ai shtoi, nga ana tjetër, se kjo fjalë i referohet rrënjës *pra*, gr. (πρό, πρῶ), **πρόμος**, (πρώιμος), dor. **πράμος**, që është numëror rreshtor ~”i parë”, duke përfunduar se “*e premtia* është ekuivalente me fjalën greke **παρασκευή** si për nga kuptimi ashtu edhe për gjënë e shënuar” (= *dita e premtë*, që përmban edhe kuptimin: përgatitje).⁶ Për Treimerin *e enjte* lidhet me emrin e hyjnisë së zjarrit **Enji** te ilirët.⁷ Në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike ka thënë se letrari romak *Enius* nga *Rudie e Kalabrisë* mbante emrin e hyut kryesor të ilirëve (e enjte). Për *e premtë* ai u shpreh se “Përmes të *premtës, premtë* na kujtohet një perëndeshë Prema, etimologjikisht e lidhur me lat. *premo*, e cila të kujton krijimin dhe plleshmërinë.⁸ Karl Oštiri ka menduar se *e enjte* lidhet me **aisnj-* (zot) apo me **axnj-* (zot i qiellit), e afrueshme me etrusken *Uni* apo me paralatinishten *I-anus*,⁹ ndërsa M. Lambertz-i e afron me *En*, që ai e krijoi si emër hyjnie ilire.¹⁰ W. Fiedler-i¹¹ u shpreh se *En-i* i Lambertz-it është “një produkt përsiatës” dhe pajtohet me Çabejn se “Ndërtimet e një hyjnie **Enjti** në mitologjinë shqiptare dhe të një *Eni* për mitologjinë ilire janë pjella e fantazisë”. Çabej mbështet vlerësimin e C. Tagliavini-t që këto etimologji e të tjera të ngjajshme janë supozime tepër të guximshme, që domethënë të pamundura.¹²

Mendimin e Ndre Mjedës për ditën *e enjte* Çabej nuk e paraqiti drejt kur shënoi: “Mjedja e afron fjalën me gr. e vj. **ένη** (scil. **ήμέρα**)”, “e treta ditë, dita e pasnesërme, e dejmja” dhe se “Mendimi që tek “*e enjte*” fshihet një numëror i hershëm përforcohet edhe nga ana morfologjike, me rrethanën që ndër emrat e ditëve të javës vetëm *e enjte* dhe *e premtë* janë for-

⁶ *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Ristampa anastatica, Livorno, 1989, f. 110-11.

⁷ *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, I, f. 32.

⁸ *Arhiv*, I, f. 32.

⁹ *Arhiv*, II (1924), Beograd 1925, f. 182.

¹⁰ *Wörterbuch der Mythologie*, Studgart, 1970.

¹¹ *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave filologjike. IV, 1974, f. 195.

¹² Në *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, IV, Tiranë, 1996, f.87.

muar me sufiksin *-të* që kanë edhe këta numërorë”. Për këtë fjalë Çabej vlerësoi se “më i mbështetur se gjithë krahasimet e tjera për ne është mendimi i Mjedës, me gjithë kritikën që i janë bërë” nga Lambertz-i e Ölberg-u.¹³ E. Çabej i referohet shkrimit të Mjedës në *Leka*, IV, 351. Ndërkaq këtu Ndre Mjeda flet për *të premtën* dhe *të enjten* si vijon: “Puna mâ e nevojshme kah moji ishte me dijtë kûr bâte *hâna e re*, pse me të fillote moji, e si mërret vesht, ajo ishte e para ditë e mojit. Anî mâ shqip na ká mbêtë émni i ksaj ditës së parë: *e premtë* si me thânë *e parmë*, greqisht *pramos, promos*; lat. *primus*... Grekët kanë pasë një *émën* edhe për të mbrâmen ditë të mojit: *èni* qi do me thânë: “e mbrâmja ditë” asë “dita para hânës së re”... Kjo fjalë ká mbetë edhe në shqipen: *e ênj-te*”.¹⁴

Shprehja: “Kjo fjalë ka mbetë edhe në shqipen” do të thotë se është fjalë e huazuar nga greqishtja e vjetër. Kjo e shton shkallën e dyshimit për vërtetësinë e etimologjisë së Mjedës, sepse, në qoftë se shqipja e ka pasur të veten fjalën *e premtë* me kuptimin “ditë e parë e muajit”, ajo do të impononte që ta kishte të sajën edhe fjalën me kuptim të kundërt “ditë e fundit e muajit” e jo ta huazonte nga greqishtja. Huazimi i fjalës *èni*, që në shqipen do të ishte fjalë e pamotivuar, na duket se tregon që edhe fjala *e premtë* nuk lidhet me numërorin *e parë* (*e parmë*). Atëherë brenda kësaj etimologjie fonetikusht do të pritej që edhe kjo të ishte e huazuar nga greqishtja (*pramos – pramos*).

Çabej është nisur nga kuptimi që ka fjala e greqishtes *éνη* që përmend Mjeda në formën *éνη* “dita e pasnesërme”, që domethënë “dita e tretë”, nga e cila ka rrjedhur *e enjtja*. Mbase Çabej e theksoi kuptimin e ditës së tretë e jo të ditës së fundit të muajit, që theksoi Mjeda, duhet konsideruar mendim të Çabejt, mbase, siç u shënua, ky i është dukur më i qëlluari. Për *e premtë* nuk dimë që Çabej të ketë dhënë arsyetimin e lidhjes kuptimore me *dies Veneris*. Ndre Mjeda me të drejtë ka vlerësuar se “Ësht një trillim i kotë ai qi thotë Rossi në fjalorin e vet se *e ejte* do me thanë Giove”, pra Jovi – Jupiteri.¹⁵

¹³ Vep. e cit., f. 87.

¹⁴ N. Mjeda, *Prënd e Prëndë*, *Leka*, IV, Tetuer, 1932, N. 10, f. 351.

¹⁵ Po aty.

Duket se është plotësisht e qartë që *e enjte* dhe *e premte* nuk mund të jenë përkthime të *dies Jovi* e *dies Veneris*. Këtë e përforcon edhe fakti se forma e tyre do të ishte e njëjtë me formën e emrave të tjerë të ditëve të javës e jo e veçantë me **-e** fundore.

Me **-e**-në fundore e me nyjën e përparme *e enjte* dhe *e premte* nuk mund të jenë me origjinë emërore. Në këtë përbërje **-e**-ja fundore mund të ketë qenë vetëm mbaresë gjinie e mbiemrit, i cili do ta kishte pasur edhe formën mashkullore me mbaresë gjinie zero: *i enjt, i premt*. Këto fjalë do të kenë qenë në funksion epiteti ndaj emrit *ditë* që në kohën kur nuk ishin bërë ende mbiemra të nyjshëm e kur para mbaresës **-e** e kishin mbaresën **-ë** për gjininë femërore, ashtu si mbiemrat e tjerë që e dallojnë gjininë edhe me mbaresë: *i kuq – e kuq-e* ← **e kuq-ë*, forma mashkullore (e asnjëse) e të cilëve përdorej edhe si ndajfolje: *kuq, keq* etj.¹⁶ **-e**-ja është edhe sufiks feminativ tek emrat e gjallesave, që janë edhe mbiemra, domethënë te fjalët emër-mbiemër: *fisnik-e, punëtor-e, mik-e* etj. Këta mbiemra, porse, nuk janë asnjëherë të nyjshëm. Sufiksi feminativ **-e** është transformuar në pjesë të temës tek emrat e veglave të përfutur nga leksikalizimi i invariantit të gjinisë femërore të emrave të vepruesit: *varëse, kapëse* etj. Shihet se *e enjte, e premte* nuk janë emra të kësaj kategorie. Kështu burimi i emrave të ditëve *e enjte, e premte* nga emrat nuk është i mundur, prandaj asnjëra nga etimologjitë e shënuara gjer tani për emrin e ditës *e enjte*: *end* (lule), *Enji* (hyjni e zjarrit), **axnj* (zoti i qiellit), *En* (emër hyjnie) etj. nuk mund të jetë e saktë, ashtu si dhe për emrin *e premte* kur mendohet ta ketë pasur kuptimin “*mbrëmë*”- “*mbrëmje*”, apo *Prema* (perëndeshë e krijimit dhe e pleshmërisë).¹⁷

Prapashtesa **-të**, si tërë sufiksats jomodifikativë, e përcakton funksionin e temës a të rrënjës: me anë të saj fjala bëhet mbiemërore. Kjo do të thotë se kjo prapashtesë mund t’u shtohet emrit, foljes, ndajfoljes, numërorit themelor, për t’i transformuar në mbiemër. Por të gjithë mbiemrat me prapashtesën **-të** janë mbiemra të nyjshëm, që nuk e shënojnë gjininë me

¹⁶ Shih *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, botim i dytë, Prishtinë, 2005, f. 85-101.

¹⁷ Mendimi tjetër i Kamardës se *e enjte* mund të lidhet me ndajfoljen *ndë* (endë) kundërshtohet edhe nga pengesa të pakapërcyeshme fonetike.

mbaresë, që do të thotë se *-ë*-ja e kësaj prapashtese (*-t-ë*) nuk ishte mbaresë gjinie që të zëvendësohej nga mbaresa *-e* (*-t-e*), por ishte pjesë e prapashtesës. Si e tillë ajo nuk do të kishte arsye të kalonte në (*-t*)-*e* tek emrat e ditëve të javës *e enjt-e*, *e premt-e*, të cilët formën më të lashtë e kanë me *-t-ë*, ku *-ë*-ja zbulohet si mbaresë gjinie me faktin se është zëvendësuar nga mbaresa *-e*. Tek emrat e gjallesave, që nuk kanë edhe përdorim mbiemëror si p.sh.: kunat-ë, zog-ë, plak-ë e ndonjë tjetër, *-ë*-ja është vetëm sufiks feminativ e jo edhe mbaresë gjinie, prandaj nuk është zëvendësuar nga mbaresa dhe sufiksi feminativ *-e* si te fjalët bikategoriale emër-mbiemër, që shënuam: *fisnike*, *punëtore*, *mike* etj. Nga kjo që u tha shihet se tek *e enjte*, *e premtë* (apo *e enjëte*, *e premëte*) nuk kemi të bëjmë me prapashtesën *-të* mbiemërzuese, siç ka pandehur Çabej,¹⁸ por kemi të bëjmë me një *-t* të rrënjës dhe me *-ë* më të lashtë si mbaresë gjinie, të zëvendësuar më vonë nga mbaresa *-e*, në opozicion me mbaresën zero të formës mashkullore të mbiemrit: *i enjt*, *i premt*. Mbasei askund tjetër nuk është bërë kalimi *-të* > *-te*, pse do të bëhej tek *e enjte*, *e premtë*? Format me *-ë*, që janë përdorur rrallë aty këtu e që përdoren në çamërishte e në Salaminë, mendoj se nuk duhet të konsiderohen trajta që e kanë ruajtur formimin e lashtë me mbaresën *-ë* të gjinisë, mbetur pa u zëvendësuar nga mbaresa *-e*, por duhet të konsiderohen të përfutuara vonë në këto të folme për analogji me emrat e ditëve të tjera të javës: *e hënë*, *e martë* etj.

Kështu përjashtohet edhe mundësia që këta emra të ditëve të javës të lidhen me numërorët *e parë* (*e parmë* për *e premtë*), siç ka menduar Mjeda, apo shumë më herët Kamarda nga *promos*, *pramos*, *ένη* (tre), siç ka menduar Çabej për *të enjten* dhe *προπο-* (pesë), siç ka menduar Oštir-i për *të premtën*.

Pengesë për të pranuar etimologjitë e Çabejt e të Oštir-it nga numërorët e shënuar është edhe fakti që dy ditë njëra pas tjetrës *e enjte*, *e premtë* nuk mund të lidhen njëra me numrin *tre* e tjetra me numri *pesë*. Edhe për këtë arsye së paku njëra prej tyre është e pasaktë. Lëre që shënimi me numrat *tre* e *pesë* nënkupton se *e enjte*, *e premtë* janë krijuar kur u krijua java shtatëditëshe, gjë që për gjuhën shqipe, siç u shënuar, del e pambështetshme.

¹⁸ Po aty.

Emërtimi i ditëve të javës me numërorë do të kishte qenë kriter, që do të thotë se kështu do të ishin krijuar edhe ditë të tjera dhe zëvendësimi me fjalët e latinishtes do t'i kishte përmbledhur të gjitha. Kështu edhe nga kjo anë shënimi me numërorë i ditëve të javës në gjuhën shqipe del i paqenë.

Oštiri tingullin *-t-* tek *e premtë* nuk e konsideroi prapashtesë, gjë që, siç thamë, është orientim i drejtë për të zbuluar etimologjinë e këtyre dy fjalëve. Oštiri këtë *-t-* e pandehu të përftuar nga emri **ditë** në përngjitje me numrin pesë: **prō/epn > prōm (pn > m) > preme + ditë > premdtë > premtë* (a *e premtë*) si në *so-ditë > sot* me kuptimin **dita e pestë** “Freitag” ashtu *si edhe te e kremtë* (apo *e kremte*) me kuptimin **ditë feste** “Feiertag”.¹⁹ Kjo etimologji e Oštirit për **të premtën** është ndërtuar nga disa supozime të paarsyetueshme: kështu, për të përftuar tingullin *-m-*, formës *prō/ep-* iu desh t'i shtonte *në-në* e kallëzores së shquar njëjës **prō/ep-n-* pasi në shqipen *pn > m* si te **supno- > gjumë* etj. Praninë e mbaresës së kallëzores së shquar *-në* e kishte menduar H. Pedersen për emrin e ditës **e diel**. Ai shënoi: “*tā diel’ā* përket te *diel*, ngase *tā hānānā* është thjesht akuzativi i *hānā*, kështu në *diel’ā* s’mund të pritët gjë tjetër pos akuzativit *diel*, pra **dielnā*. Emrat e ditëve të javës zakonisht dalin si përcaktorë të kohës në akuzativ; forma nominative *e diel’ā* është natyrisht formë e re . *tā diel’ā* është rasti i vetëm i ndërrimit mes *l* e *l’* në deklinacion”.²⁰

A duhet të trajtohet kështu edhe përfitimi i formës **diel** (diellnë > diel) për **diell**, që dëshmohet në të folmet e fshatrave të Atikës: Kouvarás, Kioúrka, Áno Liósia, Mándra etj.²¹ e në të folmen e Falkonarës të Provincës së Kozencës?²² Kjo formë ka një difuzion tepër të kufizuar, larg fushës së gjerë dialektore të formës *e diel(ë)*, prandaj duket se në të folmet e shënuara është përftuar nga ndikimi i formës së ditës **e diel: diell** → **e diel:**

¹⁹ Arhiv, II, 1925, f. 182-3.

²⁰ H. Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2003, f. 39.

²¹ Shih E. Hamp, *Mbi dialektet arvanitase të Atikës dhe të Megaridit në Linguistique balkanique, III*, Sofija, 1961 e në *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, 2007, f. 243.

²² M. Camaj, *Die albanische Mundart von Falkonara. Albanese in der Provinz Cosenza*, München, 1977.

diel. Neve na duket se vetëm kështu mund të sqarohet pse nuk u bë kalimi -ll > -l edhe tek emrat e tjerë si *miell*, *qiell* etj.

Përveç formës **e diel** (*e diellë*) përdoret edhe forma **e dillë**, **dita e dillë** në gegërishten verilindore e në mjaft të folme të gegërishtes. Kjo duhet konsideruar formë primare (**e diellë**) e pandikuar nga forma e shënuar e kallëzores. Forma me **-ll-** është ruajtur edhe në disa të folme arbëreshe, si p. sh. në të folmen e Qanës (rrethi i Kozencës): **e djella**,²³ **e diela**, **t' diellen**, **e diell-ja** – në Provincën e Potencës – Kalabri.²⁴

Duke qenë pra se forma **e diel** është më e re se **e diellë** dhe jo e tërë shqipes, mbaresa e kallëzores së shquar njëjës **-në** nuk mund të ishte shtuar në kohë aq të lashta sa pretendohet me formën ***prō/ep-n-** për të *premtën*. Si mbaresë shquarësie **-n-ja** është përfutur, siç dihet, përmes fazave **-nt-** > **-nd-** > **-nn-** > **-n**, kështu që në kohën e formës së menduar nga Oštir-i ***prō/ep** kjo mbaresë shquarësie e kallëzores nuk mund ta ketë pasur formën **-n**.

Pse formës së evoluar të kallëzores, që, sipas Oštir-it, qenka përgjithësuar për të gjitha rasat (**të preme**, **e preme**) iu përgjiti emri **ditë** e jo edhe emrave të tjerë të ditëve të javës? Përngjitja e emrit **ditë** do të mund të pranohej vetëm po të ishte realizuar me të gjithë emrat e ditëve të javës pa përjashtim, sepse do të përdorej në bashkëvjajtje me shënuesit e të gjitha ditëve, ashtu siç ka ndodhur në gjuhët neolatine (kujo: fr. *lundi*, *martedi* etj., ital. *lunedì*, *martedì* etj.) dhe atëherë nuk do të kishte mundësi që të përdorej prapë emri **ditë** me ta. Nga ana tjetër përngjitja e emrit **ditë** nuk do të mund të bëhej në kohë aq të largët - para krijimit të ditëve të javës.

Fjala **pesë** është çmuar si fjalë e trashëguar nga gjuha e lashtë ie. ***penk^ue-** apo si refleks i një forme parashqiptare ***penk^wtja** a ***pe(n)ktjũ** dhe nuk shihet arsyeja që të ketë pasur edhe një fjalë tjetër për numrin **pesë**, fjalën **πρῶτο-** të dakishtes. Edhe numrin **tre** shqipja e ka të trashëguar nga

²³ *Dialektologjia shqiptare* VI, f. 460.

²⁴ M. Camaj, *La parlata arbëreshe di San Constantino albanese in Provincia di Potenza*, 1993, f. 201 dhe Pasquale Sentari, *Il lessico della parlata arbëreshe di San Constantino*, 2002.

gjuha e lashtë indoevropiane **trej-es*,²⁵ kështu që s'ka pasur pse ta huazon-te nga greqishtja si numëror. Kjo fjalë mund të ishte huazuar si shënuese e një dite të javës pa lidhje me kuptimin e numrit tre. Po atëherë do të duhej pranuar e pamundura se disa emra ditësh u huazuan nga latinishtja, kurse kjo nga greqishtja. Nga ana tjetër kjo sjell edhe nevojën e arsyetimit të zorshëm që java të ketë filluar nga e marta.

V. Orel në fjalorin e tij etimologjik të shqipes²⁶ për *të enjten* ka pranuar mendimin se kishte një formë më të lashtë *enjtë* si mbiemër me -*të*. Ai thotë se kjo “duket të jetë përkthim nga latinishtja i *Jovis dies*, kështu që *enj-* i shqipes “duhet të jetë një ekuivalent i hershëm në shqip i Jupiterit”. Ai shënon supozimin e Treimer-it se kjo fjalë “është vijuese e parashqipes **agni*, që reflekton formën arkaike indoevropiane të fjalës “zjarr”. *Të premtën* (f. 343), që del edhe në format *e prempete*, *prende* e konsideron deverbativ nga *premtoj* që kishte kuptimin e padëshmuar “parashikoj, përgatis më herët” dhe paraqet një përkthim të greqishtes *παρασκευή* “të bëhet gati, të përgatitet”.

Siç u pa, ne i konsiderojmë të pasakta etimologjitë e gjertanishme për emrat e ditëve *e enjte*, *e premtë*, por, përveç përcaktimit si më sipër të kahjeve të hulumtimit që nuk japin rezultat në përcaktimin e origjinës së tyre, edhe vetë nuk jemi në gjendje t'i sqarojmë.

Përftimi i emrave të ditëve të javës na shpie në një kohë të largët, kur fleksioni nominal i shqipes ishte tepër i ndryshëm nga ky i sotmi a i shqipes së fazës së dokumentuar.

Të gjithë emrat e ditëve të javës në shqipen janë funksionalisht mbiemra. *Dita e hënë, dita e martë, e hëna ditë, e marta ditë, e hënë, e martë, e hëna, e marta etj. ashtu si dita e mirë, dita e mbarë, e mira ditë, e mbara ditë, e mirë, e mbarë, e mira, e mbara etj.* Këto forma, duke shënuar ditët e javës, janë të seleksionueshme nga emri *ditë*, prandaj kanë gjini të fiksuar si mbiemra vetëm të gjinisë femërore.

²⁵ Për origjinën e këtyre numrave shih edhe B. Demiraj, *Sistemi i numërimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997.

²⁶ Orel, Vladimir: *Albanian Etymolog Dictionary*, Boston – Köln, 1998, f. 88

Pedersen i vlerësoi se fillimisht emrat e ditëve të javës kanë qenë emra në rasën gjinore.²⁷ E. Çabej e kundërshtoi këtë vlerësim: “mendimi i tij që të *dielë* të ketë dalë nga genitivi të *diellit*, nuk është i drejtë. Emrat e ditëve të javës në shqipen nuk janë genitive, po mbiemra: *e diel* është një elipsë e *ditë e diel* etj.²⁸ Nga kjo duket se Çabej konsideroi që edhe burimisht ishin mbiemra, gjë që është e paqëndrueshme, përveç *e enjte*, *e premte*, që ne i konsiderojmë që burimisht ishin mbiemra. Vetë Çabej, siç shënuam, është shprehur se gjuha shqipe i ka krijuar emrat e ditëve (ditë) *e diel*, (ditë) *e hënë*, pas latinishtes *dies Solis*, *dies Lunae*. “Pas latinishtes” do të thotë se edhe shqipja i ndërtoi duke e respektuar vlerën gjentivale të këtyre emrave të përveçëm me mjetet e veta, d.m.th. duke e ruajtur kuptimin: dita e Diellit, dita e Hënës. Forma e gjinore së asaj kohe të fjalëve *diell* e *Hënë* ndikoi që të perceptohen si forma të gjinore në gjuhën shqipe edhe emrat e përveçëm Mart, Mëkur, Saturn, që nuk i kishte shqipja, prandaj emrat e tyre do të vinin edhe në gjuhën shqipe në formën e rasës gjinore të atëhershme, si ditë që u takonin këtyre emrave të përveçëm.

Mendimin se kemi të bëjmë edhe fillimisht me mbiemra Çabej e shoqëroi edhe me renditjen *dita e hënë*, *dita e diel* etj. si dhe në latinishten: *dies Lunae*, *dies Solis* etj. Gjuhët neolatine i kanë ditët e javës të përfutuara nga renditja *Lunae dies*, *Martis dies*, *Merkurii dies* etj. në latinishtë. Rënditjen Emër – Mbiemër dhe Emër – Emër në gjinore të re (të sotme) shqipja e ka krijuar pas përfundimit të huazimeve latine,²⁹ kështu që ndikimi i latinishtes është më i lashtë, sepse do të vinte përmes renditjes Emër në gjinore – Emër, që e kishte atëherë edhe shqipja.

Ndërkaq edhe mendimi i Pedersenit se p.sh. *e dielë* ka dalë nga forma e gjinore *e diellit* nuk mund të qëndrojë, sepse kalimi i formave *e diellit*, *e hënës*, *e martit*, *e mërkurit* etj. në *e diellë* (> *e dielë*), *e hënë*. *e martë*, *e mërkurë* etj. s’ka pasur mundësi të bëhej. Këtu nuk mund të bëhet fjallë pra kurrsesi për rënie të tingujve: *e Diellit* → *e dielë*, *e Martit* → *e martë*

²⁷ Shih *Tekste shqipe me Glosar* në Holger Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, f. 286.

²⁸ E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1976, f. 125.

²⁹ Shih *Rruga...*, f. 346

etj. Kështu emrat e këtyre ditëve të javës nuk mund të jenë përftuar nga gjinorja që ka shqipja e sotme. Ata na shpien në kohën para krijimit të gjinorës së emrave të formuar nga nyja + forma e dhanores.

Emrat e pesë ditëve të javës janë të formuar nga emra të përveçëm të gjinive të ndryshme edhe në gjuhën shqipe (khs. Mars – Martis: Marti, Mercurius: Mërkuri, Saturnus: Shtuni, Dielli, Hëna), kështu që nyja e përparme, që del vetëm në gjininë femërore, nuk ishte e akordueshme me gjininë e këtyre emrave. Kjo do të thotë se kjo nyjë nuk ishte nyjë e tyre. Ajo kështu ekspozohet si nyjë shquese e emrit *ditë* e vendosur në distancë me të me ndërhyrjen e këtyre emrave të përveçëm. Kur nuk përdoreshin këta emra, nyja e qëndronte para emrit *ditë* në të gjitha format e paradigms: *e ditë = dita, së ditë = ditës* etj.

Këta emra e zbulojnë pra gjendjen kur nyja para tyre ishte nyjë shquese e emrit të përcaktuar (*ditë*) e kur ky emër i përcaktuar qëndronte prapa emrit përcaktues:

e | Hënë | ditë, e | Mart | ditë, e | Diell | ditë etj. me kuptimin *dita e Hënës, dita e Martit, dita e Diellit* etj.

Emrat *Hënë, Mart, Mërkur, Saturn, Diell* në këtë funksion të përcaktuesit, të cilin te dëftorët e realizonte forma e dativit adnominal: *e | tuj | shtëpi* etj., tregojnë se shqipja në këtë kohë nuk kishte fleksion mbaresor emëror, që do të thotë se i kishte humbur mbaresat rasore indoevropiane e nuk i kishte krijuar ende ato që i ka sot. Ky funksion realizohej nga renditja e detyrueshme para emrit të përcaktuar. Nga kjo pozitë e këtyre emrave dilte kuptimi përcaktues i përkatësisë, i cili me emra të përgjithshëm do të mund të realizohej vetëm me prani të nyjës shquese a të përcaktorëve të tjerë. Meqë nyja shquese ishte krijuar, gjë që dëshmon nyja e emrit të përcaktuar që është emër i përgjithshëm (*ditë*), këta emra tregojnë gjendjen kur nyja shquese ende nuk përdorej me emra të përveçëm, e cila do të dilte në atë kohë në pozitë të përparme: *e | së Hënë | ditë, e | të Mart | ditë* etj. (= *dita e Hënës, dita e Martit* etj.). Edhe mospërdorimi i nyjës shquese me këta emra flet për një kohë mjaft të hershme të huazimit nga latinishtja. Mbasi *e*-ja nuk ishte nyjë e këtyre emrave të përveçëm, kontakti i saj me këta emra mund ta shprehte funksionin përcaktues adnominal të tyre, sepse kjo nyjë shquese e mbante të katalizueshëm emrin *ditë*, të cilit i takonte, kështu që ai mund të mos përdorej,

d.m.th. mund të figuronte me ekspresion zero: **e Mart** \emptyset (= e Martit) etj. Nga kjo mundësi, si me të gjitha rastet e dativit përemëror adnominal, ishte hapur rruga për kalimin e kësaj nyje në një të përparme pa efekt shques, siç është paraqitur në veprën Rruga ... (ff. 452-462). Me emra të përgjithshëm konstruktet e tilla me një zero të emrit përcaktues e të përcaktuar kalonin në kompozita të tipit *mëmëdhe, atdhe, hekurudhë* etj.

Emrat e ditëve të javës tregojnë se nyja shquese e emrave përcaktues të përveçëm (Mart, Mërkur etj.) nuk u përdor gjithë kohën sa ishte prepozitive ndaj emrit, d.m.th. edhe kur nyja kishte kaluar në përdorim edhe me emra të përveçëm jashtë këtij përdorimi përcaktues gjenitival. Kontakti i nyjës **e** me këta emra kishte mbetur që atëherë i pacenueshëm në vazhdim të gjendjes së shënuar origjinale, kështu që bashkë erdhën e përbënë një konstrukt sintagmatik arkaik, jashtë zhvillimeve sistemore që ndodhnin në segmentet e sintagmës nominale.

Kontakti i këtyre emrave me nyjën mbeti i pacenuar edhe nga shkakku se me këta emra, si të përveçëm që ishin, nuk përdorshin mbiemrat (apo kishin përdorim përjashtimor), të cilët do ta prishnin që në fillim këtë kontakt, ngase do të qëndronin para këtyre emrave e prapa nyjës **e**. Dihet se edhe gjuhët neolatine, përveç portugalishtes, në formimin e emrave të ditëve të javës: it. *lunedì, martedì, mercoledì* etj., fr. *lundi, mardi, mercredi* etj. nuk e lejuan përdorimin e nyjave bile as me emrin *ditë* në vijim të gjendjes në latinishte. Por kur nyja **e** e humbi kuptimin konkretizues ndaj emrit *ditë* e kur ky kuptim u ruajt vetëm në kontakt me emrin përkatës, d.m.th. kur u krijua renditja **e hënë e ditë, e mart e ditë, e mërkur e ditë, e diell e ditë** etj., format **e hënë, e mart, e mërkur, e diell** nuk mund ta kishin më interpretimin si gjinore, sepse kishin mbetur tepër të dallueshme nga gjinorja e të gjithë emrave të tjerë, d.m.th. edhe nga gjinorja e këtyre emrave të përveçëm kur nuk ishin të lidhur me emrin *ditë* (khs. *e hënë* dhe *e së Hënë* “e Hënës”, *e mart* dhe *e të Mart* “e Martit” etj.). Këto forma, që tani nuk ishin më gjinore të emrave të përveçëm, shënonim ditët e javës. Në krahasim me grupin nominal të kësaj kohe: **e mirë e ditë** etj., **e hënë** në **e hënë e ditë** funksionalisht do ta kishte vlerën e mbiemrit, sepse tani mund të interpretohej vetëm si segment që ishte në të njëjtën rasë me emrin pasues, gjë që e siguronte forma e njëjtë e të dy nyjave: **e (hënë) e (ditë)**: e para - një e përparme pa efekt shques, që bënte që **hënë** të mos shënonte

më *Hënën*, por ditën *e hënë*, e dyta - një shquese prepozitive: *e ditë* = *dita*. Nga kjo kohë ato do të ndjekin zhvillimin që e pësojnë mbiemrat:

e mirë e ditë → *e mira ditë*

e hënë e ditë → *e hëna ditë*,

prandaj do të imponohej edhe një adaptim përkatës i temës sipas gjendjes të mbiemrat nën presionin e nyjës së përparme *e*: temat që përfundonin në bashkëtingëllore, si pasojë e burimit të tyre nga emrat e gjinisë mashkullore, morën një *-ë*: *e mart* → *e martë*, *e mërkur* → *e mërkurë*, *e shtun* → *e shtunë*, *e diel* → *e dielë* (ortografisht: *e diel*). si mbiemrat e tipit *e mirë*, që e realizojnë gjininë vetëm me anë të nyjës, pa dyshim nën ndikimin e trajtës së shquar: *e marta*, *e mërkura* si *e hëna* që u krijua pas aglutinimit të nyjës shquese.

Këto forma të shquara e të pashquara kishin kuptim sintagmatik, sepse përmbanin kuptimin e emrit *ditë*: është *e hënë*, *e hëna* etj. dhe prandaj janë shënuesë të ditëve të javës përmes funksionimit si mbiemra të substantivuar.

Emrat e ditëve *e enjte*, *e premte* nuk kanë rrjedhur nga gjinore emrash, siç mund të përfundohet nga sa u tha më lart. Ato janë formuar nga mbiemra që në kohën kur nuk ishin bërë ende të nyjshëm, d.m.th. që në kohën kur qëndronin para emrit *ditë* dhe pas nyjës shquese të këtij emri, e cila gradualisht e humbi fuqinë shquese dhe u bë një e përparme e mbiemrit, siç është trajtuar detajisht në veprat *Rruga* dhe *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*.

Si përfundim po shënojmë se emrat e ditëve të javës tregojnë se u formuan kur:

1. Shqipja e kishte krijuar një shquese.
2. Nyja shquese ishte prepozitive.
3. Nyja shquese nuk përdorej ende me emra të përveçëm.
4. Shqipja nuk kishte fleksion dezinencial rasor.
5. Shqipja kishte një fleksion rasor të përemrave dëftorë e si pasojë edhe të nyjave, që realizohej jo me mbaresa, por me modifikim të temës.
6. Këta përemra nuk kishin formë të gjinores. Në vend të saj përdorej dhanorja në funksion adnominal.

7. Emrat e përgjithshëm në funksion të përcaktuesit dilnin me formën e nyjës në dhanore (*e* | *të djalë* | *shtëpi, i* | *së vajzë* | *vëlla* etj.), apo edhe të dëftorit në funksion limitativ (*e* | *(kë)tij djalë* | *shtëpi, i* | *(kë)saj vajzë* | *vëlla* etj.).

8. Renditja e segmenteve të sintagmës nominale ishte e detyrueshme: nyjë shquese (e emrit të përcaktuar) – emër përcaktues – emër i përcaktuar.

9. Renditja midis nyjës dhe emrit të përcaktueshëm i bënte këta emra të përveçëm përcaktues të emrit pasues me kuptim të përkatësisë: *e* | ***Hënë*** | ***ditë***, *e* | ***Mart*** | ***ditë*** etj. (= *dita e Hënës, dita e Martit* etj.).

10. Nuk ishte krijuar nyja e përparme e mbiemrit dhe e gjinores.

VËSHTRIM KRAHASUES I SISTEMIT RASOR TË “MESHARIT” ME TIPAT E TJERË TË SISTEMIT RASOR TË SHQIPES¹

Rindërtimet e sistemeve të gjuhës janë gjithnjë hipotetike dhe trajtimi shkencor i pranueshëm i bën ato vetëm të mundshme. Në shqyrtimin e zhvillimit të sistemit rasor të shqipes, bazuar në teorinë e Hjelmslevit për kategorinë e rasave, na ka rezultuar se ishte ende një sistem unik për tërë shqipen mjaft kohë para “Mesharit” të Gjon Buzukut e të Katekizmit të Lekë Matrëngës, pas aglutinimit të nyjës shquese, pas përngjitjes mekanike të nyjës në sintagmën gjenitivale – ablativale e në kallëzoren parafjalore të pashquar dhe pas kalimit të përemrit *si*, *so* në invariant të rrjedhore së dëftorit. Ky tip përbëhej nga pesë rasa me këto korelacione:

Rrjedhorja, që shënonte kuptimin e largimit pa drejtim, përbënte rasën pivot të këtij sistemi, rasën më intesive, termin alfa (α) dhe përcaktonte orientimin negativ të sistemit edhe pse në përdorim adnominal si segment epitetik shënon kuptimin neutral (të qëndrimit).

Dhanorja si kundrinë e zhdrejtë shënonte një kuptim afrimi mjaft të zbrazët. Si SP dilte me kuptim prosekutivi dhe hynte kështu edhe në fushën e afrimit e të largimit. Si SP ajo ishte edhe allative (shkoi | afër/ para/ pas | shtëpisë) kryqëzuar me kuptimin e qëndrimit (është/ rri | afër/ para/ pas | shtëpisë). Kështu dhanorja, duke u shtrirë në të tri fushat e dimensionit të drejtimit, vinte theks mbi fushën e afrimit, prandaj përbënte termin opozitar ekstensiv A të këtij sistemi.

Emërorja me funksionin e kryefjalës shënon kuptimin e largimit e me funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit – kuptimin e afrimit. Në këtë kohë emërorja ishte futur edhe në SP në relacion solidariteti me parafjalët [kaha / kah – nka, te, tek, tu, tuk], duke dalë në të tri fushat kuptimore të drejtimit. Me funksionin e kryefjalës emërorja vinte theks mbi kuptimin e

¹ Në tryezën shkencore për 450-vjetorin e “Mesharit” – Prishtinë.

largimit, prandaj, duke qenë rrjedhorja term intensiv alfa i sistemit, emërorja është termi intensiv beta (β).

Kallëzorja në funksion të kundrinës së drejtë shënon kuptimin e afrimit, kurse në funksion të kundrinës partitive - kuptimin e largimit, ndërsa brenda SP e lejonte vetëm relacionin me parafjalët që shënojnë kuptimin e afrimit e të të qëndruarit. Shihet kështu se kallëzorja theksonte kuptimin e afrimit përkundër kuptimit të të qëndruarit e të largimit, prandaj përbënte termin opozitar ekstensiv B të këtij sistemi.

Gjinorja përmbledh të tri fushat e zonës kuptimore të drejtimit. Kështu përveç përkatësisë (afrim), ajo shënon origjinën e prejardhjen (largim), “subjektin” e segmentit *regens* (largim), “objektin” e të njëjtit segment (afrim), funksionin e gjinore atributive me kuptim të fushës neutrale. Gjinorja përqendrohej në fushat e afrimit e të largimit përkundër fushës neutrale, duke përbërë kështu termin kontradiktor gama (γ) të këtij sistemi njëdimensional.

Ky sistem rasor la mundësi të zhvillimeve divergjente të sistemit. Sintagmat parafjalore që, përveç rrjedhore kishin brenda edhe emëroren, dhanoren e kallëzoren, dilnin, siç u pa, edhe në fusha të njëjta të dimensionit të drejtimit, d.m.th. se në atë pjesë të funksionit të tyre ishin variante të lira.

“Meshari” i Buzukut dhe “E mbsuame e krështerë” e Matrëngës (me opus të kufizuar gjuhësor) dhe gjuha e autorëve pas tyre tregojnë se të dy dialektet e shqipes kishin marrë kahje të ndryshme në zhvillimin e sistemit rasor, duke arritur të kenë sisteme të ndryshme në shek. XVI – XVII - XVIII. Gegërishtja e toskërishtja kishin favorizuar SP të ndryshme për të shprehur kuptime të njëjta.

“Meshari” tregon se gegërishtja e kishte përforcuar përdorimin e SP ablativale me parafjalën *prej* (te Buzuku më shumë me parafjalën *ën*, me të cilën ai, të thuash, e përjashton përdorimin pa parafjalë, çka nuk mund të jetë realitet i gegërishtes së kohës. Shumë të rrallë janë shembujt si *nxjermë ansish qi muo më kanë ngjëruom*. Parafjalën *ën* ai e përdor edhe për kuptime të tjera jashtë kuptimit të largimit: *ki mëshërier ën nesh...; ën meje; Më ra ndë mend ën ditësh plaka* etj.). Përmes këtij prioriteti të theksuar të

përdorimit të SP ablativale ndaj SP së emërores me parafjalën *kaha, kah (nga)* në kuptim largimi, përfutur nëpërmjet funksionit të prosekutivit, u arrit që në gegërishte, siç shihet te “Meshari”, rrjedhja me parafjalët *prej* dhe *ën* të përdoret në vend të kësaj emëroreje edhe kur shprehte kuptimin e afrimit: [*e se ma do me klenë prej dreqit se prej Krishtit; E si u ba prej nate; ata sytë e tu të përmishërieshim prej nesh kthe; ktheu prej meje, o Zot: e u kthye prej gruojet; mos e kthe faqenë tande ën meje etj.*], pa e neutralizuar përdorimin e SP nominative me *kaha(kah) etj.*, në kuptimet e tjera. Mospërdorimi te Buzuku i kësaj parafjale po ashtu nuk e shpreh gjendjen e gegërishtes së kohës. Të qenit e *kah* si ndajfolje te “Meshari” [*Kah vjen këta qi e ama e Tinëzot vjen tek u?*] na duket se e përjashton mundësinë të mos ketë qenë edhe parafjalë paralelisht me te – tek: *tek u etj.* (Në gegërishten në kuptim largimi kjo parafjalë ka mbetur tepër reliktoze). Siç ka konstatuar A. Xhuvani, parafjala *prej* nuk e kishte as nuk e ka në toskërishten kuptimin e afrimit. Kjo vlerë antonimike e parafjalës *prej* në gegërishten shënon ekstensivim të rasës rrjedhore në tërësi.

Toskërishtja kishte shkuar duke e zgjeruar përdorimin e SP nominative me parafjalën *kaha, nka* në fushën e takimit me rrjedhoren, duke e reduktuar përdorimin e rrjedhores, por nuk e kishte përjashtuar nga përdorimi edhe pa parafjalë, siç shihet në tekstin e Matrëngës: [u ngre së vdekurëshit; pirosmotë dhënë së tjerësh; se s’ ishte njeri nesh që mkatë s’ka; u anastris mortjet etj.]. Reduktimin e përdorimit të SP ablativale në toskërishten e shpreh edhe fakti që Matrënga nuk e ka parafjalën *prej*, e cila nuk mund të mos ishte e tërë shqipes. Ajo, siç ka shënuar edhe Xhuvani, edhe në toskërishten përdorej baraz me parafjalën *nga, nka*.

Dhanorja allative, e pashkëputur nga lidhja formale kundrinore me foljen kallëzues të tipareve që e përjashtojnë kundrinën e zhdrejtë: [iu afrua | shtëpisë/ lumit/ shokut etj.] e kishte marrë lehtë edhe kuptimin e illativit varësisht nga tiparet kontekstuale të foljes: [iu largua | rrezikut/ të këqiaive; Sdripë malit]etj., duke dalë edhe këtu sinonimike me rrjedhoren: [u largua | fejet/ rreziqesh, shokësh; Sdripë ën malit] etj.). Dhanorja allative i kishte transformuar disa ndajfolje të vendit në parafjalë “të rrejshme”, disa prej të cilave ishin neutrale ndaj fushave të drejtimit: [rri/ shkoi/ iku | larg/ jashtë (muo) dheut; mbrapa (prapa) shtëpisë (përpara muo), vjedmis juve] etj.,

(siç dalin edhe te Buzuku) dhe mund të shtrihen edhe në fushën e largimit, prandaj linin mundësi për të kaluar edhe në reksion me rrjedhoren: [larg shokësh, jashtë shtëpie]- te Buzuku: [ën shtëpie, mbrapa jashtë (prapa) kodre; tue dalë jashtë prej deret; enbas sodi; enbas meje vjen një njeri...; Mbas anso së këqish s'atyne dite] etj. Kjo do të ketë ndikuar që edhe parafjalët e tjera të këtij burimi si **parë**: [parë muo], **pëpara**: [përpara ti, përpara faqesë], **afër**: [afërë shtëpisë, Pashkësë] etj. që nuk mund të dilnin në fushë të largimit, të përdoreshin me rrjedhoren pas Buzukut, meqë të gjitha ishin parafjalë me kuptim të inkoherencës në dimensionin e dytë të sistemit të tyre, ishin parafjalë distance nga objekti. Kështu rrjedhorja me këto parafjalë kishte hyrë sadopak në sinonimi me dhanoren edhe në fushat e afrimit e të qëndrimit.

Në fushat kuptimore të përkimit të dhanores me rrjedhoren gegërishtja e përforcoi përdorimin e rrjedhores, ndërsa toskërishtja – të dhanores.

Kështu në kohën e Matrëngës toskërishtja e kishte lënë rrjedhoren term intensiv alfa si në sistemin që u parapriu të dy dialekteve.

Dhanorja si SP kishte përforcuar neutralitetin ndaj tri fushave të drejtimit, ndërsa jashtë SP-së qëndronte si dhe më parë në gërshetim të fushave të pushimit e të afrimit. Toskërishtja pra e kishte lënë dhanoren edhe më tutje si term më ekstensiv A të sistemit.

Emërorja, që si SP me parafjalën nka (nga) e kishte kuptimin e largimit, pranë kuptimit të afrimit e të pushimit si edhe me parafjalë të tjera, vinte theks mbi kuptimin e largimit edhe me funksionin e saj primar të kryefjalës, duke mos lëvizur nga termi intensiv beta i sistemit rasor.

Kallëzorja mbeti po ajo që ishte në sistemin rasor paraprijës dhe, meqë rrjedhorja ishte edhe tani termi alfa, ajo do të qëndronte në të njëjtin korrelacion, duke përbërë termin opozitar B.

Gjinorja nuk kishte pësuar asnjë zgjerim a përkufizim në rrafshin kuptimor. Pasi rasat e tjera kishin ruajtur të njëjtat relacione midis tyre, gjinorja vijoi të qëndronte term gama e këtij sistemi.

Kështu toskërishtja e kohës së Matrëngës e më vonë e kishte ruajtur

tipin e sistemit rasor paraprijës që që i përbashkët për të dy dialektet.

Gegërishtja e Buzukut dhe e Veriorëve të tjerë zbulon këtë tip të sistemit rasor:

Dhanorja kishte mbetur me kuptim të afrimit si kundrinë e zhdrejtë, kurse si SP e përjashtonte kuptimin e largimit, kështu që ajo ishte tani termi më intensiv alfa i sistemit rasor të gegërishtes.

Rrjedhorja, që me disa parafjalë shprehte edhe kuptimin e afrimit e të të qëndruarit, por që e zotëronte shumë më tepër fushën e largimit, ishte termi më ekstensiv i sistemit rasor të gegërishtes, termi opozitar A. Në “Meshar” ka raste të përdorimit të rrjedhores nën ndikimin e gjuhës nga e cila u përkthye, siç ka shënuar S. Riza, p.sh.: [më dhimbetë ën kso turme = kjo turmë; e kush mund nginjë këta ën kso buke = me bukë; ke kujdes ën shumë kafshësh = për shumë kafshë etj.].

Kallëzorja kishte mbetur me të njëjtat karakteristika: si kundrinë e drejtë shprehte kuptim afrimi, si kundrinë partitive – kuptim largimi e me parafjalë dilte në fushat e afrimit e të të qëndruarit, duke vënë theks mbi fushën pozitive të drejtimit, që do të thotë se në relacion me dhanoren si rasë pivot të sistemit përbënte termin intensiv beta.

Emërorja përbënte termin opozitar B të këtij sistemi, sepse si SP dilte në fushat e afrimit e të pushimit, ndërsa si kryefjalë kuptimin e largimit e bënte dominant.

Gjinorja as në këtë sistem rasor të gegërishtes nuk kishte pësuar ndryshim funksioni e kuptimi dhe mbeti termi kontradiktor gama.

Kështu gegërishtja e toskërishtja kishin tipa të ndryshëm të sistemit rasor në rrafshin e kuptimi në dimensionin e vetëm të drejtimit, që kanë sistemet deri në gjashtë rase.

Në zhvillimin e mëtejshëm të dy dialektet do të ndryshojnë tipin e sistemit rasor, duke dalë me një sistem unik në pjesën më të madhe të të folmeve të tyre. Kjo nuk u shkaktua në rrafshin e kuptimit, por në rrafshin e shenjave, u shkaktua nga zëvendësimi i formës së rrjedhores me formën

e dhanores tek emrat, për arsytet e përcaktuara nga S. Riza,³⁰ nga përputhja fonetike e tri trajtave të njëjësimit mashkullor, femëror e asnjës të lakimit të pashquar, si dhe e dy trajtave të njëjësimit mashkullor e asnjës të të shquarit p.sh.:

prej një djali: një djali, prej një vajze: një vajze, prej një dylli: një dylli; prej djalit: djalit, prej dyllit: dyllit

Nga kjo gjendje, në të cilën “sa herë që, në kuptimin themelor të prejardhjes, rrjedhorja e emrave përdorej në mungesë të çdo parafjale, aq herë të njëjtat trajta: një djali, një vajze, një dylli; djalit, dyllit shërbenin edhe si rrjedhore edhe si dhanore” u kalua në gjendjen kur “...edhe ato trajta të dhanores si: grues(ë), djemve(t), vajzave(t), të cilat nuk përputheshin fonetikisht me trajtat përkatëse të rrjedhores (prej) grueje, (prej) djemsh (it), (prej) vajzash (it), zunë të bëjnë punën e këtyre të fundit; e për pasojë atëherë çkëmbyeshmëria e rrjedhores me dhanoren zuri të bëhet e gjithanshme...”. Ai shënon po me të drejtë se “në kuptimin themelor të rrjedhores, prania e parafjalës *prej* u bë e *domosdoshme* për dhanoren”.

Nga kjo kuptohet pse është ruajtur forma e rrjedhores në përdorim me përemrat vetorë [prej | meje/ teje/ nesh/ jush; afër/ larg | meje etj.] si dhe pse nuk është ruajtur te zëvendësuesit e emrave [prej tij, saj, atij, asaj etj.].

Forma e rrjedhores ka mbetur edhe tek emrat në përdorim adnominal [tufë lulesh, mish viçi/ lope etj.], sepse si tërësisht e pashquar, nuk mund të zëvendësohej nga dhanorja. E këmbëveshme me formën e gjinore: [tufë e luleve(t), mish i viçit, i lopës etj.], për të realizuar opozicionin e shquar ~ e pashquar, ajo në shqipen e sotme është variant i formës së gjinore. Kështu rrjedhorja me të drejtë konsiderohet reliktoe.

Sistemi rasor del pra me një rasë më pak. Kjo natyrisht ka krijuar korrelacione të tjera të rasave të mbetura dhe të dy dialektet kanë tani një tip tjetër të përbashkët të sistemit të rasave:

Kallëzorja është tani termi intesiv beta me theks në fushën e afrimit, që përcakton orientimin pozitiv të këtij sistemi katër rasash, emërorja –

³⁰ Në veprën *Emrat në shqipe: sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*, Tiranë, 1965 dhe në *Vepra* 3, f. 65.

termi opozitar B me theks në fushën negative të drejtimit, gjinorja – që vijon të vërë theks mbi fushat e afrimit e të largimit përkundër fushës neutrale, përbën termin gama. Dhanorja me tri fusha kuptimore vë theks në fushën neutrale të të qëndruarit dhe përbën termin kontradiktor të këtij sistemi:

β Akuzativ

B Nominativ

γ Gjenitiv

Γ Dativ

Mundësia për zëvendësimin e shënuar të rrjedhës me dhanoren ka ekzistuar shumë më parë, prandaj duhet hulumtuar shkaqet që e kanë bërë të realizueshme. Natyrisht është e nevojshme të përcaktohet koha kur u përgjithësua ky tip i sistemit rasor, në cilin nëndialekt u zhvillua më herët dhe si ka shkuar kahja e përgjithësimit.

NJË SISTEMIM I PARAFJALËVE TË SHQIPES

Sistemimi i parë i parafjalëve të shqipes është bërë nga Viggo Brøndal-i më 1940 në veprën *Théorie des prépositions – Introduction à une sémantique rationnelle*.³¹ Brøndal-i i pati në konsiderim parafjalët që i kishte shënuar G. Weigand-i në veprën *Albanesische Grammatik im süddeutschen Dialekt* (Leipzig, 1913). Pasqyrën e sistemimit të atyre parafjalëve sipas teorisë së Brøndal-it e kemi dhënë në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (Prishtinë, 1980). Edhe pse kjo pasqyrë sistemuese ka të meta të shënuara nga ne në këtë vepër, mund të çmohet se parafjalët e shqipes janë trajtuar mbi bazat e kësaj teorie nga vetë autor i saj dhe nuk ka pse të vështrohen rishtas në këtë mënyrë. Pasqyra mund të pastrohet nga ndonjë parafjalë e “rreme” e të plotësohet me parafjalët **te**, **nga** dhe **ndaj**. Parafjala **te** do të kualifikohej si parafjalë transitive simetrike, parafjala **nga** do të çmohej si intransitive simetrike, ndërsa parafjala **ndaj** si asimetrike intransitive.

Në punimin *Parafjalët A*. Xhuvani ka paraqitur në mënyrë shteruese përdorimet e parafjalëve të shqipes nëpër të folme të ndryshme e në tekstet e vjetra. Ai shënoi se shqipja ka 18 parafjalë. Nga kjo listë duhet të hiqen parafjalët **andyy** apo **andyç** dhe **mjet** (mje, mjen, mjeç), sepse, duke qenë në përdorim tepër të kufizuar dialektor, kanë mbetur jashtë përdorimit të përgjithshëm e jashtë gjuhës së sotme standarde. Duhet përjashtuar si e papërdorshme më edhe parafjala **ën**. Xhuvani e ka konsideruar parafjalë edhe pjesëzën **deri** – **gjer** (ashtu si dhe Brøndal-i dhe Weigand-i para tij). Nga bashkimi i dy parafjalëve, që nuk funksionon si ndajfolje, por si parafjalë, Xhuvani ka shënuar me të drejtë parafjalën **nëpër**. Ne jemi shprehur se **kah** dhe **nga** duhet të trajtohen si dy parafjalë të ndryshme.³² Ato burojnë nga forma **kah** si parafjalë e përbashkët për tërë shqipen me kuptim allativi e prosekutivi. Gegërishtja e ruajti edhe formën edhe kuptimin primar të kësaj parafjale. Në toskërishte u krijua forma **nka** që u zhvillua në **nga** që

³¹ Përkthimi frëngjisht më 1959.

³² Shih B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010, f. 181-83.

në kohën e Argjirokastritit dhe mori kuptimin e largimit nga kuptimi i prosekutivit. Kuptimi i prosekutivit është ruajtur në të dy këto parafjalë, por kuptimi i largimit mbeti jashtë parafjalës **kah**, që ka kohë që është vetëm e gegërishtes. A. Xhuvani e E. Çabej në punimin *Parashtesat e gjuhës shqipe*³³ formën **nkah** e sjellin të përfutur nga parafjala **në** në funksion të parashtesës **n-kah**. Kuptimi i largimit, që ka kjo parafjalë, do të mund të kuptohej po të pranojmë se me parafjalën **kah** nuk u bë prefiks parafjala **në** po parafjala **ën** që në kohën kur ishte në reksion me rrjedhoren, d.m.th. kur shprehte kuptimin e largimit. Kjo do të thotë se, mbasi parafjala **kah** në gegërishte nuk e përftoi prefiksin parafjalor **n-**, nuk e mori kuptimin e largimit. Në gegërishten për kuptimin e largimit u përdor parafjala **prej**, e cila e pengoi përgjithësimin e përdorimit të parafjalës **nga** nga toskërishtja.³⁴ Në procesin e përjashtimit të formës **kah** e bashkë me të edhe të kuptimit të allativit, që nuk e mbajti dot aktiv parafjala **nga** në rrugë të përfutur të kuptimit të largimit, toskërishtja hyri në vështirësi të shprehjes së këtij kuptimi me parafjalën **nga**, ashtu si dhe gjuha standarde, në të cilën po ashtu nuk është parafjala **kah**. Për këtë arsye parafjala **kah** në kuptim të allativit bën presion që të bëhet e tërë shqipes, që të bëhet pjesë e sistemit të parafjalëve të shqipes standarde.

Në *Gramatika e gjuhës shqipe* (Tiranë, 1995) **pas/mbas** konsiderohet ndajfolje që del edhe si parafjalë. A. Xhuvani, edhe pse shënon se ajo përdoret edhe si ndajfolje, e pranon si parafjalë të parme. Përdorimi tepër i kufizuar si ndajfolje na lejon ta pranojmë si parafjalë të parme. Për shkak të opozicionit kuptimor të polarizuar me parafjalën **pas/mbas**, edhe fjala **para** del në vlerë të parafjalës, siç janë edhe parafjalët **mbi/nën**. Nga kjo që u tha del se shqipja e sotme ka 16 parafjalë të mirëfillta. Ato janë:

1. në, 2. më, 3. te / tek, tu / tuk (ke), 4. ndaj, 5. mbi, 6. nën, 7. kah. 8. nga, 9. prej, 10. ndër, 11. pas / mbas, 12. para, 13. për, 14. nëpër, 15. me, 16. pa.

L. Hjelmslevi është shprehur se edhe parafjalët sistemohen mbrenda

³³ Studime gjuhësore III, f. 267.

³⁴ Parafjala **prej** është përdorur e përdoret edhe në toskërishte “baras nga kuptimi me parafjalën **nga**”. Shih A. Xhuvani, *Vepra I*, f. 305.

dimensioneve të njëjta semantike si rasat, d. m. th. sipas teorisë së tij lokaliste pankronike për rasat: dimensionin i drejtimit, dimensionin koherencë-inkoherencë dhe dimensionin subjektivitet-objektivitet.³⁵ Hjelmslev-i nuk ka bërë sistemim të tillë për parafjalët, por në procesin e përcaktimit të sistemit të rasave dalin në shesh edhe karakteristikat përkatëse të parafjalëve me tiparet e tri dimensioneve të shënuara. Numri 16 i parafjalëve të shqipes flet se sistemimi i tyre nuk është i kufizuar në dimensionin e parë të drejtimit (afrim – pushim - largim), por shtrihet edhe në dimensionin e dytë, në dimensionin koherencë – inkoherencë. Më poshtë ne do të japim edhe karakteristikat e këtij dimensionin për parafjalët përkatëse.

Metoda imanente, që qëndron në principet e përgjithshme teorike të L. Hjelmslev-it, është realizuar nga Knud Togeby për frëngjishten në veprën *Structure immanente de la langue française* (Paris, 1965). Në këtë veprë autori bën edhe sistemimin e parafjalëve të gjuhës frënge mbi bazën e kësaj metode, që është brenda analizës funksionale. Meqë frëngjishtja nuk ka sistem rasor mbaresor, të gjitha parafjalët drejtojnë rasën “e shkëputur” të përemrave, si p.sh. *chez moi* etj., d. m. th. se nuk mund të klasifikohen duke u bazuar në reksion të parafjalëve, siç është e mundur për gjuhët me fleksion mbaresor rasor. Kështu kjo metodë e aplikuar për sistemimin e parafjalëve të frëngjishtes së sotme mund të përdoret për klasifikimin e parafjalëve të shqipes në kohën kur ajo kishte mbetur pa lakim nominal mbaresor e kur kishte një fleksion tri rasash të përemrave dëftorë e vetorë, realizuar me variacion teme a me tema të ndryshme për emërore, dhanore e kallëzore. Dëftorët në përdorim si mbiemra limitativë (si përcaktues) bashkë me tri format e nyjës shquese, që ishte e paravendosur, i shënonin këto tri rasa të emrit, që realizonin vetëm funksionet abstrakte a gramatikore të fjalisë, që domethënë se nuk dilnin në funksione të sintagmës parafjalore me parafjalë zero (siç dalin sot format e dhanores e të kallëzores: fushave, kodrave, bregut, dimrit, natën, ditën etj.). Në veprën e cituar kemi ardhur në përfundim se të gjitha parafjalët e asaj kohe seleksionoheshin nga rasa kallëzore e realizuar në mënyrën e treguar,

³⁵ *La categorie des cas – Étude de grammaire générale, Première partie*, Acta Jutlandica, VII, 1935.

d.m.th. se në sistemin tri rasash (emërore, dhanore, kallëzore) kallëzorja ishte e vetmja rasë që dilte edhe si SP me parafjalë, të cilat kështu i realizonin funksionet konkrete a lokative të emrit.³⁶ Kjo gjendje është e dëshmuar në kuadër të gjuhëve indoevropiane: në danishte të gjitha parafjalët përdoren vetëm me kallëzoren.³⁷

Kjo strukturë analitike e shqipes shtrihet në tërë periudhën e huazi-meve nga leksiku i latinishtes. Duket se në atë kohë parafjalët kanë qenë në numër më të vogël se në shqipen e sotme. Nga lista e shënuar me 16 parafjalë duhet hequr parafjalët: **te/ tek (tu/tuk)** dhe **kah e nga**, sepse janë përfutur si parafjalë shumë më vonë se ajo kohë e lashtë, janë përfutur në periudhën midis shekujve XIII e XV;³⁸ parafjala *nëpër*, si bashkim i dy parafjalëve, është më e vonshme se parafjalët përbërëse; parafjala **në**, e cila është formuar nga parafjala **ën** me ngjitje të nyjës shquese prepozitive të emri: **ën të pus** → **ëntë pus**, kur parafjala **ën** kishte kuptim vendor inesiv³⁹ dhe u zhvillua në **ëndë – ndë** e prej saj në **në** në kohë krejt të vona.⁴⁰ E përfutur më vonë se kjo kohë është edhe parafjala **ndaj** që është krijuar, siç na njoftojnë etimologët, nga përngjitja e parafjalës **ndë** me emrin **anë**. Kështu për t' u shqyrtuar për atë kohë mbesin parafjalët:

1. ën, 2. më (mbë), 3. me, 4. mbi, 5 nën (ndën), 6 prej, 7. ndër, 8. pas/ mbas, 9. para, 10. për, 11. pa (në format përkatëse të kohës).

Togeby shënon se për frëngjishten është i mundur një klasifikim funksional i parafjalëve, me të cilin ato mund të karakterizohen në rrafshin sintaksor të drejtimit të tyre. Nga ky këndvështrim parafjalët janë të gjitha homonekse (të një lidhjeje të njëjtë), sepse drejtojnë një rasë, por disa janë edhe heteronekse (të një lidhjeje të ndryshme), sepse mund të drejtojnë edhe fjali kompletive të prira nga lidhëza *que*.

³⁶ Shih vep. e cit., f. 180-184.

³⁷ K. Togeby, vep. e cit., f. 187.

³⁸ B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010, f. 181-83.

³⁹ Shih vep. e cit., f. 349-352.

⁴⁰ Shih *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, f. 54.

Për këtë kohë të lashtë të shqipes parafjalë që mund të ishin vetëm homonekse janë parafjalët që edhe sot janë të tilla: **ën, më, me, mbi, nën, ndër** dhe **pa**, ndërsa katër të tjerat janë edhe heteronekse, sepse drejtojnë edhe fjali kompletive që nisin me *që, se, si*: [**para** se të shkonte, **pas** si të vijë, **prej** se ka shkuar, **prej** që vjen rregullisht, **për** që vjen, jam i sigurt, **për** si punon, nuk e di] etj. Në këtë relacion ka hyrë më vonë edhe parafjala **nga**: [kjo sëmundje vjen nga që (nga se) bën vapë] etj., ndërsa parafjala **kah** nuk e ka këtë mundësi, gjë që e mbështet mendimin se janë parafjalë të veçanta. Forma **meqë** është përfutur me shkurtrim të shprehjes: [me qenë që], kështu që parafjala **me** nuk është edhe heteronekse. Togeby ka shënuar se gjuhët e vjetra, gjuhët me fleksion të zhvilluar rasor “nuk kanë pasur parafjalë që të kenë për objekt një fjali” dhe se kjo është karakteristikë e gjuhëve moderne evropiane perëndimore, që paralelisht e kanë humbur fleksionin mbaresor rasor, dukuri kjo që e ka lehtësuar krijimin e konstrukcionit parafjalë + ndajfolje.⁴¹ Funkzioni heteroneks i këtyre parafjalëve të shqipes është përfutur pra në këtë gjendje pa fleksion rasor dezincencial dhe është ruajtur edhe pasi janë krijuar mbaresat rasore që i ka shqipja e sotme dhe, siç pamë, ka kaluar edhe në parafjalën e re **nga**.

Parafjalët **prej** dhe **për** drejtojnë fjalinë e varur të mënyrës dëftore: [**prej** se ka ardhur, **prej** që hyri në shkollë etj.; **për** që vjen e di, **për** që ka ardhur..., për se ka shkuar.. **për** që vinte me kohë...] etj., ndërsa parafjalët **para** dhe **pas / mbas** drejtojnë fjali të mënyrës lidhore: [**para** se të shkonte, **para** se të udhëtojnë, **pas** si (mbas si) të nisen, **pas** si të arrijnë] etj. Nën peshën e sinonimisë me parafjalën **prej** edhe parafjala e re **nga** doli heteronekse para fjalive me folje të mënyrës dëftore: [**nga** që nuk duron, **nga** se vjen vonë] etj.

Parafjalët karakterizohen edhe sipas mundësisë që të realizojnë funksionin e preverbit a të prefiksit, të ndajfoljes e të drejtojnë foljen infinite. Në këtë klasifikim vetëm parafjalët e vjetra **me** e **prej** dhe parafjalët e reja të shqipes së sotme **te/ tek** (tu/ tuk) dhe **kah** janë parafjalë të thjeshta intensive, që nuk dalin në asnjërin nga këto tri funksione.⁴² Të

⁴¹ Shih K. Togeby, vep. e citë, f. 188.

⁴² Parafjala **prej** del vetëm një herë si parashtesë : prej-ardhje. Kështu edhe parafjala

gjitha parafjalët e tjera dalin edhe në funksion të preverbit a të parashtesës:

ën: u n-gjall, n-dryj, n-dore, n-gërdheshem, n-guqem, n-gjerohem etj.;

më: i m-vojtur, më-këmbës, më-dyshje, m-synje, më-ditje, m-burr, mburrja, m-bëltoj, i m-rudhët, m-dore a mbë-dore, mbë-gojcë, m-guri, m-ziu etj.;

mbi: mbi-shkrim, mbi-zotëron, mbi-vlerësim, mbi-emër, Mbi-shkodër, mbi-këqyr, mbi-çmim etj.;

nën: nën-shkrim, nën-toger, nën-vlerësim, nën-kreje, nën-detëse, Nën-shat, nën-darje, nën-çmoj, nën-barkëz, nën-bishte, nën-krejcë etj.;

pas / mbas: pas-nesër, pas-thirrmë, pas-dreke, pas-darke, mbas-andej, pas-luga, mbas-grushte etj.;

para: par-dje, par-mbrëmë, para-ardhës, para-prijës, para-gjykim, para-roje, para-folës, para-derë, para-kalim, para-qes etj.;

ndër: ndër-marrje, ndër-hyrje, ndër-kombëtare, ndër-gjegje, ndër-sej, ndër-gishte, Ndër-fusha, ndër-lidhje, ndër-hyj, ndër-marr, ndër-pres, i ndër-mjem etj.;

për: për-gjegjës, për-mbledhje, për-dorim, për-vetësoj, për-vëloj, për-mirësim, për-jetoj, për-mbajtje, për-mallim, për-ngjitje, për-fytyrim, për-buz, për-gjak etj.;

pa: i pa-aftë, i pa-besë, i pa-ndarë, pa-drejtësi, pa-ngopësi, pa-varësi, pa-mundësi, pa-kujdesi, i pa-fe etj.;

në: në-punësi, i n-gurtë, i n-dritëm, n-gishte, n-dal, n-dreq, n-garkoj, n-xij etj. Ka edhe formime të pakta me formën **ndë** të parafjalës: nd-anë, nd-ujtë, nd-urej.

Vërejtje:

Përdorimin si parashtesë parafjala **ndaj** nuk e ka në gjuhë të popullit.⁴³ Si e tillë ajo del vonë në gjuhë të shkrimit dhe gjithsej në dy terma gramatikorë, që i ka shënuar Xhuvani: ndaj-folje ndaj-shtim. Për këtë arsye ajo është e trajtueshme si parafjalë që nuk ka funksionuar e nuk funksionon si parashtesë. Dy rastet e shënuara për gjuhën e shkrimit tregojnë se ajo mund të aktivizohet si parashtesë. Me dy shembuj të përdorimit si parashtesë: nëpër-këmbje, nëpër-mjet edhe parafjala e përngjitur **nëpër** nuk mund të konsiderohet se është zhvilluar në funksion të parashtesës.

Shembujt e sjellë nga Xhuvani e të shënuar më sipër për funksionin parashtesor të parafjalëve **ën** e **në** sjellin një pasiguri të trajtimit si parashtesim i njëjës apo i tjetrës parafjalë. Dihet se kalimi i parafjalës **ndë** në **në** është mjaft i ri,⁴⁴ kështu që kalimi i saj në parashtesë do të jetë proces i ri e tepër i kufizuar. Përdorimi të Rilindasit e në toskërishte të asaj kohe dhe të autorët e vjetër të parafjalës **ndë** paralelisht me parashtesën parafoljore **n-** tregon se kjo parashtesë nuk mund të jetë e përfutur nga parafjala **në**, sepse nuk mund të mendohet që **ndë** të ketë kaluar në **në** si parashtesë, ndërsa si parafjalë të ketë qëndruar **ndë**. Në shembujt e shënuar për parafjalën **në**: n-gurtë, i n-dritëm, n-gishte, n-grykë – ashtu si dhe në shembujt për parafjalën **ën**: n-gjall, n-dryj, n-guqem, n-gërdheshem, n-gjerohem shihet se kalimi në parashtesë është i lashtë, para se të përfutohej forma **në**. Kështu del se është parafjala **ën** që ka kaluar në parashtesë edhe në shembujt e sjellë për parafjalën **në**, që në kohën kur shënonte kuptimin vendor – të qëndrimit e të afrimit si parafjalë inesive e trashëguar, e një burimi me **εν** të greqishtes, me **in** dhe **en** të latinishtes etj. Shembujt me parashtesën **n-** nga parafjala **ën** janë me dy prejardhje kohore :shembujt: n-dore, n-goje, **n-**duersh, e ndonjë tjetër, janë në formën e rrjedhore, d.m.th. se janë të kohës kur parafjala **ën** ishte në reksion me rrjedhoren dhe shprehte kuptim

⁴³ Xhuvani e Çabej në punimin e shënuar kanë dhënë vetëm këta shembuj: ndajnate, ndajnatëherë dhe me dyshim edhe me iu ndajgjetë.

⁴⁴ Në gegërishten **ndë** ka kaluar në **në** nga fillimi i shek. XVIII, në toskërishten – në përfundim të shek. XIX. Shih veprën *Prapavendosja e njëjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, f. 54.

largimi, kurse shembujt e tjerë tregojnë se janë më të lashtë, se janë të kohës kur parafjala **ën** ishte në bashkëvajtje me kallëzoren, d.m.th. kur e kishte kuptimin e saj primar inesiv që nga origjina.

Funksionimi i parafjalëve të parme si ndajfolje

Parafjalët **kah** dhe **nga** dalin ndajfolje vetëm në përdorim të kufizuar në fjalitë pyetëse: *Kah/ nga erdhën? Kah/ nga po shkoni? etj.* Parafjalët **mbi**, **para** dhe **pas** / **mbas** bëhen ndajfolje kur u përngjitet parafjala **për**: **përmbi**, **përpara**, **përmbas** (përpas). Parafjala **për** bëhet pjesë e ndajfoljes kur bashkohet me pjesë të ndryshme të ligjëratës: **për-mes**, **për-qark**, **për-anë** (pranë), **për-rreth**, **për-pjetë**, **për-poshtë**, **për-sipër**, **për-mbrapa**, **për-mdryshe**, **për-veç** etj. Kur ngjitet me ndajfolje bën përforsim të funksionit të ndajfoljes. Ndajfolje krijohen edhe me parafjalët **mbë** (mbanë), **ndë** (ndanë), **ndër** (ndërmjet, ndër-kaq), **mbas** (mbasandej, pasandej, pas-taj), **para** (parvjet, parmbrem, pardje), **nëpër** (nëpërmjet), Nuk bëhen pjesë të ndajfoljes parafjalët **ndaj**, **në**, **nën** dhe **pa**, bashkë me parafjalët **prej**, **me**, **te**, që, siç u konstatua, nuk dalin në asnjërin nga tre funksionet e shënuara.

Dy parafjalë të përdorura njëra pas tjetrës nuk dalin në funksion të ndajfoljes a të lokucionit ndajfoljor: **nëpër**, **për në**, **për pa**, **për nën**, **për nga**, **për kah**. Nga kjo karakteristikë e përgjithshme del se kalimi në ndajfolje i bashkimit të parafjalës **për** me parafjalët **mbi**, **para** dhe **mbas** / **pas** i nxjerr këto në vlerë të ndajfoljeve, të bashkuara me parafjalën **për** kur ishin ndajfolje, d.m.th. se parafjala **për** ishte në funksion përforsues të vlerës së tyre ndajfoljore. Nga ajo gjendje mund të përfundohet se këto tri ndajfolje dilnin edhe në përdorim si parafjalë (parafjalë “të rreme”) dhe forma e përforsuar e ndajfoljes mbeti formë e vetme e saj, ndërkohë që përdorimi si parafjalë ua humbi përbërësve të dytë (mbas/ pas, mbi dhe para) mundësinë për të funksionuar si ndajfolje. Ne kemi shënuar se **para** dhe **pas** kanë qenë ndajfolje vendi në kohën para krijimit të mbiemrit të nyjshëm dhe se janë bërë parafjalë të kallëzores, siç ishin të gjitha parafjalët e asaj kohe të lashtë.⁴⁵ Nga kjo mund të thuhet se kalimi i tyre në

⁴⁵ Shih veprën *Rruga...*, ribotim, f.182.

parafjalë të “rreme” është edhe para krijimit të mbaresave të reja rasore të shqipes. Këtë vjetërsi të përdorimit të tyre si parafjalë e tregon fakti që janë edhe heteronekse: **para se, pas si** dhe që lidhen me ndajfolje: **pas-nesër, mbasandej, pardje, parmbremë**, që është lehtësuar me humbjen e fleksionit nominal mbaresor.⁴⁶ Nga kjo mund të nxirret një përfundim i rëndësishëm: parafjalët **pas/ mbas, para** dhe **mbi** e **nën** ishin jashtë sistemit të parafjalëve të mirëfillta, që do të thotë se ky sistem nuk kishte parafjalë të dimensionit të tretë: subjektivitet – objektivitet.

Si në funksion të parashtesës, ashtu edhe në funksion të krijimit të ndajfoljeve bashkë me heteroneksitetin e saj parafjala **për** është më ekstensivja. Ajo është parafjala qendrore e sistemit të parafjalëve të shqipes me begatinë e saj të treguar funksionale.

Përdorimi me format infinite të foljes

Parafjala **për** drejton infinitivin: **për me mbjellë, për me pritë** etj. Parafjalë që ka drejtuar folje infinite ka qenë edhe parafjala **me**, e cila, duke u përdorur para pjesores pësore të së kryerës (që u nominalizua), krijoi infinitivin: **me mbjellë** etj. që ishte i tërë shqipes. Të njëjtin particip e ka drejtuar edhe parafjala **pa** në të njëjtën kohë, duke krijuar formën foljore privative **pa mbjellë** etj. Parafjalët **për** e **me** janë bërë pjesë e formave infinite foljore: **me mbjellë, për të mbjellë, me të mbjellë** etj.

Parafjala **tu / tuk** u bë pjesëz e përcjellores **tu-e, tuk-e** (duke), që është e tërë shqipes. Kjo do të thotë se edhe kjo parafjalë, e përfutuar mbasi ishte ndajfolje, ishte e përgjithshme për shqipen. Parafjalët e tjera të emërores te / tek, kah, nga nuk patën përdorim paraprak ndajfoljor, prandaj nuk u zhvilluan në pjesëza të mënyrës përcjellore.⁴⁷

⁴⁶ Shih K. Togeby, vep, e cit., f. 188.

⁴⁷ Shih detajisht në veprën *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, Prishtinë, 1998, f. 124-36.

Tabela e sistemit të parafjalëve sipas metodës imanente

Nexus	Ekstension
Homonekse	Intensive
në, më, te / tek (tu tuk), me, ndaj, mbi, nën, ndër, pa, kah, nëpër.	me, prej, te / tek (tu tuk), kah, ndaj, nëpër.
Heteronekse	Ekstensive
para, pas / mbas, prej, për, nga.	Prefiks
prej, për, nga - me dëftore para, pas / mbas me lidhore	ën, më, mbi,, nën, për, pa, pas / mbas, para, ndër, në.
	Ndajfolje
	Kah, nga për + parafjalë: mbi, para, pas / mbas. për / mbë / ndë / ndër / mbas (pas) / para / nëpër + pjesë të ligjëratës. Nuk bëhen pjesë të ndajfoljes : ndaj, në, nën, prej, me, te / tek.
	Me format infinite
	për + infinitivi i gegërishtes. për, me, pa : pjesë të formave infinite : për të mbjellë, me të mbjellë. tu / tuk - pjesë e përcjellores

Në kuadër të analizës transformacionale gjenerative sistemimi i shënuar me metodën imanente bazohet në tiparet inherente të parafjalëve, të cilat “reduktohen në një sistem të pozicionit e të lëvizjes në një vend apo

në një vend-kohë” si **mbi / nën, para / pas** (mbas). Këtij sistemimi duhet shtuar edhe ndarjen e parafjalëve sipas tipareve kontekstuale vend, mënyrë, instrument, kohë:

[+ vend]: përveç parafjalëve **pa, me** dhe **më**;

[+ mënyrë]: **me, pa**;

[+instrument]: **me**;

[+ kohë]: **para, pas/mbas, prej, me, për, kah, nga**.

Këtu shihet se parafjala **me** është parafjala më ekstensive.

Reksioni i parafjalëve të shqipes së sotme

Me përfitim të mbaresave të reja rasore në mënyrën e paraqitur në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (Prishtinë, 1980) emërorja e kallëzorja dolën me mbaresë rasore zero në njëjës e në shumës, dhanorja e gjinorja dolën me mbaresë të njëjtë në të dy numrat. Gjinorja doli e përftuar nga dhanorja me një të përparme në përdorim adnominal, duke u dalluar kështu nga dhanorja pa këtë një në përdorim adverbial. Gjinorja tërësisht e pashquar: mish **viçi**, lëkurë **lope** në njëjës e tufë **lulesh**, grumbull **njerëzish** në shumës doli edhe në funksion adverbial, në funksion të rasës rrjedhore: doli **feje** u largua **shokësh** etj. Kështu me krijimin e mbaresave rasore sistemi i rasave përbëhej nga katër forma rasore: emërore-kallëzore, gjinore, dhanore e rrjedhore. Në lakimin e shquar, që ishte krijuar më parë, në numrin njëjës emërorja dhe kallëzorja dolën me forma të ndryshme, ndërsa në shumës dolën me të njëjtën formë. Rasa rrjedhore, që buronte nga gjinorja tërësisht e papërcaktuar, nuk kishte formë të shquar, as në njëjës, as në shumës. Mbaresa rasore nuk ishte e aftë të shënonte rasat pa praninë e përcaktorit, të njëjës shquese a të renditjes së detyrueshme, përveç rasës rrjedhore. Paradigma e mbaresave rasore shënon vetëm opozicionin midis termave intensivë: dhanore, gjinore e rrjedhore dhe termave ekstensivë: emërore e kallëzore.⁴⁸

Me përfitim të rasës rrjedhore si SP (sintagmë parafjalore) pa parafjalë (me parafjalë zero): doli **shtëpie**, u nda **shokësh** etj., u krijua mun-

⁴⁸ Shih *Rruga...*, f. 289.

dësia që parafjala **prej** të kalonte nga përdorimi me kallëzoren: doli ***prej shtëpinë, *prej një shtëpi, *u nda prej shokët** etj.,⁴⁹ në përdorim me këtë rasë: **doli prej shtëpie, u nda prej shokësh** etj. Ky kalim u bë për shkak se rrjedhja pa parafjalë dhe parafjala **prej** ishin të barabarta në anën kuptimore. Kjo parafjalë me rrjedhoren kishte funksion dallues për të shmangur çdo konfuzion, kurse me kallëzoren ishte ajo që e shënonte kuptimin e largimit. Kjo qe parafjala e parë që e ndërroi reksionin nga bashkëvajtja me kallëzoren në bashkëvajtje me rrjedhoren e porsakrijuar. Parafjala e dytë që e bëri këtë kalim është parafjala **ën**. Kalimi në përdorim me rrjedhoren u bë me ndryshim të kuptimit të saj primar inesiv të të qëndruarit në kuptim të largimit. Ky ndryshim i reksionit u realizua pra edhe me ndryshim të fushës kuptimore të drejtimit.⁵⁰ Sipas tiparit largim në dimensionin e drejtimit parafjala **pa** do të duhej të kalonte në reksion me rrjedhoren, por ajo nuk e pësoi këtë kalim, për shkak të kuptimit antonimik me parafjalën **me**, që nuk kalon në reksion me rrjedhoren për shkak të kuptimit të afrimit. Këto dy parafjalë i bënë të qëndrojnë në një reksion të përbashkët me një rasë kohezioni që krijon opozicioni i antonimisë. Parafjalë të tilla antonimike edhe në disa gjuhë seleksionohen nga e njëjta rasë, si p.sh. **cum** dhe **sine** në latinishten klasike janë në reksion me rrjedhoren, në latinishten vulgare - me kallëzoren.⁵¹ Mjaft kohë më vonë në reksion të kufizuar me rrjedhoren ka kaluar edhe parafjala **për**, për arsye se në këtë kohë rrjedhja pa parafjalë kishte dalë në pak raste sinonimike me sintagmën **për+kallëzore**, prandaj parafjala **për** u seleksionua në ato raste edhe nga rrjedhja,⁵² por pa pësuar ndryshim kuptimi që e kishte me kallëzoren, me të cilën mbeti në reksion të përgjithshëm me kuptim afrimi. Kështu parafjala **për** u lidh me formën e rrjedhores jo për shkak të kuptimit të barabartë me të. Kjo është parafjala e parë në reksion me dy rase. Parafjalët **para** e **pas** kaluan nga reksioni me kallëzoren në reksion me dhanoren në kohën kur rase dhanore nga kundrina e zhdrejtë doli edhe në

⁴⁹ Në kohën kur me kallëzoren shkonin të gjitha parafjalët pas humbjes së mbaresave rasore.

⁵⁰ Shih lëvizjet transformuese funksionale e kuptimore të kësaj parafjale në veprën e cituar, botimi parë, f. 295-98.

⁵¹ Shih *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, f. 138.

⁵² Shih veprën *Rruga...*, botim i parë, f. 320-21.

funksion të sintagmës parafjalore pa parafjalë, në plotës rrethanor me kuptim të prosekutivit: **shkoi fushës/ fushave/ malit/ maleve** etj. Ndryshimi i reksionit të këtyre parafjalëve u bë, sepse edhe këto parafjalë, ashtu si parafjalët “e reme” të kësaj rase (nga ndajfoljet): **afër, larg, jashtë, brenda** etj. shënonin një distancë vendore nga objekti në dhanore dhe shprehin kuptim afrimi e qëndrimi: [shkoi/ rri larg/ afër/ jashtë shtëpisë etj.: shkoi/ rri para/ pas shtëpisë] etj. SP dativale me këto parafjalë përdoret kur emri shënon cakun e veprimit të foljes a perceptohet si i tillë. SP e dhanores pa parafjalë përmes kuptimit të saj prosekutiv mund të kalonte edhe në kuptim të largimit: [u largua maleve = nëpër male → iu largua maleve, erdhi arave = nëpër ara → erdhi prej arave] etj., duke dalë këtu sinonimike me rrjedhoren. Kështu edhe parafjalët **para** e **pas** dhe parafjalët e “reme” të lidhura me këtë dhanore do të dalin edhe në reksion me rrjedhoren: [para shokësh, pas kodre, para sysh, pas dite] etj., duke u bërë parafjalët e dyta me reksion të dyfishtë.⁵³ Kalimi i këtyre parafjalëve në reksion edhe me rrjedhoren bëhet edhe për shkak të nevojës së kalimit në trajtë tërësisht të pashquar, që nuk e kishte rasa dhanore, e cila në funksion të SP-së doli nga funksioni kundrinor, që nuk mund ta kishte trajtën me një zero: **para shtëpisë** (së njohur) ~ **para shtëpie** (e papërcaktuar), **pas/mbas shtëpisë** ~ **pas/mbas shtëpie**, **para shokëve(t)** ~ **para shokësh/ fushash/, para syve(t)** ~ **para sysh, pas (mbas) shpinës** ~ **pas/mbas shpine** etj. Kështu kalimi nga trajta e shquar në trajtë tërësisht të pashquar realizohej me kalim nga rasa dhanore në rasën rrjedhore.⁵⁴ Edhe këto parafjalë në reksion me rrjedhoren nuk e ndërruan kuptimin që kishin në reksion me dhanoren: **para/ pas** = kuptim afrimi e qëndrimi. Kjo do të thotë se rrjedhorja me këto parafjalë e toleroi edhe kuptimin e kundërt me kuptimin e saj primar të largimit.⁵⁵

⁵³ Shih lëvizjen e këtyre parafjalëve nga funksioni i tyre primar si ndajfolje vendi, *Rruga...*, f. 141, 303, 319.

⁵⁴ Për proceset e funksionimit të njëjës zero edhe në vlerë të njëjës shquese, ashtu si dhe të njëjës -t të shtuar mekanikisht: fejet, trimashit etj. shih vep. e cit, f. 292, 314.

⁵⁵ Këtu fillojnë ndryshimet dialektore të seleksionimit të njëjës a tjetrës rasë për të shprehur të njëjtin kuptim. Shih *Rruga...*, f. 321 e vijim.

Meqë ndajfoljet e shënuara të vendit dolën parafjalë të dhanores, sepse shënojnë pikën e të qëndruarit a të afrimit si dhanorja pa parafjalë. reksioni i tyre me dhanoren është reksioni i tyre i parë. I pasaktë është, prandaj, vlerësimi i Sh. Demirajt se përdorimi i disa parafjalëve ... me format rasore të dhanores ... është një dukuri e mëvonshme⁵⁶ si dhe trajtimi i dhanores në funksion të rrethanorit pa parafjalë e me parafjalë si rasë rrjedhore.⁵⁷

Rasa gjinore nuk seleksionon parafjalë, sepse nuk funksionon si Sintagmë parafjalore. Lokucionet e saj parafjalore janë të atilla që e bëjnë ta ruajë përdorimin e saj adnominal, pasi në këto lokucione gjinorja është në kontakt me një emër në rasën kallëzore dhe segmenti i parë i lokucionit është parafjalë e rasës kallëzore: [me anë të bisedimeve, në drejtim të përmirësimit, për arsye të reshjeve, për shkak të keqpërdorimit] etj. Këtu shihet se burimisht kemi të bëjmë me sintagmën parafjalore të kallëzores me parafjalët **me**, **në**, **për** si në shembujt: [u takua me miq të fëmijërisë, shkeli në prak të derës, u kujdes për përparim të mësimit, arriti në fund të parkut, u shpreh me fjalë të pedagogut] etj., ashtu si dhe me parafjalë të tjera: [pa dëshirë të fqiut, mbi majë të malit, mbë datë të lindjes, nën petk të së mirës, ndër shkaqe përmirësimi] etj. Kështu emri i përcaktuar nga gjinorja, që ishte segmenti konstant i Sintagmës nominale me gjinoren si segment variabil (që mund të mungojë) u tërhoq nga parafjala dhe u bë pjesë e lokucionit parafjalor: SP → parafjalë + SN (me + anë të bisedimeve, për + arsye të reshjeve etj. → lokucion parafjalor + emri në gjinore (me anë + të bisedimeve, për shkak + të reshjeve) etj. Në veprën *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1995 është shënuar se gjinorja e paranyjzuar prapa “parafjalës **me anë**, **me anën** tregon mjet”...se “parafjala **në drejtim** përdoret zakonisht me kuptim synimi a kufizimi”, se gjinorja e prirë nga “parafjala **në sajë** tre-

⁵⁶ *Gramatika historike e shqipes*, Prishtinë, 1988, f. 641.

⁵⁷ Në këtë vepër Demiraj shënon edhe: “Sipas qëndrimit të mbajtur në vëllimin e dytë të veprës *Fon. dhe Gram.*, si funksion i rasës dhanore pranohet vetëm ai i kundrinës së zhdrejtë dhe i ndajshimit të saj; përdorimi i parafjalëve me këtë rasë është përjashtuar, duke e interpretuar këtë rast edhe formën e dhanores shumë me -ve pas parafjalëve si formë të rasës rrjedhore”. Në fusnotë na njofton se “Ky qëndrim është mbajtur edhe nga autorë të tjerë më parë. Kështu janë trajtuar këto forma aty edhe kur përdoren në funksione rrethanorësh pa parafjalë”, f. 652)

gon në përgjithësi shkakun a mjetin”, se gjinorja e prirë nga **në vend** tregon zëvendësim, këmbim e se lokucionet **për arsye** e **për shkak** tregojnë shkak. Kjo do të thotë se gjinorja me këto lokucione parafjalore u transformua funksionalisht në plotës rrethanor. Ky kalim është bërë i mundur për shkak se rasa gjinore me nyjën e përparme e mban në përbërje të saj emrin e përcaktuar nga ajo: [(djali) i fqiut, (vajza) e fqiut, (djali) i lagjes, (vajza) e lagjes] etj., duke përfaqësuar kështu një sintagmë nominale, para së cilës mund të krijohet lokucioni i shënuar parafjalor. Ndërkaq përdorimi i gjinores tërësisht të pashquar, p.sh. [në drejtim përmirësimi, me anë bisedimesh, për arsye përfitimesh] etj. nuk e ka brenda saj emrin e përcaktuar. Kjo gjinore (që në funksion adverbial ka vlerën e rrjedhores) nuk mund të jetë në funksion të saj adnominal pa prani të emrit të përcaktueshëm prej saj, prandaj lidhja e domosdoshme e kësaj forme të gjinores me atë emër e mban emrin brenda sintagmës nominale, duke mos e lejuar krijimin e lokucionit parafjalor, d.m.th. duke e lënë jashtë saj vetëm parafjalën: SP → parafjalë+SN: [në+drejtim përmirësimi, me+anë bisedimesh, për+arsye përfitimesh] etj., siç janë edhe ndërtimet me parafjalë të tjera të kallëzores: [pa+arsye kundërshtimesh, ndër+shkaqe copëtimi, nën+drejtim ekspertësh, mbi+shkaqe lufte] etj. Kështu format e gjinores tërësisht të pashquara nuk kanë lokucione parafjalore. Trajtimin e gjinores së tillë si rrjedhore, d. m. th. si sintagmë parafjalore, nuk e lejon struktura e SP-së së rasës kallëzore.

Lokucionet parafjalore të gjinores përbëhen nga një numër tepër i kufizuar i emrave (te Sh. Demiraj): **anë, arsye shkak, punë**, (te Gramatika I) edhe: **drejtim, vend, sajë** (përcjellë edhe me etj) dhe nga një numër edhe më i kufizuar parafjalësh: **me, në, për**. Ç’është e veçantë te këta emra që ua mundëson kalimin në pjesë të lokucionit parafjalor me gjinoren? Emri **anë** me të tri parafjalët **me, në, për** nuk mund të përbëjë sintagmë parafjalore: **me anë, në anë, për anë**; emrat **arsye** dhe **shkak** përbëjnë SP vetëm me parafjalën **me: me arsye, me shkak**, jo me parafjalët **për** e **në** (për arsye, për shkak, në arsye, në shkak). Emrat **punë, vend** dhe **drejtim** përbëjnë SP me të tri këto parafjalë: [me vend, në vend, për vend; me punë, në punë, për punë; në drejtim, me drejtim, për drejtim]. Këta emra kështu janë si emrat e tjerë që nuk dalin në përbërje të lokucionit parafjalor me gjinoren. Këtu hyjnë edhe emrat **arsye** dhe **shkak** kur shkojnë me parafjalën **me**. Kusht tjetër që këta emra të jenë pjesë e lokucionit të shënuar parafjalor është që të jenë në formë tërësisht

të pashquar. Nga sa u tha mund të nxirret përfundimi: pamundësia e emrave të shënuar për të përbërë SP me parafjalët e shënuara nuk ka mundur të hiqet nga prania e gjinores. Gjinorja e lë të qëndrojë para saj jo si SP që s' ishte, por si një segment përcaktues i saj, d.m.th. formë të SP-së në funksion të parafjalës së përbërë. Tani emrat e shënuar nuk janë në kuptimin primar, por në kuptime të tjera që gjinores i japin funksione të tjera jo përcaktuese që i ka në përdorim adnominal. Gjinorja në këtë kontekst është në funksion të një SN-je që bashkë me lokucionin përbën, siç u tha, plotës rrethor.⁵⁸ Vërtet që përdorimin e gjinores e mundëson emri në lokucionin parafjalor, por nuk e përcakton atë emër, mbasi është jashtë Sintagmës nominale si pjesë e parafjalës së përbërë.

Emrat tërësisht të papërcaktuar që përbëjnë SP me parafjalë nuk bëhen pjesë të lokucionit parafjalor të gjinores.

Parafjalët e rasës kallëzore: [në, me, pa, mbi, nën, ndër, nëpër, më, për] janë parafjalë të parme që shprehin të gjitha kuptim afrimi e të qëndruari në dimensionin e drejtimit. Përrjashtim bën parafjala **pa**, që është antonimike me parafjalën **me**, se shpreh një kuptim të largimit, kështu që ato do të duhej të ishin në reksion të ndryshëm që nga koha kur u krijua Sintagma parafjalore e rrjedhore: parafjala **me** me kallëzoren, parafjala **pa** me rrjedhoren. Arsyen e reksionit të të dyjave me kallëzoren e treguam më lart. Parafjala **në**, që përmban parafjalën vendore **ën** (**ën+të** - njëj shquese e kallëzores) e që e përftoi këtë formë nga forma **ndë** (< **ntë**), e ka trashëguar reksionin me kallëzoren nga parafjala inesive **ën**, e cila, siç u tha, kaloi në reksion me rrjedhoren. Nga parafjalët e kallëzores vetëm parafjala **për** ka reksion të kufizuar me rasën rrjedhore. Kallëzorja funksionon edhe si tërësisht e pashquar: [kam shokë, pash ujç, nuk ka shtëpi, nuk merr qira] etj., prandaj parafjalët e saj nuk dalin edhe në reksion me rrjedhoren, siç dalin parafjalët e dhanores.

Parafjalët e rasës emërore **kah**, **nga**, **te/tek**, **tu/tuk** janë përftuar, siç ka konstatuar H. Pedersen, nga përemra dëftorë lidhorë, që kaluan në ndajfolje përemërore e pastaj në parafjalë. Sipas Pedersen-it "*te prifti* në të vërtetë do të thotë "ku prifti (d.m.th. është)" ... *nga shtëpia* është pra në të vërtetë "prej atje ku shtëpia (d.m.th. është)".⁵⁹ Edhe W. Cimochowski shpreh të njëjtin mendim

⁵⁸ Shih *Gramatika e gjuhës shqipe* I, f. 390.

⁵⁹ *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe*, BUSHT SSHSH, 3, 1959.

për parafjalën **tu**: “*tu shpija e eme në origjinë shënon: aty, ku (është) shtëpia ime*”.⁶⁰ Lidhja e këtyre parafjalëve me emrin në rasën emërore vetëm kur është i shquar a me përcaktorë të tjerë tregon se janë krijuar si parafjalë pas përngjitjes së nyjës shquese. Këto parafjalë shprehin kuptim vendor. Parafjalët **te/ tek** dhe **tu/ tuk** janë sinonimike dhe e gërshetojnë kuptimin e afrimit e të qëndrimit. Pjesëmarrja e parafjalës **tu/ tuk** në krijimin e formës së përcjellores tregon se ishte e tërë shqipes. Kjo kaloi në parafjalë drejtpërdrejt nga funksioni i ndajfoljes, ndërsa parafjala **te/ tek**, nuk u bë pjesëz e përcjellores, sepse nuk kaloi në parafjalë nga ndajfolja, por nga lidhori, siç e përcaktoi Pedersen. Parafjala **kah** dhe forma **nka** e kësaj parafjale, që del te Matrënga e tek arbëreshët e Italisë, tregon se parafjala **nga** e toskërishtes dhe e gegërishtes jugore ka të njëjtin burim. Kështu parafjala **kah** zbulohet si parafjalë që ishte e tërë shqipes. Kuptimet e allativit dhe të prosekutivit, që ka parafjala **kah**, do të kenë qenë kuptime burimore të saj, kështu që kuptimi i largimit, që morën format **nka** e **nga** (< nka), është kuptim i përfutur më vonë. Kështu u bë një dallim kuptimor e si pasojë u përfutuan dy parafjalë të ndryshme dialektore **kah** dhe **nga**. Ne jemi shprehur⁶¹ se kalimin në parafjalë të rasës emërore e ka pësuar forma më e vjetër **kah** që domethënë se forma **nka** (> **nga**) e ruajti funksionin e parafjalës së emërores në toskërishte edhe pasi e mori parashtesën parafjalore **n-** (nka, nga), që, si shënuam, i dha kuptimin e largimit.

Kuptimet e parafjalëve

1. Parafjalët e kallëzores:

Parafjala në (< ën–të) ka trashëguar kuptimin inesiv nga parafjala **ën** kur kjo ishte në reksion me kallëzoren, në të cilën e kishte bartur edhe kuptimin që kishte në reksion të dikurshëm me lokativin (në kohën e mbarësavës rasore të tipit ie.). Kështu parafjala **në** shënon edhe kuptimin interesiv (të qenit brenda) edhe kuptimin interdirektiv (të afrimit kah brendia). Në dimensionin e dytë kjo parafjalë shënon kuptimin e koherencës e brenda saj kuptimin e inherencës.

⁶⁰ *Le dialecte de Dushmani*, f. 198.

⁶¹ Shih *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, f. 182-83.

Parafjala **nëpër** është prosekutive (shënon depërtim, kalim përmes). Në dimensionin e drejtimit shënon afrim e largim, ndërsa në dimensionin e dytë shënon kontakt, d.m.th. adherencë brenda koherencës.

Parafjala **më** (mbë): Për shkak të kuptimit inesiv kjo parafjalë ia ka lëshuar vendin parafjalës **në**, me të cilën dilte sinonimike në pjesën më të madhe të përdorimit. Në gjuhë të shkrimit kjo ka mbetur sot vetëm në të shënuarit e datës.⁶²

Parafjala **mbi** me kuptimin supersiv hyn në kriterin e objektivitetit në dimensionin e tretë, ndërsa shpreh kuptimin e koherencës e të inkoherencës (kontakt e jo kontakt), kurse në dimensionin e drejtimit shpreh kuptimin e qëndrimit e të afrimit.

Parafjala **nën** me kuptimin subesiv qëndron edhe kjo brenda kriterit objektivitet të dimensionit të tretë dhe i përjashton koherencën e inkoherencën, ndërsa në dimensionin e drejtimit shpreh kuptimin e afrimit e të qëndrimit.

Parafjala **me** me kuptimin e saj komitativ (sociativ e instrumental) shënon afrim në dimensionin e drejtimit dhe koherencë në dimensionin e dytë.

Parafjala **pa** është antonimike me parafjalën **me**, d.m.th. se “tregon përgjithësisht mungesën, mosqenien, përjashtimin e një sendi a të një personi”.⁶³

Parafjala **për** mund të karakterizohet si direktive me kuptim afrimi, indiferente ndaj dimensionit koherencë-inkoherencë. Bashkë me parafjalën **në** pas saj (për në) identifikohet si interdirektive (lëvizje në drejtim kah brendia); **përmbi** është një supradirektiv (lëvizje kah një pikë përmbi) dhe në dimensionin e drejtimit shënon pikën e afrimit e të pushimit dhe është neutrale në dimensionin e dytë, **për nën** ka kuptim sublativ (lëvizje në drejtim kah pika nën) dhe shpreh po ashtu afrim e qëndrim dhe është edhe kjo indiferente ndaj dimensionit të dytë.

Parafjala **ndër** është elative (shënon një brendësi nga e cila ndahet, veçohet a del diçka a dikush). Kjo shpreh kuptim largimi e koherencë.

⁶² Shih A. Xhuvani, *Vepra I*, f.285.

⁶³ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, f.392.

2. Parafjalët e emërores

Parafjala **te/ tek** është allative. Shpreh kuptim afrimi pa kontakt, d.m.th. se shënon inkoherencë në dimensionin e dytë. Sinonimike me të në gegërishten veriore është parafjala **tu/ tuk**, që ka qenë e tërë shqipes, siç e dëshmon përdorimi i saj në formimin e mënyrës përcjellore.

Parafjala **kah** ka kuptimin e allativit e të prosekutivit. Kuptimi allativ me inkoherencë, ndërsa kuptimi prosekutiv me koherencë.

Parafjala **nga** shpreh kuptim prosekutivi e ablativi. Si prosekutive mban në reciprocitet kuptimet e afrimit e të largimit në koherencë, ndërsa si ablativale shpreh kuptim largimi me inkoherencë.

3. Parafjalët e rrjedhore e dhanores

Parafjala **prej** me kuptimin e saj ablatival me zotërim të kuptimit elativ shënon drejtim largimi edhe nga brenda e në dimensionin e dytë tregon koherencë.

Parafjala **ndaj** na duket se mund të karakterizohet si adesve, d.m.th. se shënon të qëndruarit pranë pa kontakt. Në dimensionin e drejtimit kjo parafjalë shënon pra termin e pushimit me kuptim të inkoherencës.

Parafjala **pas/mbas** me kuptimet postesiv (të qenit prapa) dhe postlativ (të shkuarit prapa) shënon termin e subjektivitetit në dimensionin e tretë, në të cilin nuk shpreh as koherencë, as inkoherencë, as afrim apo largim, por të qëndruar.

Parafjala **para** me kuptimin adkomitativ hyn në dimensionin e subjektivitetit që shpreh edhe kuptimin e afrimit e të të qëndruarit bashkë me kuptimin e inkoherencës.

RRETH PROBLEMIT TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE¹

Të nderuar kolegë e kolege,

Paskajorja *me + forma e pjesores pësore e së kryerës* është krijuar para formimit të mbiemrit të nyjshëm, që domethënë se ishte e tërë shqipes, ashtu si dhe privativi *pa + forma e pjesores*. Krijimi i kësaj forme nuk e pengoi përdorimin e mënyrës lidhore, që ishte para kësaj forme infinitivale. Përveç në disa raste tepër të pakta, ku nuk ishin të zëvendësueshme nga njëra-tjetra, lidhorja e paskajorja e tillë ishin variante stilistike, variante të lira, d.m.th. funksionuan e funksionojnë edhe sot si të tilla në dialektin e gegërishtes, ashtu siç funksionojnë edhe në disa gjuhë të tjera. Kuptohet, prandaj, se dalja nga përdorimi i kësaj paskajoreje vetëm nga të folmet toske do të jetë bërë nën ndikimi e jashtëm, nën ndikimin e një gjuhe në kontakt intim, që për dialektin e toskërishtes mund të ishte greqishtja e mesme, që e kishte humbur paskajoren, në kohën kur në gjuhën shqipe ishin dobësuar së tepërmi lidhjet veri-jug. Ajo doli nga përdorimi nga preferenca e shprehjes me lidhore.

Nga kjo kuptohet se toskërishtja, që domethënë edhe shqipja standarde, nuk e kundërshton praninë e një paskajoreje, që do të ishte në funksion varianti me lidhoren. Nga ky aspekt paskajorja e tillë e ka vendin e zbrazët në sistemin foljor të shqipes standarde. E meqë një paskajore e tillë ekziston në gjuhën shqipe dhe është shumë e përdorshme në dialektin gegë, në kushtet e bashkëjetesës së intesifikuar të të folmeve të dy dialekteve tona, kjo paskajore ushtron presion për të hyrë në standard dhe po shfaqet e përdorur te folësit e gjuhës standarde gjithnjë e më tepër, sidomos në të folurit e shpejtë, për shkak se, duke qenë formë foljore pa vetë e pa numër, është e seleksionueshme më me lehtësi se lidhorja e ngarkuar me këto kuptime.

Në këtë paskajore është përcjellë ndryshimi i formës së pjesores. Ajo qe me formë të njëjtë për tërë shqipen jo vetëm në kohën e përfimit të

¹ Kumtesë në Aktet e konferencës gjuhësore – Durrës, 15-17 - dhjetor 2010.

kësaj paskajoreje, që është e periudhës para përfundimit të huazimeve latine, por edhe kur ra **-n**-ja fundore te pjesorja në **-on**: ***ka shko**, ***ka puno** dhe deri kur kjo **-o** u diftongua në **uo**: **shkuo**, **punuo** etj. dhe kur ra më vonë edhe te pjesorja me zanore të tjera: **ka pre**, **ka ble**, **ka ra**, **ka pi**, **ka thye** etj. Kjo gjendje e përbashkët e formës së pjesores dëshmohet në format e habitores: **la-kam**, **pre-kam**, **thye-kam.**, **shkuo-kam** etj., që mendojmë se është krijuar kah shek. XI. Pas kësaj kohe toskërishtja formën e mbiemrit prejpjesor e kaloi edhe në pjesoren në përdorim foljor: **i, e pre-rë – ka pre-rë, i, e la-rë – ka la-rë, i, e thye-rë – ka thye-rë**, duke e barazuar formimin e mbiemrit nga pjesorja, siç ishte në formën e pjesores me apofoni: **ka mbjellë – i, e mbjellë**, **ka dalë – i, e dalë** e në **-në**: **ka thënë – i, e thënë**, **ka lënë – i, e lënë –**, **ka marrë – i, e marrë** etj. dhe te pjesoret në konsonant: **ka pritur – i, e pritur**, **ka ardhur – i, e ardhur**, **ka djegur – i, e djegur** etj. Pjesa më e madhe e gegërishtes ndoqi rrugë tjetër. Ajo e ruajti dallimin e formës së mbiemrit prejpjesor nga pjesorja në zanore e në diftong në përdorim foljor, duke e lënë formimin e mbiemrit nga pjesorja + prapashtesë: **ka la – i la-m – i la-në**, **ka pre – i pre-m – i pre-në**, **ka thye – i thye-m – i thye-në**, **ka punuo – i punuo-m – i punuo-në** etj. dhe e përgjithësoi këtë mënyrë formimi të mbiemrit edhe me format e tjera të pjesores: **ka mbjellë – i, e mbjell-un**, **ka mjellë – i, e mjell-un**, **ka tjerrë – i, e tjerr-un**, **ka lanë – i, e lan-un**, **ka marrë – i, e marr-un**, **ka thanë – i, e than-un** etj. Në realizim të këtij kriteri që mbiemri të formohet nga pjesorja plus prapashtesa, në gegërishte u shkurtua pjesorja në bashkëtingëllore, kështu që nga **ka ardhunë – i, e ardhunë** u kalua në **ka ardhë – i, e ardh-unë**, nga **ka pritunë – i, e pritunë** në **ka pritë – i, e prit-unë** etj., në një proces të përfunduar pas autorëve tanë të vjetër, te të cilët shihet se ky proces porsa kishte filluar. Kështu e vetmja formë e pjesores që mbeti e barabartë në të dy dialektet është forma e foljeve apofonike në sonante: **vjelë, mbjellë, dalë, marrë** dhe në ato që përfundonin në **-n**: **thënë, lënë** (thanë, lanë) etj. me dallimin fonetik **a – ë**.

Kjo formë e përbashkët e pjesores e lehtëson përdorimin paskajoren **me** + pjesore brenda gjuhës së folur standarde: **me vjelë, me mbjellë, me dalë, me marrë, me lënë, me nxjerrë** etj., ndihmuar edhe nga format e pranuar më parë në toskërishte si **me thënë, me qenë** (do me thënë, me qenë se, me qenë që).

Humbja e paskajores, që duket të jetë kryer kah shek. XIII si në disa gjuhë ballkanike, u bë kur format e pjesores në toskërishte ishin këto që u shënuan, d.m.th. këto që janë edhe sot. Paskajorja e tillë është e dëshmuar si formë reliktoze e ngurosur në shumë pak raste në ndonjë të folme të arbërishtes në Itali, siç na e thotë edhe Altimari: **për me ngrën, për me pir, pir me qeshur, pir me bler**, e në ndonjë rast të izoluar në toskërishte, siç dalin format **tuk me mbaruar, tuk me thënë** në të folmen e Beratit. Këto të fundit duket se janë mbetje të paskajores në toskërishte edhe nga shkaku se në këtë përdorim paskajorja nuk mund të zëvendësohej nga forma e lidhore.

Pas mënjanimit të kësaj paskajoreje, toskërishtja qëndroi vijimisht brenda arsyeve që e përjashtuan nga përdorimi, kështu që nuk mund të pritej që të fillonte ndonjë proces i krijimit të një paskajoreje të tillë. Përdorimet e paskajores te disa shkrimtarë toskë të Rilindjes **me + pjesorja** e toskërishtes si: **me (mos) pasurë, për me (mos) prishurë, për me (mos) mbeturë** etj. janë çmuar me të drejtë si trajta të formuara si “përpjekje të vetëdijshme për afrimin e dy dialekteve të shqipes në të shkruar”. Format e tilla të paskajores nuk mund të jenë krijuar nën ndikimin e gegërishtes, sepse me formën toskërishte të pjesores janë të paqena edhe në gegërishte, d.m.th. janë krijime artificiale, të cilat prandaj nuk i pranoi as toskërishtja e folur, duke i lënë jashtë përkrahjes që të bëhen edhe formë e shkruar.

Kështu paskajore në gjuhën standarde mund të bëhet vetëm paskajorja e gegërishtes nën presionin e përdorimit intensiv në gegërishte, paskajore me format e pjesores së saj bashkë me format e toskërishtes: lënë, thënë etj.

Duke u bërë pjesë e sistemit foljor të shqipes standarde, paskajorja nuk imponon ndryshimin e formës së pjesores të kësaj gjuhe, sepse kjo formë është e mbështetur nga dialekti toskë në të gjitha funksionimet e saj, përveç të tjerash, siç u tha, edhe me mënyrën e formimit të mbiemrit të nyjshëm prejpjesor drejtpërdrejt nga pjesorja, edhe me krijimin e emrave asnjans prejpjesorë: të vrapuarit, të ushqyerit etj. edhe brenda formave të ndryshme foljore e emërore. Atë e mbron funksioni i saj identifikues si pjesë e sistemit foljor të toskërishtes. Kështu paskajorja e gegërishtes imponohet të hyjë në shqipen standarde edhe për arsye se nuk provokon efekte

ndryshimesh të tjera në morfologjinë e kësaj gjuhe.

Mundësia e hyrjes së kësaj paskajoreje të gegërishtes në shqipen standarde për arsyet që u shënuan, ka mbështetje edhe te disa forma të pjesores së gegërishtes që kanë hyrë në standard me formën e habitores: **la-kam, thye-kam, prit-kam, marr-kam, ardh-kam** etj., te mbiemrat prejpjesorë në **-shëm**: **i punue-shëm, i thye-shëm, i afrue-shëm, i pa-shëm, i ble-shëm, i rrit-shëm, i prek-shëm, i bind-shëm** etj., te emrat e vepruesit: **mësue-s, ndërtue-s, thye-s, pritë-s, ardhë-s, djegë-s, prekë-s, prishë-s** etj. si dhe te formimi i disa emrave të prejardhur me prapashtesën **-je**, që figuron e shtuar mbi pjesoren e gegërishtes: **ardh-je, mbet-je, vërejt-je, humb-je, fol-je** etj. Edhe këto pjesore të gegërishtes në kuadër të këtyre formave nuk kanë ushtruar presion që të bëhet e njëjtë pjesorja e gjuhës standarde dhe nuk ka bërë presion as pjesorja e standardit që të dalë në vend të këtyre formave geqe të pjesores (me pak përjashtime). Kështu pjesorja e standardit e toleron pjesoren e gegërishtes në përbërje të formave të shënuara foljore e emërore.

Paskajorja po vjen në përdorim gojor të shqipes standarde, tash me trajtim si devijim nga standardi. Duke e pranuar në standard, si lejim i standardit e jo për hatër të gegërishtes, do të përshpejtohej përdorimi i shllirshëm i saj, inkuadrimi me tërë begatinë e saj funksionale që do t'ia sjellin folësit gegë të gjuhës standarde.

Me paskajoren e tillë si variant i lirë me lidhoren në gjuhën standarde të shkruar bëhet e mundur edhe një shprehje stilistike me përzgjedhje herë të lidhores, herë të paskajores, që i mungon shqipes standarde.

Kjo formë e paskajores, si kategori foljore që “përfaqëson kulmin e abstraksionit gramatikor në sistemin foljor të një gjuhe”, nuk është futur në gjuhën standarde në Kongresin e Drejtshkrimit për shkak të mendimit të gabuar se me të do të imponohej ndryshimi i pjesores së standardit, gjë që do ta lëndonte shumë bazën dialektore të saj.

Shqipja standarde e ka paskajoren e gegërishtes mundësi të begatimit të shprehjes. Në rrugë të realizimit të kësaj mundësie duhet të ndihmohet, me u ndihmue duhet.

E FOLMJA E ARBNESHËVE TË ZARËS NË VEPRËN E IDRIZ AJETIT¹

Në 90-vjetorin e lindjes së akademik Idriz Ajetit na jepet rasti që të rivlerësojmë, në shenjë nderimi, veprën e tij shkencore, na jepet rasti të na dëshmohet edhe një herë qëndrueshmëria e vlerës së saj në studimet albanistike jo vetëm si një hallkë në zhvillimin e kësaj shkence, por edhe si vepër vijimisht shërbyese.

Gjerësia tematike e studimeve të tij, thuaja nga të gjitha disiplinat albanistike: dialektologji, çështje të morfologjisë historike e të sotme, të fonetikës, të etimologjisë, të teksteve të vjetra, të normimit të gjuhës standarde, të kulturës së gjuhës, të origjinës së gjuhës shqipe, çështje të huazimit të elementeve leksikore të shqipes nga gjuhët fqinje sllave etj., bashkë me të qenët i ndryshëm në trajtim i jep Idriz Ajetit një vend të nderuar ndër studiuesit e shqipes. Të rrallë profesor Ajetin e bën edhe qasja e tij ndaj gjuhës amnore në frymë të teorisë së Humboldt-it si shprehje specifike e shpirtit të popullit. Prandaj kujdesi i veçantë i tij për ruajtjen e pastërtisë së shqipes e respekti krenues ndaj dukurive të strukturës së saj.

Vepra *“Zhvillimi historik i së folmes geqe të arbëneshëve të Zarës”* është tezë doktorate e Idriz Ajetit, e drejtuar nga albanologu Henrik Barić dhe e mbrojtur, pas vdekjes së këtij, më 1959 në Beograd. Kjo vepër, e shkruar serbisht, u botua në Sarajevë më 1961 nga Shoqata e Shkencave e Bosnjës e Hercegovinës.

Për këtë vepër Waclaw Cimochowski ka shkruar: “Kjo monografi tepër interesante dhe me vlerë e Idriz Ajetit merret me dialektologjinë historike, me një fushë hulumtimi që zakonisht është paraqitur tepër pak edhe në shumë gjuhë të tjera të hulumtuara më rrënjësisht se ç’është rasti me shqipen”. “Kjo monografi”, vijon ai, “e ndihmon thellësisht begatimin e njohurive tona në dialektologjinë historike si dhe në historinë e zhvillimit

¹ Në 90-vjetorin e lindjes së akademik Idriz Ajetit.

të brendshëm të shqipes”. Për prezantimin e së folmes së Krajës, si pjesë që ia krijon monografisë së Idriz Ajetit dimensionin e një studimi historik dialektologjik, Cimochowski ka vlerësuar: “Gjuhësia dhe dialektologjia i de-tyrojnë Ajetit mirënjohje të veçantë për të dhënat mbi të folmen e Krajës dhe vendosjen e pozitës së saj në kuadër të të folmeve fqinje të shqipes veriore”.²

Meqë është fjala për një të folme të izoluar në diasporë, e ndarë nga e folmja burimore e Krajës dy shekuj më parë, trajtimi i zhvillimit të së folmes së Zarës, mund të arrihej vetëm përmes krahasimit.

Këtë monografi dialektologjike historike Ajeti e ka ndërtuar duke përcaktuar disa rrafshe të trajtimit:

1. E ka bërë regjistrimin thelbësor të strukturës së të folmes së Zarës duke pasur parasysh nevojën për ekonomizim të trajtimit që kërkon dimensionin historik krahasues i monografisë.

2. Kështu ka vepruar edhe për të folmen e Krajës. Këtu porse Ajeti po e bënte vetë përshkrimin e së folmes së Briskut e të Shestanit, të pastudiuar në mënyrë të plotë gjer atëherë. Këtë të folme Ajeti e ka trajtuar në dy relacione: në relacion me të folmet rreth Krajës dhe në relacion me të folmen e sotme të Arbëreshit të Zarës. Në relacionin e parë ajo është ndërtuar si punim me kriteret e gjeratëhershme të studimit sinkronik të të folmeve, ndërsa në relacionin e dytë, që është më i vështirë, përqaset, për aq sa është e mundur, edhe me gjendjen e saj dy shekuj më parë (koha e shpërnguljes). Kjo ka përbërë pjesën më delikate të objektivitetit shkencor në këtë monografi. Kjo do të thotë se Ajetit i është dashur të përpiqej të bënte një rindërtim të gjendjes së të folmes së Krajës para dy shekujsh vetëm aq sa e mundësonte krahasimi i elementeve arkaike të kësaj të folmeje me të folmen e arbëreshit të Zarës.

3. Pas kësaj Ajeti veçon shtresën e elementeve krahasuese që i vë në pozicione diakronikisht të polarizuara dy gjendje sinkronike të Krajës e të Arbëreshit.

² Në vështrimin e përmbledhur brenda veprës së I. Ajetit që po shqyrtojmë.

4. Ka bërë një kronologji relative të vjetërsisë së elementeve gjuhësore të krahasuara dhe ka dhënë disa etimologji sqaruese, që ia kompletojnë karakterin historiko-krahasues monografisë.

5. Ajetit i është imponuar edhe trajtimi i disa çështjeve të historisë së brendshme të shqipes, siç janë: theksi dhe ndikimi i tij në reduktim të zanoreve në gegërishte, kuantiteti i zanoreve, hundorësia, llojet e l-së në gjuhën shqipe, trajtimi i diftongjeve, çështja e ambigjinitetit, format e “vendores”, format e imperfektit, të futurit etj. Trajtim të çështjeve të diakronisë Ajeti ka bërë edhe duke shqyrtuar elementet dalluese të të dy të folmeve edhe duke korrigjuar përfundimet e paqëndrueshme të studiuesve para tij të së folmes së arbëreshëve të Zarës. Vërejtje e sqarime të tilla të shumta ai ka bërë edhe gjatë shqyrtimit të trajtesave a monografive dialektologjike të gjeratëhershme të shqipes. Me këtë veprim profesor Ajeti shpaloi thellësinë e njohurive që kishte që atëherë për zhvillimin e elementeve të strukturës së shqipes dhe aftësinë e aplikimit krijues të tyre. Dhe kjo ishte ajo që e shtyri Cimochowskin të vlerësonte se kjo vepër “e ndihmon thellësisht begatimin e njohurive tona në historinë e zhvillimit të brendshëm të shqipes”. Këto vërejtje e sqarime po i shënojmë sipas renditjes në vepër:

— shembujt e fjalëve me **u** e jo me **y** që ndeshen në të folmen e Çamërisë e në disa të folme të tjera, p.sh. **kure**, **dalanduše**, **skure** për **küre**, **dalandüše**, **sküre** i konsideron burimore;

— **ë**-së toske në dialektin gegë në fillim i përgjigjej vetëm **e**, **â** nazale e jo edhe **o** , siç mendon Pekmezi nisur nga shembujt e Dibrës **tonde**: **tënd**, sepse **o**-ja rrjedh nga **â**-ja ;

— duke e trajtuar të folmen e Përmetit në bazë të veprës së A. Dozon-it *Manuel de la langue chkiye ou albanaise (1879)* shprehet: “Mund të thuhet se letrarishtja toske gjithnjë e më tepër po largohet nga përdorimi i tepruar i së pazëshmes **ε**, me të cilën është e stërm bushur e folmja e shqiptarëve të Përmetit dhe letrarishtja toske, që mund të thuhet se po favorizohet edhe si gjuhë letrare shtetërore...”;

— e kundërshton mendimin e Selim Islamit që monoftongimi i **ua**, **ie**, **ye** në **u**, **i**, **y** në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës si p.sh. **du**, **muj**, **dur**, **gru**, **dill**, **mill**, **kry**, **dyr**, **pys** e vendos këtë të folme “në zonën ka-

limtare të dialektit toskë e gegë, përafërsisht ndërmjet Polisit, afër Elbasanit dhe Pogradecit”, duke u shprehur se monoftongimi do të jetë bërë në trua-llin e ri (në Ukrainë) dhe se karakteristikat e tjera e nxjerrin burimin e kësaj të folmeje nga rrethi i Korçës, siç ishte shprehur më parë edhe Islami, e nuk mund të bëhet fjalë për një të folme të përzierë;

— kundër mendimit të Weigand-it se elbasanishtja e ruan nazalitetin e të gjitha zanoreve, mendon se nazalitet në elbasanishte nuk ka **e**-ja;

— mendon se e folmja e Matit që në shek. e XVII i kishte ndryshuar grupet **kl, gl** në **q, gj** e jo në **kj, g-j**, siç kanë menduar disa gjuhëtarë;

— nuk e konsideron të saktë mendimin e të gjithë studiuesve të deriatëhershëm të shkodranishtes që “**ε**-në e mbyllët e shënojnë si **e** të pastër orale”: **babën, token, veper, vjeher** etj.;

— duke pasur parasysh format **njeni, teknjeni, sikurnjenin, niri** si dhe diftongun **ue** në tekstin e “Djalit plangprishës” nga e folmja e shqiptarëve të Istrisë përfundon se këta shqiptarë do të jenë larguar nga treva e Shkodrës apo e Ulqinit dhe e Tivarit e jo nga treva e Podgoricës dhe e Pejës, siç ka menduar Ndre Mjeda;

— zanoren para tingujve **n, m, l** në pozitë parakonsonantike e konsideron të shkaktuar “nga nevoja e lehtësimit të artikulimit të tingujve përkatës, të ndryshëm nga tingulli nistor që është etimologjik e në reduktim e sipër, duke qëndruar kështu në mospajtim me vlerësimin e E. Çabejt, i cili mendoj se ky vokal në të gjitha rastet “përfaqëson zëvendësimin në shqipe të vokaleve të patheksuara indoevropiane ose latine në pozicion parakonsonantik në ballë të fjalës”;

— shënon se grupet konsonantike **mb, nd** në të folmen e Istrisë janë ruajtur së paku deri në gjysmën e shek. XIX. Edhe e folmja e Zarës “tregon qartë se grupet e përmendura konsonantike në Krajën e Malit të Zi ishin ruajtur deri në gjysmën e parë të shek. XVIII”, ndërsa mendon se “asimilimi i tyre nuk u paraqit së paku edhe për njëqind vjet”. Me këto konstatime çmohet i pasaktë mendimi i Çabejt se në këto grupe konsonantike asimilimi nuk ishte kryer vetëm deri në shek. XVII;

— formën **ěšt** në të folmen e Istrisë e merr formë primare (ensti > ešt)

ndaj formës së përgjithshme gege **ãšt** që e konsideron sekondare, që do të thotë se vetëm kjo e folme gege e ka ruajtur formën burimore si dhe toskërishtja. Ky mendim duket interesant, por i diskutueshëm;

— e nxjerr të pasaktë mendimin e Tagliavinit për kalim **y > u** në të folmet e Kosovës nisur nga shembujt e Kujundžić-it: **ćuš**, **drušk** (për **qysh**, **dryshk** etj.);

— të pasaktë e konsideron edhe mendimin e Jokl-it e të Tagliavini-t se e folmja e Gjakovës nuk e ka tingullin **h**, të bazuar këta në shënimet e pasakta të Kujundžićit;

— e kundërshton mendimin e Tagliavini-t se edhe në gegërishten lindore, si në atë perëndimore, në vend të tingullit interdental të zëshëm **dh** përdoret likuida e fortë **ll (l)**. Lë mundësinë që kjo të jetë vetëm në të folmen e katolikëve të Prizrenit.

Duke kaluar në pjesët vijuese të këtij disertacioni kemi dalluar këto konstatime të Ajetit:

— mendimin e Weigand-it se forma e së folmes së Zarës **me še** është trajtë e shkurtuar nga **me fše** (**h**) e vlerëson të pasaktë, sepse trajtat **fsheh** dhe **msheh** flasin se **f** dhe **m** janë prefiksa, që domethënë se forma **me še** është burimore;

— nuk i duket bindës mendimi i Çabejt se shembujt **growa = groua**, **Grovemire = Grouemire** vërtetojnë praninë e dikurshme të diftongut **ou**. Ajeti mendon se në shembullin **Grovemirë** kemi të bëjmë me një **v** antihia-tizuese të futur nga autori anonim;

— e gjykon të pasaktë mendimin e Gliša Elezović-it që diftongu **uo** përdoret edhe në Kosovë;

— nuk pajtohet me mendimin e Branko Miletić-it se **k**, **g** në të folmen shqipe të Krajës para vokalit palatal janë palatalizuar në **ќ** gjegjësisht në **ǵ**, duke shënuar se nuk qëndron askund që konsonantet e prapme **k**, **g** të kalojnë në palatale **ќ**, **ǵ**;

— të papranueshëm e vlerëson mendimin e I. Popović-it që “butësia e konsonanteve palatale **ќ**, **ǵ** në të folmet e toskërishtes është ruajtur në saje të afërsisë së gjuhës greke”, sepse “këto palatale përdoren edhe në të

folmet shqipe të Briskës e të Shestanit e kjo do të thotë se këto palatale kanë qenë në përdorim në të gjitha të folmet shqipe, do të thotë se kjo ishte veçori e mbarë gjuhës shqipe”;

— është kundër mendimit të Gj. Pekmezit se **i** e mesme përdoret në të folmen e Gjakovës;

— nuk pajtohet me Çabejnë që mendoi se grupet konsonantike **mb**, **nd**, **ng** janë ruajtur “në mënyrë të përkryer përveç në toskërishte edhe në të folmen e Gjakovës edhe në disa të folme shqipe të Kosovës”. Ajeti mendon se ato janë ruajtur në qytetin e Pejës e të Vuçitërnës, (jo nëpër fshatra) dhe askund tjetër në Kosovë;

— thotë se Çabej bën gabim të dytë kur pa verifikim paraprak sjell të dhëna, sipas të cilave tingulli **ń** (në vend të **j**) është ruajtur edhe në të folmen e sotme të Gjakovës si p.sh. **fñońat** për **ftoj** etj.;

— e sheh të gabuar pohimin e J. Rrotës se të folmet e Krajës velarin **l** e shdërrojnë në interdentalin e zëshëm **dh** (**đ**) dhe thekson se mund të flitet vetëm për një raport të kundërt të alternimit;

— mendon se duhet hedhur poshtë mendimi i S. Rizës me të tjerë se edhe futuri **do+lidhore** (**do të shkoj**) është po aq i lashtë sa dhe futuri **kam+paskajore** (**ka me shkue**);

— e konsideron gabim të madh të Tagliavini-t e të Weigand-it pohimin se e folmja arbëreshe e Zarës nuk e ka diftongun **uo**, pranë **ua**-së dominante;

— të pasaktë e vlerëson mendimin e Weigand-it se artikulimi i gjysmëvokalit **ɛ** (**ě**) në të folmen arbneshe të Zarës është i njëjtë me artikulimin në toskërishte;

— dikton se kalimi i tingujve fundorë **-on**, **-or**, **-ol** në **-un**, **-ur**, **-ul** në të folmen e Zarës ka depërtuar nga të folmet serbokroate të Dalmacisë;

— kalimin e **a**-së në **ai**, që për të folmen e Zarës Tagliavin-i e bën ligj fonetik, nisur nga një shembull i dyshimtë a i dëgjuar gabimisht (gërshaint = gërshanët), Ajeti e konsideron të paqenë;

— sufiksin **-t** e quan mbiemëror e jo si Jokli që e konsideron sufiks participor;

— supozimin e Miklošič-it që fjala **sapuni** është nga latinishtja e jo nga greqishtja e re e konsideron pa kurrfarë baze, për shkak të tingullit s që s’ka kaluar në š dhe për shkak të mungesës së rotacizmit.

Përveç tri rasteve të shënuara nga W. Cimochoowski që Ajeti ka përkrahur mendimet e paqëndrueshme të të tjerëve (për emrin **peshë**, për emrin **Ohrid** dhe për **zverk**), ne shtojmë edhe përkrahjen që Ajeti i bën mendimit të paqëndrueshëm të Barić-it e të Skok-ut se variantet kontekstuale të nyjës shquese **-i**, **-u** rrjedhin nga përemra të ndryshëm, që pranon mendimin e Jokl-it e të Barić-it se -t e “lokativit” (ëmbë shpirti-t, për gjumë-t etj.) rrjedh nga një ***dhi** indoevropiane e jo që është një e përngjitur mekanikisht, siç ka konstatuar me të drejtë H. Pedersen-i. Në atë kohë Ajeti mendonte se teoria, “e cila dita-ditës gjithnjë e më tepër po arsyetohet dhe vërtetohet me argumente të pakundërshtueshme, veçanërisht me argumente gjuhësore, qëndron në pohimin se trualli i sotëm i shqiptarëve është i një date më të vonë, prandaj trualli i tyre i hershëm duhet kërkuar diku gjetkë, me siguri në brendi të Gadishullit Ballkanik”. Më vonë ai e pa të qëndrueshme teorinë mbi prejardhjen ilire të shqiptarëve, duke pranuar edhe se ata banojnë në trevat e sotme në kontinuitet të pandërprerë iliro-shqiptar.

6. Në çfarë raporti është kjo monografi me studimet dialektologjike të kohës në përgjithësi dhe me dialektologjinë shqiptare?

Vetë Ajeti e ka parë të nevojshme që në fillim të kësaj vepre të na japë një pasqyrë të gjendjes së studimeve dialektologjike të shqipes gjer atëherë (46 faqe), duke na e bërë të gatshëm sugjerimin për një krahasim të veprës së tij me ato. Një vlerësim veprës së tij ai ia ka bërë implicite, duke shënuar se “dialektologjia shqiptare nuk ka monografi të përsosura. Shënimi i materialit gjuhësor kalimthi në udhëtim e sipër, me vështrime të shkurtra... që e ndeshim te disa albanologë: Weigand-i, Lambertz-i dhe të tjerë nuk mund të krahasohet me monografitë e plota dhe moderne italiane, madje edhe me monografitë dialektologjike të sllavëve të jugut”.

Ndërkaq, nga monografitë e pakta të deriatëhershme dialektologjike Ajeti veçon veprën e Pedersen-it për të folmen e Çamërisë *Tekste shqip me glosar*, për të cilën shënon: “se deri më tani ajo është punimi më i mirë në dialektologjinë shqiptare” dhe veprën e Cimochoowski-t *Dialekti i Dushma-*

nit, për të cilën thotë se “me të dialektologjia shqiptare u pasurua për një studim të shkëlqyeshëm për të folmen në fjalë... dhe se autori arriti me sukses që të japë një rën ndër monografitë gjuhësore më komplete”.

Meqë kjo monografi e Idriz Ajetit është studim dialektologjik historik i praktikuar, siç u tha, shumë rrallë edhe në gjuhësitë e tjera, nuk duket të jetë krijuar në bazë të ndonjë modeli të teorisë dialektologjike të kohës. Mënyra e trajtimit të tillë duhet njeher meritë e rëndësishme e Ajetit, një kontribut i çmueshëm i tij në dialektologjinë shqiptare. Strukturën e tillë të punimit e imponoi njohja, që nga Tagliavini, se arbëreshët e Zarës kishin ardhur nga Brisku e Shestani i Krajës. Kjo monografi e Ajetit ka mbetur e veçantë gjer tani në studimet dialektologjike shqiptare dhe bashkë me punimin e mëparshëm (1959) mbi zhvillimin e së folmes së Gjakovës që nga **Vehbija** e Tahir Efendi Boshnjakut e pastaj edhe për të folmen e Rahovecit që nga **Divani** i Sheh Hilmi Maliqit u bë mënyrë identifikuese e Idriz Ajetit si dialektolog i ndryshëm nga të tjerët, i dha një vend autoritativ të veçantë në studimet tona dialektologjike. Pikëpamjet e Ajetit për studime dialektologjike mbështeten në disa elemente të gjeografisë gjuhësore dhe të neolinguistikës italiane si në trajtimin e formave arkaike ashtu dhe në trajtimin e risive, duke i pasur në konsideratë marrëdhëniet speciale të të folmeve në hapësirën qendrore, anësore dhe të izoluar. Ajeti me të drejtë i dallon risitë e të folmes së Krajës nga risitë e së folmes së arbëreshit të Zarës: risitë e para i sheh të shkaktuara nga ndikimi i jashtëm, që niset në formë të valës nga zona qendrore dialektore. Këto risi janë:

- humbja e hundorësinë te zanorja **e** (si në të folmen e Elbasanit);
- diftongu **ue** në të folmen e Briskut në vend të **uo** të Shestanit;
- asimilimi i grupeve konsonantike **nd, mb** në **n, m** (përveç te njerëzit e shkuar në moshë);
- përdorimi i trajtës së shquar të emrave në gjinore-dhanore edhe në vend të trajtës së pashquar;
- përdorimi i trajtave foljore **jena, kena** etj.

Risitë e arbëreshit janë spontane dhe krejtësisht të veçanta:

— të gjithë mbiemrat janë të nyjshëm, d.m.th. edhe mbiemrat e pa-nyjshëm kanë marrë një të përparme: **i ćor – e ćore, i ćorët, të plak, e kontent, i desno, i divlo, e gjušto** etj. Për këtë Ajeti shprehet: “Njeriu mahnitet kur sheh se me çfarë ndjenje të flakët e dashuri ndaj gjuhës së vet amtare — arbëneshët i modifikojnë trajtat mbiemërore të sllavishtes e huazimet e tjera, duke ua nënshtruar ligjeve gjuhësore të së folmes së tyre”;

— mbiemrat prejpjesorë të foljeve në bashkëtingëllore në vend të formës së përgjithshme gege me **–un**, formohen me **–um: i ćulum, i mshilum, i ćuditum, i dehum, i pasum, i lagum** etj.;

— ka dalë nga përdorimi aoristi sigmatik: **rova** (për **rashë**), **pova** (për **pashë**), **sova** (për **thashë**) etj.;

— tendenca e evitimit të trajtave të parregullta të shumësit: në **dora** (për në **duer**), çili **derat** (për **dyert**) etj.

— synimi për evitimin e trajtave të parregullta foljore si p.sh.: unë **poj** apo **ponj** (për unë **shoh**), unë **roj** apo **ronj** (për unë **bie**) etj., synim që po ndodh sot në të folur të gjeneratave të reja në Kosovë: ia **japa** (për ia **dhashë**), apo ia **dho** (për ia **jap**) etj.;

— humbja e formës së kallëzores parafjalore apo të “vendores”;

— zhdukja e tingujve **h** dhe **rr**;

— palatalet **ć, ĝ** nuk janë ruajtur si në të folmen e Krajës, por nën ndikimin e serbokroatishtes kanë kaluar në afrikate;

Si elemente arkaike të kësaj të folmeje janë shënuar:

— diftongu **uo**, që po ia lëshonte vendin grupit **ua** të zanoreve;

— ruajtja e kuantitetit të zanoreve;

— ruajtja e grupeve konsonantike **nd, mb, nğ**, përkundër Krajës që i ka asimiluar;

— ruajtja e tingullit **-ń** pa u zëvendësuar nga tingulli **-j** : të šulińta, un preń etj., ashtu si në Krajë;

— përdorimi i nyjës së përparme **të** e jo **e** pas kallëzores së shquar njëjës e shumës: [zjarmin të zemrës, mundët të mia] etj.;

— imperfekti me **nja - nje** si në të folmen e Krajës, pranë të cilit përdoret edhe imperfekti sigmatik: [u përziëshin, u matshin] etj., që nuk është në Krajë;

— ruajtja e njëgjinishmërisë së emrave mashkullorë në shumës si në njëjës, d.m.th. mosnjohja e ambigjenisë.

Këtë kumtesë po e përmbyll me konstatimin se e folmja e arbëreshëve të Zarës, e prezantuar në veprën e Idriz Ajetit, mbetet dëshmi e vlefshme e një të folmeje shqipe të izoluar në Kroaci, e cila me kalimin e moteve do të shuhet nga atlasit gjuhësor i shqipes. Ajo me elementet konservative është bazë e disa referencave të rëndësishme për sqarime diakronike bashkë me të folmen e Briskut e të Shestanit, ndërsa me inovacionet e shënuara, të përfutuara nga një aktivizim analogjish të pashfrytëzuara nga të folmet e tjera të shqipes, shënon një shkallë vitaliteti kundërshtues ndaj gjendjes së saj të izoluar.

Idriz Ajetit i mbetet lëvdata për regjistrim të saktë të të folmeve të Zarës e të Krajës në gjendjen e viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar, lëvdata për sqarimet e sakta të elementeve të strukturës së këtyre të folmeve dhe për meritën që në kohë të duhur na e la si përmendore të qëndrueshme të folmen e arbëreshëve të Zarës.

Akademik Idriz Ajetit i dëshiroj jetë të shëndetshme me energji krijuese. Dëshiroj të shpreh konsideratat edhe ndaj punës përkrahëse sakrifikuese të zonjës Hajrije për realizimin e veprës shkencore të bashkëshortit të saj e të Profesorit tonë.

TRAJTIMI I RELIKTEVE GJUHËSORE NGA SELMAN RIZA¹

Vepra gjuhësore e Selman Rizës nuk shënon hap evolutiv të gjuhësisë shqiptare në fushë të morfosintaksës, vijim të punës së pararendësve a të bashkëkohësve të tij. Ajo shënon, përkundrazi, një kapërcim të hovshëm kualitativ të këtyre studimeve, me synim këmbëngulës të këtij shkencëtari për të ndryshuar gjendjen e kohës në këto studime, për të arritur nivelet e studimeve të gjuhëve të mëdha evropiane.

Ai vlerësoi me të drejtë se në monografitë: *Nyjat e shqipes; Pronorët e shqipes; Emrat në shqipe, sistemi i rasave dhe tipat e lakimit; Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, kishte bërë, “pastrimet e morfologjisë shqipe prej sa e sa shfaqjesh jashtëshkencore e madje kundërshkencore në fushën qoftë të pozitave konceptionale qoftë të praktikave didaktike” dhe se në këto punime “niveli teorik mesatar evropian i gramatografisë së përgjithshme ku nuk është kapërcyer ndieshëm, është ruajtur në çdo vështrim”.

Selman Riza ishte studiues i sinkronisë së shqipes, gramatikan deskriptiv. Por trajtimi sinkronik i gjuhës të vë para mjaft elementeve reliktorë si mbetje të së kaluarës së gjuhës që e kanë si arsyen e pranisë mbrenda sistemit të ri, ashtu edhe funksionin e tyre të dikurshëm sistemor. “Çdo gramatikan deskriptiv – shënon Riza – duhet të synojë drejt qëllimit që edhe të dhënat e strukturës së kaluar si të mbetura të pjesshme a të veçanta në përdorjen e tashme t’i trajtojë shkencërisht... të bëjë me një mënyrë makar indirekte punën e një historiani gjuhësor”. Duke e pasë ngritur këtë mënyrë trajtimi në metodë, Selman Riza është edhe kështu i veçantë ndër studiuesit deskriptivë të shqipes. Ai prandaj ka vlerësuar se “Numri i pamjaftueshëm respektivisht mungesa e kryekëputshme e “ekskursevet” historikë në gramatikat tona deskriptive që nga Samiu e tëhu ka pasur pasoja negative si për trajtim shkencor të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe ashtu edhe për procesin e unifikimit të shqipes së shkruar”. Këtë mënyrë

¹ Në Konferencën shkencore në Tiranë, më 14 dhjetor 2009.

trajtimi, që praktikohet edhe nga disa studiues të gjuhëve të tjera, ai e konsideroi si shfaqje metodike të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme.

Sqarimet e relikteve gjuhësore nga Selman Riza janë në numër të konsiderueshëm. Ato zbulojnë gjendje të elementeve sistemore të shqipes në kohë të ndryshme deri te mjaft të lashtat. Kështu Selman Riza ka hapur mundësitë e rindërtimit të ndonjë niveli sinkronik në zhvillimin e shqipes dhe ka korrigjuar mjaft supozime të paqëndrueshme të zhvillimit diakronik. Pa pasur mundësi për t'u bazuar në një ecuri diakronike të shqipes në mungesë të një gramatike historike, sqarimin e saktë të këtyre relikteve mund ta bënin vetëm studiuesit e një aftësie të lartë veneruese. Selman Riza në këtë mënyrë ka dhënë kontribut të çmueshëm për ndriçimin e disa çështjeve të rëndësishme në diakroninë e shqipes.

Të dhënë gjuhësore “të mi vëllezër”, që është “relikt kundrejt shprehjes “vëllezërit e mi”, Selman Riza e sheh “të analizueshme në disa elementë të ndryshëm që përbëjnë aq relikte të një vlere të paçmueshme për sintaksën historike të gjuhës sonë”. Ai thotë se “ajo na mëson se në shqipen e lashtë: 1) mbiemrat pronorë, e për pasojë edhe cilësorët, ndejtoheshin para emrave, 2) mbiemrat e parandejtuar ishin të panyjshëm, sepse në këtë variante arkaike nyja të i takon emrit të paprapanyjzuar: “vëllezër” dhe 3) emrat nyjëzoheshin së përparmi”. Ky vlerësim i elementeve të kësaj shprehjeje reliktove të lë para një befasi të këndshme. Në shqyrtimet tona të gjitha këto konstatime janë të sakta. Në bazë të kësaj ai ka vlerësuar me të drejtë edhe se nyja shquese si prepozitive është e lashtë dymijë e sa vjet përpara, ndërsa aglutinimi i saj në postpozicion, kur është përfutur edhe renditja Emër – Mbiemër, është bërë në shekullin VIII-IX. Këto konstatime për nyjën ishin një përmbysje e tezave të Pedersen-it e Graur-it, La Piana-s, Jokl-it, Çabejt e të sa albanistëve e ballkanologëve të tjerë që ishin të pranuar në parim me nuanca plotësuese dhe fatkeqësisht kanë mbetur të pranuar edhe nga gjuhëtarë të ditëve tona. Këto teza bënë të ngecej në çdo hap në arsyetimin e gjendjes së përdorimit e të zhvillimeve të nyjës shquese e të përparme në gjuhën shqipe.

Teza e papritshme e Pisanit dhe e Çabejt bashkë me disa gjuhëtarë të tjerë se aglutinimi i nyjës shquese është bërë në renditjen emër – mbiemër, që ishte, sipas tyre, shumë e lashtë e me burim nga një gjuhë paraindo-

evropiane, nuk mund të arrinte më larg së vërtetës. Si do të shpjegoheshin një sërë momentesh, ndër të cilat po përmendim formën **ftoi, kroj** etj. me aglutinim të nyjës pas rënies së **-n-së** dhe aglutinimi me **-n** fundore në shembujt si **peni, freni, zani**, ku do të pritej në atë rast të ishte përfutur palatalizimi e metafoia e jo rotacizimi ? etj.

Renditja Nyjë shquese - Mbiemër – Emër e sqaron përfutimin e mbiemrit të nyjshëm, nyjën e të cilit Selman Riza me të drejtë konsideron se “përbën relik të nyjës së përparme shquese të shqipes së lashtë me kuptim të ndryshuar, respektivisht të asgjësuar”. Edhe kjo është një arritje e rëndësishme që flet se nyja e mbiemrit është përfutur para aglutinimit të nyjës shquese në postpozicion, kështu që dalin të paqëndrueshme hipotezat e Pedersenit, të Çabejt e të sa të tjerëve për përfutimin e saj.

Selman Riza zbuloi se shqipja edhe sot ka dëshmi të përdorimit të nyjës shquese prepozitive te numërorët **të dy, të tre** etj. dhe te përemrat e pacaktuar **të gjithë, të tërë**.

Jashtë çështjeve të renditjes së përbërësve të grupit nominal e të nyjës Riza ka trajtuar edhe relikte të tjera:

1. Nuk e pranon me të drejtë mendimin e G. Meyer-it që **-i-** në formën turq-i-t, bujq-i-t etj. të jetë relik i mbaresës së lashtë të shumësit, por e çmon ashtu siç është – tingull anapitit.

2. Gjininë asnjëse të mbiemrave të substantivuar dhe të emrave prejpesorë e konsideron relik, d.m.th. një mbetje jashtësistemore ‘nga ajo epokë e historisë së shqipes, kur gjinia asnjëse ekzistonte plotvlershmërisht edhe për emrat e parmë”.

3. Duke i konsideruar relikte format e rrjedhore si **lopet** (tambël lopet), ashtu si dhe rrjedhoret e ndajfoljizuara **krejt, heret, faret, sheshit** etj., Selman Riza ka pranuar, pa e thënë, se me përfundimin në **-t** kanë qenë të përdorshme në tërë shqipen, gjë që na ka dalë e vërtetueshme. Me këtë hiqet dilema e vijueshme se mos ishte në përdorim të pjesshëm.

4. Shpreh mendimin se aoristi sigmatik, që ekziston vetëm në vetën e parë njëjës, përbën relik të gjendjes kur do të ketë ekzistuar edhe për vetat e tjera të njëjësit e të shumësit.

5. Shënon se format **u ka përgjegjë, m'u ka përgjegjë** etj. përbëjnë relikte të një gjendjeje kur format me **u** ishin në të gjitha kohët si shënuese të diatezës vetvetore, që domethënë edhe në prezent e në imperfekt.

6. Janë mbetje reliktove trajtat: **bana, hyna - bëra, hyra**, sepse “vazhdojnë të jenë të zgjedhimit konsonantik”, ndërkohë që “format e tjera të të njëjtave folje kanë kaluar në zgjedhim vokalik: bëfsha, hyfsha.

7. Duke konstatuar se e nxjerra analitike p.sh. “fluturua” nga “fluturuakam” përbën relikte kundrejt formës **fluturuar**, Selman Riza ka pranuar se habitorja është ndërtuar mbi format e shkurtuara të pjesores, që do të kenë qenë të tërë shqipes para se të krijohej habitorja. Në shqyrtimet tona kjo ka dalë e saktë, përveç formës që përfundon me **-un / -ur**: hapunkam, hapurkam etj., e cila është shkurtuar më vonë vetëm në gegërishten.

8. “Në gegërishten veriore e verilidore grupi sintaktik i veçuar: **dëftore + lidhore** p. sh. “**s'un dalish**” përbën relikte kundrejt grupit sintaktik **dëftore + paskajore “s' mundesh me dalë**”. Selman Riza përfundon se “sintaksa **dëftore + lidhore** na paraqitet kështu jo vetëm si toskërishte bashkëkohore, por edhe si gegërishte e dikurshme e për pasojë edhe si shqipe e përbashkët”.

9. Nga forma e numrit “njizet” ai nxjerr përfundimin se dikur edhe gegërishtja e ka pasur fjalën “dyzet” në vend të së sotmes “katërdhjetë” e se elementi **nji** në gegërishten **njizet** është relikte i sistemit vigezimal të tërë shqipes.

Këtu ne përmendëm disa nga reliktet e trajtuar nga Selman Riza, të cilat na i konsiderojmë se janë trajtuar me saktësi. Kuptohet se ka edhe ndonjë që trajtimi i Rizës nuk na del i bazuar. Kështu p.sh. nuk qëndron vlerësimi i tij se të shprehja “**trungu i lisit të gjatë**” forma të **gjatë** e mbiemrit është formë reliktove e gjinore së lashtë. Edhe nga shembujt: **i Pjetrit më pëlqen... Ky kalë është i Palit**, Selman Riza nxjerr pa të drejtë përfundimin se “trajtat **Pjetrit, Palit** etj., që “shqipja e vonë i njeh vetëm si rasa dhanore, në shembujt e sipërm janë përkundrazi gjinore reliktove të shqipes së vjetër”. Po kështu, duke pranuar mendimin e Joklit habitoren e njeh relikte me kuptim të ndryshuar të futurit të shqipes së lashtë, e për pasojë se format e pjesores brenda kësaj mënyre kanë qenë paskajore para se të

bëheshim pjesore pësore të së kryerës. I diskutueshëm është vlerësimi i tij se dëshirorja p.sh. **lëvdofsha** është relik i së pakryerës së lidhore.

Selman Riza ka bërë korrigjime të trajtimeve të gabuara për disa elemente morfologjike. Për shembull: :

Kundër tezave të Meyer-it, Pedersen-it, Desnickaja-s etj. gjeti përgjigje të saktë të përfutimit të variantit **-u** të nyjës shquese dhe korrigjoi mendimin e Pedersen-it se nyja, kur u aglutinua në rasën kallëzore nuk e kishte formën **tam**, po **të**. Ai e argumentoi pasaktësinë e mendimit të Jokl-it për burim të ndryshëm rasor të pjesores së shkurtuar e të pjesores së plotë, konstatoi me të drejtë se sistemi rasor i shqipes së Mesjetës së vonë nuk ka pasur ndonjë rasë më tepër se ato që dalin në shqipen e teksteve të vjetra. E pa të paqëndrueshëm vlerësimin e Jokl-it se format **ftoi**, **kroi** dhe **ftoni**, **kroni** burojnë nga rasia të ndryshme. Dha sqarime të plota për përfutimin e kallëzores parafjalore. I konsideroi trajtat e pjesores (letra e) **shkruene**, (teshat e) **lane** si pjesore të para të së kryerës pësore (përfutuar nga paskajorja) e se (letra e) **shkruome**, (teshat e) **lame** janë forma dytësore me këtë vlerë të pjesores. Ka çmuar se “rjedhorja e vetëmjaftueshme ... si për numrin shumë p.sh. **lisash**, **shtyllash** ashtu për njëjës: **lisi**, **shtylle** në shqipen e sotme përbën vetëm një shfaqje kryesisht reliktoze”. Ka edhe çështje të tjera që kanë mbetur pa u shënuar në këtë kumtesë të shkurtër.

PËR THEK SIN E SHQIPES DHE PËR LËVIZJEN E HERSHME TË TIJ¹

Është pranuar se theksi i shqipes është theks i fuqishëm dinamik, apo theks absolutisht ekspirator. Që ky karakter i theksuar dinamik është i lashtë e vërteton ndikimi i tij i fuqishëm mbi tingujt fundorë të temave emërore që në kohën e kontaktit të shqipes me latinishten.

Zanores ë, e përftuar para huazimeve të para nga latinishtja, kur edhe tema emërore me **-ā** kishte përfunduar me **-ë**, është rezultat i veprimt të këtij theksi të intensitetit, gjë që vërteton se protoshqipja nuk e kishte trashëguar theksin kryesisht dinamik nga ndonjë fazë e gjuhës së lashtë ie. (sepse ë-ja do të ishte përftuar më herët), por e krijoi nga një gjendje e saj e më parme me zotërim të theksit muzikor a të tonit. Ky theks i intensitetit u përftua pas reduktimit të temave emërore të gjuhës ie. në katër tipa në gjuhën shqipe, siç kemi shënuar tjetërkund (tema në **-ō**, që përmbliidhte edhe emrat e temave në **-ī**, **-ū** dhe në konsonant, tema në **-ā**, tema njërrrokëshe atematike në bashkëtingëllore dhe tema në sonantet **-n**, **-r**).

Nuk mund të përcaktohet largësia kohore ndërmjet sistemit të temave me katër tipat e shënuar dhe krijimit të theksit dinamik që i gjeti këto tema, por largësia kohore e theksit nga kontaktet e para me latinishten duhet të ketë qenë relativisht e gjatë, sepse deri në këtë kontakt do të duhej që theksi të kishte shkaktuar rënien e tingullit tematik **-ō**, reduktimin e **-ā**-së së temës në **-ë** dhe heqjen e bashkëtingëllores së temës njërrrokëshe **mūs** > **mi**, **ghem** > **dhe** etj. Kështu përftimi i theksit dinamik në gjuhën shqipe del të jetë i kohës parahistorike, do të thoshim edhe më i lashtë se ç' ka menduar W. Meyer-Lübke.²

¹ Në Konferencën “Çështje të studimeve diakronike të shqipes”.

² W. Meyer-Lübke është shprehur se “kalimi nga sistemi i theksit të lirë indoevropian në sistemin e theksit të fiksuar të shqipes është vërtetuar që para depërtimit të elementeve latine... Në *Rumänisch, Romanisch, Albanesisch* – Mitteilungen des romanischen Institut an der Universität Wien, I, Heidelberg, 1914 – Sipas Sh. Demirajt, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f, 117.

Krijimi i theksit nënkupton se gjatësitë e vjetra të zanoreve të kohës së tonit ishin transformuar në tipare zanoresh më të hapura a më të mbyllura, më të prapme a më të parme dhe vetëm kur theksi binte mbi to. Këto tipare dalluese, që ishin shfaqur që në kohën e tonit, nën theks do të pësojnë një transformim gradual kualitativ duke përfunduar në zanore që i ka shqipja përmes procesit të kalimit nga sistemi me dy seri zanoresh në sistemin me një seri të vetme. Tani zanoret e theksuara ishin të gjata, ndërsa të patheksuarat – të shkurtra. Kjo lidhje e theksit me gjatësinë (përveç në zanoret fundore të patheksuara) tregon se kemi të bëjmë me një theks që A. Martinet e shënon si theks jo thjeshtësisht dinamik, por “më tepër kuantitativ se dinamik”, i cili, sipas tij, vetëm si i tillë mund të sqarojë ndryshimet që pësojnë zanoret e patheksuara.³

Por ky transformim i zanoreve është bërë edhe para krijimit të theksit dinamik. Kështu, siç dihet, kalimi $\text{ō} > \text{a}$, që është ndryshim i përbashkët me gjuhët gjermanike e baltike, është bërë shumë kohë para krijimit të theksit në gjuhën shqipe, i cili kujtojmë se nuk ka se si të mendohet jashtë vendosjes së protoshqipes në Ballkan. Ky ndryshim nuk arrin të huazimet nga greqishtja e vjetër. Po kështu jashtë efektit të theksit do të jetë bërë edhe ndërrimi $\text{ē} > \text{o}$, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet fazës $\text{ē} > \text{ā}$, sepse është kryer para kontaktit me gjuhën greke.

A. Meillet ka shënuar se ō e indoevropianishtes “ishte shumë e hapur”⁴ kështu që me këtë tipar ajo kaloi në a në gjuhët e shënuara, të cilat po nga tendencat në gjuhën ie. e kanë zhvilluar edhe ndërrimin $\text{ā} > \text{o}$, që e ka realizuar edhe shqipja, por më vonë, brenda huazimeve nga greqishtja e vjetër e kur e kishte theksin dinamik. Kjo mund të flasë se edhe ndryshimi $\text{ō} > \text{a}$ mund të jetë bërë më vonë pa kontakt me gjuhët gjermanike e baltike.

Ndërrimi i hershëm në gjuhën latine, ku ruhet gjatësia e tonit ($\text{ē} > \text{ō}$, $\text{ē} > \text{ī}$, $\text{ā} > \text{ū}$ etj.), shihet i shkaktuar jo më nga theksi i supozuar nistor di-

³ Në veprën *Économie des changements phonétiques*, Paris, 3 edit., 1970, f. 171.

⁴ Në *Uvod u uporedno proučavanje indoevropskih jezika* (përkthim i veprës *Introduction à l'étude comparative des langues indo-européennes*, Paris 1936), Beograd, 1965, f. 54.

namik brenda kohës së tonit, por, siç thuhet, nga dinamika e fjalës, d.m.th. nga rrethanat prozodike e kontekstuale të zanoreve. Edhe shqipja ka shembuj të ndërrimeve të ngjajshme, siç janë dy reflektimet e \bar{u} -së (-y-, -i), kalimet e \bar{o} -së në **u, vo-,va-,ve-**, katër reflektimet e \bar{e} -së e të tjera ndryshime që kanë mbetur ende të pasqaruara. Me studime në këtë drejtim do të mund të arriheshin rezultate. Këtij trajtimi do të duhej t'i nënshtrohej edhe kalimi $\bar{e} > \bar{a}$ i ndërrimit $\bar{e} > \bar{o}$ që, për shkak të ruajtjes së gjatësisë, nuk mund të jetë shkaktuar nga theksi.

Kalimi në kohë të ndryshme i zanoreve të tipit ie. në zanore që ka shqipja, d.m.th. të qëndruarit në të njëjtën kohë të zanoreve me gjatësi të tonit dhe të zanoreve të transformuara në zanore të sotme të shqipes paraqet një gjendje që e vështirëson tepër të kuptuarit e funksionimit të opozicioneve fonematike të këtij sistemi të përzier zanoresh. Kamarda këtë gjendje të parregullt e konsideron të shkaktuar nga natyra e zanoreve, të cilat në ndryshimet e tyre nuk u binden rregullave të përgjithshme.⁵

Mendohet se theksi dinamik i shqipes ishte i lëvizshëm.

Në këtë rast njëra mundësi, që do ta arsyetonte këtë lëvizje, do të ishte që edhe në protoshqipen theksi të kishte zënë vend në të njëjtën rrokje që zinte toni më parë, siç ka ndodhur në greqishten, në latinishten, në lituanishten e në disa gjuhë sllave, që do të thotë se do të kishte mbetur i lëvizshëm si toni e se do të ishte mbërthyer më vonë në një rrokje të caktuar të temës emërore.

Mundësia tjetër do të mund të ishte që në protoshqipen toni të kishte pësuar një rregullim mekanik si në latinishten, duke zënë pozitë në rrokjen e parafundit (me përjashtim kur penultima ishte e shkurtër) dhe theksi i shqipes të ketë rënë po në atë rrokje që binte toni, që do të thotë se lëvizte për të ruajtur pozitën në rrokjen e parafundit gjatë eptimit. Neve na duket më e besueshme që në protoshqipen të jetë zhvilluar kjo e dyta. Në këtë rast i ashtuquajhuri rregullim mekanik del të ketë qenë i kohës së tonit e jo i kohës së theksit.

Mendimi për lëvizjen e theksit në një kohë të lashtë në gjuhën shqipe

⁵ K. Topalli, *Shdërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2000, f. 56.

bazohet në disa shembuj të paktë nga gjuha e sotme Kështu përmenden *vesht / vësht* nga njëjësi **vénest-*, *vënesht-/ vëresht-*, nga shunësi **venést-*, *jetër* nga njëjësi **éter*, *tjerë* nga shumësi **etéri*. Neve na del se këtu përfundon lista e shembujve të tillë.

Shembulli (*i*) *poshtër* – mbiemër, *pështjerë* – ndajfolje nuk mund të merret si shembull i lëvizjes së theksit për të përfutur ndajfoljen nga mbiemri. E. Çabej, duke shënuar se *i poshtër* me **-r**-në e saj duket se ruan mbaresën e komparativit, ka lënë të kuptohet se theksi e gjeti si fjalë që mbaronte me **-ër**, si *motër*, *dimër*, *vepër* etj., prandaj zuri pozitën paroksitone që ka, ndërsa te *pështjerë* theksi ra mbi **-e-**, sepse ndajfolja kishte në fund një zanore, me të cilën dallohej nga mbiemri, prandaj theksi ra edhe këtu në pozitë paroksitone. Forma *shtërpinj* është përfutur nga rrënja *srep* që dha *shtrap* dhe nga prapashtesa e theksuar e kolektivit ***-inio**, siç e ka përcaktuar Jokli, pra nga *srepinio*, që nuk lidhet me emrin *gjarpën*, që rrjedh nga baza **serp-* (**srep*: **serp* është një dubletë rrënjësh si në latinishten serpo: repo < *srepo) dhe sufiksi ***-en**: **serpen*, i cili, si emër asnjans që ishte, e kishte shumësin me **-ā**: **serpenā*. Emri kolektiv *shtërpinj* më vonë u bë shumës i emrit *shtrap*. Po kështu duhet përjashtuar edhe shumësin *dhëndurë*, sepse **-urë** nuk është mbaresë shumësi, por prapashtesë, e cilësuar si e tillë edhe nga Xhuvani e Çabej e siç e tregojnë edhe shembujt: *lëkurë*, *pëlhurë* etj. Është thënë se kësaj prapashtese “nuk i dihet as gurra as lidhja që mund të ketë me trajtat e rumanishtes, të italishtes e të greqishtes”, në të cilat, po ashtu, nuk është mbaresë shumësi. Kështu mund të thuhet se edhe kjo prapashtesë e theksuar në këtë shembull do të ketë përbërë një emër kolektiv që me vonë ka kaluar në shënim të shumësit. Për *krahën* G. Meyeri është shprehur se është emër i formuar me sufiks **-en** si *dimën*, *emën* etj., që d.m.th. se theksi ra në pozitë paroksitone si te të gjithë emrat e temës në **-n**, **-r**. Nuk mund të kuptohet se si emri *gërhan* (krehër lesi) të vështrohet si shumës i emrit *krahën*. Këtu kemi të bëjmë me dy emra të përfutur nga një rrënjë me sufiks të ndryshëm: *krah-en* dhe *krah-anë* (folja *kreh*) dhe theksi në të dy ra në rrokje të parafundit.

Edhe vetëm me këta dy shembuj të shënuar dëshmohet lëvizja e moçme e theksit në protoshqipen. Këta janë shembuj të mjaftueshëm për të pranuar se theksi dinamik në fillimet e tij ka qenë i vendosur në një rrokje

të caktuar të temës, por i lëvizshëm gjatë eptimit të fjalës nominale. Lëvizja e theksit ka pasur lidhje me fleksionin e zhvilluar nominal.

Ndërkaq, të dy shembujt *vesht - vënesht* dhe *jetër - tjerë* e dëshmojnë lëvizjen e theksit vetëm në lidhje me shumësin. Në latinishten, në greqishten e vjetër e në të gjitha gjuhët që e kanë, lëvizja e theksit del e lidhur me shënimin e rasës në njëjës e në shumës.

Pse shqipja nuk e ka ruajtur lëvizjen e theksit për shkak të rasës, siç e kanë ruajtur gjuhët e tjera me fleksion dezinencial rasor?

Shembujt e gjuhëve të tjera tregojnë se, po të ishin mbaresat rasore të shqipes së sotme reflekse të mbaresave të vjetra të gjuhës së lashtë ie., theksi do të ishte edhe sot i lëvizshëm, duke ndjekur pozitën paroksite brenda formave rasore të tipit *fushavet, vepëravet, hekuravet* etj. Mungesa e kësaj lëvizjeje tregon se mbaresat rasore që ka shqipja nuk janë vijim i mbaresave indoevropiane. Të shtuara mbi formën e emërores shumë ato janë relativisht të reja, jashtë kohës së lëvizjes së theksit, d.m.th. pasi shqipja kishte mbetur pa fleksion dezinencial rasor. Ndryshe do të duhej thënë se në gjuhën shqipe nuk ka pasur lëvizje të theksit.

Këtu është e nevojshme të shtjellohet çështja pse shqipja nuk ka ruajtur asnjë shembull të lëvizjes së theksit për shkak të rasës, asnjë relik të tillë nga koha e mbaresave rasore të tipit ie.

Emrat e temave të shënuara dyrokëshe në *-ō* e në *-ā* gjatë lakimit nuk dilnin me ndonjë rrokje më shumë as në njëjës, as në shumës. Emrat e temës njërokëshe në bashkëtingëllore dilnin me një rrokje më tepër në rasat e njëjësit e të shumësit, por theksi nuk kishte pse të lëvizte, pasi në këto rasa zinte pozitën parafundore. Vetëm emrat e temës në *-n*, *-r* fitonin një rrokje më tepër gjatë formave rasore të njëjësit e të shumësit, për shkak se emërorja njëjës e këtyre emrave ishte me mbaresë zero. Kështu nevoja për ta lëvizur theksin në rrokje të parafundit për shkak të rasës do të duhej të kishte ekzistuar në kalimin nga emërorja – në rasat e varura në njëjës dhe nga emërorja e njëjësit në rasat e shumësit.

Kjo mungesë e dëshmisë për lëvizje të theksit për shkak të rasës nga koha e fleksionit rasor të tipit të gjuhës ie. do të jetë bazuar në faktin se në njëjës forma e emërores me mbaresë zero te emrat e temës në *-n*, *-r* mbeti e

vetnja formë pas humbjes së fleksionit dezinencial rasor, kështu që format e rasave të tjera bashkë me theksin e tyre paroksiton nuk ekzistonin më. Në shumës forma e emërores kishte rrokje të barabarta me rasat e tjera. Ajo mbeti formë e vetme e shumësit dhe, në raport me formën e njëjësit me mbaresën zero, kishte një rrokje më shumë, prandaj, theksi do të vazhdonte të qëndronte në pozitën paroksitone në shumës edhe pas humbjes së mbaresave rasore. Kjo lëvizje ishte tani e kufizuar, sepse dilte vetëm në rastet e emrave të temës paroksitone në **-n**, **-r**, meqë tema në **-ō** me rënie e këtij tingulli mbeti temë oksitone në bashkëtingëllore: *gjak, asht, tul* etj. dhe theksi në shumës nuk kishte pse të lëvizte, mbasi mbaresa e shumësit e mbante në pozitë paroksitone. Edhe emrat e temës paroksitone në **-ë** mbe-teshin paroksitonë edhe në shumës, sepse në vend të **-ë-së** vinte një mbaresë e shumësit. Kjo lëvizje e kufizuar e theksit në shumës vetëm te emrat e temës në **-n**, **-r**, do të jetë hequr nga përdorimi, sepse mungonte në të gjitha rastet e tjera. Dhe mbetën dëshmi deri në shqipen e sotme vetëm dy shembujt e shënuar.

Format *vesht* ~ *vënesht* nuk i takojnë temës paroksitone në sonantet -n, -r Lëvizja e theksit këtu ka arsye tjetër. Njëjësi **vënest** do t'i ketë takuar temës në **-ō**: *vënestō* si shembull i fjalës me theks nistor. Edhe shumësi kishte të njëjtat rrokje, por theksi kishte lëvizur në rrokjen e parafundit: *venéstoi, venésti* etj. e u ruajt edhe kur ra **-o**-ja nga njëjësi *vënest*, sepse shumësi vazhdonte të ishte me mbaresë edhe pas rënies së mbaresës **-i**. Me kohë forma e njëjësit do t'i përshtatet strukturës së temës që i takonte e do të kalojë në *vesht*.

PËR PARASHTESAT E SHQIPES STANDARDE

Parashtesat e latinishtes janë ndarë në tri grupe: në grupin e parashtesave me origjinë popullore, në grupin me origjinë diturore dhe në grupin e parashtesave me origjinë të huaj. Në grupin e parë disa gjuhëtarë kishin numëruar 27 parashtesa, në grupin e dytë 20 e në grupin e tretë tri, gjithsej 50.

Për të pasur një numër të saktë të parashtesave të mirëfillta të latinishes Knud Togeby (dhe jo vetëm ai) nga ky numër heq, siç thotë ai, partikulat nga grupi i parë që kanë kaluar edhe në gjuhën frënge: a, avant, contre, en, entre, fors, non, outre, par, plus, pour, sans, sous, sur, sus, tres- dhe format fleksive: bien, mal, mi, en; një formë anësore të fjalës bis- bes-; dhe vi-, që është formë e shkurtuar e vise-. Nga grupi i dytë heq: ante (avant), per (par), pro (pour), sub (sous), super, supra (sur), ultra (outré), inter-, dis- (nga dé), ré (nga re). Për grupin e tretë Togeby shënon: “Në grupin me tri, ca- nuk është morfemë, por- është partikulë, tanimë e eliminuar dhe para- është variant i foljes parer. Kështu mbesin 16 parashtesa: dé-, é-, mé-, pré-, re- të grupit të parë; abs-, circon-, con-, dis-, extra-, in-, inter-, ré-, super-, trans-, të grupit të dytë, plus një in- pozitive në importer, imposer”.

Në punimin “Parashtesat e gjuhës shqipe” A. Xhuvani e E. Çabej kanë shënuar 82 parashtesa, prej të cilave, për gjuhën standarde duhet të hiqen në radhë të parë parashtesat dialektore. Parashtesa të tilla janë: 1. akë-, 2. c -(s-z-), 3. ciri-, 4. ciru-, 5. ç- (për sh-), 6. çara-, 7. çili-, 8. kata-, 9. Katra-, 10. kor(r)o-, 11. nj-, (nje-, nji-), 12. pala- 13. pici-, 14. pili-, 15. pre-, 16. pro-, 17. qe- (q-, qi-), 18. që-, 19. surru-, 20. tu-. 21. x-. Në *Gramatika e gjuhës shqipe* për tërë shqipen janë shënuar 64 parashtesa. Nga ky numër (61) duhet të hiqen parashtesar e huaja shumica e të cilave, siç shënojnë autorët, “Janë marrje të gatshme fjalësh të huaja”. Këto janë: 1. anti, 2. kara-, 3. koco-, 4. kolo-, 5. kse-, 6. ma-, 7. po-, 8. pro-, 9. shtë- / shtër-, si dhe 10. shala-, 11. zdër- që janë tepër pak të përdorshme. Për të përfutur parashtesat e mirëfillta, që nuk kanë përdorim tjetër përveç funksionit të parashtesës, duhet të largohen fjalët që, duke qenë parafjalë, pjesëza e ndajfolje përdoren edhe si parashtesa. Ato mbesin në kategorinë e tyre (parafjalë, pjesëza a ndajfolje) edhe kur funksionojnë si parashtesa, d.m.th. se nuk

mund të numërohen si parashtesa. Këto janë: 1. bashkë-, 2. e- (në e-sëll, e-gjëll) 3. jo-, 4. kollo- (pezhorative), 5. kundër-, 6. m(ë)-/ mb(ë)-, 7. mbi-/ mi-, 8. me-, 9. mos-, 10. ndaj-, 11. n(ë)-, 12. nën-/ ndën-, 13. nëpër-/ ndëpër-, 14. nër-/ ndër-, 15. pa-, 16. para-/ parë-, 17. pas-/ mbas-, 18. për-, 19. përmbi-/ përmi-, 20. prapa-/ mbrapa-, 21. t(ë)- (nyjë e përparme), 22. tej-, 23. u-, 24. x- , 25. xh- e përdorur në vend të parashtesës ç-.

Kështu rezulton se tërë shqipja ka 25 parashtesa të mirëfillta: 1. a-, 2. b(ë)-/ bër-, 3. dë-, 4. f-, 5. g(ë)-/ gër-, 6. kë-, 7. kaca-/ kac-/ kaça-, 8. kakë-/ kakër, 9. kala-/ kali-, 10. ko-/ koko-, 11. ku-/ kuku-, 12. l(ë)-/ la-/ li-/ lu-, 13. r(ë)-/ rr(ë)-, 14. ri-, 15. s-/ së-, 16. skë-/ skër-, 17. spër-, 18. stër-, 19. sh-, 20. shka-/ skala-/ shakara-/ shkarra-/ shkë-/ shkël-/ shkër-, 21. shpër-, 22. tër-, 23 v(ë)-, 24. z-, 25. zh-.

Nga këto parashtesa 10 konsiderohen të trashëguara nga gjuha e lashtë indoevropiane: 1. a-, 2. d(ë)-, 3. e-, 4. f-, 5. gë-, 6. kë-, 7. lë-, 8. s-, 9. sh-, 10. vë-⁶

Nga shënimet e Xhuvanit e të Çabejt shihet se :

1. Parashtesat më ekstensive që përdoren me emra, mbiemra, folje e ndajfolje janë parashtesat r(ë)- / rr(ë)-, s- / s(ë)-, sh-. Pas këtyre vijnë parashtesat që përdoren me emra, me folje e me ndajfolje:

2. kala-, tër-, bashkë me parashtesën z-, që përdoret me emra, me mbiemra e me folje.

3. Më pak të përdorura janë parashtesat bë-/ bër-, kakë-, ko-/ koko-, ku-/ kuku- që shkojnë me pak emra, f-, shka-/ shkala-/ shkara-/ shkarra, spër- dhe zh-, që dalin me pak folje. Shumë pak e përdorshme është edhe parashtesa skë- / skër-.

4. Parashtesat deiktike a- dhe kë- kanë përdorim të kufizuar me për-emra dëftorë e të pakufishëm e me ndajfolje përemërore.

5. Mjaft produktive janë parashtesat që përdoren edhe me emra dhe me folje. Këto janë: dë-, vë-, gë-/ gër-, kaca-, lë- / li- / lu-, ri-, stër-shpër-.

⁶ Shih Kolec Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011, f. 1157-58 . Në nuk e kemi shënuar parashtesën e-, sepse paraqitet vetëm në dy shembuj: e-sëll, e-gjëll.

POLITIKA GJUHËSORE NË DISA VISE TË JUGOSLLAVISË¹

Tema “Çështje aktuale rreth toponimeve dhe antroponimeve të shqipes”, që e ka vënë sot në shqyrtim Instituti Albanologjik në vazhdë të realizimit të programit të tij të punës, është temë që përmblihet në çështjen e politikës gjuhësore, e cila ka të bëjë me aplikimin e të drejtës së përdorimit të gjuhës amtare. Për shkak të gjerësisë së dukurive që dalin në këtë temë, ndihmesën e tyre sqaruese e interpretuese mund ta japin dijetarë e specialistë nga fusha të ndryshme të shkencave shoqërore.

Politika gjuhësore është edhe temë që në gjuhësi shqyrtohet në kuadër të studimeve të bilinguizmit e të kontaktit të gjuhëve. Gjuhësia, ndërkaq, mund të përcaktojë vetëm natyrën dhe peshën shoqërore të mospërfilljeve a të keqtrajtimitve konkrete të gjuhës anëtare në segmente të ndryshme të jetës, duke tërhequr kështu vërejtjen për nevojën e një kontrolli permanent juridik mbrojtës në përputhje me politikën e aprovuar kombëtare.

Në shqyrtimin e çështjeve të politikës gjuhësore, gjuhësisë i imponohet terminologjia politike. Kështu në këtë lëmë përcaktohet shovinizmi gjuhësor, i cili manifestohet në rastet kur personi që ka gjuhë amtare një gjuhë të prestigjit botëror nuk nxë asnjë gjuhë tjetër, edhe pse asnjëra gjuhë nuk e ka “monopolin për dije universale”. Nga kjo kuptohet se ç’shkallë shovinizmi është ajo kur individët që jetojnë në një mjedis dygjuhësor nuk e nxënë gjuhën tjetër që përdoret aty pranë tyre tërë jetën, pa e pasur as arsyen e prioritetit të gjuhës së tyre si për formimin intelektual të individit ashtu edhe për nivelin e njohjes së saj në përmasa botërore në raport me gjuhën e injoruar. Është rasti këtu i nënçmimit të gjuhës dhe të kombësisë tjetër, i madhërimit të gjuhës së njërit komb dhe i përdhosjes së ndjenjës së barazisë së njerëzve. Mosnxënia e gjuhës tjetër, siç është rasti me gjuhën shqipe, nuk mbetet formë e vetme e shovinizmit gjuhësor. Ai manifestohet pastaj përmes përpjekjeve të vazhdueshme për ngushtim të përdorimit

¹ Kumesë në tryezën gjuhësore të Institutit Albanologjik, botuar në revistën Gjuha shqipe, 1, 1987.

publik të saj, gjithnjë nën parulla të një interesi më të lartë, por në fakt me qëllime të qarta unitriste e asimiluese. Ndër të tjera, të kësaj natyre janë rastet e mospranimit në Shkup të dëftesave shkollore të plotësuar në gjuhën shqipe, në gjuhën e të diplomuarit dhe rasti i mospranimit kategorik të shqipes në pasaportë vitin e kaluar nga personat zyrtarë kufitarë (në vendkalimin për Greqi), pas një kohe disavjeçare të respektimit të saj edhe në këtë përdorim, në përputhje me të drejtën kushtetuese se gjuhë zyrtare në Jugosllavi janë gjuhët e kombeve e të kombësive, në bazë të së cilës edhe janë plotësuar shqip pasaportat nga organet kompetente. Një përpjekje individuale kjo e këtyre personave për ta rregulluar ndryshe e “më mirë” çështjen e gjuhës zyrtare, të bindur që më parë, besoj, se kjo nismë “qëllimmirë” nuk do të ndëshkohej. Këto momente janë shkelje të së drejtës së qytetarëve për përdorim të sanksionuar të gjuhës së tyre në një shtet federal, në të cilin, vërtet nuk aplikohet parimi i bilinguizmit personal a individual si formë më e lartë e respektimit të gjuhëve brenda një shteti, kur individit i ofrohen shërbimet në gjuhën e tij në tërë territorin e shtetit, por, në përbërjen e tij multinacionale, ka dalë i përshtatshëm parimi territorial i komunikimit në gjuhën e individit në territore të ndryshme të tij në bazë të homogjenitetit kombëtar të popullsisë. Nën politikën e të drejtave të barabarta të popujve në të, Jugosllavisë iu ka përshtatur po ashtu edhe qëndrimi që të mos shpallet zyrtare gjithëshitetore asnjëra gjuhë, duke mënjeluar kështu gjithë ato konflikte të rënda ndërnacionale që do të sillte caktimi i njëres si të tillë, siç ka ndodhur e ndodh për shembull në Indi sa herë që bëhen përpjekje të tilla e siç ka ndodhur edhe në Belgjikë, kur s’përfillej gjuha flamane.

Është e njohur se personat që flasin gjuhën e një kombësie në një krahinë të caktuar janë nën presion të vazhdueshëm të gjuhës tjetër që ka një status tjetër shoqëror si gjuhë e shumicës në një republikë. Presioni i maqedonishtes e i serbokroatishtes ndaj shqipfolësit ushtrohet në tërë jetën e tij publike: në punë, në shkollë, në qeverisje e përmes radios, televizionit, kinemasë, shtypit etj. Përveç kësaj, ai është nën presion që të bëhet bilinguist që në fazat e hershme të jetës së tij, duke bartur të gjitha pasojat e njohura negative në formimin e tij intelektual e psikik. Këto janë, natyrisht, pasoja të pamundësisë së krijimit të barazisë së plotë të gjuhëve nën parimin territorial. Ndërkaq, kjo gjendje e disfavorshme e gjuhës së kombësisë,

që e bën gjuhë të rangut të dytë edhe në komunat me të drejtë dygjuhësie, mund të bëhet vatër, nga e cila, në kushte të mungesës së theksuar të traditës demokratike e të përkujdesjes shoqërore, mund të voken e të ngjallen bindje të deformatuara për perspektivën e dygjuhësisë me pasoja të veprimeve asimiluese. Pozita e pabarabartë si më sipër shkon gradualisht e bëhet, në mendjen e individëve të gjuhës dominuese, edhe në planin publik, e drejtë absolute e asaj gjuhe, privilegj i dhënë i saj dhe i kulturës së shprehur në të, bëhet pozitë “e merituar” edhe për shkak të “tingëllimit më të bukur”, të shkrimit “më të pashëm”, të shprehjes “më të përsosur e më të saktë” e të strukturës së saj “ideale”, shkon e bëhet pra një vetëdije nacionaliste, të cilën e pengon përdorimi i gjuhës tjetër në kontakt, i duket e tepërt prania e saj e si rezultat i një oportunitizmi politik me karakter dezintegruues, që çrregullon komoditetin njëgjuhësor të tyre.

Gjersa në nivel të Jugosllavisë parimi territorial i bilinguizmit është akt decentralizues, nëpër republika ka forca që ende ushqehen nga koncepti nationalist i shekullit të kaluar e i fillimit të këtij shekulli për shtetin, koncepti që shprehej me aksiomën: “një shtet, një popull, një gjuhë”. Këto forca, përmes shtypit e në jetën e përditshme, lavdërojnë individët e kombësisë shqiptare që shprehen kundër nevojës për shkollim në gjuhën shqipe, kundër përdorimit të garantuar të shqipes në Mal të Zi, ashtu si dhe më parë kundër përdorimit të flamurit kombëtar. I mbajnë këta individë të paktë si njerëz më të përparuar nga radhët e shqiptarëve, më të liruar nga “ngarkesat e përkatësisë kombëtare”. Kundër një trajtimi të tillë të tyre nuk mbetën pa ngritur zërin edhe njerëz të kombit malazias. Paraqitja e të tillëve nga kombësia shqiptare nuk është befasuese, sepse fundërrina të tilla njerëzore ka pasur në çdo komb në rrethana të caktuara historiko-shoqërore, por është për keqardhje se si ka qenë e mundur të krijohet atmosfera që favorizon paraqitjen dhe vlerësimin e tyre si prototipa për një prodhim të dëshiruar serik, që do ta zgjidhte çështjen kombëtare përfundimisht në dobi të lundrimit të qetë të aspiratave nacionaliste.

Qëndrimet e tilla unitaritare brenda një njësie federale janë të fuqishme dhe agresive dhe kanë ndikim të madh në opinion. Për nga perspektiva historike ato janë anakronike, ashtu siç janë antidemokratike dhe në kundërshtim me vetëqeverisjen si sistem marrëdhëniesh shoqërore që shënon

një decentralizim të theksuar të pushtetit, i cili edhe në gjuhësi merret si parakusht për modalitete më të favorshme të të drejtave të përdorimit të gjuhës së kombësisë e të realizimit të një shkalle më të lartë të të drejtave kombëtare.

Përdorimi i gjuhës shqipe nëpër vise të ndryshme në Jugosllavi praktikisht duket se realizohet gati-gati në të katër tipat e njohur të bilinguizmit: nga tipi *integral*, siç është gjendja në Kosovë, ku të gjitha materialet shënohen në dy gjuhë (ose edhe në tri), edhe pse në të folur nëpër forume përdoret më tepër serbokroatishtja, deri te tipi *unileter*, kur në shkrim përdoret vetëm njëra gjuhë e flitet në të dyja, siç është gjendja, duket jo e izoluar, në shkollën “Liria” të Shkupit, ku, edhe pse mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, vula dhe emri i shkollës shënohen vetëm në gjuhën maqedone, gjë që lë të kuptohet se edhe komunikimi reciprok me shkrim midis organeve të shkollë dhe nxënësve shqiptarë e prindërve të tyre bëhet vetëm në këtë gjuhë.

Brenda këtij tipi diskriminues të bilinguizmit bën pjesë edhe unifikimi i toponimeve për të gjitha gjuhët brenda një bashkësie shoqërore-politike në bazë të toponimeve të njëres gjuhë. Cilat arsye do të jenë aq madhore, cilat arsye – aq dobiprurëse shoqërore e njerëzore që do ta arsyetonin heqjen nga gjuhët e kombësive të toponimeve të tyre tradicionale për të njëjtat vende e treva në Maqedoni? Toponimet janë pjesë e pandashme e një gjuhe e të pakorrigjueshme nga jashtë. Detyrimi që në gjuhën shqipe në Maqedoni të përdoren nëpër libra, në shkollë e kudo në të shkruar e deri edhe në të folur zyrtar toponimet e maqedonishtes është ndërhyrje e dhunshme në strukturën e saj. Është e drejtë e paqenë e çfarëdo subjekti që të mund t’i imponojë ato me dekret. Në të nënkuptohet urdhri absurd që ato të ruhen në gjuhën shqipe të paadaptuara e gjithnjë sipas ndryshimeve që do të pësojnë në maqedonishte, urdhër që s’e pranon dot jeta e gjuhës. Toponimet që ka shqipja për territorin e Maqedonisë janë krijuar në kontinuitet të pandërprerë të pranisë së saj në këto treva, qofshin kur janë me burim të saj si Shkupi, Sharri, Shtipi etj., qofshin kur janë të huazuara nga sllavishtja e turqishtja dhe gjatë kohës iu kanë nënshtuar ndryshimeve fonetike etj. nëpër të cilat kanë kaluar edhe fjalët e tjera të shqipes nëpër periudha të caktuara. Shqipja nuk është gjuhë e huaj në

Maqedoni, që të fshihen toponimet e saj si të ndonjë gjuhe të kolonizatorit të dëbuar. Ajo është gjuhë e gjallë e popullit në të.

Tentime për t'i unifikuar toponimet sipas toponimisë së serbokroatishtes ka pasur edhe në Kosovë para Plenumit të Brionëve, por edhe në atë kohë ato janë ndërprerë, sigurisht për shkak të efektit tepër negativ edhe për atë kohë, që do të kishte ky akt në marrëdhëniet ndërnacionale.

Mosshënimi i toponimeve të një gjuhe brenda mjedisit ku ajo flitet e shkruhet është thjerrëz që e bën tepër të dukshme shkallën e lirisë së përdorimit të gjuhës amtare, të respektimit të dygjuhësisë dhe, natyrisht, edhe shkallën e respektimit të të drejtave kombëtare.

Edhe mbiemrat me **-iq** të shqiptarëve në Mal të Zi në aspektin gjuhësor janë futje me pahirë e së huajës në formimin e emrave të atyre të familjeve, respektivisht të patronimeve, ndërsa ruajtja e vazhdueshme e tyre në aspektin politik mund të kuptohet vetëm si shenjë nostalgjie ndaj të drejtave të pakicave kombëtare në Jugosllavinë e vjetër.

Në ditër tona forcat hegjemoniste, nën parullën e luftës së nacionalizmit shqiptar, veprojnë për të arritur qëllimet e veta, duke u përpjekur ta kufizojnë përdorimin e gjuhës shqipe, ta ngushtojnë mundësinë e shkollimit në gjuhën amtare, ta reduktojnë programin e letërsisë shqipe e, në përgjithësi, t'i cungojnë të drejtat kombëtare. Ato shfrytëzojnë çdo mundësi që edhe atë që është e pastër kombëtare ta shpallin nacionaliste. I tillë është edhe rasti, kur arsimtarët e një shkolle filllore në Komunë të Tetovës vendosin t'ia ndërrojnë emrin "Skënderbeu" shkollës së tyre e t'ia vënë "Liria". Me ndërgjegjen e tyre "të lartë" prej edukatorësh ata dhanë kontribut që t'i shpëtonin nxënësit e dashur nga "indoktrinimi nationalist" që e shkaktuaka emri i heroit kombëtar i po këtyre nxënësve, pa e kursyer në këtë rast as lirinë nga ky ironizim kaq i vrazhdë. Në presionin e të tillëve do të jenë krijuar edhe listat që e ndalojnë përdorimin e disa emrave të njerëzve nëpër disa komuna të Maqedonisë, sepse shprehin "përmbajtje nacionaliste". Këta emra, sa më kujtohet nga shënimet në shtyp, janë: Liridon, Alban, Arbër, Kastriot, Shpresë, Shqipe e ndonjë tjetër. Nga këto qarqe të këqijat vijnë kaluar njëra pas tjetrës. Ato s'do të kenë të ndalur e do të lënë vrage të thella në marrëdhëniet ndërnacionale, përderisa forcat përparim-

tare e përgjegjëse të qëndrojnë pasive para tyre. Të ndalohet që foshnjave t'u jepen emra që kanë të bëjnë me përkatësinë kombëtare a etnike si Ilir, alban, Arbër, të ndalohet emri Kastriot për shkak të Gjergj Kastriotit, Shqipe, mbase për shkak të gjuhës shqipe apo të shqipes në flamur, të mos lejohet t'i jepet Shpresë aty krejt pranë Nadës e Liridon pse e ka kuptimin e atij që e do lirinë dhe fëmijëve që i kanë që më parë këta emra të mos u lejohet të regjistrohen në shkollë pa i ndërruar, kjo është shëmti e përsosur e primitivitetit shpirtëror të shovinizmit. Do të duhej në këtë kontekst të urohet shqipja që nuk e ka krijuar emrin Shqiptarodon a Shqiptardashës, siç e ka krijuar serbokroatishtja Serbolub, sepse e ka shpëtuar kështu ndonjë prind të këtyre komunave nga anatemi edhe më i ashpër politik.

Fausti vdes në çastin kur i shkon mendja ta ndalë kohën. Përpjekje për ta kthyer mbrapa mund të bëjnë ata që ngjallen nga motet e errëta. Helmin e rëndë të kafshimeve na e sjellin që andej.

NGA BISEDAT NË BEOGRAD¹

[...]

Krijimi i gjuhës unike standarde është vlerësuar gjithmonë si akt shumë i rëndësishëm kulturor i një populli. Ai - thuhet - ia hap rrugët depërtimit të kulturës, shkencës e teknologjisë kulmore në masat popullore. Ai është – thonë më tej – akt që tregon shkallën e lartë të përparimit të një populli dhe është bazë e domosdoshme e përparimit të më tejshëm në ritmin e zhvillimit të kulturës moderne. Gjuha letrare e një populli - thonë – integron forcat e saj krijuese nga të gjitha anët që të ndikojnë në mënyrë të barabartë në pasurimin e kulturës kombëtare të pandalshme. Thonë se ajo shpreh identitetin kombëtar, unitetin e kulturës, me të cilat një popull hyn në marrëdhënie me të tjerët, i aftë të respektojë të tjerët dhe i denjë për respekt nga të tjerët.

Gjuha letrare shqipe - thonë - është ngjarje e ndritshme që kurorëzoi mundin e gjeneratave të gjuhëtarëve më të mirë dhe të intelektualëve më përparimtarë të popullit shqiptar qysh nga koha e Rilindjes. Dhe thonë fill e mbarim se është e drejtë e secilit popull të vendosë vetë për krijimin, normimin dhe kodifikimin e gjuhës së tij letrare të njësuar. Por te ne disave kjo nuk u ka pëlqyer vetëm sa i përket gjuhës shqipe të njësuar. Te shqiptarët, kanë thënë ata, kjo vepër është prapanike dhe e rrezikshme. Ata kanë thënë botërisht përmes shtypit se është gabim që gjuha shqipe e njësuar të hyjë në përdorim edhe ndër shqiptarët në Jugosllavi. Kanë thënë se për ata është dashur të krijohet një gjuhë standarde tjetër soji, d.m.th. tjetër fare nga ajo që përdoret në Shqipëri. Nuk ka rëndësi ajo që pjesëtarët e nacionaliteteve të tjera në Jugosllavi përdorin gjuhën letrare të shtetit amë, si për shembull hungarezët, rumunët, italianët, turqit etj. dhe si sllovenët e kroatët në Itali e Austri. Me rëndësi, kanë thënë, është që vetëm shqiptarët

¹ Nga bisedat në mes shkrimtarëve të Kosovës e të Serbisë në Beograd - qershor 1986. Pjesë nga kumtesa ime që nuk është ruajtur, e që është publikuar nga Zekeria Cana në librin e tij *Apeli i 215 intelektualëve*, Prishtinë, 2002, si tekst i përkthyer prej tij nga serbishtja.

të kenë gjuhë të ndryshme. Në këtë frymë disa “shkencëtarë” në Mal të Zi kanë zbuluar se e folmja shqipe e Malësisë na qenka gjuhë tjetër që ndryshon nga shqipja dhe se ky dallim mbështetet në histori. Është thënë madje se malësorët janë tjetër popull dhe e gjithë kjo është botuar në gazetatat qendrore, siç është *Borba*, sigurisht si “kontribut serioz” në diskutimin rreth krijimit të gjuhës së veçantë letrare shqipe në Mal të Zi.

Derisa në shkallë të Jugosllavisë parimi territorial i dygjuhësisë është akt demokratik, nëpër republika ka forca të ndryshme e edhe burokratike, që ushqehen nga koncepti nacionalist i shekullit të kaluar dhe i fillimit të këtij shekulli që shprehej me aksiomën “një shtet, një popull, një gjuhë”. Dhe janë pikërisht këto forca që e bëjnë të mundur realizimin në praktikë të devijimeve nga përcaktimet e miratuara. Këto forca, përmes shtypit e në jetën e përditshme, lavdërojnë individët e kombësisë shqiptare që shprehen kundër nevojës për shkollim në gjuhën shqipe, kundër përdorimit të garantuar në Mal të Zi e Maqedoni, ashtu si dhe më parë kundër përdorimit të flamurit kombëtar. I shpallin këta individë të paktë si njerëzit më të përparuar nga radhët e shqiptarëve, më të liruar nga “ngarkesat” e përkatësisë kombëtare, në të vërtetë i shpallin prototipa për një prodhim të dëshiruar serik. Përdorimi i mbiemrave me -iq nga shqiptarët në Mal të Zi është futje me pahir i së huajës në gjuhën shqipe - në formimin e mbiemrave të familjeve, përkatësisht të patronimeve. Në qoftë se shqiptarët vërtetë kërkojnë vetë t’i kenë të tillë, atëherë motivi për ta bërë këtë e akuzon gjendjen e marrëdhënieve ndërnacionale.

Unifikimi i toponimeve të Maqedonisë sipas atyre që ka maqedonishtja, d.m.th. përjashtimi nga gjuhët e kombësive të toponimeve të tyre tradicionale për të njëjtat vende e treva është bërë në praktikë i detyrueshëm. Në gjuhën shqipe sot përdoren nëpër libra në shkollë e kudo në të shkruar e në të folur zyrtar toponimet e maqedonishtes. E dihet se toponimet janë pjesë e pandashme e një gjuhe dhe pjesë e pakorrigjueshme nga jashtë. Toponimet që i ka shqipja për territorin e Maqedonisë janë krijuar në vazhdimësi të pandërprerë të pranisë së saj në këto treva, qofshin kur janë me burim nga lashtësia si Shkupi, Sharri, Shtipi etj., qofshin kur janë të huazuara nga sllavishtja e turqishtja dhe gjatë kohës u janë nënshtruar ndryshimeve fonetike e adaptimeve nëpër të cilat kanë kaluar edhe fjalët e

tjera të shqipes. Shqipja nuk është gjuhë e huaj në Maqedoni, që të mund t'i fshihen toponimet e saj si të një gjuhe të kolonizatorit të dëbuar. Ajo është gjuhë e gjallë e popullit në këtë vend, e popullit, që bashkë me maqedonasit e turqit përbën R. S të Maqedonisë. I tërë absurditeti i këtij qëndrimi, si në raport me shqipen e shqiptarët, ashtu edhe në raport me Kushtetutën e me botën përreth, u nxor në shesh edhe në një sesion gjuhësor në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe materiali është botuar, kështu që nuk ka vend ta shkoqisim këtu. Duhet shënuar se ka edhe kërkesa e procese që kjo punë të sanksionohet edhe me ligj dhe se, për befasi, kjo gjë kërkohet edhe nga disa shkrimtarë e shkencëtarë. Që nga krijimi i RS të Maqedonisë e deri para një viti shkollimi i mesëm i shqiptarëve bëhej në gjuhën amtare. Tani, për dy vjetët e fundit të shkollimit është hequr gjuha shqipe dhe nxënësit shqiptarë janë të detyruar të vijnë në mësimin vetëm në gjuhën maqedone në të ashtuquajturat “paralele të përziera”. Edhe në Shkollën pedagogjike nuk ka më mësim në gjuhën shqipe. Nëpër komuna ka mospërfillje të dygjuhësisë. Në shtyp janë shënuar raste të moslejimit të mbishkrimeve në gjuhën shqipe. Të gjitha këto reduktime kundërshtuese të përdorimit të gjuhës shqipe bëhen në emër të ndihmës që i jepet popullit shqiptar “për të luftuar nacionalizmin” nga radhët e tij.

Vërtet është e pakuptimtë të merremi me arsyet e trajtimit e të vlerësimeve të këtilla të gjuhës letrare shqipe të njësuar, sepse ato burojnë nga mënyra primitive e rezonimit të krijuar nga ekskluziviteti nacionalist, i cili funksionimin e tij e mbështet në trillimin e rreziqeve që i kanosen bashkësisë sonë. Mirëpo puna ka qenë megjithatë serioze, sepse edhe disa anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë kanë menduar se shqiptarëve në Jugosllavi nuk është dashur t'u lejohej përdorimi i gjuhës letrare shqipe të njësuar, gjë që shihet nga ajo që ka dalë në opinion prej Memorandumit të papërfunduar. Kështu, arsyet e qëndrimit të tillë tash janë në duart e “shkencës” së lartë, ndaj do të ishte shumë me interes të na bëhet e mundur t'i dëgjojmë. Sa më përket mua, jam i sigurt që do të përmbahem nga të qeshurit.

II. ÇËSHITJE BALLKANISTIKE

FORMAT E FUTURIT TË SHQIPES NË PËQASJE ME ATO TË GJUHËVE BALLKANIKE¹

1. Për një futur të lashtë sintetik të protoshqipes

Futuri sintetik me ***-syǫ**, që nuk ishte i gjuhës së lashtë ie., por që e kishin krijuar disa gjuhë, si gjuhët indo-iraniene e baltike e që e ka edhe greqishtja e vjetër në formën **-sō**,² dëshmohej se ishte edhe i protoshqipes në formën e pjesores pësore të futurit me **-shëm** < ***-syǫ** + ***-mǫ**: [i thyeshëm, i dukshëm, i pishëm etj.]. Prapashtesën ***-mǫ** ~ ***-mā**, siç jemi shprehur në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, (Prishtinë, 1980) e zbulojnë si formant të participit mediopasiv të njëkohësisë emrat si **bimë** = që bin, **mjelm** = që millet, **pështymë** = që pështyhet, **frymë**, **shkelm** etj., që dalin të nominalizuar në të dy gjinitë. Eric Hamp-i në vitin 1973 e kishte barazuar prapashtesën **-m** të shqipes me atë të baltosllavishtes e të luvianishtes, ku ajo e kishte vlerën e shënuesit të participit pasiv të prezentit ashtu si dhe në gjuhën shqipe, duke u shprehur se kjo “e rrit listën e lidhjeve baltosllave dhe shqipe”. Edhe në greqishten e vjetër mbi futurin me **-sō** është shtuar prapashtesa **-meno-** e mediopasivit të njëkohësisë për të krijuar participin medial të futurit (*lusómenos*), të futurit ekzakt (*lelusómenos*) dhe të futurit të dobët (*ludhesómenos*). Trajtimi i prapashtesës **-shëm** si formant i dikurshëm i participit pasiv të futurit mbështetet edhe në kuptimin që e zbulojnë mbiemrat deverbativë të tipit i thyeshëm = që mund të thyhet, a më parë: që do të thyhet, i pishëm = që mund të pihet a që do të pihet, i përdorshëm = që mund të përdoret a që do të përdoret etj.

Kuptohet se prapashtesa **-mǫ** ~ **-mā** nuk mund të bëhej prapashtesë e participit të futurit kur shënonte participin pasiv të prezentit, por kur ende nuk e shënonte kohën, d.m.th. kur ishte formant i mediopasivit të njëkohësisë. E. Hamp-i, në kundërshtim me N. Jokl-in, është kategorik se **-m** nuk është

¹ Kumtesë në Konferencën “Shqipja dhe gjuhët e Ballknit” – Prishtinë.

² Greqishtja kishte dy forma të futurit, njërin me **-mai** – nga një lidhore e vjetër, tjetrin me **-sō** nga deziderativi i vjetër, Pierre Monteil, *Eléments de phonétique et de morphologie du latin*, Paris, 1986, f. 329.

të zvogëlim i prapashtesës **-meno-** (apo **-mno**), por është vetëm refleksi i prapashtesës ***-mō**. Nga sa u shënuar del se edhe përftimi i participit pasiv të futurit është i kohës së afërisë baltosllave të protoshqipes ashtu si dhe forma e futurit me ***-syo** dhe e participit pasiv të prezentit me prapashtesën **-mō-** **mà**, që do të thotë se janë shumë më të hershëm se kontakti i protoshqipes me greqishten.

Futuri me ***-syo** i protoshqipes ka arritur të jetë formë e vetme e futurit për të gjitha foljet, që domethënë se kishte kaluar nëpër një proces përgjithësimi, duke nxjerrë nga përdorimi ndonjë formë tjetër të futurit, si në disa gjuhë të tjera, ku është përgjithësuar vetëm një futur i vjetër. Kjo nuk ka ndodhur as në greqishten e vjetër, as në latinishten, gjë që mund të flasë për një kohë më të vonë të krijimit të këtyre formave të futurit në ato gjuhë.

Mendimi i Jokl-it, pranuar nga Sandfeld-i, Riza, Hamp-i e ndonjë tjetër se habitortja p.sh. **qenkam** është përftuar nga përngjitja e formës së futurit që paska qenë sipas tij **qenë kam** me pjesën **qenë** në vlerë të paskajores **me qenë**, d.m.th. me kuptimin **me qenë kam = kam me qenë**, është i pasaktë, ashtu siç janë të pasakta edhe mendimet e disa gjuhëtarëve që i shohin format e pjesores pësore të së kryerës si forma orgjinalisht të paskajores së lashtë në shprehjet **duhet/ do mbjellë** dhe **tue/ duke mbjellë**, d. m.th. edhe në **me mbjellë, pa mbjellë** etj.³ Kjo është në përputhje me mendimet e shumë studiuesve se protoshqipja nuk kishte krijuar ndonjë formë sintetike të infinitivit.⁴

2. Forma e futurit *kam + infinitiv*

Paskajorja *me+forma e pjesores pësore e së kryerës* (me dalë, me mbjellë) është përftuar para krijimit të mbiemrit të nyjshëm, domethënë brenda huazimeve latine para sh. VI të erës sonë, kështu që ishte e tërë shqipes, ashtu si dhe privativi *pa dalë, pa mbjellë*. Nyja e përparme e mbi-

³ Shih vërejtjet për paqëndrueshmërinë e këtyre vlerësimeve në veprën *Pjesorja e shqipes – Vështrim diakronik*.

⁴ Për futurin me **-syo* në protoshqipen kemi folur në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*.

emrit është përftuar shpejt pas këtyre huazimeve latine deri nga sh. VIII.⁵

Edhe perifraza **kam** + **infinitiv** (kam me dalë, kam me mbjellë etj.) imponohet të shikohet e përftuar shpejt pas krijimit të kësaj paskajoreje. Po kur kjo perifrazë do të ketë kaluar në futur?

Futurin **kam** + **infinitiv** në gjuhën shqipe Sandfeldi e disa të tjerë e shohin të përftuar nën ndikimin e latinishtes, ashtu siç është, sipas tyre, në rumanishten, në bullgarishten e greqishten bizantine.

E. Benveniste-i ka shënuar se perifraza **habeo**+**infinitiv** për një kohë shumë të gjatë nuk ka pasur mundësi të kalonte në futur e ta zëvendësonte futurin e lashtë me **-bo** (cantabo etj.) për shkak se kishte një vlerë semantike “krejtësisht të ndryshme nga vlera e synimit që e shoqëron nocionin e futurit”. Kjo perifrazë ka pësuar ekstension duke kaluar në fjali të lirë nga fjalia e varur dhe me infinitiv nga të gjitha foljet e se “ky ekstension është përftuar shumë vonë (sh. VI –VII)”. Pas kësaj kohe të dy shprehjet “janë takuar dhe në kushte të ndryshme të përdorimit janë përzier. Në të njëjtën kohë është realizuar progresivisht fiksimi i renditjes **infinitiv** + **habeo** dhe fuzioni i dy pjesëve përbërëse. Është ky transformim i sintagmës në një formë unike që e ka bërë të aftë të marrë në paradigme vendin e futurit të vjetër”.⁶

Ne jemi shprehur se në gjuhën shqipe forma perifrastike **kam**+**infinitiv** (kam me mbjellë etj.) burimisht nuk ka mundur të shprehte kuptimin e futurit, sepse infinitivi pas foljes **kam** do të ishte në funksion kundrinor. Nga kjo lidhje me foljen **kam** nuk mund të dilte kuptimi i veprimt që synohet, që do të kryhet, kuptimi i kohës së ardhme. **Kam me mbjellë** etj. do ta kishte kuptimin [kam të mbjellët, kam veprimin e të mbjellit etj.], pra kuptimin e një veprimi të kryer, të afërt me [kam mbjellë]. Kjo domethënë se paskajorja e tipit të shënuar nuk mund të dilte e lidhur në një perifrazë me foljen **kam**.

⁵ Shih *Periodizimi...*, f. 82 e vijim, Sh. Demraj, *Gjuha shqipe – Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë, 2003, f. 33.

⁶ E. Benveniste, *Problèmes de linguistique générale*, Paris, 1974, 2, f. 132.

Neve na ka rezultuar se kjo paskajore e përftuar nga sintagma para-fjalore me kuptim instrumental të para-fjalës **me**, që ka kaluar në pjesëz, nuk mund të dilte në funksion të fjalisë qëllimore.⁷ Funksionin e fjalisë qëllimore paskajores ia sjell para-fjala **për**. Kështu më parë ishte krijuar shprehja **kam për me mbjellë** = kam për qëllim me mbjellë, e cila që në krijim e kishte krejt të afërt kalimin në funksion të futurit si formë e parë e kësaj kohe. Më vonë me elipsimin e para-fjalës **për** në këtë kontekst u përftua forma e së ardhmes [kam me mbjellë etj.], ku **me mbjellë** erdhi tani si fjali e varur qëllimore me prani të nënkuptuar të para-fjalës **për**. Kështu ndodhi në të gjitha rastet kur duhej të përftohej vlera e paskajores si fjali qëllimore, d.m.th. edhe me foljet jokalimtare të lëvizjes si p.sh. **shkoi për me mbjellë** → **shkoi me mbjellë** etj. Përftimi i funksionit të fjalisë qëllimore të paskajores në bashkëvajtje me para-fjalën **për** (për me mbjellë etj.) është i njëkohshëm me përfkrimin e funksioneve të fjalive të tjera të varura të paskajores, d.m.th. është krejt i afërt me kohën e krijimit të kësaj paskajoreje.⁸ Mund të përfundohet, prandaj, se futuri **kam+për+infinitiv** është përftuar brenda kohës së shënuar të huazimeve latine, para kontaktit me gjuhët sllave.

Kalimi i perifrazës së shënuar në futur në gjuhën latine, siç u pa, ka përfunduar pas ndryshimit të renditjes në **infinitiv + habeo** me elementet e përngjitura dhe del i përgjithësuar kah shek. VII. Ky zhvillim i kësaj perifraxe është kryer në gjuhët neolatine perëndimore përmes latinishtes tardive. Kjo do të supozonte se latinishtja perifraxën **kam për me mbjellë** në gjuhën shqipe e kishte lënë pa ndikim të mëtejshëm për të kaluar në futur. Ndikimi i vjetër nga latinishtja do të ishte i pandërprerë drejt kalimit në renditje të përmbysur të elementeve përbërëse edhe në gjuhën shqipe. Kështu kalimi i kësaj perifraxe të shqipes në futur, duke e ruajtur renditjen **kam+për+infinitiv** tregon se nuk u krijua nën ndikimin e latinishtes. Rënditja e tillë e segmenteve përbërëse (habeo+infinitiv) nuk u bë formë e futurit në gjuhët romane. Ajo, siç është çmuar, “është etapë e ndërmjetme midis futurit latin dhe futurit roman”.⁹ Nga sa u tha mund të përfundohet se

⁷ Shih *Pjesorja e shqipes – Vështrim diakronik*, Prishtinë, 1998, f. 136 e vijim.

⁸ Shih *Pjesorja e shqipes - vështrim diakronik*.

⁹ E. Benveniste-i, vep. e cit.

kuptimin e futurit perifraza **kam+për+infinitiv** e kishte marrë në një proces më të shpejtë se perifraza e latinishtes që u desh të kalonte nëpër një transformim të gjatë kuptimor e formal deri në kuptim të futurit.

Në latinishten ballkanike kontinentale a danubiane perifraza **habeo + infinitiv** u krijua më vonë e nuk u zhvillua si në latinishten vulgare perëndimore, kështu që nuk u përftua e njëjta formë sintetike e kohës së ardhme. Në latinishten vulgare, që kaloi në dalmatishte, nuk u zhvillua as perifraza **infinitiv+habeo**, as perifraza **habeo + infinitiv**, kështu që në këtë gjuhë futuri **kantura** (do të këndoj) është vijim i formës së futurit II **cantavero** (do të kem kënduar).

Për perifrazën **habeo+ad+infinitiv** në gjuhën rumune është thënë se është më e vonë se rumanishtja e përbashkët¹⁰ dhe del edhe në greqishten e mesme a bizantine. Në greqishten e mesme kjo perifrazë qëndroi deri kur infinitivi doli nga përdorimi, d.m.th. deri në përfundim të kësaj periudhe dhe vetëm disa të folme e zëvendësuan infinitivin me lidhore dhe shprehja **kam+lidhore** e përftoi pastaj vlerën e së ardhmes, ndërsa për rumanishten, siç ka shënuar Mihăescu, “në provincat danubiane nuk ndeshet konstrukti **habere+infinitiv**, por vetëm **uele** dhe **debere+infinitiv**”. Kjo do të thotë se perifraza e tipit **kam+lidhore**, e krijuar pas rumanishtes së përbashkët, d.m.th. si dialektore pas perifrazës **kam+infinitiv**, ka mbetur shprehje modale me kuptimin e detyrimit pa arritur të kalojë në një formë të futurit, ashtu siç nuk ka kaluar në futur perifraza **kam + lidhor** në bullgarisht, maqedonisht e serbisht.

Perifraza **habeo+ad+infinitiv**, që del më e vonshme se krijimi i futurit **infinitiv+habeo** në perëndim dhe më e vonshme se rumanishtja e përbashkët dhe si dialektore dhe në greqishten bizantine, d.m.th. gjithsesi pas sh. XI, e përjashton mundësinë e lidhjes së saj me futurin e shqipes **kam për me mbjellë** etj. Krijimi i vonshëm i kësaj perifraze në rumanishte e në greqishten e mesme mbase përkon me krijimin recent të së njëjtës perifrazë (**habeo+infinitiv**) në disa dialekte të italishtes, spanjishtes e të sardishtes.

*

¹⁰ Shih *Istoria limbii rumâne*, grup autorësh, vëllimi i dytë, București, 1969, f. 268.

Shqipja e fazës së dokumentuar si forma të futurit ka edhe format **do+lidhore e tashme** [do të mbjell] etj. dhe **kam+paskajore e dytë** [kam për të mbjellë] etj.]. Toskërishtja e ka edhe formën e futurit [kam të shkoj] etj.] në përdorim tepër të kufizuar dialektor, në të folmet italo-arbëreshe, në çamërishte e në nja dy fshatra të Bregdetit të Poshtëm në përdorim të rrallë. Kjo formë del edhe në elementin italo-grek e në ndonjë të folme të greqishtes.¹¹

Futuri **kam për të mbjellë** është më i ri se futuri **kam për me mbjellë** a **kam me mbjellë**. Ai është përfutuar pasi ishte krijuar mbiemri i nyjshëm. SP-ja **për të mbjellë** etj. në funksion të plotësit të qëllimit me foljet jokalimtare të lëvizjes ka kaluar në infinitiv me funksion të kufizuar të fjalisë qëllimore. Kështu, format e futurit **kam për me mbjellë** etj. dhe **kam për të mbjellë** etj. kanë arritur të jenë variante të lira për mjaft kohë në tërë shqipen. Ato vijuan të jenë të tilla në gegërishte deri në ditët e sotme.

Në toskërishte, kur doli nga përdorimi paskajorja **me mbjellë** etj. nga preferenca e shprehjes me lidhore, ajo nuk qëndroi as në përbërje të futurit **kam me mbjellë**, edhe pse aty nuk ishte e zëvendësueshme nga lidhorja. Këtu mbeti në përdorim futuri sinonimik **kam për të mbjellë**, që vijonte të përdorej edhe në gegërishte.

Mbasi paskajorja brenda futurit **kam me mbjellë** në toskërishte nuk u zëvendësua nga lidhorja **të mbjellë** etj., futuri **kam të mbjell** etj. nuk del të ketë qenë i tërë toskërishtes e se përdorimi i tij tepër i kufizuar do të jetë krijim mjaft më i ri se dalja nga përdorimi i paskajores **me mbjellë** etj. në këtë dialekt. Ngurosja e foljes kam: **ka të vemi** etj. në të folmen e San Marcanos, të Castroregios e në ndonjë të folme tjetër të arbërishtes, nuk ndeshet në të folmet e shënuara të toskërishtes, që do të thotë se kjo ngurosje është bërë pas kalimit të arbëreshëve në Itali. Kështu edhe mosngurosja në pjesët e tjera tregon se përfutimi i kësaj forme të futurit është relativisht i ri, përfutuar nën ndikimin e të folmeve greke që, siç u tha, e kishin krijuar këtë futur pas heqjes nga përdorimi të infinitivit, d.m.th. pas sh. XII.

¹¹ Me trajtim të veçantë duhet të shikohen rastet e rralla, të reja të përdorimit të tillë të futurit në të folmen e Dibrës e të Matit.

3. Forma e futurit dua + lidhore

Është konstatuar se mënyrën lidhore shqipja e ka të trashëguar nga gjuha e lashtë ie., “por gjatë zhvillimit historik të kësaj gjuhe, siç shënon Shaban Demiraj, ajo ka pësuar ndryshime largëvajtëse si nga ana kuptimore-funksionale ashtu edhe nga ana formale”.¹²

Në kohën kur protoshqipja nuk kishte paskajore lidhorja nuk do të mund të mbetej pa u begatuar me funksione të shumta të fjalive të varura.¹³ Paskajorja, që u krijua më vonë, i mori të gjitha funksionet e fjalive të varura që i kishte marrë më parë lidhorja dhe doli sinonimike me të. Ato, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë, ku nuk ishin të zëvendësueshme me njëra-tjetrën, qëndruan variante stilistike, variante të lira dhe funksionojnë të tilla edhe sot në gegërishte.¹⁴

Nuk mund të mendohet po ashtu që lidhorja të mos ketë krijuar që atëherë edhe shprehje modale të tipit **dua të shkoj, mund të shkoj, lypset të shkojmë, duhem të shkoj** etj. e që paskajorja të mos i ketë gjetur këto shprehje të krijuara para saj. Ajo edhe këtu hyri në përdorim sinonimik me lidhoren: **dua/ due me mbjellë, mund (muj) me mbjellë, lypset me mbjellë, duhet me mbjellë** etj. Në **due/ dua me mbjellë** paskajorja “përbën objektin e dëshirës së shprehur prej foljes **dua**” ashtu si dhe lidhorja. Në **dua të mbjell** etj. ishte i hapur procesi i krijimit të futurit **do të mbjellë** etj., pa e humbur përdorimin e saj si shprehje modale paralele me shprehjen **due/ dua me mbjellë**.

Paskajorja e shënuar e shqipes nuk merr pjesë në evoluimin e shprehjes **dua/ due me mbjellë** në futur, d.m.th. se ajo vijon të mbetet shprehje modale **due me mbjellë, duem me mbjellë** etj. si në gjuhët neolatine përëndimore. Meqë kjo perifrazë nuk kaloi në futur si në greqishten e

¹² Sh. Demiraj, *Gram..hist. e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 865.

¹³ Sandfeldi ka shënuar: Nëse shqipja primitive nuk ka pasur infinitiv, siç thuhet, atëherë ajo është pikënisje për të krijuar futurin me anë të foljes dua... *Linguistique balkanique*, f. 183.

¹⁴ Shih funksionet paralele të lidhores e të paskajores: W. Fiedler, *Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë*, Gjurmime albanologjike, V – 1975.

vjetër në disa të folme dialektore e në rumanishten e përbashkët, nuk mund të ketë gjenezë të përbashkët me të.

Nga kjo shihet se procesi i formimit të futurit volitiv në gjuhën shqipe e greqishte është i ndryshëm. Për greqishten është konstatuar se që në shekujt e parë të erës së re është krijuar shprehja **thélō + infinitiv** (thélō gráfein - dua + infinitiv), shprehje që nuk është zhvilluar në futur. Futuri me **do** u përfutua pasi u përjashtua infinitivi nga lidhja e prirë nga pjesëza **na: thélō na gráfō** e pastaj në greqishten e mesme krijohet forma **thé na gráfō** me **thé** si formë të apokopuar të vetës së tretë **thélei** e përdorur si pavetore. Kështu, ndërsa shqipja para se ta krijonte shprehjen **dua + infinitiv** e kishte krijuar shprehjen **dua+ lidhore e tashme** (dua të shkoj) dhe i la të dy shprehjet të qëndronin variante të lira deri kur në toskërishte infinitivi doli nga përdorimi, në greqishten, siç u pa, në përgjithësi (me përjashtim të pak të folmeve) u desh që infinitivi të zëvendësohej nga lidhja, kur ai në tërësi doli nga përdorimi dhe vetëm atëherë perifraza e krijuar **thelō na gráfō** mori rrugën e gramatikalizimit në formë të futurit **thà grafo**. Përjashtimi i paskajores ka përfunduar në greqishten e mesme aty nga shek. XII, që do të thotë se perifrazës **thélō na gráfō** i është dashur edhe një kohë për të kaluar në futur. Kështu, duke qenë se **dua të shkruaj** del formim më i lashtë se **thélō na gráfō**, rezulton se edhe gramatikalizimi i këtyre shprehjeve në futur volitiv është më i hershëm në gjuhën shqipe.

Meqë paskajorja e shënuar ka dalë nga përdorimi vetëm në toskërishte nga preferenca e shprehjes me lidhore, ne kemi pranuar se kjo është zhvilluar nën ndikimin e greqishtes së mesme në një kohë kur në gjuhën shqipe ishin dobësuar shumë lidhjet veri-jug. Por prania e futurit **do të shkoj**, për të cilin Sandfeld-i ka menduar se është vetëm i toskërishtes, bashkë me futurin **kam me shkue** në gegërishten është një fakt tjetër që e përjashton mundësinë që futuri i parë të jetë përfutur nën ndikimin e greqishtes, sepse nuk do të ishte edhe i gegërishtes, siç nuk ndikoi që të dalë nga përdorimi futuri me paskajore kam + infinitiv. Po të kishte qenë krijuar nën ndikimin e greqishtes, **do të shkoj** etj. do të ishte formë e futurit vetëm në dialektin e toskërishtes.

Nga sa u shënuar del se i pari futur i shqipes është futuri **do + lidhore** (do të shkoj etj.). Futuri i dytë, i afërt në lashtësi me të parin, është futuri

kam + paskajore (kam me mbjellë etj.), paraprirë nga **kam + për + paskajore** (kam për me mbjellë), ndërsa **futuri kam + paskajorja e re** (kam për të mbjellë) është i kohës pas krijimit të nyjës së përparme, d.m.th. pas shek. VI e deri para huazimeve sllave. Futuri **kam + lidhore** (kam të vete etj.) është krijim edhe më i ri: pas largimit të infinitivit nga toskërishtja, d.m.th. pas shek. XII-XIII.

RASAT GJINORE-DHANORE NË GJUHËT BALLKANIKE¹

Përdorimi i një forme të vetme për rasat gjinore e dhanore është dukuri e përbashkët e gjuhëve ballkanike: shqipe, greke, rumune, bullgare e maqedone. Kjo dukuri shfaqet në kohë të ndryshme në këto gjuhë. Më re del në gjuhët e shënuara sllave (pas shekullit XV), mjaft më herët përftohet në gjuhën rumune (që nga krijimi i saj kah shek. VII) dhe edhe më herët në gjuhën greke (në shekujt e parë të e. së re) e në gjuhën shqipe, siç do të shihet, edhe para kësaj kohe. Në latinishten vulgare përdorimi i dhanores edhe në funksion të gjinores në të gjitha lakimet e ka fillin në shek. IV. Në greqishten e vjetër forma e gjinores ka dalë edhe në funksion të dhanores. Në latinishte dhe në greqishte të vjetër forma e përbashkët për këto dy rasa është përftuar në kushtet e sistemit të tyre rasor dezinençial, që do të thotë se në këto gjuhë forma e njëjës rasë e ka zëvendësuar formën e rasës tjetër duke dalë sinkretike për gjinore e dhanore, ndërsa në gjuhët e shënuara sllave forma e përbashkët është sajuar pas humbjes së mbaresave rasore, që do të thotë se në to është krijuar një formë analitike me vlerë rasore për të dy këto rasa. Këtë formë të përbashkët rumanishtja e ka trashëguar nga latinishtja tardive danubiane.

Kur gjuha shqipe e kishte humbur eptimin dezinençial rasor, përemri dëftor dilte me forma të ndryshme për rasat emërore, dhanore e kallëzore, të realizuara me variacion teme a me tema të ndryshme: njëjës emërore (a)**i**, (aj)**o**, dhanore (a)**tij**, (a)**saj**, kallëzore (a)**tan**; shumës emërore-kallëzore (a)**ta**, (a)**to**, dhanore (a)**tyn**(e). Këto forma ishin reflekse të trajtave të njëjta rasore të gjuhës së lashtë ie. : (a)**i** < ***is**, ***ei**; (aj)**o** < ***ejā** (> **eó** > **ó**); (a)**tij** < ***tei**, (a)**saj** < ***tjāi**; (a)**tan** < ***tōm** (forma e mashkullores e ka dominuar formën femërore ***tām** (> tom > ton); emërore (a)**ta** < * **tōi**, (a)**to** < * **tāi** – kallëzore ***tōs** > (a)**ta**, ***tās** > (a)**to**; (a)**tyn** < * **tou-i-n-is** (> ***tuin** > tyn - zanoja **-e** (tyn-e) është përftuar mbasi u krijuan mbaresat e reja rasore

¹ Botuar te *Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes*, Koha ditore dhe Dega e Gjuhës Shqipe, Fakulteti i Filologjisë i UP-së, redaktor Bardh Rugova, Prishtinë 2012, ff. 115-119.

tek emrat (disa miq-e etj.).²

Trajtat rasore të përemrave dëftorë përdorshin edhe në funksion të mbiemrit limitativ, në vend të përcaktorëve të emrit: (a)**i djalë**, (a)**tij djalë**, (a)**tan djalë**, (a)**ta djem**, (a)**tyn djem**; (aj)**o vajzë**, (a)**saj vajzë**, (a)**tan vajzë**, (a)**to vajza**, (a)**atyn vajza** etj., duke e përcaktuar edhe funksionin rasor të emrit në këtë sistem tri rasash. Këtë vlerë rasore emrit ia jepte edhe nyja shquese e përftuar në këtë kohë nga format e shënuara të përemrit dëftor në përdorim anaforik e që ishte prepozitive: **i pus, të pus, e motër, së motër, të motër** etj.³ Si prepozitive ajo zinte të njëjtin vend si përcaktuesit e tjerë. Nga këto shënime shihet se format e dhanores së përemrit dëftor rrjedhin drejtpërdrejt nga format paraprake dezinciale të dhanores, pa asnjë shembull të prejardhjes nga format e gjinores.⁴ Në këtë kohë funksionin e gjinores e realizonte dhanorja në përdorim adnominal, e cila zinte vend midis përcaktuesve dhe emrit të determinuar prej saj: **i (a)saj djalë, (a)i asaj djalë, njan (a)saj djalë** etj., ashtu si dhe dhanorja e përcaktorëve bashkë me emrin: **i (a)saj nanë bir, (a)i (a)saj nanë bir, njan (a)saj nanë bir; e (a)tij djalë motër, (aj)o (a)tij djalë motër, njan (a)tij djalë motër** etj.

Përemrat vetorë kishin mbetur në këtë gjendje: veta e parë njëjës rasa emërore **u(në)** <*ezu <*eğō;⁵ dhanorja ***mon** (>muo) < dhanorja ***mēni, me** (me-je) < kallëzorja ***më**. Më vonë, kur u krijuan mbaresat e reja rasore, kjo formë e kallëzores u bë formë e rasës së re të rrjedhore dhe mbaresën **-je** (me-je), të marrë nga rrjedhorja e emrave të tipit **be-je, fe-je** etj., e bëri pjesë të pandashme.⁶ Vetori i vetës së dytë njëjës: emërorja **ti** <*tū, dhanorja **ty** < dhanorja ***tu-i, te** (te-je) < kallëzorja ***të**. Edhe në këtë

² Shih B. Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980, f.117- 32.

³ Për përfitim e nyjës **e** nga forma përkatëse e dëftorit shih vep. e cit., f. 106-7.

⁴ Në veprën *Rruga...* shih paqëndrueshmërinë e mendimit se format e emrit për gjinore-dhanore në numrin shumës burojnë nga forma e gjinores.

⁵ Shih B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, Prishtinë, 2004, f. 144 – Shtesa përforcuese **-në** është më e vonshme se përfundimi i rotacizmit.

⁶ Si kaluan format **me** dhe **te** nga kallëzorja në rrjedhore dhe si e përftoi dhanorja ***mon** (muo) edhe vlerën e kallëzores shih veprën e cit., f. 145-48.

përemër dhanorja mori më vonë edhe funksionin e kallëzores, ndërsa forma origjinale e kallëzores kaloi si formë e rrjedhore me mbaresën **-je** të emrave. Veta e parë shumës në emërore **na** < ***nōs**,⁷ **ne** < kallëzorja ***nōs**, që funksiononte edhe si dhanore, prandaj edhe forma e re **ne** doli sinkretike për kallëzore e dhanore. Për vetën e dytë shumës në emërore **ju** < ***ius** (me **-i** gjysmëvokalike), forma e kallëzores me vlerë edhe të dhanores, që nuk është ruajtur, ishte **vé** < kallëzore-dhanorja ***uōs**. Forma **vé** u zëvendësua më vonë, para krijimit të mbaresave të reja rasore, nga forma e emërores **ju**, duke u bërë kështu formë sinkretike për të tri rasat.

Ne kemi shënuar se shqipja kishte kaluar në strukturë analitike pa fleksion dezinencial rasor në kohën e kontaktit me latinishten. Mjaft para kësaj kohe ishte krijuar theksi dinamik, i cili do të ushtrojë ndikimin e tij në krijimin e gjendjes pa fleksion nominal me mbaresa. Kështu përdorimi i formës së dhamores edhe për gjinoren është kaq i lashtë.

Ndërkaq, burimi i këtyre formave të dhanores së përemrit dëftor nga forma e dhanores së kohës së fleksionit mbaresor rasor, siç u paraqit më lart, na shtyn të mendojmë për gjendjen e sistemit rasor që i parapriu sistemit pa fleksion mbaresor. Në përcaktimin e atij sistemi na udhëzon forma e kallëzores ***nōs**, që funksiononte edhe si dhanore, ashtu siç do të ketë funksionuar edhe kallëzorja paralele e vetës së dytë **vōs**, që nuk është ruajtur. Ky sinkretizëm kaq i hershëm, para krijimit të theksit dinamik, flet se në protoshqipe vetorët e dy vetave të para në numrin shumës kishin në këtë kohë dy forma rasore: emërore **nōs**, kallëzore-dhanore **nōs**, emërore **jus**, kallëzore-dhanore **vōs**. Kjo do të thotë se në paradigmen e këtyre vetorëve nuk ishte ruajtur forma e rasës dhanore e rrjedhimisht as forma e rasës gjinore, së cilës do t'i takonte të merrte edhe funksionin e dhanores. Nga kjo kuptohet se që në atë kohë **nōs** e **vōs** do të kenë funksionuar edhe si dhanore adnominale në vend të gjinore që nuk ishte ruajtur. Vlerat e tilla rasore nga **nōs** i trashëgoi forma **ne** që u përftua nga ajo në rrugë fonetike në kohën e humbjes së mbaresave rasore. Këtë sistem tri rasash në kohën kur

⁷ Përemri **nōs**, që nuk ishte formë e emërores në gjuhën e lashtë ie., në gjuhën shqipe e mori funksionin e rasës emërore në vend të formës burimore me **v-** a me **m-**. Shih vep. e cit. f. 130.

ende ekzistonin mbaresat e lashta rasore e dëshmojnë edhe format e veto-rëve të vetës së parë e të dytë në numrin njëjës: dhanore **mëni**, **tui**, kallë-zorja **më**, **të**, ashtu si dhe vetorët e vetës së tretë që ishin edhe dëftorë: dhanore **tei**, **tjai**, kallëzore **töm**, shumë dhanore **tou-i-n-is**, kallëzore **tös**, **täs**, kështu që në këtë kohë këto forma dezinenciale të dhanores do të kenë funksionuar edhe si dhanore adnominale.

Në veprën *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes* (Pri-shtinë, 2010, f. 43-4) nga gjendja me tri forma rasore të dëftorit dhe të ve-torëve pas rënies së mbaresave rasore dhe nga mungesa e formës së rrje-dhores së këtyre përemrave, që do të ishte e ndryshme nga të tri rasat e tjera,⁸ patëm ardhur në përfundim se edhe kur ekzistonin mbaresat rasore sistemi rasor ishte reduktuar në tri rasat e shënuara. Kjo gjendje ishte arri-tur nga proceset e preferimit të sintagmave parafjalore në vend të formave rasore lokative, d.m.th. se ishte zhvilluar procesi kur parafjalët po ua merrnin mbaresave rasore aftësinë për të shënuar funksionet lokative të emrit si në gjuhët që përfatuan gradualisht strukturën analitike. Kështu duhet menduar se në këtë proces format e rrjedhore, të instrumental-sociativit e të lokativit ishin përjashtuar nga përdorimi i kallëzores parafjalore me pa-rafjalët **prej**, **me**, **në**. Nga kjo kuptohet se edhe emri në dhanore e në kallë-zore pa parafjalë mund të ishte vetëm kundrinë e zhdrejtë dhe e drejtë e jo edhe plotës rrethor. Kështu të gjithë rrethorët i realizonte kallëzorja me parafjalë përkatëse. Kuptohet pra se me mbaresa rasore kishin mbetur ve-tëm rasat e funksioneve abstrakte a “gramatikore”: emërore, dhanore, ka-llëzore.

Përdorimi i dhanores edhe në vend të gjinore që në kohën e mba-resave rasore të tipit indoevropian e bën këtë dukuri shumë të lashtë në protoshqipe, disa shekuj para kontaktit të saj me latinishtes, sepse pas kësaj kohe do të fillonte procesi i ndikimit të theksit dinamik mbi tingujt fundorë të temave emërore bashkë me mbaresat rasore, duke ndihmuar kalimin e protoshqipes në gjuhë analitike pa mbaresa rasore që në fillim të interfe-

⁸ Forma përemërore **si**, **so**, u bë formë e rrjedhore së dëftorit në kohë shumë të vona. Kuptimi burimor i këtij përemri ka qenë: **si** = **i tillë**, **so** = **e tillë**, me të cilin ai nuk ishte pjesë e paradigmës së përemrit (a)i, (a)jo. Shih për këtë përemër në veprën Rruga ..., f. 375.

rencave me latinishten. Kjo lashtësi e funksionimit të dhanores edhe si gjinore e përjashton si mundësinë e ndikimit nga greqishtja, ku gjinorja del edhe në funksion të dhanores në shekujt e parë të erës së re, ashtu edhe mundësinë e ndikimit nga latinishtja, ku, siç u tha, përgjithësimi i përdorimit të dhanores edhe në funksion të gjinores në të gjitha lakimet është bërë kah shek. IV të erës sonë.

Kjo lashtësi më e madhe e kësaj dukurie morfologjike në protoshqipen si gjuhë paleoballkanike i jep krah teorisë së Miklošič-it që e shihte aty burimin e kësaj dukurie, ashtu si edhe Weigand-i. Por ne nuk mund të sjellim argumente për ndikimin e protoshqipes në gjuhët e tjera ballkanike. Shfaqjen e kësaj dukurie në greqishten e vjetër më vonë se në protoshqipen nuk e shohim të përfutur nga ndikimi i protoshqipes, por e shohim, siç e ka parë Sh. Demiraj, “nga prirja e hershme ... për thjeshtimin e lakimit emëror (dhe përemëror)”,⁹ pra nga i njëjti proces i pavarur si në protoshqipen.

Me krijimin e nyjës së përparme të dhanores adnominale (kur u krijua edhe nyja e përparme e mbiemrit) ajo u dallua nga dhanorja në përdorim adverbial, d.m.th. u krijua gjinorja e re *nyjë paradigmatiche + dhanore*. Kjo nyjë, që ishte nyjë shquese e emrit të përcaktuar, duke u bërë pjesë e kësaj gjinoreje, e humbi gradualisht fuqinë shquese, por e ruajti lidhjen me emrin e përcaktuar në gjini, numër e rasë.¹⁰ Nyja e përparme e dhanores adnominale dhe e mbiemrit është përfutur para aglutinimit të nyjës shquese dhe para krijimit të mbaresave të reja rasore, aty nga fillimet e periudhës së shekujve VI-VIII.¹¹ Kjo është koha kur gjuha shqipe i kishte dalluar format e gjinores e të dhanores si më sipër.

Për rumanishten mund të thuhet se që në latinishten danubiane në shekujt V-VII ishte përgjithësuar dhanorja adnominale me parafjalën **ad** (*ad+akuzativ apo rasa prepozicionale*) në vend të dhanores sintetike, kështu që kjo kishte mbetur e vetmja formë e gjinore-dhanores kur dilte në bashkëvajtje me përemrin anaforik e me përcaktorë të tjerë, ndërsa si gjinore

⁹ Shih Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 97.

¹⁰ Shih *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*.

¹¹ Shih veprën e cit., f. 82-87.

e papërcjellë nga përcaktues dilte vetëm sintagma nominale me parafjalën **de**: gjenitivi-dativi **ad bunu illui rege** dhe **ad illo rege**; genitivi: **de bonu rege filiu** dhe **de rege filiu** etj. Në latinishten vulgare, nga e cila do të krijohej rumanishtja, dativi me **ad**, për të shprehur kuptimin e gjinores, do të duhej të kishte renditje tjetër brenda frazës nga përdorimi si kundrinë e zhdrejtë. Kështu për funksionin kundrinor të dhanores u ruajt renditja kundrinë e drejtë - kundrinë e zhdrejtë e latinishtes më të hershme: **dare caballu ad lui rege, dare illu caballu ad illo rege** etj. Edhe për përdorimin adnominal të dhanores (në funksion të gjinores) u ruajt renditja e vjetër e latinishtes që gjinorja të dalë para emrit të përcaktuar prej saj: **ad illo rege illu caballu** me **illu** si përemër anaforik, ndërsa në rastin e përdorimit të përemrit me kuptim demonstrativ e deiktik kjo dhanore do të qëndrojë midis këtij përemri dhe emrit të përcaktuar: **istu/ illu/ unu ad illo rege caballu**, ashtu siç qëndroi edhe mbiemri: **istu/ illu/ unu bonu homo**. Kjo renditje, që arriti të bëhej e detyrueshme në fazën e parë të rumanishtes së përbashkët, ishte renditje që protoshqipja e kishte që në kohën e humbjes së mbaresave rasesore, kështu që mund të mendohet për një ndikim të saj mbi latinishten danubiane e mbi fillimet e formimit të gjuhës së përbashkët rumune. I vetmi ndryshim në këtë kohë ishte se protoshqipja nga kjo renditje e nyjës shquese para dhanores adnominale krijoi dhanoren me nyjë të përparme, krijoi një formë të dalluar nga dhanorja kundrinore, d.m.th. e formoi gjinoren *nyjë+dhanore*. Meqë rumanishtja dhanoren e formoi me parafjalë, ndryshimet në të patën kahje të ndryshme. Para aglutinimit të nyjës parafjala **a(d)** ra nga përdorimi kur ishte në ballë të sintagmës nominale: **alo rege alo calu** etj. (Me *alo* nyjë shquese), ndërsa qëndroi kur dhanores adnominale i printe ndonjë përcaktor: **alu/ estu/ unu a(d) alo rege calu** etj. Nga kjo gjendje ka rezultuar përdorimi i parafjalës **a** për gjinoren pas emrit të pashquar: **o casă a vicinului** e jo kur ky emër ishte i shquar: **casa vicinului** etj.

Proceset e aglutinimit të nyjës shquese në gjuhën rumune kanë shkuar si kishin shkuar më parë në gjuhën shqipe: **i thellë + i pus – bunu+alu omu** → **i thelli pus – bunul om**. Pa mbiemër nyja vazhdonte të

qëndronte para emrit **i pus – əl om**.¹² Nga kjo renditje **mbiemër+nyjë emër** u bë e mundur që të kalohej në renditje **emër+nyjë mbiemër**, që doli renditje e zakonshme e shkaktuar nga shembujt e përdorimit të fjalëve bikategoriale mbiemër – emër **punëtori djalë** → **punëtori i mirë**, prandaj edhe **pusi i thellë** etj. Ky proces u zhvillua edhe në gjuhën rumune. Kjo renditje e zakonshme bëri që edhe dhanorja adnominale të dalë prapa emrit të përcaktuar prej saj: **un cal a regelui – calul regelui** etj., ashtu si dhe **fiu de rege** etj. Në librin *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike* kemi shënuar detajisht zhvillimet e këtij procesi në të dy gjuhët, ku na ka rezultuar ndikimi i shqipës. Për zhvillimet e gjinore-dhanores në gjuhën rumune ndikim i shqipës nuk vijon përtej pikave të shënuara deri në këtë kohë.

Për bullgarishten e maqedonishten krijimi i një forme të përbashkët të dhanore-gjinore është, siç është konstatuar, proces i ri, (shek. XV), pas shuarjes së fleksionit rasor nominal në shek. XIV.¹³ Në mungesë të mbaresave rasore krijimi i formës së dhanores me parafjalë është mundësi e natyrshme e si e tillë ajo do të dalë edhe në përdorim adnominal në vend të gjinore. Për këtë arsye ne nuk e shohim mundësinë e ndikimit jo vetëm të greqishtes e të shqipës, por edhe të rumanishtes.

Sh. Demiraj ka njoftuar se përdorimi i rasës dhanore të përemrave vetorë në vlerë të gjinore posesive në gjuhët ballkanike është dukuri që e ka edhe shqipja e që studiuesit e kanë deklaruar si të paqenë në këtë gjuhë. Ai jep shembujt **i tij, i saj, i tyre**, në të cilët dhanorja **tij, saj, tyre** është përdorur si dhanore posesive, d.m.th. si gjinore e tillë ((a)tij vajzë – (a)saj djalë etj.) dhe përemrat pronorë me elemente të përngjitura, në të cilët segmenti i dytë ka qenë një dhanore e tillë: **ai ty bir** → **yt bir, ajo ne vajzë** → **vajza jonë - ai mon (muo) bir** → **im bir** etj. Përngjitja e këtyre përbërësve është bërë pas përfundimi të rotacizmit (shek. VIII), d.m.th. kah shek. IX. Por si segmente të papërngjitura me vlerë të një lokucioni përemror pronor, siç e kanë vlerësuar Fr. Bopp-i dhe Dh. Kamarda¹⁴ janë përfutur në

¹² Në rumanishte kjo gjendje është ruajtur me emrat e përveçëm e të dinjitetit.

¹³ Siç është konstatuar ndër të tjerë edhe nga Mirčevi e Koneski – Shih edhe Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, f. 92.

¹⁴ Shih Periodizimi..., f. 142.

kohën kur nuk mbetën më në përdorim pronorët e vjetër. Ata nuk mbetën më si përemra pronorë në kohën pas humbjes së fleksionit nominal rasor, sepse atëherë dolën në formë të barabartë me dhanoret përkatëse të veto-rëve.¹⁵ Këtë lokucion ne në veprën e cituar e kemi vlerësuar të krijuar aty kah shek. VI, para aglutinimit të njëjës shquese e kur zanoret e tipit ie. ki-shin kaluar në zanore që i ka edhe shqipja e sotme. Para këtij lokucioni funksionin e këtyre pronorëve të vjetër e kryenin pronorët **mi** dhe **tu**, që u bënë të nyjshëm **të mi**, **të tu** si dhe dhanorja adnominale e përemrave vectorë. Kjo lashtësi e këtij lokucioni si dhe e dhanores adnominale të veto-rëve, që, siç u pa, përdorej më herët me kuptim posesiv dhe si e tillë e mundësoi edhe formimin e këtij lokucioni. Kjo dhanore u bë posesive në renditjen regressive të segmenteve të sintagmës nominale, d.m.th. kur dhanorja adnominale qëndronte para emrit të përcaktuar. Nga ky aspekt renditja e dhanores posesive në gjuhët e tjera të Ballkanit pas emrit të përcaktuar si renditje progresive, është në këto gjuhë më e re se renditja e parë, prandaj mund të thuhet se përdorimi i tillë në protoshqipen është shumë më i lashtë. Kjo mbështetet edhe në faktin që vetëm në protoshqipe në këtë funksion ka dalë trajta e theksuar e dhanores.

¹⁵ Shih vep. e cit., f. 139-40.

RIMARRJA E KUNDRINAVE NË GJUHËT BALLKANIKE

Shaban Demiraj në veprën *Gjuhësi ballkanike* (1994) e ka shtruar çështjen e rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike në një vëllim prej 20 faqesh. Ai paraqet gjendjen e rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe, rumune, bullgare, maqedone e në greqishte të re dhe jep mendimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për burimin e kësaj dukurie, e cila “zhvillim më të madh ... ka marrë në shqipe e në maqedonishte” (f. 127).¹

Rimarrjen e kundrinave në gjuhën shqipe ne e patëm trajtuar në veprën *Për vetorët e shqipes* (2004) nën temën: Relacionet sintagmatike të varianteve të dy serive të vetorëve (f. 87-94). Aty ishim shprehur se “Variantet e lira dhe variantet e lidhura janë në relacion seleksioni sintagmatik, në të cilin segmentin konstant të këtij relacioni e përbëjnë variantet e lidhura, ndërsa segmentin variabil - variantet e lira, meqë këto nuk mund të përdoren pa qenë të pranishme variantet e lidhura”. Kjo gjendje shihet se ishte e përgjithshme në fillim të fazës së dokumentuar të shqipes, sidomos për funksionin e kundrinës së zhdrejtë e për dy vetat e para të kundrinës së drejtë. Në një pjesë të konsiderueshme mospërdorimi i variantit të lidhur te autorët e vjetër është bërë nën ndikimin e tekstit nga i cili u përkthye, siç shihet qartazi te Bogdani. Mungesa e trajtës së lidhur përdoret edhe si variant stilistik në raport me përdorimin e tij, p.sh: ...do të kuptojnë qi mua do; Asimi herë shikonte mua... etj.²

Për variantet e dy vetave të para, të cilat shënojnë gjënë e re të kumtimit, Sh. Demiraj mendon se “janë format e reduktuara ato që, në zanafill, kanë përforcuar format e theksuara të këtyre përemrave”.³ Ky parashikim është i pambrojtshëm, sepse e lë të pasqarueshëm përfitimën e trajtave atone a të patheksuara. Kjo rrjedh nga mendimi i pasaktë se format e reduktuara të vetorëve të vetës së parë e të dytë njëjës **më, të** janë përftuar nga format e plota që dalin në shqipen e fazës së dokumentuar **muo, ty** Duke u nisur

¹ Këtë temë e kishte trajtuar më parë në *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (1986).

² Shih edhe shembuj të tjerë te Sh. Demiraj, vep. e cit, f. 588.

³ Vep. e cit., f. 595.

nga fakti se format e lidhura të vetës së tretë njëjës për dhanore **i** dhe për kallëzore **e** janë forma të përfuara nga format atone të një përemri të lashtë dëftor-vetor: ***is,(*ei), *iā, (*eiā), *id,**⁴ para se të krijohej theksi dinamik, mund të përfundohet se format **më, të** burojnë nga forma atone edhe më të lashta se këto të vetës së tretë.

Nga ky përemër i lashtë, që u zëvendësua nga përemri i rrënjës në ***-to** (përemër që e ka edhe shqipja e sotme, por pa elementin deiktik) me përjashtim të rasës emërore njëjës, që e mori në paradigëmë të tij bashkë me dy format e shënuara atone kundrinore, nuk u krijua nyja shquese. Ajo u përftua nga përemri në ***-to** që e zëvendësoi, kështu që trajtat atone **i, e** janë krijuar para nyjës, e cila, sipas shumicës së gjuhëtarëve, është përftuar në kohën e kontakteve të para të shqipes me latinishten. Nga kjo nxirret përfundimi i shënuar më lart se këto forma janë krijuar edhe para theksit në gjuhën tonë.⁵ Është e padyshimtë pastaj që variantet atone kundrinore të dy vetave të para, si vetorë të mirëfilltë, të jenë krijuar mjaft më herët se variantet atone të vetorit të vetës së tretë, i cili paradigëmën e serisë së lidhur deri në kohë të vona nuk e kishte të plotë, sepse nuk kishte forma për kundrinat në shumës.⁶ Disa gjuhë indoevropiane kanë krijuar trajta atone kundrinore me forma të ndryshme nga trajtat tonike, disa trajta pra që nuk kishin përdorim tonik. Forma të tilla gjithnjë atone të dhanores njëjës ishin për vetën e parë ***mōi**, për vetën e dytë ***tōi**, kurse për kallëzore të tilla ishin format ***më, *të.**⁷ Kështu imponohet të besohet se protoshqipja bashkë me gjuhë të tjera kishte krijuar këto forma atone kundrinore, të cilat, kur u krijua theksi, u bënë të patheksuara dhe e ndërruan gradualisht formën: ***mōi > *mi > më, *tōi > ti > të; *më > më, *të > të**, që përfunduan kështu në forma sikretike për dhanore e kallëzore. Që atëherë si forma atone për gjinore-dhanore-rrjedhore të dy vetave të para të numrit shumës përdorëshin rrënjët përemërore ***nō-,*vō-.**⁸ Këto kanë përfunduar: ***nō- >**

⁴ Shih B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, Prishtinë, 2004, f.103-4. Shih edhe mendimin e Sh. Demirajt në vep. e cit., f. 457.

⁵ Shih vep. e cit., f. 100-103.

⁶ Për përfitim të këtyre formave të shumës shih vep. e cit., f. 105-12.

⁷ A. Meje, *Uvod u uporedno proučavanje indoevropskih jezika*, Beograd, 1965, f. 184.

⁸ A. Meje, po aty.

***në** e zëvendësuar më vonë nga **na**, ***vō-** > ***vë** > **u**, e zëvendësuar krejt vonë nga **ju**.

Nga sa u tha del se që në një periudhë të protoshqipës për të shënuar kundrinat përdorshin trajtat atone, në fillim të të dy vetave të para e më vonë edhe të vetës së tretë njëjës. Ishin format tonike e pastaj të theksuara ato që u përdoren për ta rimarrë kundrinën. Duket, besoj qartas, se krijimi i këtyre formave atone është bërë për të realizuar funksionet e kundrinave.

Varianteve të të dy serive të vetave të para, mbasi zëvendësojnë vetat e pranishme në bisedë, u mungon kuptimi anaforik, prandaj nuk mund të shënojnë subjektin e njohur më parë. Ato mund të përdoren vetëm për të shënuar personin e papërmendur. Përdorimi i trajtave tonike a të theksuara bëhej për ta vënë më në pah vetën, për ta spikatur dallimin me vetat e tjera, duke rënë edhe theksi i fjalisë mbi to. Kështu variantet e lira ishin të markuara, ndërsa të lidhurat - të pamarkuara, të cilat si të tilla e përjashtojnin bashkëvjajtjen. Përjashtimin e përdorimit të varianteve tonike a të theksuara nga prania e varianteve të lidhura e vërtetojnë edhe gjuhët sllave e gjuhët romane, që kanë trajta të patheksuara edhe formalisht të ndryshme nga trajtat e theksuara. Përdorimi i dy varianteve ka filluar nga një ndërhyrje e vonuar e variantit të lirë në një fjali eliptike apozitive, mbasi ishte përdorur varianti i lidhur, ashtu siç del në gjuhën frënge p.sh.: [tu me con-nais, moi? Tu veux me voir, moi?] etj.⁹ Për frëngjishten përemri i theksuar në këtë përdorim çmohet si “nënvizues i kundrinës nëpërmjet një pleonazme”, apo se këtu “forma e palidhur shfaqet për të rimarrë një formë të lidhur ...”.¹⁰ Përdorimi i varianteve të lira të vetorëve dhe i emrave në funksion të kundrinës për të vënë në spikamë gjënë e re a gjënë e njohur në bashkëvjajtje me variantet e lidhura të të tri vetave është mjet i gjuhës afektive, i cili përfundon në automatizëm dhe bëhet mjet i gjuhës logjike - mjet sintaksor.¹¹

Ndërkaq, përdorimi i varianteve të vetës së tretë është me ndryshime nga ai i dy vetave të para:

⁹ Shih vep. e cit., f.89.

¹⁰ *Grammaire du français contemporain* (grup autorësh), Paris, 1964, f. 233.

¹¹ J. Vendryes, *Le langage – introduction linguistique à l’histoire*, Paris, 1968, f.157 e v.

Variantet e lidhura të vetës së tretë kanë kuptim anaforik, kështu që përdorimi i tyre zanafillës për ligjet vetëm kur në funksion të kundrinës shënojnë personin e njohur e të përmendur më parë. Edhe këtu variantet e lira përdoreshin për të spikatur vetën. Por veta e tretë si vete jashtë diskursit, ishte e nevojshme të shfaqej edhe si subjekt i panjohur, i papërmendur më parë, si element i ri i kumtimit. Ndërsa variantet e lidhura nuk mund ta realizonin këtë kuptim, variantet e lira e kishin këtë mundësi. Ato mund ta tregonin gjënë e re të kumtimit duke qenë të shoqëruara me një gjymtyrë zgjeruese të tyre, me një fjali relative përcaktuese, p.sh.: [Pashë atë që erdhi] etj. Emri në trajtë të shquar, të cilin nyja shquese e bën të njohur, mund të dilte në funksion të kundrinës vetëm si nënvizues i gjësë a i personit të përmendur më parë, prandaj do të dilte në bashkëvajtje me trajtën e pathek-suar të vectorit si rimarrës i kundrinës: [*e pashë djalin, e dërgoi letrën, i tha djalit*] etj. Vetëm emri me përcaktues të tjerë mund të shënonte gjënë e re të kumtimit: [pashë një djalë të shtrirë. takuan disa nxënës] etj. Kështu, mbasi variantet e lidhura të vetës së tretë mund të shënonin vetëm gjënë e njohur të kumtimit, variantet e lira, ashtu si dhe emrat kur shënonin gjënë e re si më sipër, nuk mund të dilnin në bashkëvajtje me to, por do të përdoreshin si shënuese të vetme të kundrinës. Nga kjo kuptohet se këtu bashkë-vajtja me variantet e lidhura është mjaft e re dhe e papërgjithësuar për ka-llëzoren: e pashë atë që erdhi, e mora atë e jo këtë etj. e gjithësi dytësore edhe për dhanoren. Në këtë përdorim u neutralizua aftësia e trajtës së pathek-suar të vetës së tretë për të shënuar vetëm gjënë e njohur a të përmendur më parë.

Në disa gjuhë indoevropiane trajtat atone a të pathek-suara të vetës së tretë janë krijuar më vonë në numrin shumë. ¹² Edhe shqipja trajtat e lidhu- ra të vetës së tretë njëjës, siç u pa, i ka shumë të lashta, ndërsa ato të numrit shumë i ka mjaft të vona. ¹³ Kjo duket se ka të bëjë me faktin se vetëm në njëjës është i realizueshëm plotësisht kuptimi anaforik, kuptimi i gjësë së njohur të kumtimit. Duke qenë se variantet atone të dy vetave të para janë mjaft më të lashta se ato të vetës së tretë njëjës dhe se për shumë janë kri-

¹² Shih B. Bokshi, vep. e cit., f.92.

¹³ Vep. e cit..

juar tepër vonë, mund të përfundohet se në fillim kuptimin anaforik e realizonin vetëm variantet e lira. Kjo do të thotë se të parat variante të lidhura ishin ato të dy vetave të para, d.m.th. ato që shënonin subjektin e ri të kumtimit.

Si mund të arsyetohet përgjithësimi i përdorimit të dy serive të vetorëve të vetës së tretë dhe të emrit bashkë me trajtën e patheksuar në rastin e kundrinës së zhdrejtë edhe atëherë kur shënohet gjëja e re e kumtimit? Njëra nga arsytet mund të jetë fakti se dhanorja në një fazë të zhvillimit të hershëm të sistemit rasor të shqipes erdhi e u bë rasa më ekstensive e atij sistemi dhe doli edhe në funksione jashtëkundrinore.¹⁴ Mbasi rasa dhanore ka një kuptim përkatësie (prandaj mund ta realizonte funksionin e gjinores), trajtat atone e pastaj të patheksuara nga lidhja me foljet që kërkojnë kundrinën e zhdrejtë dolën të lidhura edhe me folje që nuk e kërkojnë këtë kundrinë. Kështu vetëm forma e dhanores, për shkak të këtij kuptimi, mund të kalonte në funksione të plotësve dhe të kryefjalës logjike. Trajta e lidhur e kallëzores, për shkak se rasa kallëzore nuk e ka kuptimin e përkatësisë, nuk e zgjeroi distribucionin e saj në funksione jashtëkundrinore, me përjashtim të përdorimit në shprehjet idiomatike e në funksionin tepër të kufizuar të plotësit të kohës (natën, ditën, të hënën, një ditë etj.).

Siç kemi shënuar në veprën *Për vetorët e shqipes*, vendosja proklitike a enklitike ndaj foljes kallëzues e trajtave atone a të patheksuara të vetorëve është e lidhur me kërkesat e ritmit, që mund të ndryshojë gjatë zhvillimit të gjuhës e që ka të bëjë me renditjen regresive a progresive të elementeve të frazës dhe me vendin e theksit të fjalës. Pajtimi zotërues i këtyre rrafsheve përbën ritmin bariton apo oksiton.¹⁵

Format e trajtave atone edhe në protoshqipen do të kenë kaluar nga enkliza burimore ndaj fjalës së parë në fjali që nuk ishte folje, në renditje proklitike a enklitike ndaj foljes kallëzues gjatë procesit të fiksimit të rendit të fjalëve. Ne kemi shënuar se protoshqipja edhe para kontaktit me latinishten kishte renditja regresive të përbërësve të grupit nominal: Mbiemër – Emër (Emër në dhanore - Emër) e rrjedhimisht e kishte vendosjen e de-

¹⁴ Shih veprën *Rruga...*, f. 299-305.

¹⁵ Shih Ch. Bally, *Linguistique générale et linguistique française*, Bern, f. 202.

tyrueshme enklitike të formave kundrinore të patheksuara të vetorëve, renditje që ishte edhe në përputhje me ritmin kryesisht bariton. Pas përngjitjes së njëjës shquese shqipja krijoi renditjen progresive Emër – Mbiemër (Emër - Emër në gjinore) si renditje të zakonshme, që do të thotë se edhe trajtat e patheksuara të vetorëve tani kishin kaluar në renditje proklitike ndaj foljes kallëzues, në përputhje me ritmin kryesisht oksiton.¹⁶ Kështu kjo proklizë është e kohës para përfundimit të rotacizmit, aty kah shek. VII. Vetëm me urdhëroren pohore trajtat e patheksuara janë enklitike. Për italishten renditja enklitike me urdhëroren është çmuar si mbetje e renditjes latine. Edhe për shqipen kjo renditje duhet të vështrohet si ruajtje e renditjes regresive që është mjaft e lashtë në fillimet e saj. Në të dy renditjet e formave të patheksuara, format e theksuara kundrinore dhe kundrinat emërore e rimerrnin kundrinën: [merr-më mua, mos më merr mua] etj. Rastet kur e anticipojnë formën e patheksuar: [mua më tha] etj. duhet të jenë më të vonshme, përfutur mbasi ishte përgjithësuar përdorimi i trajtës së theksuar pranë variantit të patheksuar në renditjen: [më tha mua] etj.

Kuptohet se kjo lashtësi e madhe e përdorimit të trajtave atone kundrinore që para kontaktit të protoshqipes me latinishten nuk do të thotë se që atëherë janë përdorur edhe format tonike në funksion të rimarrjes së kundrinave. Por duke marrë parasysh faktin se shkalla e përgjithësimit të rimarrjeve të kundrinave është shumë e madhe në gjuhën shqipe, më e madhe se në gjuhët e tjera ballkanike dhe del identike edhe në shkrimet e autorëve tanë të vjetër që në shek. XVI, është reale të mendohet se kjo gjendje është mjaft shekuj më e lashtë dhe gjithsesi më e lashtë se rimarrja në gjuhët e tjera ballkanike.

Meqë zhvillimi i përgjithësuar i rimarrjes së kundrinave në maqedonishten perëndimore e jugore, që është i ngjajshëm me zhvillimet në gjuhën shqipe, është i vonshëm (sh. XIII) dhe meqë kjo dukuri është mjaft e rrallë në Bullgarinë lindore, nuk ka si të përjashtohet mundësia e ndikimit të shqipes mbi këtë gjuhë sllave, me të cilën kontakti i shqipes ka qenë më intim.

¹⁶ Shih arsyetimet në veprën *Për vetorët e shqipes*, f. 166-172.

Në rumanishten e sotme përveç rimarrjes së rregullt të kundrinave me anë të dy vetave të para të vetorëve, që është e njëjtë me rimarrjen në gjuhën shqipe, në raste të tjera rimarrja ndryshon nga gjendja në gjuhën shqipe, sepse rimarrja aty “mund të jetë e detyrueshme, fakultative apo e pamundshme” ashtu si dhe fakti se në gjuhën rumune nuk është përgjithësuar rimarrja e kundrinës së zhdrejtë.¹⁷ Dyfishimi i kundrinës në rumanishte e ka fillin në shek. XVI dhe nuk arrin të dalë e konsoliduar mirë as në shek. XVIII.¹⁸ Kjo e përjashton mundësinë që dyfishimi në gjuhën rumune të jetë përfutur në kontinuitet nga latinishtja, që do me thënë se e përjashton edhe ndikimin e saj mbi gjuhët e tjera të Ballkanit.¹⁹ Zhvillimi i kësaj dukurie shumë më vonë se në gjuhët e tjera ballkanike tregon se rumanishtja u ndikua nga gjuhët përreth: sllave, shqipe e greke.

Dukuria e dyfishimit të kundrinës del në raste të kufizuara vetëm në dialektet veriore të greqishtes së sotme “ku kontaktet me popullsinë romane, shqiptare dhe sllave kanë qenë më të ngushta”.²⁰ Kontakti i lashtë i këtyre të folmeve të greqishtes me të folmet e shqipes dhe lashtësia e dukurisë në gjuhën shqipe flasin për mundësinë e ndikimit nga shqipja. Ndikimi nga dialekti vllah nuk është i mundur nga shkaku se fenomeni i dyfishimit të kundrinës në gjuhën rumune, siç pamë, përfshirë edhe vllahishten, është shumë më i vonë se në këtë pjesë të greqishtes.

Në bazë të kësaj mendojmë se ndikimi fillestar në përhapjen e dukurisë së dyfishimit të kundrinës në gjuhët ballkanike është ushtruar nga shqipja në greqishten e në maqedonishten. Pastaj këtë e ka përhapur maqedonishtja mbi bullgarishten e bashkë me të edhe mbi rumanishten, mbi të cilën ka ndikuar edhe shqipja e greqishtja.

¹⁷ Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f.133.

¹⁸ Po ai, po aty.

¹⁹ Siç ka pretenduar Ilievski. Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 138-9.

²⁰ Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 137.

THEKSI DINAMIK DHE GJATËSIA E ZANOREVE NË GJUHËT BALLKANIKE

Gjuhëtari çekoslovak B. Havranek në vitin 1933 theksin ekspirator (dinamik) dhe mungesën e dallimeve kuantitative të zanoreve i pa si një ndër bashkëpërkimet e gjuhëve ballkanike.¹ Kjo çështje është trajtuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë si dhe nga Sh. Demiraj në veprën e shënuar. Ai e paraqet gjendjen e kësaj dukurie në gjuhën shqipe, në greqishten e re, në rumanishte, bullgarishte dhe në maqedonishten perëndimore. Demiraj shënon se theksi ekspirator dhe mënjanimi i kundërvënies zanore të gjata – zanore të shkurtra në gjuhët ballkanike “do të meritonin hulumtime më të plota, për të sqaruar jo vetëm vjetërsinë e tyre, por edhe faktorët që u kanë dhënë shkas atyre në secilën nga gjuhët ballkanike në shqyrtim” (f. 73).

Konstatimi i W. Meyer-Lübke-s se “kalimi nga sistemi i theksit të lirë indoevropian në sistemin e theksit të fiksuar të shqipes është vërtetuar që para depërtimit të elementeve latine”² na ka dalë plotësisht i saktë. Në punimin *Zhvillimi i strukturës së temave emërore të shqipes*³ e pastaj në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (Prishtinë, 1980) kemi ardhur në përfundim se shqipja kaloi në theksin dinamik në kohën kur e kishte ende sistemin e temave të gjuhës së lashtë indoevropiane, por të reduktuar në katër tipa: dy të polarizuar në gjini: tipi tematik në **-ō** : *ken-kō, *rōthō, *sōkō, *tulō, *kupō etj. i emrave të gjinisë mashkullore e asnjansë (në të cilin ishin integruar emrat e këtyre gjinive nga temat në **-i**, **-u** dhe në konsonant⁴ dhe tipi në **-ā** i emrave të gjinisë femërore e asnjansë: *lamā, *gherā, *bhallā, *pōlnā, *spudnā, kēsā, *trekā etj. dhe dy tipa neutralë në gjini: tipi atematik njërrrokësh në konsonant a sonant: *mus, *sus, *ghem, *ūren, *ūreg etj. dhe tipi në sonantet **-n**. **-r**: *ghiemen,

¹ Shih Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 72.

² Në *Rumänisch, Romanisch, Albanesisch*, 1914, cituar sipas Sh. Demirajt në veprën *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f. 117.

³ *Gjurmime albanologjike*, I, 1971.

⁴ Shih veprën e shënuar, f.161.

*māter, *enmen, s̥ekur, *serpen etj. Ky reduktim i numrit të temave emërore u bë në kohën e tonit me dy seritë e zanoreve (të gjata e të shkurtra).

Në trajtimin e huazimeve nga latinishtja ka dalë se ato e gjetën sistemin e temave të shqipes me katër tema, ndër të cilat tema në **-ā** kishte përfunduar në temë në **-ë** (*lamā, *kēsā, *spudnā, *pōlnā, *balla etj. - lamë, kohë, punë, pelë, ballë etj.) dhe tema në **-ō** kishte mbetur pa këtë zanore (*tulo, *sōkō, ōsthō < ōsthi, *glunō < glunu, ūlaksō < ulaks etj. - tul, gjak, asht, glun, lesh etj.), ndërsa tema në sonantet **-n, -r** dilte me zanore të reduktuar në **-ë** para këtyre sonanteve (*gheimen, *māter, *enmen etj. - dimën, motër, emën etj.) dhe tema njërrrokëshe e kishte pësuar rënien e bashkëtingëllores fundore (*mus, *sus, *ghem, ūreg etj. - mi, thi, dhe, re etj.).⁵ Mbasi nuk mund të besohet se zanorja **-ō** të ketë rënë drejtpërdrejt, del e pranuehme se, para se të binte, kishte kaluar në **-ë** në një zhvillim paralel me zanoren **-ā**:

-ō > -ë > zero

-ā > -a > -ë

Nga kjo del se zanorja **-ë** e pëftuar nga **-ō** nën ndikimin e theksit dinamik është e kohës para kontaktit me latinishten e krijimi i theksit edhe më i lashtë. Është pra protoshqipja që e ka krijuar këtë zanore shumë kohë para gjuhëve të tjera ballkanike: në gjuhën rumune zanorja e ngritjes së mesme **ă** (ë) është përftuar në kohën e rumanishtes së përbashkët në mes të shek. VI – VIII, ndërsa e ngritjes së lartë **î** (ë) është përftuar vetëm në dako-rumanishte dhe jo më herët se në shek. XVI, kurse në gjuhën bullgare - në shekullin XIII.⁶ Ky tingull është përftuar në mënyrë të pavarur edhe në gjuhë të tjera jashtë Ballkanit, kështu që edhe në Ballkan nuk shihen faktorë që ta bënin të përftuar nga substrati ilir, d.m.th. nga protoshqipja, siç ka besuar Fr. Miklošič-it. Përftimi në kohë të ndryshme i kësaj zanoreje në tri gjyhët ballkanike mendojmë se e përjashton ndikimin e substratit. Problemi të veçantë paraqet përftimi i zanores **ë** në gjuhën bullgare. Dallimi i saj në këtë pikë nga gjuhët e tjera sllave, bile dhe nga maqedonishtja, nxit

⁵ Shih Periodizimi ..., f. 49

⁶ Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f.78 dhe 82.

vlerësimin se kemi të bëjmë me një ndikim të rumanishtes, e cila e kishe reduktuar në *ë* zanoren e patheksuar shumë kohë para bullgarishtes. Ky ndikim do të jetë bërë në kohën e lidhjeve të ngushta të këtyre gjuhëve për një kohë të gjatë deri në shekullin XIII.

Zanorja *ë* e theksuar është përftuar në rumanishten e përbashkët nga zanorja *a* në pozitë nazale. Kjo do të thotë se këtë zanore e kanë edhe dialektet. “Zanorja qendrore (*ã* e rumanishtes së përbashkët është ruajtur në disa të folme arumune (veçanërisht në ato të Shqipërisë e të Maqedonisë).⁷ Në gjuhësinë shqiptare ka mbetur i paspjeguar fakti se pse *ë*-ja e theksuar, që rodhi nga *a*-ja para sonanteve nazale, u përftuar vetëm në dialektin jugor e jo në tërë shqipen. Kjo gjendje sugjeron që të shihet e përftuar nën ndikimin e një gjuhe që do të ketë qenë në afërsi intime me dialektin toskë. E, meqë në gjuhët ballkanike vetëm rumanishtja me dialektet e saj e ka *ë*-në e theksuar para zanoreve hundore, një mundësi e ndikimit të arumanishtes mbi toskërishten me një zhvillim reciprokisht përforcues bëhet i besueshëm. Kjo zanore e theksuar në toskërishte del të jetë përftuar para procesit të rotacizmit, i cili duket të ketë filluar kah fundi i shekullit VII,⁸ gjë që përputhet me kohën e ndikimit të arumanishtes.

Humbja e dallimit të gjatësisë së zanoreve të gjuhës së lashtë ie. (me serinë e zanoreve të gjata e me serinë e zanoreve të shkurtra) në gjuhën shqipe përfundoi plotësisht nga ndikimi i theksit brenda kohës së huazimeve latine në mbarim të shek. V. Në atë kohë ishin përftuar të gjitha zanoret që ka shqipja e sotme. Në kohën e krijimit të theksit zanoret e kohës së tonit ishin transformuar në zanore me tipare më të hapura a më të mbyllura, më të prapme a më të përparme kur theksi binte mbi to. Këto tipare dalluese të dy serive të zanoreve, që ishin shfaqur që në kohën e tonit, nën theks do të pësojnë një transformim gradual kualitativ duke përfunduar në zanore që i ka shqipja përmes procesit të kalimit nga sistemi me dy seri zanoresh, në sistemin me një seri. Tani zanoret e theksuara ishin të gjata, ndërsa të patheksuarat - të shkurtra. Por kalimi i zanoreve të dy

⁷ Shih *Istoria limbii române*, II, Grup autorësh, București, 1969, f. 191.

⁸ Shih *Periodizimi...*, f.128-9.

serive në zanore që ka shqipja është bërë edhe para krijimit të theksit në gjuhën shqipe.⁹

Kështu protoshqipja e kishte krijuar theksin dinamik disa shekuj para kontaktit të saj me latinishten dhe e kishte përfunduar kalimin nga sistemi me dy seri gjatësie të zanoreve indoevropiane në një seri të vetme pa gjatësitë e vjetra në përfundim të huazimeve latine. Të dy këto procese në protoshqipe dalin të jenë më të lashta se në gjuhët e tjera ballkanike.¹⁰

Gjendja burimore në gjuhën shqipe, kur zanorja e theksuar ishte e gjatë, u ndryshua gradualisht nga ndikimi i rrethanave të ndryshme fonetike, në të cilat gjendej kjo zanore: nga tingujt ndjekës në kontakt dhe nga lloji i rrokjes. Këto shkaktuan tri shkallët e njohura të gjatësisë së zanores së theksuar. Është konstatuar se që në shqipen e përbashkët gjatësia e ndryshme e zanores së theksuar është e lidhur me llojin e rrokjes: zanore e gjatë – rrokje e hapur fundore (mi, thi, re,ka, qershi, kala etj.), zanore gjysmë e gjatë – rrokje e hapur në trup të fjalës (rrugë, lopë. pelë, fushë, bukë etj.), zanore e shkurtër – rrokje e mbyllur (top, gjak, vjet, mot, shkop etj.).¹¹ Në këtë lidhje gati të përpiktë të gjatësisë së zanores së theksuar me tipin e rrokjes shqipja nuk është e izoluar. Kjo është zhvilluar edhe në idiomat e ndryshme të latinishtes vulgare si fenomen panroman.¹² Duke e konsideruar fenomen të shqipes ende të pandarë në dialekte, kjo gjendje del të jetë krijuar para rotacizmit, d.m.th. afër shek. VII, kur mendojmë se kishte filluar ky proces fonetik, d.m.th. para fillimit të huazimeve nga gjuhët sllave të Ballkanit.

Këtë gjendje e kanë çrregulluar krijimi i gjatësisë kompensatore dhe natyra e konsonantit ndjekës. Lidhja e rrokjes së mbyllur me shkallën e shkurtër të zanores së theksuar është kundërshtuar që nga fillimi nga

⁹ Shih kumtesën “Për theksin e shqipes e për lëvizjen e hershme të tij”.

¹⁰ Pohohet në përgjithësi se në epokën imperiale të latinishtes theksi ka pësuar një transformim, vjen e bëhet intensiv nga ai muzikal” – *Istoria limbii romane*, f. 26. Theksi dinamik në gjuhën bulgare është krijuar pas ardhjes së sllavëve të jugut në Ballkan.

¹¹ Shih E. Çabej, në punimin *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, BUSHT SSSH, 2, 1957, f. 208, 213.

¹² Shih P. Tekavčić, *Grammatica storica dell’italiano*, Bologna, 1972, f. 20-22.

sonantet para të cilave është ruajtur gjatësia burimore. Kështu në kohën kur në rrokjen e mbyllur u krijua shkalla e shkurtër e gjatësisë së zanores së theksuar, ajo që përfundonte me sonante kishte mbetur e gjatë: [pen, mullin, kaproll, mjal(të), mall, ar, lter, vëner, taftar, nder, end, hyll, qiell, halm (helm), fill, hir] etj. Në disa prej tyre zanorja me kohë është shkurtuar nën presionin e rrokjes së mbyllur si në [gardh, short, mort, an, gjind, mal, turp] etj. në radhë të parë në rrokjet që prapa sonantit kishin edhe një bashkëtingëllore.

Gjatësia kompensatore është kalimi i gjatësisë së shkurtër të zanores në rrokje të mbyllur, në gjatësi të shkallës së lartë si reagim nga humbja e një rrokjeje të fjalës me bashkëtingëllore të zëshme: [kūt < ku-bë-t < cūbitum, dēt < de-ubë-t < dēubetos, mjëk < mje-dë-k < mēdicus, djäll < dia-bë-ll < diäbolum] etj. Nga kjo shihet se gjatësia kompensatore është kryer pasi ishte krijuar zanorja e shkurtër në rrokje të mbyllur.

III. PËR DISA PERSONALITETE AKADEMIKE

PËR WACLAV CIMOCHOWSKIN

Zonja e zotërinj,

Kjo vepër e albanologut polak Waclaw Cimochowski me titull *Për gjuhën shqipe* është përmbledhje e të gjitha studimeve të tij për shqipen. Akademia jonë kishte vendosur t'i botonte në shqip këto studime që nga fundi i viteve të tetëdhjeta, por procesi i përkthimit e i redaktimit të tyre hasi në pengesa të ndryshme, kështu që vetëm në fund të viteve të nëntëdhjeta tekstet shqip, që ishin radhitur nga zoti Arbër Nuhiu, ishin vënë në proces të korrektimit. Gjatë luftës versionet e radhitura bashkë me kompjuterët u zhdukën, kështu që puna u desh të fillonte gati nga e para. Studimet e shkruara në frëngjisht i përktheu prof. Murat Bejta, ndërsa - të shkruarat në gjermanisht - profesoresha Nexhibe Palloshi. Një punim është marrë nga BUSHT SSHSH, 2, 1958 e një tjetër nga *Kuvendi i Studimeve Ilire*, 1974. Veprën postume *Gjuha shqipe* e kishte botuar Rilindja më 1988. Dorëshkrimin e kësaj vepre e kishin sjellë albanologet e çmuara Irena Sawicka e Jollanda Mindak. Një pjesë të këtij teksti, shkruar nga autori polonisht, e kishte përkthyer në shqip profesoresha Mindak, ndërsa pjesën tjetër - profesoresha Sawicka në serbisht e nga serbishtja në shqip - prof. Latif Mulaku.

Botimi i veprës së Cimochowsk-it është bërë në kuadër të planit të Seksionit të Gjuhësisë e të Letërsisë për të ribotuar vepra albanistike që kanë shënuar vlera të larta shkencore e që edhe sot janë të domosdoshme për të kaluar në studime të reja. Kështu, përveç veprës së gjertanishme të akademik Idriz Ajetit në pesë vëllime, është botuar edhe vepra e Selman Rizës në katër vëllime e pak kohë më parë - edhe përmbledhja e studimeve për shqipen të Holger Pedersen-it. Është gati për botim një vepër e gjerë monografike e Wilfried Fiedler-it. Ka filluar puna për botimin e studimeve të Mark La Pianës e, në bashkëpunim me Akademinë e Sllovenisë, edhe studimet për shqipen të Franz Miklošič-it e të Rajko Nahtigal-it dhe paralelisht edhe për përkthimin e veprës së Auguste Dozon-it. Pas këtyre shihet i mundshëm edhe botimi në gjuhën shqipe i studimeve të Norbert Jokl-it e të Eric Hamp-it.

Zonja e zotërinj,

para Waclaw Cimochowski-t interesimi për studime të shqipes në Poloni ka qenë i vogël. Gjuhëtarët polakë e merrnin parasysht shqipen vetëm në mënyrë anësore, duke shqyrtuar tema të gjuhësisë krahasuese. Po përmendim në këtë rast vetëm gjuhëtarin e njohur Jan Rozwadowski që kishte shprehur mendimin për origjinën ilire të shqipes dhe kishte dhënë sqarime plotësuese të pranuar për reflekset e s-së dhe sk-së ie. në gjuhën e sotme shqipe.

Waclaw Cimochowski gjatë studimeve të rregullta të indoevropianistikës në universitetin e Vilnius-it, u nxit nga profesori i tij Otrębski-t për t'u orientuar kah studimet për ilirishten. Në Vjenë, ku për një vjet ndoqi ligjëratat e profesorëve të njohur të kohës bashkë me ato të Norbert Jokl-it, ai u përcaktua përfundimisht për studime albanologjike. Më 1937, kur ishte 25-vjeçar, Cimochowski shkoi në Shqipëri dhe për studim zgjodhi të folmen e Dushmanit. Studimin për këtë të folme Cimochowski e mbrojti si tezë doktrate, e cila u bë e mundur të botohej frëngjisht më 1951. Edhe me studimet e tjera Waclaw Cimochowski solli në qarqet shkencore të Polonisë albanologjinë dhe e bëri që ajo të flasë edhe polonisht në nivel të ndritshëm shkencor. Me rezultatet e trajtesave të tij albanologjike Cimochowski hapi rrugën që ato të vijohen nga studiues pas tij, ndër të cilët e dalluar është edhe profesoresha e pranishme këtu, Irena Sawicka, e cila tani vijon ligjëratat e gjuhësisë krahasuese në vend të profesor Cimochowskit.

Menjëherë pas viteve 1950 e '51, kur e kishte publikuar punimin e tij të gjerë "*Kërkime mbi historinë e sand'hit në gjuhën shqipe*" dhe vepërën "*E folmja e Dushmanit*", Cimochowski u çmua si studiues i një prestigji të lartë shkencor. Shfaqja e tij në letrat për shqipen ishte fatmirësi për studimet e mëtejme albanologjike.

Ai i bëri objekt studimi disa çështje të rëndësishme siç janë: *Prejardhja e gjuhës shqipe; Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane; Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave; çështje të toponimisë shqiptare, të fjalëformimit në gjuhën shqipe, bëri vështrime etimologjike të mjaft fjalëve të shqipes, trajtoi reflekset e guturaleve ie. në gjuhën shqipe e, siç u përmend, shkroi monografinë*

shteruese për të folmen e Dushmanit me efekte modeli për studimet dialektologjike të kohës dhe na e la në dorëshkrim në mënyrë të përmbledhur strukturën e gjuhës shqipe me veprën *Gjuha shqipe*.

Fatkeqësisht ky njohës aq i mirë i shqipes dhe trajtues aq i saktë i strukturës e i sistemeve të saj dhe vështrues aq i hollë i disa proceseve të zhvillimit, me dije të gjera e të thella nga teoritë gjuhësore e krahasuese indoevropiane e ballkanike, nuk pati mundësi t’ia kushtonte më tepër energjinë e tij krijuese çështjeve të shqipes. Por vepra e tij, edhe pse me këtë vëllim të vogël, me mënyrën e trajtimeve rigorozisht shkencore e me rezultatet, ka qëndruar vijimisht në lartësinë e veprave më të arritura albanistike, e imponueshme për t’u konsultuar nga studiuesit e çështjeve të shtruara. Vepra e tij do të jetë në relacione të pashkëputshme nga veprat e tjera të dalluara, që shënojnë ecje të shkencës albanologjike.

Nga morfosintaksa historike e shqipes, që është fushë e interesimit tim, Cimochowski nuk ka lënë ndonjë studim monografik. Ai, ndërkaq, mjaft çështje nga gramatika diakronike i ka trajtuar në veprën *E folmja e Dushmanit*, kalimthi e sporadikisht, ndërsa në veprën *Gjuha shqipe* - më gjerësisht. Në këto vështrime Cimochowski, në njërën anë, mbështeti edhe me argumentimet e tij disa përfundime të sakta të studiuesve e, në anën tjetër, shprehu mospajtimin me disa të tjera, qoftë duke shfaqur mendim të ndryshëm, qoftë duke i vënë në dyshim me arsye e duke sugjeruar nevojën për rishqyrtim.

Në këtë mbledhje përruese të veprës së tij po lejojmë të veçojmë disa rezultate të rëndësishme të këtij gjuhëtari në këtë fushë:

a) Që në veprën për të folmen e Dushmanit, pra që kur ishte fare i ri, ai shfaqti mendimin se “Shqipja kishte dikur një sistem lakimi të trashëguar nga gjuha indoevropiane”, por “Proceset fonetike, rrëgjimi i fondit të fjalëve indoevropiane dhe, në përgjithësi, e tërë vija e rrugës së zhvillimit të shqipes, e kanë rrënuar plotësisht sistemin zanafillës të lakimit”. “Formimi i një sistemi të ri të lakimit ...ka kushtëzuar, thotë ai, një ndryshim të dukshëm të nocionit të temës”. Ai shënoi se trajta e pashquar e emërores së njëjësit dhe e emërores së shumësit janë bërë tema për formimin e të gjitha trajtave rasore. Kështu Cimochowski implicite kishte pranuar se mbaresa

ie., që shënonte elementet e numrit e të rasës, kishte kaluar në gjuhën shqipe në shënuese vetëm të numrit, duke e hapur mundësinë që mbaresat rasore, që dalin të përngjitura me mbaresën e numrit jo vetëm në shumës, të mund konsideroheshin më të vonshme. Ai kështu kishte arritur në kufrin e kapërcimit në një trajtim të ri dhe largvajtës për origjinën e mbaresave rasore të shqipes së sotme, origjinën e të cilave nga mbaresat rasore të gjuhës ie. e kishte vënë në dyshim Auguste Dozon-i që më 1879 dhe e kishte mohuar Petar Skoku më 1926. Kështu edhe Cimochoowski me autoritetin e tij shkencor u bë nxitës për të kaluar në qasje të reja në vështrimin e kësaj çështjeje të rëndësishme të diakronisë së fleksionit emëror të shqipes.

b) Cimochoowski solli rezultate në përcaktimin e origjinës së disa mbaresave të shumësit. Kështu mbaresën **-a**, në kundërshtim me G. Meyer-in, që e konsideroi të përftuar nga ie. ***-ās**, Cimochoowski e pa të krijuar me të drejtë nga **-ë** (e temës) + **e** (mbaresë shumësi), e gjykoj të pasaktë, po me të drejtë, mendimin e Pedersenit për prejardhjen e mbaresës **-e** nga ie. ***-ās**, nuk e pranoi po ashtu mendim e Pedersenit që tingulli anaptitik **-i-** (njerëzit, turqit etj.) të jetë ruajtje e mbaresës së lashtë **-i** të shumësit, përftuar nga ie. ***-ōi**. Në punimin *Rreth fjalëformimit në gjuhën shqipe* Cimochoowski bëri sqarime të hollësishme të disa prapashtesave të shumësit kolektiv e të kalimit të tyre edhe në funksion të prapashtesave që formojnë emra abstraktë si dhe përcaktoi rastet e kontaminimit të tyre që në faza të hershme, duke argumentuar paqëndrueshmërinë e disa tezave për to.

c) Për origjinën e nyjës, që Pedersen-i e sjell nga përemri dëftor ie. ***sō**, ***sā**, Cimochoowski shprehet me të drejtë se “koncepti i tij nuk është i sigurt as pa kundërthënie në të gjitha detajet”. Ai pati të drejtë që, në kundërshtim me Çabejn, e riaktivizoi tezën e G. Meyer-it për vlerën fillimore funksionale e kategoriale të emrave të ditëve të javës.

ç) Cimochoowski ka ndihmuar edhe për sqarimin e disa formave përemërore. Ai me arsye e pa të pasaktë tezën e Pedersenit për prejardhjen e formës përemërore **tyne** dhe nuk u pajtua me etimologjitë e Pedersenit e të Joklit për trajtën **ty** e të Çabejt për shkurtimin e zanores te forma **ti**, e diktoi vijën e përftimit të formës **na** të patheksuar, u shpreh me të drejtë për

pamundësinë e përfutimit të **u**-së së vetës së tretë shumës nga **u** e vetës së dytë, që e mendonte Çabej etj.

d) Cimochowski dha sqarime të qëndrueshme për lashtësinë dhe mënyrën e formimit të prezentit me **-iō** e **-niō**, duke e parë pikënisjen të disa formime primare të kësaj kohe të indikativit dhe të formimet denominative, që janë përfutuar nga pjesorja në **-no** e nga mbiemri foljor në **-to**.

Ata që merren me këto çështje të morfologjisë historike kanë arsye të çmojnë se këto rezultate të Cimochowskit nuk janë të vogla. Ato tregojnë se autori ynë e kishte dijen, aftësinë dhe mënyrën e trajtimit të këtyre elementeve të sistemit morfologjik të shqipes si edhe studiuesit e shquar para tij.

Me botimin e veprës së Cimochowskit Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovë ka dashur të shprehë edhe respektin e saj ndaj këtij gjuhëtari të shquar nga Polonia, që e zgjodhi gjuhën shqipe si vokacion të punës së tij shkencore e që e trajtoi me dashuri e me vlerësime krenuese.

NË 80-VJETORIN E LINDJES SË SHABAN DEMIRAJT¹

I nderuari akademik Shaban Demiraj, zonja e zotërinj,

kremtimi i përvjetorëve të lindjes së miqve të mëdhenj krijues, siç është akademik Shaban Demiraj, të shtyn që fjala jote e shkurtër të jetë thelbësisht krenuese, duke lënë të paarsyetuara përfundimet e sinqerta për vlerën e lartë të veprës që krijoi mendja e tyre e fuqishme.

Akademik Shaban Demiraj u shfaq në jetën shkencore më 1953 me punimin për Jul Varibobën. Në këtë punim ai shpalosi një dije solide për shqyrtim të çështjeve gjuhësore, një aftësi veneruese e një trajtim krijues të matur e bindës. Ai po afirmohej si shkencëtar i një peshe të veçantë në kohën kur rrjedhat e mendimit albanologjik në Shqipëri i përcaktonin personalitetet e larta shkencore: Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Selman Riza e Mahir Domi, të cilët me veprat e tyre bënë që albanistika ta kalojë qendrën e saj në Tiranë. Shaban Demiraj me impenjim të posaçëm për akumulim të dijes krijoi besimin për të vënë në provë fuqinë e tij krijues, duke synuar nivelin e lartë të fjalës shkencore të këtyre studuesve të mëdhenj të shqipes dhe formësoi individualitetin e tij larg epigonizmit, që do të ketë qenë mjaft kërcënues.

Studuesit e përmendur kishin formim gjuhësor të fituar në qendra të ndryshme universitare të Evropës. Ky formim i ndryshëm manifestohej edhe nëpërmjet tematikave të preferuara, të cilat janë të njohura për të gjithë ne.

Shaban Demiraj zgjodhi për trajtim çështje të rëndësishme të gramatikës së gjuhës së sotme, shkroi morfologjinë e saj dhe hyri me tërë potencialin e tij krijues në çështje të vështira të diakronisë së elementeve të strukturës së shqipes, duke arritur pikërisht në këtë fushë lartësinë e një studiuesi të paharrueshëm në historinë e albanistikës. Ai i pastroi, i dëliri këto studime nga shumë trajtime e përfundime të paqëndrueshme të albanistëve të ndryshëm dhe sqaroi shumë çështje që kishin mbetur të errëta a të pa-

¹ Botuar në *Studime* 5, 6, 7, 2002.

shqyrtuara. Ai kështu me kompetencë ndoqi shembullin e pararendësve të tij për shqyrtim e rivlerësim të të arriturave të albanologjisë në funksion të hapjes së mundësive reale për rezultate të reja në të gjitha fushat.

Vështrimi kritik ndaj rezultateve të arritura i imponoi vetëm atij një hulumtim sistematik në tërë gjerësinë e problematikës që shtron morfosintaksa diakronike e shqipes, duke qëndruar në një përbërje të njësuar të diturisë e të metodës. Ky qëndrim kritik nuk karakterizohet me ekskluzivitet e degradim të përpjekjeve të të tjerëve për të sqaruar dukuritë dhe fenomenet e zhvillimit, por karakterizohet me një mirëkuptim kolegial që çmon edhe përfundimet e pasakta e të paqëndrueshme si energji pozitive në rrugën e sqarimit të tyre. Edhe kjo është një nga tiparet që e dallon këtë studiues të shqipes prej të tjerëve para dhe pas tij.

Akademik Shaban Demiraj në këto studime nuk përvetësoi ndonjë metodë të re për të pushtuar me anë të saj “hapësira të reja epërsie, prej nga do t’i shihte të dhënat e mëparshme si gjëra të reja që duhet të shpjegohen”. Nën drejtimin e profesorëve të tij Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo dhe Eqrem Çabej ai qëndroi brenda kornizave të metodës së tyre, që ishte korresponduese me një kahje të gjuhësisë evropiane të kohës së formimit të këtyre profesorëve si gjuhëtarë të një formati të lartë shkencor. Kësaj metode, porse, Shaban Demiraj i bëri një adaptim në kuptim të kaplimit të tërësishëm sistemor të çështjeve, me krahasimin si komponentë të pandashme për të arritur te burimi i njësive të njëjta a të ngjajshme gjuhësore me ato të gjuhëve ballkanike e të gjuhëve të tjera indoevropiane e për të kualifikuar me objektivitetin e tij të lakmueshëm si ndikim, ngjajshmëri tipologjike apo si të trashëguara nga një fazë e lashtë e përbashkët. Akademik Shaban Demiraj në këto studime është shkencëtari që i shfrytëzoi të gjitha mundësitë e kësaj metode, që është vlerësuar si metodë korrekte tradicionale, duke e përmbyllur me rezultate maksimale kohën e zotërimit të saj. Rezultatet e shumta që arriti nën këto kushte na bëjnë ta çmojmë edhe më lart invencionin dhe kapacitetin krijues të këtij gjuhëtari kaq të frytshëm.

Studimet e tilla të diakronisë së strukturës së shqipes e futën profesor Demirajn edhe në sqarime të çështjeve të ballkanistikës, duke e bërë të rëndësishëm ndikimin e gjuhësisë shqiptare në ndriçimin e këtyre çështjeve.

Për këtë kontribut ai është vlerësuar si studiues i një prestigji të lartë në qarqet ballkanistike.

Gramatika historike dhe diapazoni i gjerë i dijes gjuhësore nuk mund të mos e drejtonin atë kah fushat e tjera albanistike që janë të lidhura e komplementare. Pas ndarjes prej nesh të profesor Çabejt, Shaban Demiraj publikoi librin për fonologjinë historike të shqipes, librin për gjuhësinë ballkanike, i pari në gjuhën tonë, dhe librat *Gjuha shqipe dhe historia e saj* e *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të shqipes*.

Veprat e tij me zgjidhjet e ofruara dhe me informacionin e bollshëm për trajtimin e temave nga studiues të mëparshëm janë bërë libra të pashmangshëm nga tavolina e punës së çdo gjuhëtari që rreket të ofrojë ndihmesën e vet për sqarim të çështjeve të ndyshme.

Dhe tani në 80-vjetorin e lindjes së tij mund të konstatojmë se akademik Shaban Demiraj vetëm si njeri i fuqishëm arriti të realizojë të gjitha ato që kishte ëndërruar kur instinkti e nxiti dhe i sugjeroi që t'i jepte krah prirjes së tij prej gjuhëtari. Me diturinë, vullnetin e pashtershëm dhe talentin krijues ai u bë mjeshtër i këtij vokacioni, për namin e tij e për të mirën e shkencës së albanologjisë.

Me kualitetet e punës së tij akademik Shaban Demiraj arriti të jetë në grupin më të ngushtë të gjuhëtarëve shqiptarë që përcaktuan shkallën shkencore të studimeve të shqipes në shekullin XX. Hiq, natyrisht, morfologjinë normative, ai e ka flakur tërësisht preskriptiven në komunikimin e tij shkencor, bile nganjëherë edhe duke e lënduar edhe ecurinë e saktësisë së përfundimeve të tij. Kjo është shprehje e të kuptuarit të shkencës si “hetim të fakteve” pa raporte preferencash. Kjo nga ana tjetër nuk i lejoi në asnjë rast ngritjen e autoritetit personal në funksion të mbështetjes së përfundimeve.

Autoriteti i lartë i punës së tij shkencore, sinkronike e diakronike, bëri që mënyra e analizës, e trajtimeve dhe e përfundimeve të përvetësohet gati edhe me përmasa të një shkolle, nga mjaft gjuhëtarë që erdhën pas tij. Për këtë, natyrisht, nuk kishte nevojë vepra e akademik Shaban Demirajt dhe mendoj se nuk kishte nevojë as gjuhësia shqiptare. Ishte atëherë një klimë gjithëkapluese që e përjashtonte interesimin për metodat frytdhënëse

të gjuhësisë bashkëkohore, asimilimi i të cilave vetvetiu do të ishte një ndihmë e çmueshme për zhvillimin e studimeve albanistike në përgjithësi dhe për perspektivën shkencore të këtyre gjuhëtarëve në formim.

“Edhe ne të moshuarit, që dukemi se i kemi arritur qëllimet tona, nuk jemi mbi dyshimet dhe gabimet, kishte thënë nobelisti Hermann Hesse. Dhe kjo është njerëzoria edhe brenda shkencës, është fati i përgjithshëm i punës shkencore, e cila, prandaj, qëndron gjithnjë në hulumtim të të vërtetave. Vepra shkencore e akademik Shaban Demirajt në rrjedhën e moteve do të sistemohet në kuadër të tërësisë së veprave që kanë paraprirë e që do të pasojnë dhe ajo do të qëndrojë e dinjitetshme midis tyre për rezultatet e arritura, për avancim shumë të dukshëm e të rëndësishëm të studimeve të morfosintaksës historike, me sugjerim për punë të pandërprerë në këtë fushë e në fusha të tjera albanologjike e do të jetë gjithmonë dëshmi e një dashurie të ndritshme të autorit të saj ndaj gjuhës dhe popullit dhe shembull i veçantë i punës vetëmohuese e këmbëngulëse si pasojë e kësaj dashurie që i shpaloi energji maksimale krijuese.

Konsiderohet art i pashoq të kesh sjellje të mira me njerëzit. Talentin për këtë art Shaban Demiraj e ka të lindur, e ka pjesë të pandashme të qenies së tij shoqërore e intelektuale, e ka shprehje të shpirtit të tij bujar. E ka edhe botëkuptim për marrëdhënie të denja njerëzore që mund të krijohen vetëm me dashuri, tolerancë, mirëkuptim e respekt. Ndaj të gjithëve në rrethin e ngushtë e të gjerë, që nga Tirana gjer në Prishtinë e në Tetovë ai e vuri në ndihmë kujdesin e tij vëllazëror për të kapërcyer pengesat e mungesat për punë të talentëve të rinj e të kolegëve. Ai ishte, si të thuash, në qendër të reflektimit të një ngrohtësie aq të nevojshme kolegjiale, që nxit për punë e që inkurajon për sukses.

E për Kosovën, për popullin e Kosovës nën shtypjen shfarosëse të shovenizmit barbar serb, zoti Shaban Demiraj ishte akademiku që nxitonte në Tiranë të organizonte e të firmoste ndër të parët petitionet, protestat, kërkesat e lutjet që u drejttoheshin në emër të shoqatave e institucioneve joqeveritare, opinionit botëror e qendrave botërore të vendosjes, që fliste i përbotur për krimet dhe eksodin që po pësonte populli i tij i Kosovës, nëpër tubime intelektualësh e nëpër mbledhje komemorative për dijetarët patriotë të vrarë nga barbaria serbe. Brengosja dhe shpresa e këtij akademiku në atë

kohë ishte brengosje dhe shpresë e një kosovari nga Vlora, nga Vlora e flamurit të pavarësisë. Fjalë miradie për këtë angazhim të tij i shpreh jo vetëm Akademia jonë e Shkencave dhe e Arteve, por i tërë subjekti shkencor e intelektual i Kosovës.

Duke e përgëzuar për 80-vjetorin e lindjes akademik Shaban Demirajn, përfaqësuesin tash sa kohë më të gjithanshëm e më autoritativ të studimit të shqipes, i dëshiroj shëndet dhe energji që t'i japë albanologjisë edhe ndonjë vepër të denjë për emrin e tij aq të nderuar.

PËR SELMAN RIZËN NË 100-VJETORIN E LINDJES

E nderuar familje Riza, i nderuar President i Republikës së Kosovës zoti Fatmir Sejdiu, i nderuar ministër Valton Beqiri, të nderuara autoritete shtetërore e shoqërore, të nderuar akademikë, zonja e zotërinj,

Kosova po e shpreh respektin ndaj një biri të saj të rrallë që na nxit krenari, po i jep nderimin e merituar Selman Rizës me “Medaljen e Artë të Lirisë” të Presidentit të Republikës zotit Fatmir Sejdiu në 100-vjetorin e lindjes, këtij personaliteti që krijoi veprën shkencore të niveleve kulmore albanistike në kushtet e përndjekjeve, të burgosjeve e të deportimeve dhe që pikëllimin e tij për Kosovën e zaptuar e ktheu në aktivitet të shënuar patriotik për çlirim të saj.

Profesor Selman Riza është dekoruar edhe nga Presidenti i ndjerë i Kosovës zoti Ibrahim Rugova me “Medaljen e “Lidhjes së Prizrenit” në vitin 2003 si dhe nga zoti Sali Berisha kur ishte President i Shqipërisë.

Zonja e zotërinj, vepra gjuhësore e Selman Rizës është një ekspozitë e qëndrueshme e shkëlqimit të mendimit shkencor ndër ne, një shkallë krenuese në të cilën arriti gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Në të është energjia e një mendjeje veçanërisht të mprehtë, vullneti i rrallë i një shkencëtari erudit, sevdaja, siç ka thënë ai, për trajtim shkencor të gjuhës amënore dhe ndjenja e përgjegjësisë personale për t’ i ngritur studimet e shqipes në nivele të studimeve të gjuhëve të mëdha të Evropës. Portreti shkencor i Selman Rizës është i veçantë për gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave, për mënyrën gjithnjë rigorozisht logjike të zërthimeve analitike, për konsideratën gjithnjë të pranishme ndaj koherencës së elementeve të sistemeve gjuhësore, për trajtim të sinkronisë së shqipes me sqarime diakronike të relikteve gjuhësore, për arsyetimet gjithëpërfshirëse, për metagjuhën saktësisht identifikuese, për stilin unikat në letrat shkencore të shqipes dhe për tehun e mprehtë të kritikës ndaj diletantizmit e improvizimeve. Pas vdekjes së Selman Rizës gjuhësia shqiptare ka mbetur pa këtë mënyrë dinamike të trajtimit të temave gjuhësore.

Profesor Selman Riza, njëri ndër intelektualët e shquar shqiptarë të shekullit XX, u lind në Gjakovë më 1909. Si i mitur e kaloi kufirin ilegalisht e arriti të kryente me ritëm të shpejtuar mësimet fillore në Tiranë e të mesmet në Liceun e Korçës me sukses të pakrahasueshëm. Drejtori francez i Liceut e rekomandonte maturantin Riza që të dërgohej gjithsesi në studime, sepse ishte i sigurt se do të bëhej personalitet që do ta nderonte kombin e tij.

Për tre vjet mbaroi studimet paralelisht për filologji e për jurisprudencë në Francë. U kthye në Shqipëri dhe punoi profesor i gjuhëve shqipe, frënge, latine e gjermane në Liceun e Korçës në vitet 1936 – 39. Si një ndër organizuesit e demonstratës së madhe në Korçë kundër okupuesit fashist dhe pushtetit kuisling më 1940 u arrestua bashkë me patriotë të tjerë dhe u internua në Ventotenë të Italisë. Pas 20 muajsh u lirua nga internimi dhe, pasi nuk gjeti punë në Durrës, kaloi në Prizren, ku punoi si avokat deri më 1944. Gjatë kësaj kohe krijoi Qendrën e Vogël të Studimeve Kosovare, që do të merrej me aftësimin e “arsimtarëve fillorë e të mesëm, që të studiojnë vetë historinë, gjeografinë dhe dialektin e Kosovës”. Njëkohësisht u vu në krye të Lëvizjes Antifashiste Iridentiste. Kjo Lëvizje nuk ishte as me Ballin Kombëtar as me komunistët. Ishte për vetëvendosje përmes shkëputjes kryengritëse. Bashkë me anëtarët e Komitetit Intelektual Shqiptar botoi gazetën “Lidhja e Prizrenit”. Më 1943 në Gjakovë u takua me një major anglez dhe u morën vesh që të formohej çeta e luftëtarëve nën komandën e Ejup Binakut.

Në vitin 1944 u kthye në Tiranë dhe botoi veprën *Tri monografina albanologjike*, me të cilën paralajmërohej se po vinte një individualitet i veçantë në studimet e shqipes. Një vit më vonë u arrestua nga regjimi komunist nën akuzën “kosovar antijugosllav” dhe u mbajt pa u gjykuar deri në fillim të vitit 1948, kur iu dorëzua autoriteteve jugosllave. Edhe këtu mbeti në burg të Prishtinës pa u gjykuar. Gjatë viteve 1952-53 qëndroi i internuar në Sarajevë dhe punoi lektor i gjuhës frënge në Universitetin e atyshëm, duke u dalluar në punën e tij si njëri nga profesorët më të respektuar. Në vitin 1953 u pranua punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të porsahapur dhe qëndroi deri në vitin 1955 kur e kthyen në Shqipëri, me ç’rast u mbyll edhe Instituti. Prania dhe puna e tij shkencore albanologjike u pa e dëmshme për synimet shoviniste të Serbisë. Gjatë qëndrimit në Prishtinë botoi tri vepra gjuhësore dhe la pas autoritetin e dijetarit që ngjalli interesimin për studime

gjuhësore e për zhvillimin e mendimit kritik në Kosovë.

Që nga viti 1956 punoi në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë në Tiranë dhe paralelisht në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

Më 1959 mori gradën “Kandidat i shkencave”, kurse një vit më vonë mori titullin e profesorit. Për veprën *Emrat në shqipe, sistemi i rasave dhe tipet e lakimit* u dekorua me “Çmimin e Republikës së Shqipërisë”.

Por ai vijimisht ishte nën kontrollin agjental si antikomunist e tani edhe si spiun i mundshëm jugosllav, kështu që në vitin 1967 mendimi i tij se filozofia marksiste nuk mund të zbatohet në gjuhësi dhe kërkesa për të ndryshuar mënyrën e udhëheqjes e të organizimit të punëve në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë në dobi të mbarëvajtjes u çmuan si mendime armiqësore, si pikëpamje të huaja antiparti, si mohuese të rolit drejtues të Partisë në punën shkencore dhe u trajtuan me një ashpërsi makabre me fletërrufetë, një herë “T”i hiqet koka Selman Rizës” e pastaj “T”i çirret maska Selman Rizës”. I thanë të kërkonte falje te udhëheqësit e lartë, por ai nuk pranoi. E transferuan në Berat si kustos i Muzeut dhe iu hoq e drejta e botimeve. Nga kjo detyrë Selman Riza doli në pension pas tre vjetësh e u kthye në Tiranë ku vdiq më 1988.

Në fate të tilla biografisë lënë pa shprehur lëndimet shpirtërore deri te dilemat e ekzistimit si dhe shpërthimet e krenarisë rezistuese. Selman Riza po ndahej nga jeta kur kishin marrë hov forcat robëruese të njeriut në tërë shtrirjen e popullit shqiptar, kur puna e tij shkencore ishte nëpërkëmbur dhe kur Kosova po përfytyej me eskalimin e dhunës.

Selman Riza nuk u ftua të jepte kontributin e tij prej eksperti të provuar në përcaktimin e normave të shqipes standarde në përgatitje të Kongresit të Drejtshkrimit më 1972, ku iu lejua të merrte pjesë pa të drejtë diskutimi. Selman Riza mbeti pa iu respektuar merita për të qenë anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Selman Riza u varros pa përcjellje nga kolegët e Institutit e të Universitetit, pa asnjë fjalë miradie për punën e tij si profesor, si shkencëtar e si krijues i kuadrit të ri shkencor.

Botimi nga “Rilindja” e Prishtinës më 1979 i një vëllimi me punime të tij gjuhësore e pat gëzuar pa masë. Ai pa se vepra e tij gjuhësore po merrte rrugën e një vlerësimi të merituar e të pamohueshëm. Akademia e

Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka botuar në pesë vëllime voluminoze të gjithë veprën gjuhësore të tij duke përmbledhur edhe dorëshkrimet.

Është thënë se “të gjitha dritat tona mbi shpirtin e njeriut kalojnë nëpër gjuhë”. Në gjuhën e Selman Rizës shohim shpirtin e tij që synon kapërcimin e së sotmes, shpirtin dashamirës e nxitës për arritje nivelesh më të larta shkencore nga të gjithë ne pas tij.

Kur e takonim, kishim përshtypjen se po qëndronim para një shikimi qortues ndaj masës së pamjaftueshme të kontributit tonë në shkencë e jashtë saj, para një shikimi të përmallshëm të dëshirës për përparimin e Kosovës. Ai vdiq me mallin për Kosovën dhe la amanet që mbetjet e tij të preheshin në “Kosovën shqiptare”, që do të thotë se ka shkuar me shpresë të pashuar se Kosova do te jetë e çliruar dhe deshi që edhe me rivarrosje të mbetej përjetësisht i pandashëm prej saj.

Selman Riza që në fillimet e jetës së tij intelektuale i tha po veçantisë së tij, moralit dhe vizionit të tij shoqëror e bashkë me to edhe jetës së tij të trazuar. Ai nuk u këput në asnjë çast nga kuptimi i qenies së tij, duke mos rënë, siç thuhet, në pellgun e njerëzve të rëndomtë. Me ndjenjën e së drejtës dhe të së vërtetës në të gjitha veprimet e tij dhe me përgjegjësinë intelektuale morale për to si dhe me kërkesën për diçka më të mire në shkencë e më njerëzore në shoqëri Selman Riza ishte ndër ato personalitete që nuk përshtaten me botën dhe goditen padrejtësisht nga bota.

Selman Riza kishte thënë: “kur e kthej kokën dhe e vështroj të kaluarën time, shoh se nuk kam pse të skuqem a të turpërohem”. Por ai kishte arsye të thoshte më shumë, kishte arsye të krenohej me veprën e vet shkencore, me moralin e tij, kishte arsye të krenohej me veprimin politik aq të dëlirë kombëtarisht e aq të lartë njerëzisht. Me punën e tij patriotike ai shkroi një varg të denjë në këngën e papërfundueshme të çlirimit e të mirëqenies kombëtare.

Selman Riza e kaloi jetën brenda ballafaqimit të vështirësive të rënda demoralizuese dhe vullnetit për të ecur kah sfera të ndritshme të mendjes. Në këtë sprovë ai qëndroi në anën e atyre që tregojnë papërkulshmërinë e shpirtit njerëzor dhe i la trashëgim kulturës shqiptare, përveç veprës gjuhësore, edhe një shembull të rezistencës së pavarësisë së mendimit shkencor.

NË PROMOVIMIN E LIBRIT TË IDRIZ AJETIT¹

I nderuari profesor Ajeti, i nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zoti Ylli Popa, i nderuari kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës zoti Rexhep Ismajli, të nderuar zonja e zotërinj!

Së pari dua të shpreh kënaqësinë që Akademia e Shkencave e Shqipërisë botoi këtë përzgjedhje të punimeve shkencore të akademik Idriz Ajetit, të parin publikim të tij në Shqipëri.

Tërë vepra albanistike e akademik Idriz Ajetit, tërë puna e tij e pedagogut, që e bëri profesor emeritus të Universitetit të Prishtinës, e gjithë veprimtaria në udhëheqje të institucioneve të larta arsimore e shkencore, tërë prezantimi i tij i autoritetshëm në kongrese e simpoziume ndërkombëtare, të gjitha janë mbështjellë me një ndjenjë të ngrohtë, njerëzish të ndritshme për prosperitetin e popullit të tij. Me vlerën e lartë të veprës së tij shkencore, arsimore e kulturore akademik Idriz Ajeti shpejt arriti të jetë shkencëtar me të cilin u krenua e krenohet populli shqiptar i Kosovës.

Krijimtaria e tërësishme shkencore e Idriz Ajetit tregon se ai iu qas studimit të shqipes duke e kuptuar gjuhën në frymë të teorisë së Humboldt-it që ajo “është emanacion specifik i shpirtit të popullit”. Iu qas pra me një dashuri e respekt të tillë, me kujdesin e veçantë që të mos lëndohej e që të mos e lëndonin as si të folme të një krahine, as si gjuhë kombëtare e letrare, as si kontinuitet që nga lashtësitë e saj të thella. E mund të thuhet se gjuha shqipe e pati Idriz Ajetin një ndër kujdestarët më të dalluar të pastërtisë së saj, një ndër spikatësit krenues të begatisë së saj. E do të jetë ky respekt që do t’i impononte të përdorte jo një metagjuhë shkencore të thatë e krejtësisht të ftohtë akademike, por një metagjuhë me frymëmarrje të lirë të gjuhës amnore, që u mor si model nga mjaft gjuhëtarë ndër ne. Me këtë ndjenjë janë të lidhura edhe shkrimet e tij për ndikimet e shqipes në fjalorin e gjuhëve sllave në kontakt, kontributi i tij në krijimin e gjuhës standarde gji-

¹ Tiranë, 18. XI, 2005.

thëkombëtare e për përsosjen së saj, si dhe me shkrimet udhëzuese për kulturën e gjuhës etj.

Në tezën e doktoratës *“Zhvillimi historik i së folmes gege të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë”*, që është edhe në këtë libër, profesor Ajeti trajtoi me kompetencë të lartë një temë që e kishin shtruar para tij gjuhëtarët famëmëdhenj Gustav Weigand-i e Carlo Tagliavini dhe, jo vetëm që nxori në shesh pasaktësitë dhe mangësitë e prezantimit të kësaj të folmeje dhe të mjaft përfundimeve e sqarimeve të tyre, por, duke i dhënë një strukturim dialektologjik historik krahasues punimit të tij, ai arriti të përcaktonte masën e evoluimit e të ndryshimit të kësaj të folmeje nga të folmet e Briskut e të Shestanit të Krajës. Punimi është vlerësuar nga W. Cimochoowski më të drejtë si *“monografi tepër interesante e me vlerë në dialektologjinë historike, një fushë që zakonisht është paraqitur tepër pak edhe në shumë gjuhë të tjera të hulumtuara më rrënjësisht...”*. Ai ka thënë gjithashtu se *“Gjuhësia dhe dialektologjia i detyrojnë Ajetit mirënjohje të veçantë për të dhënat mbi të folmen e Krajës dhe vendosjen e pozitës së saj në kuadër të të folmeve fqinje të shqipes veriore”*. Kjo mënyrë e trajtimit të materies dialektologjike i cakton një vend të veçantë Idriz Ajetit në dialektologjinë shqiptare të deritashme. Në punimet e tij të bazuara në shkrimet shqipe me alfabet arab, siç janë *“Vehbija”* e Tahir Efendi Boshnjakut dhe *“Divani”* i Sheh Hilmi Maliqit, profesor Ajeti përcaktoi ndryshimet që kishte pësuar e folmja e Gjakovës nga viti 1835 dhe e folmja e Rahovecit nga fillimi i shek. XX.

Në vitet e pesëdhjeta për ne, gjeneratat e para të studentëve I. Ajeti bashkë me Kadri Halimin e Mark Krasniqin, për penën e tyre shkencore e për vlerën kombëtare të asaj pene në përballje me denigrimet ndaj kulturës shqiptare përbënin mburrjen tonë kolektive rinore. Ajo penë sinjalizonte haptas se edhe nga mjedisi ynë, atëherë i mbërthyer në analfabetizëm, do të mund të shpërthente një potencial i fuqishëm intelektual e shkencor në të gjithë lëmenjtë e dijes.

Niveli i studimeve gjuhësore të Idriz Ajetit që nga fillimi u bë pikësynim i dëshirueshëm i gjuhëtarëve kosovarë që po formoheshin. Ky nivel ndikoi në mënyrë efektive që edhe ndër ne të bëheshin shpejt të paprueshme si shkencë improvizimet, nxitimet e dija e pamjaftueshme në

trajtimin e temave gjuhësore, ndikoi të kuptohej ajo që ka shënuar Emil Benveniste-i se “të folurit është vërtet lëndë e vështirë” e se “analiza në studimin gjuhësor bëhet përmes rrugësh të vështira”.

Akademik Idriz Ajeti për gjuhëtarin e ri të Kosovës ishte ai kritiku i nevojshëm me të cilin komunikohet në mungesë gjatë procesit të krijimit, ai mentori i ashpër prej të cilit duhej marrë pëlqimi i heshtur se trajtimi i temës së zgjedhur është solid. Dhe akademik Idriz Ajeti u zgjodh me të drejtë si i tillë edhe për shkak se nuk u kursye të drejtonte, të udhëzonte e të ndihmonte ata që premtinin dhe për arsye se personalitetin e tij e ka hijeshuar gjithmonë gëzimi i sinqertë për veprën e suksesshme shkencore të tjetrit.

Ne nuk mund të dimë se çfarë pyetjesh i drejton vepra akademik Idriz Ajetit. Ne dëgjojmë vetëm njërin nga ato: a ka pasur mundësi që kjo veprë të ishte ca më e gjerë, ca më e vëllimtare? Dhe ne kemi të drejtë ta shtrojmë këtë pyetje si qortim, për shkak të mendimit të lartë që kemi për studimet e tij e nga dëshira që gjuhësia shqiptare të kishte pasur edhe ndonjë të tillë.

Në rastin e akademik Idriz Ajetit, siç ndodh me krijues veçanërisht të dalluar, mendimi i të tjerëve për vlerën e veprës së tij është krejt i afërt a identik me idenë që ka ai për veprën e vet. Kualitetet e trajtesave të tij shkencore kanë bërë që vepra t’i radhitet ndër veprat e qëndrueshme të gjuhësisë shqiptare, të radhitet krahas veprave të pak gjuhëtarëve shqiptarë, krahas veprës së Aleksandër Xhuvanit, Mark La Pianës, Selman Rizës, Shaban Demirajt, Mahir Domit – të prira nga vepra e Eqrem Çabejt.

Vepra shkencore përmban mundin e mundur të hulumtimeve dhe të kërkimeve, këmbënguljen shteruese të energjisë fizike e krijuese në një jetë të tërë. Për të gjitha këto akademik Idriz Ajeti pati shpërblimin më të madh e më të këndshëm që mund të pritët: në letrat e shqipes hyri në radhën e bijve të paharrueshëm të popullit të tij. Do të jetë ky një satisfaksion që krenon e që i thotë se jetën pati pse ta jetonte.

PËR EQREM ÇABEJN SHKURTIMISHT¹

Disa herë më ka rënë të takohem me profesor Çabejn. Në vitin 1976 mbajta një ligjëratë para studiuesve të Institutit të Gjuhësisë dhe të Katedrës së Gjuhës Shqipe në Tiranë e më nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe profesor Çabej, profesor Domi e profesor Demiraj. Kisha mendime krejt të ndryshme nga ato të gjeratëhershmet për zhvillimin e sistemit rasor të shqipes. Askush s' bëri zë. Vetëm profesor Çabej m'u afrova e më tha: “Një gjuhëtari të ri i kanë thënë: në këtë grusht e ke të vërtetën, në këtë tjetrin e ke dëshirën për ta gjetur. Gjuhëtari i ri, tha profesori, zgjodhi atë që duhej zgjedhur: zgjodhi dëshirën për ta gjetur”. Kështu profesor Çabej, përkundër mendimeve të tjera që kishte për temën, po më thoshte me dashamirësinë e një autoriteti shkencor e njerëzor që të ecja ashtu si di vetë në rrugën hulumtuese që kanë hapur të tjerët. Tre vjet më vonë në Ankara, në Kongresin e Studimeve të Evropës Juglindore, pata kënaqësinë të shihja me krenari respektin e lartë që ia shprehnin Çabejt gjuhëtarët e huaj eminentë. Po aty në ato pak ditë që ndejm profesor Çabej më afrova e rrezatoi dashuri e miqësi aq të dëshirueshme për të qenë afatgjatë. Sjellja e tij e çiltër shoqërore dhe kolegjiale shfaqej njerëzisht e natyrshme, sepse dilte nga thjeshtësia që i karakterizon njerëzit e mëdhenj. Profesor Çabej ishte i veçantë edhe për faktin se tek ai nuk mund të dalloje as më të voglën shenjë të përcëimit të atyre që ishin poshtë tij.

Dhe më iku shpejt ajo mbështetje kurajodhënëse e atij shpirti fisnik, që ta bënte të këndshme jetën, e atij studiuesi që lartësitë e rezultateve të tij shkencore përpiqej t'i fuste mbrenda horizonteve të ambicieve tona krijuese, t'i sillte si diçka që mund t'i arrinin edhe ne.

Rruga e vështirë që bëri Çabej nga toka tek yjet qe e mundur, sepse ai pati shumë dhunti të mëdha: pati horizontin e gjerë të mendjes, forcën e përfytyrimit dhe dinamizmin e shpirtit që thuhet se e kanë njerëzit e shquar dhe nje zemër dëshiruese, pati një vullnet që ia bënte të pashtershëm dëshira për prosperitetin e popullit të tij. Mendoj se Çabej pati aftësi të

¹ Tekst i thënë gojarisht gazetarit Ali Llundj për RTK-së.

spikatur për të njohur shkaqet e dukurive. Të gjitha këto ia dhanë besimin në aftësitë e veta për të aplikuar mjeshtërisht dijen e akumuluar e për të krijuar vepra që avancuan në kontinuitet rezultatet e studimeve albanologjike. Me Çabejn ndodhi diçka e re në albanologji, diçka epokale: kulmet e kësaj shkence me të po shkëlqenin për herë të parë edhe nga Shqipëria.

Mendja e Eqrem Çabejt i dha një ndriçim të veçantë kulturës kombëtare.

Konferenca shkencore për Çabejn, që do të mbahet në Tiranë në 100-vjetorin e lindjes së tij, shpresoj se do t'i vazhdojë më tutje përpjekjet për të përcaktuar sa më realisht vlerën e veprës së këtij studiuesi të madh të shqipes.

PËR REXHEP ISMAJLIN¹

Kolegë të nderuar,

në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Akademisë së Shkencave e të Arteve të organizuar për t'i shprehur bashkërisht urimet tona kolegut Rexhep Ismajli për mirënjohjen që i rezervuan instancat e larta shkencore evropiane, duke e pranuar anëtar të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Evropës, nuk është rasti të përiqemi të shpalojmë mendimet tona për vlerat e veprave të tij veç e veç. Lëre që, edhe në ndonjë rast tjetër të volitshëm, nuk është e sigurt se kjo do të mund të bëhej me kompetencë të plotë, për shkak të dallimit të konsiderueshëm, për tash, të përvojave krijuese të autorit dhe të atij që synon ta bëjë vlerësimin. Por një vlerësim i përgjithshëm i veprës gjuhësore të Rexhep Ismajlit mund të shprehet pa asnjë hezitim: Rexhep Ismajli është gjuhëtari që po i jep gjuhësisë shqiptare një shtytje vendimtare për një zhvillim të ri cilësor me deduksion te teoritë bashkëkohore gjuhësore evropiane e botërore.

Mendoj se albanistika në zhvillimin e saj ka shënuar tre hapa të rëndësishëm kualitativë:

Hapi i parë është ai i Hahn-it me Bopp-in, Kamardën etj., që bëri të tejkalohej gati tërësisht faza parashkencore e trajtimit të çështjeve të gjuhës shqipe. Hapi i dytë u hodh nga G. Meyer-i, H. Pedersen-i e N. Jokl-i, të cilët studimet e shqipes i ngritën në nivel të një rigoroziteti të theksuar shkencor, me referenca në teoritë gjuhësore të kohës. Hapi i tretë është hapi i E Çabejt, e brenda tij, edhe hapi i I. Ajetit në Kosovë. Çabej nuk solli ndonjë bazë të re deduktive, por e solli këtë rigorozitet shkencor brenda subjektit kombëtar, duke u bërë nxitës me shembullin e veprave të tij që ai të arrihej nga një plejadë e tërë gjuhëtarësh shqiptarë në të gjitha fushat studimore të shqipes. Rezultatet janë të mëdha. Por kjo fazë, që nisi të shfaqej në fillim të gjysmës së dytë të shekullit XX, duke qëndruar, me përjashtime të parëndësishme, në pozitat teorike të fazës së dytë, kishte mbetur e izoluar nga rrjedhat e gjuhësisë evropiane, që kishte bërë ndër-

¹ Në Akadmeinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 08/04/2003.

kohë zhvillime të hovshme epokale në trajtimin e strukturës e të sistemeve të gjuhës në përgjithësi. Si e tillë ajo ishte detyrimisht e përmbyslshme, kështu që, edhe brenda kohës së saj, dukej shumë i nevojshëm një hap rivitalizues i gjuhësisë shqiptare, që do ta lidhte me të arriturat e gjuhësisë së përgjithshme.

Ky hap vjen me emrin e Rexhep Ismajlit. Ai e nisi këtë fazë të studimeve të shqipes që në publikimet e para, d.m.th. që në vitet e shtatëdhjeta dhe vijoi me vepra të njëpasnjëshme në vitet e tetëdhjeta me intensitet gjithnjë në rritje gjer në ditët e sotme. Njohja e gjerë dhe e thellë e teorive moderne gjuhësore ia hapi Rexhep Ismajlit mundësinë e vështirimit të lëndës gjuhësore si objekt të ri që duhet ritrajtuar. Si studiues i tillë ai doli me punimet për tekstet e vjetra, për çështje të fonologjisë sinkronike e diakronike, për gjuhën e standardizuar, për problemet e origjinës së gjuhës shqipe, për lidhjet e saj me rumanishten e me gjuhët e tjera ballkanike, për shtresat e ndryshme të huazimeve, për çështje socio-linguistikore dhe hapi dyert kah trajtimi i çështjeve të gjuhësisë tekstore. Me studimet e tij në këto fusha ai gëzon autoritetin e një shkencëtari të nivelit të lartë të studiuesit e huaj të shqipes e, tanimë, edhe të të gjithë studiuesit shqiptarë.

Ky hap i ri karakterizohet nga synimi për një koherencë të pashkëputshme me zhvillimet e teorive gjuhësore, mbështetur edhe në synimin dhe mundësinë e tërë shoqërisë shqiptare për integrim në rrjedhat e zhvillimeve të shoqërisë evropiane. Kështu Rexhep Ismajli me kualitetet shkencore bashkëkohore të veprave të tij hapi një rrugë që do të ndiqet detyrimisht nga kuadrot tona të reja, të cilat do t'i zgjerojnë analizat e tilla në të gjitha fushat albanistike e gjuhësisë sonë do t'i sigurojnë standarde analizuese të nivelizuara me ato të gjuhësive të vendeve të ndryshme evropiane. Në këtë mënyrë vepra e R. Ismajlit do të sjellë gradualisht pjesëmarrjen adekuate të gjuhësisë sonë edhe në trajtimin bashkëkohor të çështjeve të ballkanistikës, duke ia siguruar rolin që i takon dhe rezultatet e saj do të bëhen më të shfrytëzueshme nga teoricienët e gjuhësisë.

Rexhep Ismajli njohjen e gjerë e të thellë të shkollave të reja gjuhësore nuk e ka dije pasive të një dijetari, por e ka dije që cilësohet funksionale, e akumuluar në një personalitet krijues, me aftësi aplikative

produktive, me aftësi të shfrytëzimit të saj për të depërtuar në thellësi të çështjeve e të fenomeneve dhe në thelbin e korelacioneve të tyre.

Puna shkencore e deritashme e akademik Rexhep Ismajlit, me gjerësinë e saj tematike, sikur flet se ai vepron në pajtim me konstatimin e R. Jakobsonit se “qëllimi suprem i gjuhëtarit është vrojtimi i gjuhës në tërë kompleksitetin e saj”.

Rexhep Ismajlit, ashtu si studiuesve të rrallë, thellësinë e shqyrtimeve shkencore ia nxjerr në pah edhe qartësia e kthjelltësia e shprehjes komunikuese.

Në vështrimet e veprave të studiuesve të njohur të shqipes, R. Ismajlit i shndrit mendimi se e kaluara duhet të kundrohët si diçka që shtyn përpara, prandaj gjithë ai respekt ndaj rezultateve të punës së tyre, të vështruar edhe në raport me kushtet e kohës, gjithë ai respekt ndaj energjisë krijuese si faktor për të lëvizur drejt niveleve më të larta.

Fillimi i një lëvizjeje, që shënon ecje përpara, siç është kjo e Rexhep Ismajlit, është akt që vjen për të shpëtuar diçka me vlerë e që, përballë kundërshtimeve që shkakton, mund ta nxisë e ta zhvillojë vetëm një personalitet i fuqishëm krijues me mendje të lirë e të begatuar me dije të gjerë e të thellë.

Pranimi i Rexhep Ismajlit anëtar i Akademisë së Shkencave të Evropës na krijon një ndjenjë krenarie që e kemi koleg e shok këtu në Akademinë tonë. Me këtë vlerësim të punës së tij është ngritur më lart edhe prestigji i kësaj Akademie në ato qarqe e kudo.

Akademik Rexhep Ismajlit i dëshiroj punë të frytshme, që ta begatojë spektrin e studimeve të tij në frymën, me të cilën ai, në historinë e albanistikës, po zë një ndër vendet më të spikatura, vetëm epokalisht të arritshme.

NË 70-VJETORIN E LINDJES SË FEHMI AGANIT

Me botimin e veprës complete të Fehmi Aganit Shtëpia Botuese “Dukagjini” ka bërë një veprim të çmueshëm shoqëror e kulturor. Duke shfaqur kështu respektin e saj ndaj autorit të ndjerë, ajo e ka nderuar veten në sy të opinionit që di të çmojë rëndësinë e publikimit të veprave të krijuesve tanë të dalluar. Mirënjohje nga të gjithë ne u shkon edhe promovuesve kompetentë të kësaj vepre, miqve të dashur të autorit. Redaksia e këtij botuesi kishte përcaktuar që në këtë ditë të 70-vjetorit të lindjes së Fehmi Aganit të them edhe unë një fjalë të shkurtër jashtë kontekstit të promovimit.

I shqetësuar për përgjegjësinë e madhe që ka fjala për Fehmiun, fjalë që më duket e papërmblyllshme sado e gjatë që të jetë, po them disa përshtypje të mia, duke u përpjekur ta zbus dështimin që pëson fjala gjykuese për shokun.

Në ato fillime të shoqërimit të hershëm me Fehmi Aganin ishte e pranishme disi xhelozia jonë ndaj kualiteteve të intelektit e të karakterit të tij. Pastaj kuptuam se me Fehmiun si shok jeta na kishte sjellë një vlerë e një gëzim të qëndrueshëm. Të tillë e përjetuam gjithnjë, sepse i tillë ai na mbeti gjatë tërë jetës.

Nganjëherë, kur e shikoja së largu duke ecur rrugës, e dija se po ecte dashuria njerëzore e po takohej me njerëzit, se po ecte mirësia e zemrës që jep ndihmë vullnetin, shpresën e kurajon e optimizmin. Kjo është edhe një vepër e pashkruar e Fehmi Aganit, e rrallë, e papërmbledhshme në vëllime, por e shfletueshme me mall në kujtimet e mijëra njerëzve të rinj e të moshuar, që e njohën, që domethënë: që e deshën.

Fehmi Agani është emër i një personaliteti veçanërisht të veçantë, që e reduktoi deri në skajshmëri numrin e të ngjajshmëve. Ai ishte mishërim i së mirës që vepron, i së mirës që guxon të shpërthejë e të përhapet e të kërkojë, prandaj Fehmiu ishte shqetësues për veprimtarët e profitit politik. Si rrallë me ndonjë tjetër, ata që s’e donin ishin vetvetiu qartësisht të identifikueshëm si njerëz matanë së mirës. Pastërtia morale e veprimit shoqëror

të Fehmiut përcaktonte shkallën e angazhimit të sinqertë e të përkushtuar të të tjerëve rreth tij.

Fehmiu ishte i përgatitur intelektualisht e shpirtërisht për ta ngritur në arsye të qenies së tij përpjekjen e pakursyer për të ndihmuar jetësimin e aspiratave të bashkëkombasve të tij. Ai po tregonte se kishte ecur tutje, se ishte bërë pjesë e atij prototipi njerëzor që endet nëpër mote për t'u hapur shtigje dritave të jetës.

Si çmues i mprehtë i zhvillimeve shoqërore e politike brenda dhe jashtë Kosovës ai diktonte me saktësi kahjet e tyre në raport me interesat e Kosovës dhe sugjeronte hapat për veprim të dobishëm.

Njeri i ndjenjave të holla, Fehmiu kishte shqetësime intime nën presionin e përgjegjësisë së asaj që bënte e nën presionin e masës së energjisë që jepte e që nuk i dukej kurrë plotësisht e mjaftueshme për nevojat e Kosovës ekzistencialisht të kërcënuar, brengosje të thella deri në përlojtje për çalimet e ngecjet në lëvizjen për pavarësi, në kapërcimin e të cilave ai dha shpesh shtytjen vendimtare. Por Fehmiu ishte gjithsesi njeri i lumtur, sepse, siç është thënë, “i aftë për të qenë i lumtur është ai shpirt i pastër e i shndritshëm që përparon vazhdimisht drejt një shtegtimi të denjë njerëzor”. Ishte i lumtur, sepse besonte, i besonte ecjes kah e ardhmja e kërkuar, ecje së cilës ia fali tërë aftësinë e tij. Edhe pse iu shkurtua jeta barbarisht, Fehmi Agani është fitimtari, fitimtari, sepse diti të dashuronte tamam atë që deshi, të vuante tamam për ata që deshi e të vepronte tamam kundër së keqes, fitimtar i lumtur edhe për ndikimin efektiv të bashkëkombësit për ta bërë vepruese nostalgjinë për liri.

Fehmi Agani bënte punën e heroit në kuptimin se shquhej aq shumë në veprimtarinë shoqërore e me cilësinë e kësaj veprimtarie sa ishte bërë shembull frymëzimi e nxitjeje për të tjerët, por ai e pati forcën e karakterit që të mos e merrte rolin e heroit, që të mbetej Fehmi, vetëm për arsye se në poliseminë e “heroit të gjallë” është i pashmangshëm kuptimi i sundimit të njerëzve, gjë që të qenët Fehmi Agan e përjashtonte.

Fehmi Agani edhe me frymën e tij të fundit i dha flamurit kombëtar edhe një valvitje krenare.

Këtu tani e kemi veprën e shkruar të Femiut, e kemi Fehmiun të rishfaqur si qenie e dashur. Ai na vjen siç ishte, me kthjelltësinë e mendjes e me thellësinë e gjykimit, me guximin për të shprehur mendimin shkencor politik, me elegancën shembullore të shprehjes e me polemikën brilante. Na vjen si nxitës i vullneteve për të lëvizur, për të krijuar e për të ndihmuar. Na vjen shpalues i denjë i kulturës së lëvizjes sonë për pavarësi e si parajlmërues i besueshëm i së ardhmes, në të cilën vetë nuk arriti. E dëshiroj të them se na vjen edhe si krenari e gjeneratës brenda krenarisë së Kosovës për të.

Fehmi Agani shtegton gjithandej në kujtesën e njerëzve tanë. Promovuesit e veprës së tij na ndihmuan që të ndjejmë se Fehmiu për disa çështje kaloi edhe nëpër këtë sallë si puhi mallëngjyese.

NË 90-VJETORIN E LINDJES SË MARK KRASNIQIT¹

Të nderuar të pranishëm, zonja e zotërinj,

Jemi mbledhur sot për t'i shprehur të gjithë së bashku urimet tona të përzemërta akademik Mark Krasniqit në 90-vjetorin e lindjes. Është një ditë e gëzuar, e hareshme për ne, një ditë feste për Akademinë tonë, sepse edhe profesor Mark Krasniqi pas profesor Idriz Ajetit qëndron me ne i shëndetshëm e energjik edhe pas nëntëdhjetë vjet jete, një jete të fisnikëruar me veprimtari të dalluar krijuese shkencore e letrare e me veprimtari po aq të dalluar patriotike. Ky jubile i jetës së Mark Krasniqit është edhe jubile i përpjekjeve frytdhënëse kundër së keqes në kushtet e rënda të jetës në Kosovë.

Nga lartësia e këtij përvjetori kujtimet zbresin në kohën e fëmijërisë, kur e përjetoi trajtimin robërues të popullit të tij dhe që atëherë ndaj kësaj gjendjeje njerëzisht poshtëruese iu brymos ndjenja e kundërshtimit e mos-pajtimit, të cilën e ktheu në aktivitet të përhershëm kundërshtues e me synim për të ndihmuar ardhjen e një kohë tjetër. Kujtimet shkojnë pastaj në Padovë, ku qëndroi dy vjet si student i letërsisë dhe vijojnë pas diplomimit në Beograd, kur filloi ta orientojë energjinë e tij krijuese në shkencën e gjeografisë dhe etnologjisë si asistent e bashkëpunëtor shkencor në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, ku punoi njëmbëdhjetë vjet me momente të nëpërkëmbjes, për shkak të veprimtarisë së tij shkencore, që filloi e pandarë nga detyra intelektuale për të mbrojtur me guxim e me trajtim të mirëfilltë shkencor të vërtetat për popullin e tij, të hidhet energjikisht kundër shtrembërimeve qëllimkëqija të fakteve për popullin shqiptar. Shkojnë kujtimet në kohën kur u detyrua ta mbronte tezën e doktoranturës në Lubjanë e jo në Beograd. Vijnë pastaj kujtimet e shumta e të shumëllojshme të njëzet vjetëve (1961-81) që i kaloi si profesor në Fakultetin Juridik-Ekonomik, si prodekan e dekan i këtij fakulteti, duke qëndruar gjithnjë profesor sugjerues për një qëndrim aktiv të studentëve

¹ 19 tetor 2010.

ndaj çështjes kombëtare. Si i tillë Marku u përjashtua nga Fakulteti, në vitin e madh 1981, kur shpërtheu revolta madhështore e rinisë. Më parë kujtimi ndalet në vitin 1966, kur brutalisht iu bënë kërcënime të rënda në një mbledhje publike në Prishtinë, ku u sulmuan qëndrimet e tij shkencore në doktoratën e botuar pesë vjet më parë, ngase ishin në kundërshtim me trajtimet joshkencore të çështjeve shqiptare të studiuesve serbë. Na kujtohet teksti i shkëlqyer i Markut në përgjigje ndaj akuzave, tekst që u lexua masivisht, duke na e ngjallur ndjenjën e krenarisë që kishim që në atë kohë shkencëtarë të zotët që e demaskojnë pseudoshkencës e drejtuar kundër nesh.

Kujtohet koha e udhëheqjes së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, e udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe zgjedhja anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por mbi të gjitha koha e themelimit të Partisë Demokratike të Kosovës dhe e drejtimit të saj për më se pesëmbëdhjetë vjet. Renditen kujtimet që dalin nga kontributi i kësaj partie e mbi të gjitha nga kontributi i kryetarit të saj Mark Krasniqi dhënë Lëvizjes sonë për pavarësi.

Dhe krahas këtij aktiviteti permanent shoqëror, Marku që i pandarë nga krijimi shkencor e letrar. Edhe shkencën edhe artin ai i vuri në shërbim të interesit të popullit të tij. Temat e studimeve shkencore janë zgjedhur e trajtuar në funksion të këtij qëllimi, siç tregojnë veprat:

Ndryshimet bashkëkohore gjeografiko-shoqërore në Kosovë e Dukagjin; Gjurmë e gjurmime - Studime etnografike; Lugu i Beranit – monografi etno-gjeografike; Rugova – monografi etno-gjeografike; Nga gurra e traditës – studime etnografike; Rrënjët tona etnike; Toleranca fetare në traditën shqiptare; Mikpritja në traditën shqiptare e disa të tjera. Me këto radhiten edhe veprat publicistike:

Katër libra me tituj *Qëndrime e reagime* dhe vepra voluminoze me titull *Përpykjet për Kosovën* si dhe referati i mbajtur në senatin belg më 1992 me titull *Kosova sot*, i përkthyer në anglisht e gjermanisht. Ka publikuar trajtesa të shumta shkencore në organet autoritative shkencore në ish-Jugosllavi e jashtë saj dhe ka marrë pjesë aktive nëpër konferenca, sim-

poziune e kongrese shkencore ndërkombëtare, gjithnjë aty ku duhej të ndëgjoheshin të vërtetat për popullin tonë.

Kështu Mark Krasniqi është ndër personalitetet që iu nevojitën kohës sonë për të hapur shtigje drejt një jete të dinjitetshme njerëzore. Dhe ja tani me të drejtë qëndron pranë nesh krenar për atë që bëri për shkencën e për popullin e tij. Ai si intelektual i orëve të para ndër ne, me ndjenjë të fortë individualizmi, qëndroi brenda synimit kolektiv për emancipim dhe prosperitet të popullit shqiptar. Ai eci nëpër jetë me ndjenjën e theksuar të përgjegjësisë shoqërore kombëtare, me guximin e këmbënguljen për të ndihmuar realizimin e aspiratave për liri. Me tërë veprimtarinë e tij të një vlere të lartë shoqërore Marku çmohet si një nga figurat tona më të shquara të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Ai arriti ta lërë të qëndrueshëm emrin e tij në rrjedhat e shkencës sonë kombëtare e të kulturës dhe të jetë njëri nga veprimtarët e ndritur patriotë të kohës sonë, që hynë në kujtesën e kombit. Mark Krasniqi la një të përmendur të vijueshëm, një përmendore për vete e për kohën e tij.

Mark Krasniqin dëshirojmë ta kemi edhe më tutje të shëndetshëm dhe energjik, të pandalshëm në aktivitetet shoqërore e në shfrytëzim të energjisë së tij krijuese Urime edhe një herë! Rrofsh edhe shumë vite!

Lus sekretarin e seksionit të shkencave shoqërore akademik Pajazit Nushin që ta marrë fjalën!

PËR JASHAR REXHEPAGIQIN NË 80-VJETORIN E LINDJES¹

Të nderuar akademikë e pjesëmarrës,

sot jemi mbledhur për të festuar 80-vjetorin e lindjes së kolegut tonë akademik Jashar Rexhepagiqit. Kjo ditëlindje është edhe ditë feste për Akademinë, sepse akademik Rexhepagiqi ka ecur me sukseset dhe vësh-tirësitë e Akademisë që nga themelimi i saj dhe se vepra e tij shkencore është pjesë e prestigjit shkencor të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kjo vepër në vëllimin thelbësor të saj është bërë pjesë e thesarit të qëndrueshëm shkencor të Akademisë.

Akademik Jashar Rexhepagiqi gjatë tërësorisht të punës së tij shkencore është identifikuar si mbrojtës i autoritetit të shkencëtarit, me respektin e rigoro-zitetit shkencor, të objektivitetit e të maturisë së trajtimeve e me korrektë-sinë ndaj rezultateve të të tjerëve. Akademik Rexhepagiqi është realizuar si studiues që, duke iu nënshtruar tërësisht kërkesave të profesionit, u bë zotërues i tij.

Zgjedhja e pedagogjisë si vokacion i jetës së tij është e lidhur me kri-jimin e tij poetik, dy veprimtari këto që si pikënisje e kanë dashurinë ndaj njeriut. Ai e zgjodhi pedagogjinë pse pa në të të bukurën si në poezi, siç është shprehur më 1961 në një shkrim me titull: *“Mbi të bukurën në art e në pedagogji”*. Rrallë është shprehur kaq intime afria emocionale me lëndën që do ta ketë të tijën tërë jetën.

Autoritetin e Akademisë sonë ai e mbajti lart edhe me fjalën e tij shkencore në Pragë, Moskë, Jenë, Ankara, Tiranë, Teheran, Novi Sad e Sarajevë.

Me punën e tij shkencore e pedagogjike akademik Jashar Rexhepagiqi është bërë personalitet, me të cilin krenohet nacionaliteti i tij, ndërsa me trajtimin e temave të rëndësishme në fushën e pedagogjisë shqiptare dhe të përhapjes së shkollave shqipe ka dhënë ndihmesë të respektueshme në begatimin e mendimit pedagogjik shqiptar.

¹ 16 janar 2009.

Akademik Rexhepagiqi deshi jo vetëm të shijonte bukurinë e gjuhës që sjell poezia, por deshi ta sillte atë edhe me poezinë e tij të shprehur në gjuhën amtare në pesë vëllime. Kështu ai e pati kënaqësinë që të kalonte nga bukuria e pedagogjisë në bukurinë e poezisë, gjithnjë duke dhënë dashuri në të dyja.

Me ngarkesat e shumta të jetës “rrallë i japim gëzime njëri- tjetrit”. E ato na nevojiten çdo ditë. Ne sot po e gëzojmë akademik Jashar Rexhepagiqin, sepse jemi edhe vetë të gëzuar për këtë jubile të tij e të lumtur bashkë me të.

Në 80-vjetorin e lindjes akademik Jashar Rexhepagiqit i dëshirojmë edhe shumë vjet jete të shëndetshme me energji krijuese e me lumturi.

PËR ALI PODRIMJEN

Për dy vjet në gjimnazin e Gjakovës me Ali Podrimjen ishim shokë klase: ai si nxënës, unë si profesor. Pastaj jeta ma solli kënaqësinë që ta kisha mik, njeri shumë të dashur e koleg të nderuar në Akademi.

Kur erdha në Gjimnaz, mora vesh se Aliu kishte qenë i përjashtuar nga mësimi, por që ishte kthyer në shkollë me intervenim të Esat Mekulit, i cili që nga poezia e parë pa se po na vinte një poet i nivelit të lartë krijues, siç mendonim edhe ne të tjerët që merreshim me poezi. Në atë kohë Ali Podrimja si poet i ri ishte vënë para një dileme për perspektivën e talentit të tij e të rrugës së tij jetësore. Me këtë ngarkesë jetike ai erdhi tek unë në shtëpi e më tha: “Abej, (ai më thërriste si vëllezërit e motrat e mia më të reja) po mendoj me shku në Shqipni. Shka më thu?” Te nxënësit e klasave të larta të fillores e te klasave të para të gjimnazit nostalgjia rinore patriotike për Shqipërinë shfaqej edhe me kalime të rrezikshme jo të rralla përtej kufirit. Brenda kësaj nostalgjie, që thërriste për ikje, nuk mund të mos ishte edhe Aliu në atë moshë rreth 16-vjeçare. I thashë se “me këtë poezi që po e krijon ke perspektivë që të ngjitesh nalt si poet. Në Shqipni shkruhet tjetër poezi, të cilën ti s’ do të dish ta krijosh në atë masë sa të bahesh poet i përmendun”. Në ndarje më tha se do të shkonte ta këshillonte edhe profesor Ali Aliun.

Aliu kishte dëshirë të merrte mendimin pozitiv për poezitë e tij para se t’i dërgonte për botim dhe më kishte edhe mua ndër lexuesit e parë që nga koha e gjimnazit deri në Akademi. Për ta përforcuar mendimin se vlerësimin e lartë për poezitë e tij e kisha objektiv, i bëja ndonjë vërejtje për ndryshim të shprehjes, por ai gjithmonë e jepte arsyetimin për të mos e ndryshuar. Nja dy muaj para se të ndahej nga jeta më mori në telefon nga ora dhjetë e mbrëmjes dhe, i entuziazmuar për poezitë e reja që kishte krijuar, më mbajti orën më të pazakonshme poetike, duke më lexuar në telefon hiç më pak se nëntë poezi me përsëritje të fjalëve: “E bukur edhe kjo, ë? A po të pëlqen?”

Me vdekjen e tij m’u shua një dashuri begatuese e jetës.

Vlera kulmore e poezisë e bëri Ali Podrimjen njërin nga yjet e pashueshëm të kulturës sonë kombëtare. Vargu i tij poetik i kumboi nëpër Evropë shpërthimet e begatisë shpirtërore të popullit të tij, synimet fisnike jetësore të popullit shqiptar. Si krijuesit e dalluar Aliu e pati, siç thuhet, aftësinë e të bërit, e të rezistuarit dhe të mospajtimit, duke qëndruar gjithnjë besnik ndaj tri formave shpirtërore të humanitetit: formës të së vërtetës, të së mirës e të së bukurës. Mbi këto dy veprime të përhershme të tij del vlera e lartë njerëzore e kombëtare e poezisë së Ali Podrimjes.

Si poet shumë i dalluar ai mbeti i veçantë, që do të thotë edhe nga pak i vetmuar. Por vetminë ai e lidhi pandarshmërisht me poezinë, me poezinë që e ngriti aq lart Ali Podrimjen, me poezinë shqiptare që e ngriti aq lart Ali Podrimja.

PËR PAJAZIT NUSHIN¹

Për akademik Pajazit Nushin mund të thuhet së pari se është njeri me energji të pashtershme, energji që, edhe me shtyrjen në moshë, i rigjenerohet e i funksionon vijimisht në tërë veprimtarinë e tij të begatshme shoqërore, arsimore e shkencore.

Së dyti, në të gjitha detyrat e funksionet e më parme e deri në të sotmet si Kryetar i Shoqatës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, si Nënkyetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve dhe si profesor i universitetit e si anëtar i ASHAK-ut, Pajazit Nushi ka shpalosur ndershmëri të veprimit e humanitet të qëndrimeve. Profesor Nushi është ndër intelektualët që e kanë të theksuar ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore.

Të gjitha këto Pajazit Nushin e kanë bërë personalitet të ndreuar, të respektuar e të dashur nga të gjithë.

Paralelisht me këtë vëllim të madh aktiviteteve profesor Nushi ka gjetur forcë që të plotësojë ambiciet e tij për punë shkencore, duke marrë gradën e doktorit të shkencës e duke publikuar vepra e trajtesa shkencore, tekste shkollore e universitare e duke marrë pjesë aktive me kumtesa e referate nëpër simpoziume e konferenca përkatëse shkencore edhe jashtë Kosovës. Niveli i lartë i veprës së tij shkencore e vendosi në elitën shkencore të Kosovës dhe e bëri anëtar të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Së treti, është e pashembullt gatishmëria e tij për t'iu përgjigjur kërkesave të shumta për fjalën e tij në promovime veprash, në manifestime kulturore, në përvjetorë ngjarjesh e personalitetesh, në mbledhje komemorative, në arsyetimin e projekteve të punës e të tjera anë e mbanë Kosovës. Dhe nuk ka dyshim se këto nuk i bënë për të arritur autoritet, por i bënë shpirti i tij i njerëzishëm, që ndihmën e ka arsye të jetesës.

¹ Me kërkesë të Jahja Shehut, që e inçizoi me kamerë – 2009.

Në Akademi Pajazit Nushi është konstruktiv e sugjerues zgjidhjesh të drejta të çështjeve e të problemeve.

Kolegut tim Pajazit Nushit i dëshiroj shëndet e suksese në punën e tij krijuese.

PËR DIN MEHMETIN¹

Nga Gjocaj, nga ai ballkon i lartë prej të cilit shihet një pjesë e mirë e Rrafshit të bukur të Dukagjinit, më 1945 zbriti malësori i vogël Din Mehmeti në, atëherë, kasabanë e Gjakovës për të vijuar shkollimin. Mësuesi i tij porsa e kishte publikuar në gazetë tregimin për nxënësin veçanërisht të dalluar Din Mehmeti, pa fshehur bindjen se edhe në shkollën e ambientit të ri do të bënte emër midis moshatarëve.

E Din Mehmeti zbriti nga bjeshka me një njohje gati tërësisht epike të jetës, me këngë patriotike historike e me këngë legjendare të Mujës e Halilit e vetëm si fshehurazi edhe me ndonjë këngë të shkurtër humoristike erotike. Dhe hasi në një njohje pak a shumë tjetër të moshatarëve e të ambientit, me intuita të krijuara nga përvoja pak a shumë të tjera jetësore. Hasi në një botë që dukej pak a shumë tjetër me elemente sjelljesh nënçmuese, përqeshëse e lënduese, një botë që iu duk se nuk të jepte komoditetin e të qëndruarit indiferent ndaj saj, por që të nxiste për punë të palodhshme e vullnet e të shtynte nga një mbyllje në vetvete. Ky ambient e të tjerët pas tij ia pasuruan ngadalë njohjen dhe ia hoqën nga vlerat reale glorifikimin romantik të njerëzve të vendlindjes së tij, ia bënë më të socializuar intuitën e sjelljes. Duke ndjekur shkollimin nëpër të gjitha shkallët, ai fitoi një njohje të thellë e të gjerë intelektuale e, meqë nuk u këput kurrë nga oda e malësisë, intuiteti i tij nuk mund të mos ishte i vendosur në hapësirë e në kohë - në kohën që po e jetonte Kosova - populli i tij i Kosovës. E brenda këtij rrethi ai lëvizi tërë jetën në veprën e tij poetike dhe u qëndroi konsequent humanitetit, të vërtetës, të së mirës e të së bukurës.

Që në shkollën tetëvjeçare ai pa se disa nxënës po varnin diçka në gazetë të murit, pa se po shkruanin vargje. E ai ishte rritur me vargje e i ruante në shpirt si vlera jetëdhënëse. Dhe nisi të shkruante, në fillim si ambicie për një afirmim më të lartë në rrethin e tij të ngushtë shoqëror e pastaj si provë për ta bërë poezinë vokacion të jetës. Nga gazeta e murit ai kaloi në faqet e Jetës së re dhe shpërtheu murin e zërit me përmbledhjen e

¹ Në 70-vjetorin e lindjes – 1999.

parë, të dytë e tutje dhe kumboi dinjitetshëm në përmbledhjet prezentuese të poezive të poetëve më të njohur kosovarë. Dhe priti kohën e depërtimit të ëndërruar të poezisë së tij në Shqipëri me botim të një përmbledhjeje, të depërtimit pranë një gjykimi të frikshëm, i cili kush e di si do ta vendoste në kuadër të poezisë bashkëkohore gjithëkombëtare. Dëgjuam pastaj se poezia e tij kishte filluar të fliste italisht, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, polonisht e në disa nga gjuhët e Ballkanit. E kur na ra ndër mend të kërkonim se ku është Din Mehmeti, e pamë të ulur këmbëkryq në njërin nga ballkonet më të larta të poezisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit. E kur e shohim të mendueshëm, na duket se në fantazinë e tij u dërgon një buzëqeshje të ngrohtë e të përmallshme mësuesit të tij të parë e malësorëve moshatarë që mbetën tërë jetën aty ku ishte dikur edhe ky.

Ndjeshmëria e theksuar që ka Din Mehmeti si poet është si te të gjithë poetët e njëmendët, pasojë e materies psiqiko-mendore të akumuluar në shpirtin e tij, bashkë me kujtesën historike për fatet e vështira të popullit të tij. Por poetin Din Mehmeti e karakterizon edhe vullneti i veçantë për krijim poetik të pandërprerë e të çdokohshëm, vullnet që mund të jetë vetëm aktivitet i një shpirti të madh e largpamës patjetër. Ai e pati gjithnjë vullnetin e të rezistuarit e të mospajtit, të cilët sinjalizojnë praninë e një vullneti të tipit prometean.

Kritika letrare në Kosovë prej fillimeve gjer tani pati një qasje dashamirëse e mirëkuptimi ndaj poetit e ndaj krijimeve të tij. Edhe në rastin e Din Mehmetit e përkrahu gufimin e talentit të tij, i ndihmoi në ecurinë e përsosjes së shprehjes poetike, ia nxiti frymëzimin dhe e inkurajoi për të qëndruar i ndërgjegjshëm ndaj detyrës së lartë që kishte marrë si poet nga momenti historik në të cilin jetonte, ia ndihmoi përpjekjet për të qenë i veçantë e me temperament e tij krijues. Por ai nuk u dej nga lavdërimet, sepse shumë herët aktivitetin poetik e kishte kthyer në ndjenjë përgjegjësie ndaj popullit të vet.

Si student ai u njoh mirë me metaforën e me fuqinë shprehëse të saj dhe pa se ishte i saj. Hyri në zgjua të metaforave dhe u bë amëz e tyre. Strukturimin e vargut ia la tërësisht metaforës, e cila ia ekonomizoi shprehjen, ia pastroi nga strukturimi narrativ. E Din Mehmeti tani ishte poet i fahut të vet, poet i mirëfilltë i shprehjes lirike. Metafora, ajo fjalë e rebeluar midis

fjalësh të rregullta e të disiplinuar në vargun sintagmatik është gëzimi, mundi dhe vuajtja e poetit. Zgjedhja e metaforës adekuate mund të bëhet vetëm në rrjedhë të natyrshme të procesit të vështrimit figurativ të jetës nga poeti, sepse ajo e ka krahasimin me meteorin që shndrit vetëm një herë. Megjithatë poetin s'e lë rehat simpatia që ka ndaj disa metaforave që i ka përdorur dhe e shtyn t'i funksionalizojë përsëri e t'i bëjë kështu polisemike, domethënë t'ua humbë kuptimin primar e t'i përjashtojë nga funksioni metaforik. Kritika jonë letrare do të ndjejë nevojën ta kompletojë vështrimin e poezisë, në rastin tonë edhe të poezisë së Din Mehmetit, me ndonjë nga trajtimet kuantitative të gjuhës së saj, me matje të frekuencës së fjalëve e të rangut të tyre në një korpus veprash të një autori. Kjo do të na zbulonte edhe një anë tjetër të poezisë edhe të Din Mehmetit e do të ndikonte që të materializoheshin arsyet e ndikimit të saj të fuqishëm në mendjen e në shpirtin tonë.

Vepra e Din Mehmetit do të hyjë në sistemin gjithnjë të korrigjueshëm që e bëjnë vetë veprat e profilit poetik të letërsisë shqiptare në përgjithësi, duke llogaritur dhe ato që do të vijnë në rrjedhë të moteve. E ajo do të mbetet gjithnjë e dallueshme bashkë me veprën e poetëve të tjerë të shquar kosovarë të kohës, si reflektim i frymëmarrjes së popullit shqiptar të Kosovës në këtë periudhë tronditëse të historisë së tij deri me përdorimin e mjeteve më shtazarake fashiste për shfarosjen fizike nga forcat barbare serbe. Do të reflektojnë në mënyrën më suptile shpirtin e pamposhtur të këtij populli që shpaloi energji të pashtershme për të mbijetuar, për të arritur dritën njerëzore të lirisë.

Mundi i madh i krijimit të veprës artistike shkon e gjen shpërblimin vetëm në çastin e shkurtër të publikimit të veprës. E thonë se atëherë autorit i pëmdritet fytyra nga një gëzim hyjnor. Të tilla gëzime hyjnore Din Mehmeti i pati më se njëzet. Duket se poetëve u mjaftojnë këto çaste lumturie hyjnore për gjithë atë punë, për gjithë atë mund, për gjithë atë përgjegjësi shoqërore.

I dëshiroj Din Mehmetit të jetë i shëndetshëm e krijues deri thellë në pleqëri të bardhë, kur edhe flokët do t'i ketë krejtësisht të bardha, siç e ka shpirtin.

PËR BARDHYL ÇAUSHIN

Profesor Bardhyl Çausi ishte energjik me guximin e veprimit këmbëngulës kundër të këqijave të jetës. Dhe që i fuqishëm, sepse nuk iu shmang punës e rreziqeve për të ndryshuar gjendjen e vështirë të popullit të tij drejt një jete njerëzore.

Si kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Gjakovë, në atë kohë të reprezaljeve, të maltretimeve e të përndjekjeve të shtetit policor të Serbisë, Bardhyli me guxim e me qartësinë e ideve e të vizionit bëri një punë tepër të vlefshme për njerëzit tanë përmes ndihmave, kujdesit, kurajos e shpresës për fitoren e lëvizjes sonë për pavarësi. Ai ka merita për organizimin e një jete kundërshtuese të popullatës shqiptare të këtyre trevave. Me oratorinë e tij e me shembullin e veprimit të vendosur, përveç çjerrjes së maskave të pushtetit serb, ndikoi që të veprohej për liri.

Të gjithë aktivitetin e tij e mbështeti në begatinë e shpirtit të tij fisnik. U angazhua me përkushtim në fushatën e faljeve të gjaqeve si akt i nevojshëm për unitetin e kompaktësinë e popullit në ballafaqim me armikun zaptues dhe si formë e një aktiviteti masovik që shprehte haptazi vendosmërinë për të arritur aspiratat e tij çlirimtare.

Edhe para krijimit të Kushtetutës së vitit 1974 Bardhyli ishte ndër zëdhënësit e dalluar të nevojës për pavarësim të mundshëm të Kosovës nga Serbia.

Veprimtaria e tij është jetëgjatë dhe e paharrueshme, sepse i shërben-te një qëllimi të ndritshëm njerëzor e si e tillë ishte pjesë e veprimtarisë së gjerë e të pandalshme patriotike.

Bardhyli ishte shok i fjalës dhe intelektual që të ofronte kënaqësinë e bisedës e të komunikimit miqësor.

Më ka rënë të shoh se kishte autoritet të madh te studentët si profesor gjithnjë i përgatitur e gjithnjë i drejtë në vlerësime e në respektim të personalitetit të studentëve. Ai me kualitetet e tij intelektuale e morale impononte respekt edhe te kolegët e Fakultetit Juridik të Prishtinës, të cilët ia besuan funksionin e Dekanit pak kohë para se të përfundonte jeta e tij.

Bardhyl Çaushin nuk e vranë si të panjohur; e vranë pse e njohën kush ishte. Ai ra dëshmor, si bir i denjë i popullit të tij. Si të tillë koha do ta mbajë në analet e vendlindjes si shembull i sakrifikimit të jetës në vijën e traditës çlirimtare të kësaj treve e të qytetit të tij - Gjakovës.

Patrioti, aktivisti i njohur i lëvizjes sonë për pavarësi prof. dr. Bardhyl Çaushi do të vijojë të jetë pranë nesh si qenie e dashur, pranë atyre që e njohën e pranë atyre që do të vijnë, sepse personaliteti i tij ka shpëtuar nga harresa e është bërë pjesë e atij shpirti patriotik që na e bën dhimbjen forcë e përkatësinë kombëtare – krenari.

PËR QAMIL GEXHËN¹

Zonja e zotërinj,

Dua të them nja dy fjalë për shokun tim në këtë ndarje të fundit prej tij. Isha fatlum që jeta ma solli shok Qamil Gexhën – me atë shpirt të çiltër, me atë dashuri të përmasave të rralla njerëzore, me atë sinqeritet, me atë optimizëm, me atë ndjenjë të së vërtetës e të së drejtës, gjithnjë shpresëdhënës për kapërcimin e vështirësive të jetës. Zbrazëti shpirtërore tani pa të, pa ngrohtësinë e tij shoqërore e njerëzore.

Profesor Qamil Gexha ua mësoi historinë studentëve, të kaluarën e trazuar të popullit të tij e pandashmërisht ua nxiti krenarinë e të qenit shqiptar. Ata tash e sa kohë nëpër shkollat anë e kënd Kosovës ua mësojnë gjeneratave historinë kombëtare pa dyshim edhe me një pjesë të shpirtit të profesorit Qamil.

Gjakova e Kosova po i japin nderimin e fundit profesorit e shkencëtarit të nderuar, të nderuar edhe për ndershmerinë, për dinjitetin, për vepërimin e tij shoqëror – profesorit që mbajti lart autoritetin e edukatorit e të mësimdhënësit edhe në situatat më të rënda politike.

Kur e shikoja në dritën e syve pas vrasjes mizore të Arbenit, shihja se pikëllimi i thellë për djalin e vetëm ishte brumosur me pikëllimin për të gjitha viktimat e terrorit serb dhe më dukej një vështrim jashtë kohës, i lëshuar mbi vuajtjet e popullit nëpër shekuj.

I le në pikëllim të papërmbajtshëm Myzejenin, Vlorën, Dafinën e nipat e mbesat e motrat e vëllezërit, por ua le edhe krenarinë që ishte i tyre, me ta, ashtu njerëzisht i ndritshëm.

Nga shokët që mbetëm ende në jetë, ti do të duhej të ishe i mbrami, miku im, i mbrami për ta përmbyllur shoqërimin tonë, të viteve tona, me atë rrezatim të dashurisë sate për ne.

Shoku im, unë e desha Gjakovën edhe pse të kishte edhe ty.

¹ Gjakovë, më 6. IX. 200.

KRYETARIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË, ZOTIT GUDAR BEQIRAJ

I nderuar zoti kryetar,

duke menduar se jeni njoftuar me përmbajtjen e mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe të datës 7 mars 2012, në të cilën për shkaqe shëndetësore nuk pata mundësi të merrja pjesë, e shoh të nevojshme që pranë mendimit të të tjerëve ta keni edhe mendimin tim për letrën e zotit Emil Lafe drejtuar Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kryesisë së Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe, me të cilën njofton se nuk do që të jetë më anëtar i këtij Këshilli.

Si arsye ai përmend:

1. “ Këshilli nuk ka një platformë të vetën .”

Kjo është e pavërtetë, sepse Këshilli e ka përpiluar dhe aprovuar unanimitisht platformën për veprimtarinë e tij në prani e me aprovim edhe të zotit Lafe. Nuk është e vërtetë po ashtu që ASHAK-u të ketë shpallur ndonjë platformë të vetën e se Këshilli punën e tij e bazuaka në “dy platforma të papranueshme njëra me tjetrën.” Kësaj ai ia shton edhe shpifjen e ulët se gjoja ASHAK-u synon të krijojë dy standarde të shqipes.

2. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës “ka shpërfillur ftesat e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për të marrë pjesë në veprimtaritë e organizuara në Tiranë në këtë fushë.” Aty ku nuk ka qenë bashkorganizuese, paraparë me Protokollin e Bashkëpunimit të dy Akademive tona, Akademia e Kosovës ka dërguar akademikët e saj gjuhëtarë që me pjesëmarrje aktive të japin kontributin e tyre në të gjitha tubimet shkencore. Për akuzën se ASHAK-u nuk e ka njohur Kongresin e Drejtshkrimit dhe shqipen standarde që krijoi ky Kongres, duhet t’ia kujtojmë zotit Lafe se Konsulta Gjuhësore e Prishtinës më 1968, që e aprovoi dhe e futi në jetë pa asnjë vërejtje a korrigjim projektin e drejtshkrimit të vitit 1967 dhe hapi rrugën e suksesit të Kongresit të Drejtshkrimit më 1972, u drejtua dhe u orientua edhe nga studiuesit që do të jenë më vonë anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të

Kosovës (themeluar më 1975) dhe delegatë në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, duke aprovuar unanimisht konkluzat e këtij Kongresi historik. Më vjen keq që zoti Lafe me këtë qëndrim keqdashës ndaj ASHAK-ut e vendos veten në një nivel të padenjë intelektual.

Si të kuptohet që zoti Emil Lafe qëndroi anëtar i Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe që nga themelimi, pa shprehur asnjë vërejtje për punën e këtij Këshilli, ndërsa tani, kur rifilloi puna pas gjashtë vjetësh, jep dorëheqje. Unë nuk befasohem që zoti Lafe jep dorëheqje nga Këshilli, sepse me qëndrimin e tij se nuk duhet ndryshuar asgjë në gjuhën standarde, ai është dashur të mos e pranonte zgjedhjen anëtar të Këshillit, sepse Këshilli është formuar për të shikuar se çfarë duhet të përmirësohet, se çfarë duhet të ndryshohet në funksion të thjeshtimit të drejtshkrimit dhe të begatimit të aftësive shprehëse të shqipes standarde dhe të ngritjes së funksionalitetit të përgjithshëm shoqëror të saj në përputhje me kërkesat e Konferencës Gjuhësore të vitit 2002 në Tiranë.

I respektuari zoti Beqiraj, ky tekst i dërgohet edhe Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës zotit Hivzi Islami dhe bashkëkryetarëve të Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe zotit Jani Thomai dhe zotit Rexhep Ismajli.

Ju përshëndes përzemërsisht dhe ju dëshiroj shëndet dhe punë gjithnjë të suksesshme në drejtim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akademik Besim Bokshi Prishtinë, 29. 03. 2012

IV. FJALË PËRSHËNDETËSE E FALËNDERUESE

NË KONFERENCËN SHKENCORE “SELMAN RIZA GJUHËTAR DHE ATDHETAR I SHQUAR”¹

I nderuar kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zoti Gudar Beqiraj, të nderuar pjesëmarrës të kësaj Konference, zonja e zotërinj,

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, bashkorganizuese e kësaj konference me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ju përshëndes dhe ju studiues ju përgëzoj që iu përgjigjët ftesës sonë që me trajtime shkencore të temave nga vepra gjuhësore e profesor Selman Rizës dhe me vlerësimet e veprimtarisë së tij patriotike po jepni ndihmesën tuaj të çmueshme në shënimin e merituar të 100-vjetorit të lindjes së tij.

Për 100-vjetorin e lindjes së profesor Selman Rizës Akademia jonë, me pajtimin e familjes Riza, ka çuar në vend amanetin e profesor Rizës që mbetjet mortore të tij t'i prehen, siç ka thënë, në “Kosovën shqiptare”. Mbasi zhvillimet në botën shqiptare e bën të mundur realizimin e këtij amaneti, mbetjet u rivarrosën në qytetin e lindjes, në Gjakovë. Aty u zbulua edhe busti i tij, u mbajt një simpozium shkencor, u hap një ekspozitë e fotografive të Profesorit e të disa dokumenteve lidhur me të. Një natë më parë, në një Akademi solemne Presidenti i Republikës së Kosovës zoti Fatmir Sejdiu dha për Selman Rizën “Medaljen e Artë të Lirisë”.

Profesor Selman Riza kishte lënë edhe një amanet që për dorëshkrimet e tij të përkujdesej akademik Rexhep Ismajli. Me sistemimin dhe redaktimin e tij botuam vëllimin e pestë të veprave të profesor Rizës me dorëshkrime si dhe veprën e akademik Ismajlit “*Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*”. Për shtëpinë botuese Dukagjini akademiku përgatiti botimin e shënimeve të Rizës me titull: “*Mendime të shkëputur të një vazhde të vetme*”.

Të nderuar zonja e zotërinj, vepra gjuhësore e Selman Rizës është në rend të parë shprehje e qëndrueshme e shkëlqimit të mendimit shkencor ndër ne. Ajo shënon një shkallë krenuese në të cilën arriti gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar në fushë të morfosintaksës. Ajo është brumosje e cilësive të veçanta studimore që solli energjia krijuese e

¹ Tiranë, 14 dhjetor 2009.

një temperament i kërkues tepër të rrallë në letrat tona. Me largimin e Selman Rizës nga jeta gjuhësia shqiptare mbetet pa këtë trajtim dinamik të temave gjuhësore, sepse, e lidhur në mënyrë identifikuese me personalitetin e Selman Rizës, është e pavijueshme.

Siç kemi shënuar edhe në një rast tjetër, Selman Riza dha shembullin e ngadhnjimit të vullnetit për të ecur kah sferat e ndritshme të mendjes në përballje me vështirësitë e rënda demoralizuese të jetës. Ai qëndroi në anën e atyre që tregojnë papërkulshmërinë e shpirtit njerëzor dhe i la trashëgim kulturës shqiptare, përveç veprës gjuhësore, edhe një shembull të rezistencës së pavarësisë së mendimit shkencor. Ai la edhe përpjekjet për çlirim nga pushtuesi fashist e për bashkim të Kosovës me Shqipërinë. Selman Riza qe ndër personalitetet që iu nevojitën kohës për t'u krenuar.

Të respektojmë pjesëmarrës, sapo erdhëm nga ceremonia e dekorimit të profesor Selman Rizës me "Urdhrin e Nderit të Kombit" nga shkëlqesia e tij, Presidenti i Republikës së Shqipërisë zoti Bamir Topi, me të cilën, ashtu si dhe me dekorimin e Presidentit të Republikës së Kosovës zotit Fatmir Sejdiu, nderimi i këtij personaliteti të shquar në 100-vjetorin e lindjes u ngrit në nivelet më të larta të dy shteteve tona.

Me organizimin e kësaj Konference për të nderuar Selman Rizën si gjuhëtar e si patriot të shquar në 100-vjetorin e lindjes, po e nderojmë edhe veten, sepse po shprehim mirënjohjen tonë kolektivisht të vonuar për kontributin e tij shkencor e patriotik, po e ndiejmë të gjithë së bashku nevojën për të shprehur një keqardhje kolegiale dhe një mllef njerëzor për anatemit, burgosjet, internimet, deportimet, izolimet, ndalesat e botimeve dhe për lëndimet e rënda të shpirtit që iu bënë padrejtësisht.

Sot në 100-vjetorin e lindjes vepra shkencore e Selman Rizës e ka mbledhur në këtë sallë gati tërë elitën e sotme të studimeve albanistike. Në shumësinë e temave të paraqitura do të shprehen konsideratat ndaj rezultateve të shumta shkencore që solli kjo vepër në gjuhësinë shqiptare.

Uroj punë të mbarë e rezultate të dëshirueshme shkencore në këtë Konferencë, me të cilën po nderojmë e po nderohemi në të njëjtën kohë.

NË KONFERENCËN SHKENCORE “STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE”¹

Të nderuar studiues të gjuhës shqipe e të letërsisë shqiptare!

Të nderuar pjesëmarrës, zonja e zotërinj!

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë e kanë parë të nevojshme ta organizojnë këtë konferencë shkencore, që studiuesve të çështjeve të filologjisë shqiptare t’u ofrohet mundësia që të takohen e të trajtojnë problemet që shtron aktualiteti i gjendjes së këtyre studimeve, që të bëhen rivlerësime të mundshme të rezultateve të gjertanishme si dhe të sillen trajtesa të reja që qëndrojnë në kahjet e studimeve filologjike bashkëkohore, mbështetur në metodat e kohës si në studimet e gjuhës ashtu edhe në studimet e letërsisë.

Studimet filologjike shqiptare në rrugën e zhvillimit të tyre kanë arritur mjaft rezultate të qëndrueshme shkencore. Ne të gjithë çojmë lart punën e gjeneratave të shkuara të studiuesve shqiptarë e të huaj, që energjinë e tyre krijuese ia kushtuan studimeve të shqipes e të letërsisë shqiptare dhe që i përparuan ato shkallë-shkallë. Në mes tyre ka pasur edhe vepra të mëdha që kanë shënuar kapërcime epokale në këto studime. Dihet, ndërkaq, se “Ajo që është sot e re dhe interesante, pasnesër nuk do të jetë më e tillë”. Por, siç është shënuar: “Nderimi për atë që tashmë ka mbijetuar për një kohë të gjatë deri në ditët tona, që ende nuk është harruar dhe nuk ka përrënduar, nuk do të pësojë ndonjë thyerje as edhe në rrjedhën e jetës sonë”. Të gjitha rezultatet e shënueshme janë arritur kur këto studime janë mbështetur në teoritë gjuhësore e letrare të kohëve përkatëse, domethënë kur çështjet e shqipes dhe të letërsisë shqiptare janë trajtuar nga nivelet e filologjisë evropiane.

Në një kohë shqyrtimet e çështjeve të shqipes në qarqet e studiuesve vendorë u shkëputën nga deduksioni i teorive gjuhësore të shekullit të XX. U kultivua e ashtuquajtura gjuhësi tradicionale që dha rezultate në gjuhë-

¹ 21-22 nëntor 2007, Prishtinë.

sinë shqiptare ende të pazhvilluar, sidomos në plotësimin e nevojave praktike me dominim të veprave me karakter preskriptiv. Kjo u çmua si metodë e denjë për të qenë e përhershme. Në studimet e letërsisë, siç dihet, dolën pengesa të rënda ideologjike për trajtime të mirëfillta shkencore. Këto mënyra trajtimi ende nuk kanë arritur të jenë të papraktikueshme. E është thënë se “askush nuk shkruan më keq se idhtarët e ideologjive të vjetëruara”. Mbetja mbrenda trajtimeve të tilla studimore pat shkaktuar në atë kohë ngecjen e filologjisë shqiptare vendore brenda një qarku jo produktiv.

Në këtë konferencë pritet të shihet edhe se sa është shkalla e relacionit të studimeve të reja filologjike shqiptare me studimet përkatëse evropiane e botërore. Qëllimi ynë, i gjeneratave të tanishme të filologëve është të ndihmojmë që të arrihet sa më shpejt kohezioni i qëndrueshëm permanent me zhvillimin e teorive gjuhësore e letrare.

Shpresojmë që kjo konferencë të bëjë një shtytje të vlefshme në këtë drejtim.

Në fund dua të them se kolegët tanë nga vendet e ndryshme, që gjithnjë gëzojnë respektin tonë si ata para tyre, mund të kenë satisfaksion që energjinë krijuese po ia falin një gjuhe që Pedersen e ka cilësuar si gjuhë të bukur dhe të fuqishme, “e cila lipset të jetë mburrje për folësit e saj dhe një vegël e shenjtë për rritjen mendore dhe arsimitare të kombit të vjetër shqiptar”.

Zonja e zotërinj, shprehim keqardhjen tonë të thellë e pikëllimin që u nda nga jeta studiuesja e vyer e gjuhës shqipe zonja Irina Voronjina, e cila sapo qe ftuar me dëshirë të veçantë për të marrë pjesë në këtë konferencë. Po ashtu e kujtojmë me dhembshuri e respekt gjuhëtarin dhe albanistin e dalluar Giovanni Battista Pellegrini që u nda nga ne para pak kohësh.

“KONGRESI I MANASTIRIT DHE NJËSIMI I ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE”¹

Të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës, zonja e zotërinj!

Nga organizatorët jam ngarkuar të them një nga fjalët e mundshme të mbylljes së kësaj konference të suksesshme shkencore për Kongresin e Manastirit që solli njësimin e alfabetit të shqipes, Kongres që arrin edhe në njëqindvjetorin e tij si një ndër kulmet e ndritshme të kulturës sonë kombëtare, si akt i vetëdijesimit për unitet kombëtar, akt që individualitetin e popullit shqiptar e shihte të shkëputur nga ajo botë e huaj, në të cilën mbahej me pahirë, duke shpallur ecjen e pashmangshme drejt vatrës së tij evropiane. Kongresi i Manastirit, kjo vepër krenuese e intelektualëve të atëherëshëm, që ditën të qëndronin nën urdhrin patriotik të kohës, zgjedhjen e shkronjave latine e pati paralajmërim për emancipim të plotë të popullit shqiptar.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në kuadër të bashkëpunimit të tyre intensiv, në protokollin e veprimtarive të përbashkëta parapanë bashkë me institucione të tjera shkencore dhe arsimore organizimin e kësaj konference për 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit në Tiranë. Në këtë rast duhet të shkojë falënderimi ynë i përbashkët për mikpritësin, për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që bajti barrën kryesore për ta organizuar këtë konferencë dhe aktivitetet e tjera rreth saj. Një falënderim u shkon edhe studiuesve që iu përgjigjën ftesës për pjesëmarrje dhe që me kumtesa dhanë kontributin e tyre për ndriçimin e mëtejme të punës së gjithanshme të këtij kongresi. Falënderojmë në mënyrë të veçantë Kryeministrin e Shqipërisë, zotin Sali Berisha, që na nderoi me pjesëmarrje dhe me përkujdesjen e tij për këtë konferencë.

Konferenca me një ritëm të përshpejtuar të punës brenda një dite po i mbyll punimet. Ajo nisi me referatin *Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendi i tij në kulturën shqiptare* të akademikëve të nderuar Shaban

¹ Fjala e mbylljes së konferencës.

Demiraj e Kristaq Prifti, në të cilin vlerësimet tingëlluan me objektivitet shkencor, të çliruara nga ngushticat ideologjike e politike të kohës së shkuar, ashtu si dhe kumtesat e kësaj konference, dhe solli një vendosje të arsyetuar reale të kësaj veprë të Kongresit në kulturën shqiptare.

Kumtesat, si ato që prunë të dhëna ë reja për Kongresin e për aktorët kryesorë të tij, ashtu edhe ato të tjerat që erdhën me trajtime të reja të fakteve të njohura, me interpretime e argumentime plotësuese, me këndvështrime të reja e me qasje studimore të avancuara, i dhanë Konferencës një atmosferë të këndshme komunikimi shkencor.

Njëzet e dy kumtesat në tërësinë e tyre tematike dhanë një pasqyrim të shumanshëm të Kongresit. Kështu për alfabetin e Kongresit u trajtuan parimet themelore të hartimit të tij, njësimi i shkronjave dhe larmia e tingujve në raport me shqiptimin letrar, perceptibiliteti i shkronjave të alfabetit, alfabeti si kurorëzim i vlerave fonetike e fonematike të shqipes në shkrim, veçoritë e alfabetit si fazë e parë për planifikim gjuhësor të shqipes dhe çështja e dyshkronjave.

Jashtë problematikës së strukturës së alfabetit ndahen ato kumtesa që trajtuan vlerën kombëtare të alfabetit e të Kongresit, si fryma bashkuese kombëtare e Kongresit, alfabeti dhe shkolla shqipe, alfabeti në ecurinë e tij njëqindvjeçare dhe aspekti kombëtar i zgjidhjes që dha Kongresi. Një grup tjetër kumtesash trajtoi relacionin e alfabetit të njësuar me njësimin e gjuhës standarde në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 nëpërmjet Konsultës Gjuhësore të Prishtinës: Kongresi i Manastirit dhe procesi i standardizimit të gjuhës shqipe, Kongresi i Manastirit dhe strategjia gjuhësore e njësimin të gjuhës letrare dhe alfabeti si shkallë e parë drejt standardizimit të gjuhës shqipe. Alfabeti i njësuar u pa edhe në relacion evolutiv me variante alfabetesh të arbëreshët e Italisë para Kongresit të Manastirit. U pa edhe si jehonë në dokumentet e Lëvizjes Kombëtare e si rezultat i kërkesave të shumta në shtypin shqiptar në njëzetvjetëshin 1888-1908. Nga personalitetet e Kongresit në Konferencë u nda kontributi i Mit'hat Frashërit dhe i patriotëve të Korçës, u fol edhe për veprimtarinë e Dom Nikollë Kaçorit dhe u trajtua edhe tema *Klerikët dhe çështja e Kongresit* dhe tema për elemente të relacionit të Kosovës me rezultatet e Kongresit të Manastirit.

Nga të gjitha kumtesat shpalosej një lidhje emocionale pieteti e autorëve me aktorët e Kongresit e me veprën e tyre.

Mendoj se kjo Konferencë shkencore i dha edhe një madhërim Kongresit të Manastirit në 100-vjetorin e tij. Natyrisht janë gjithnjë të hapura mundësitë e trajtesave të reja nga gjeneratat e ardhshme të studiuesve, të cilët në rrjedhën e kohës do ta bëjnë edhe më monumentale këtë ngrehinë të lavdishme në kulturën shqiptare.

Kumtesat në versione më të gjata do të botohen në një vëllim, i cili do të mbetet dokument i nivelit tonë shkencor në trajtimin e çështjeve të Kongresit të Manastirit.

Në përfundim ju dëshiroj suksese në punën tuaj krijuese.

Mirupafshim në takime të tjera shkencore!

FJALË FALËNDERUESE¹

Ju falënderoj, miq e kolegë të nderuar, për respektin që më shprehët duke e organizuar, aq pa pritur nga unë, këtë mbledhje përuruese të veprës sime dhe për fjalët që i thatë për vlerën e kësaj vepre. Vepra shkencore lirohet vetë nga lëvdatat e tepruara e nga vërejtjet e pabazuara. Do të ketë qenë e mundimshme të gjendet masa e nevojshme e trajtimit objektiv nën trysinë e raporteve tona shoqërore e miqësore dhe të minimizohet kalimi i papëlqyeshëm në “nihil sine bene”. Kompetenca juaj e lartë shkencore dhe, për kohën, më e kualifikuara, më ndihmoi që të kem një vlerësim përkatës për të arriturat e mia dhe ma përforcoi edhe një herë mendimin se diversiteti i trajtimit është vërtet lëvizje vitalizuese e shkencës.

Nuk ka nevojë të thuhet se secili prej nesh nuk do të ishte ai që është si studiues i shqipës pa u pasë nisur nga kontributet e albanologëve pararendës, pa rezultatet e punës së tyre. Të gjitha veprat për shqipen, që nga më të vjetrat deri te më të rejat, përbëjnë atë ngrehinë të ndritshme shkencore që quhet albanologji, krijuar nga një energji e vijueshme e mendjeve të kthjellta me ndihmesa disa më shumë e disa më pak, por të gjitha me funksionin e tyre avancues. Duke qenë se talentin krijues ia kemi falur kësaj shkence, çdo kontribut të tjetrit kemi arsye ta konsiderojmë të përbashkët, ta konsiderojmë edhe tonin. Kemi arsye, sepse përgjegjësinë për një ecje përpara të shkencës sonë, në kohën tonë, e kemi ne të gjithë së bashku. Si shpërblim i punës sonë të mundimshme është gëzimi që na e jep mendimi se kemi zbuluar ndonjë të vërtetë, se kemi ndriçuar ndonjë proces, ai gëzim i veçantë që thuhet se “e bën të vibrojë tërë qenien tonë” e që edhe në moshë të shtyrë na e lehtëson ndjenjën e rëndë të dyshimit për saktësinë e mjaft përfundimeve tona. Vepra ngadalë largohet prej nesh dhe arrin përtej mundësive tona për ta korrigjuar a për ta mbrojtur. Ajo ngadalë shtyhet në kohë të shkuar nga kriteret vlerësuese të veprave të reja që vijnë.

¹ Tiranë, 2. IV. 2004.

Falënderoj Kryesinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që e përkrahu organizimin e këtij përirimi dhe që e emocionalizoi kështu afrimin tim ndaj saj. Falënderoj akademikët Idriz Ajeti e Shaban Demiraj, këta studiues të mëdhenj të shqipes, që më nderuan me pjesëmarrjen e tyre e që nuk e kursyen mundin për të shprehur mendimet e veta aq të çmueshme për mua. E dua të them këtu se për çështjet e morfosintaksës historike nuk do t'i kisha rezultatet që kam, pa pasë qenë para meje edhe vepra e Shaban Demirajt. Edhe vepra e Idriz Ajetit. Falënderoj mikun tim akademik Rexhep Ismajlin e prof. dr. Seit Mansakun për trajtesat e tyre të thelluara dhe që zgjodhën veprën time për ta përiruar në Tiranë. E dihet se “ta zgjedhësh do të thotë ta duash”. U jam mirënjohës prof. dr. Ethem Likës e prof. dr. Kolec Topallit për ndihmesat që i dhanë trajtimit shkencor të një pjese të veprës sime. I falënderoj të gjithë pjesëmarrësit që me praninë e tyre i kontribuan autoritetit të kësaj mbledhjeje përiruese.

Ky përirim më shtyn të shpresoj se në Tiranë po hapet një rrugë për të publikuar vepra të rëndësishme shkencore të autorëve nga Prishtina, në mënyrë që ato të bëhen të njohura nga një shtresë më e gjerë studiuesish. Si detyrë. Si obligim ndaj popullarizimit të veprave të kulturës sonë të pandashme.

Qofshi shëndosh e mirupafshim!

NË 50-VJETORIN E THEMELIT TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS

Zonja dhe zotërinj, studiues të Institutit Albanologjik, zoti drejtor, në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ju përshëndes e ju uroj 50-vjetorin e themelimit të Institutit Albanologjik, ju përgëzoj për punën shkencore gjysmëshekullore, me të cilën kemi arsye të mburremi të gjithë. Ky jubile i Institutit është jubile i rëndësishëm i kulturës shqiptare.

Instituti Albanologjik, në ato pak vite që funksionoi pas themelimit më 1953, pati, të thuash, vetëm karakter simbolik. Nga riaktivizimi i punës së tij në gjysmën e dytë të viteve të gjashtëdhjeta Instituti po bëhej gradualisht një ngrehinë e fuqishme e studimeve albanologjike. Me botimet e veprave monografike, me organizimin e simpoziumeve e të konferencave shkencore, me botimin e rregullt të revistës “Gjurmime albanologjike” (deri edhe në katër seri) Instituti i krijoi potencialit shkencor të Kosovës mundësi të shprehjes së mendimit shkencor në këto fusha studimore dhe ndikoi kështu që ky potencial të zgjerohet e të arrijë nivelet e studimeve bashkëkohore albanologjike dhe të ndihmojë që ato të plotësohen e të avancohen.

Instituti Albanologjik u ngrit në një institucion autoritativ në qarqet e studiuesve të kulturës shqiptare. “Gjurmimet albanologjike”, “Recherches albanologiques” dhe botimet e veçanta u bënë të konsultueshme në mënyrë të pashmangshme nga të gjithë studiuesit e çështjeve albanologjike.

Por Instituti Albanologjik qe edhe diçka më tepër për ne në Kosovë: qe mbështetje e individualitetit tonë kombëtar, qe pasqyrë emocionuese e mundësive tona krijuese e për qytetarët tanë - një nga simbolet kombëtare. Për këtë arsye edhe goditjet që iu dhanë Institutit nga shumë aspekte deri te dhuna fizike u përjetuan si goditje jo ndaj një institucioni shkencor, por ndaj një tempulli kombëtar. Kjo obligonte edhe më tepër dhe obligon për një punë gjithnjë të përgjegjshme brenda Institutit e tanimë për një kujdes përkatës shoqëror ndaj tij.

Zonja dhe zotërinj, për një gjysmë shekulli pune të frytshme e tepër të vlefshme shoqërore të Institutit duhet t’u shkojnë urimet tona të gjithë

atyre që u kujdesën për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës dhe për ngritjen e prestigjit të këtij institucioni. E të shprehim miradijen tonë edhe për kontributin e atyre që nuk janë më midis nesh.

Për punën e mëtejme dëshirojmë që të realizohen synimet tuaja për ta ristrukturuar Institutin në mënyrë që puna hulumtuese shkencore në të të jetë në nivel të kërkesave të kohës, që Instituti Albanologjik i Prishtinës të qëndrojë në lartësinë e dëshiruar si institucion i studimeve të mirëfillta albanologjike. Dëshirojmë po ashtu që marrëdhëniet e mira midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Institutit Albanologjik të intensifikohen më tutje e të jenë gjithnjë e më frytdhënëse.

Në fund ju përcjell përshëndetjet e Kryetarit të Akademisë, zotit Rexhep Ismajli, i cili nuk pati mundësi, për një arsye madhore familjare, të vinte e të shprehte vetë urimet për rezultatet e arritura dhe dëshirat për suksese të vijueshme në punën tuaj krijuese.

Simpoziumit i dëshiroj punë të mbarë e rezultate të shënueshme shkencore.

NË PËRURIMIN E VEPRËS SË NORBERT JOKL-IT²

Zonja e zotërinj të nderuar, mirë se erdhët në përurimin e veprës së Norbert Joklit. Falënderoj akademik Kolec Topallin e profesor Seit Mansakun që erdhën nga Tirana për të marrë pjesë në këtë përurim.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në projektin e saj për të sjellë në gjuhën shqipe veprat e albanologëve më të njohur të jashtëm, të traditës e të sotëm, ka publikuar tërë veprën albanologjike të Cimochowsk-it, të Miklošič-it, të Pedersen-it e të Hamp-it dhe dy vepra të Fiedler-it. Në këtë synim u realizua edhe ky vëllim i parë nga vepra e gjerë albanologjike e Norbert Joklit: *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip* me përkujdesjen e përkushtuar të akademik Rexhep Ismajlit, i cili paralelisht e ka organizuar punën e përkthimit të studimeve të tjera të këtij autori. Me këtë veprimtari Akademia shpreh respektin e saj ndaj kontributit të këtyre studiuesve në zhvillimin e mendimit shkencor për shqipen dhe u ofron ndihmë studiuesve tanë të rinj të shqipes, duke ua sjellë të përmbledhura trajtesat e këtyre albanologëve të publikuara nëpër revistat shkencore të kohës, që është vështirë të gjenden.

Pasi ka shënuar se “Vija kryesore e etimologjisë shqipe deri në kohën e Luftës së Dytë Botërore karakterizohet nga emrat Miklošič – Gustav Meyer – Pedersen - Jokl, Eqrem Çabej i ka veçuar studimet etimologjike të profesorit të tij të çmuar, duke vlerësuar se “I pajisur me bagazhin e elementeve të reja dhe duke i shikuar studimet gjuhësore shqiptare në lidhje më të gjerë, Norbert Jokli në ditët tona e ka zgjeruar e thelluar në një masë të rëndësishme gjurmimin etimologjik, sidomos të fondit të trashëguar të shqipes, duke i vënë baza të forta si anës morfologjike ashtu edhe anës historike-kulturore të gjurmimit të fjalës”.

Vrasja e Jokl-it nga nazistët më 1942 qe një fatkeqësi e rëndë për studimet albanologjike e bashkë me të edhe fatkeqësia e humbjes së fjalorit

² Norbert Jokl: *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip* – 18.10.2011.

të tij etimologjik të shqipes, për të cilin, siç shënon Çabej, ai punoi tërë jetën me zell asketik.

Norbert Jokl-i në studimet albanologjike erdhi, si askush para tij, zotërues i tërë problematikës studimore të gjuhës shqipe dhe solli, siç është thënë, trajtime të reja në tërë gjerësinë tematike, duke “e zgjeruar e thelluar esencialisht njohjen gjuhësore të shqipes”.

Rezultatet e rëndësishme të tij në studimet diakronike, morfologjike e fonetike, ai i ka begatuar edhe me synimin për të përcaktuar kronologjinë e dukurive gjuhësore dhe këtë synim e ka ngritur në pjesë të nevojshme në shqyrtimin e zhvillimeve të strukturës së gjuhës dhe e ka bërë sugjerues.

Sot botimi dhe promovimi i këtij libri shqip e gjermanisht në 100-vjetorin e publikimit të parë në gjuhën gjermane përbën një solemnitet, me të cilin edhe koha jonë i shpreh mirënjohje Norbert Jokl-it, që pjesën më të madhe të kohës së tij shkencore ia fali trajtimit të gjithanshëm të çështjeve të shqipes e që la në trashëgim gjithë atë lartësi të trajtimit shkencor të gjuhës sonë. Kjo mirënjohje do të fuqizohet me botimin e gjithë veprës së tij për shqipen. Ne e kujtojmë me kënaqësi që Norbert Jokl-i pa se çmohet e nderohet për veprën e tij të madhe për shqipen me rastin dekorimin nga Mbreti Zog me urdhrin e lartë “Skënderbe” në 25-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Qe një fat për zhvillimin e studimeve të shqipes që Jokl-i, mbasi u mor me studimin e gjithëve ugrofine, sllave e baltike, vendosi t’i përkushtohet vetëm studimit të shqipes, në të cilin solli gjithë atë përparim. Dhe qe po ashtu fat që për student e pati Eqrem Çabejnë me aftësi të veçanta krijuese, i cili në fushën e etimologjisë së shqipes e bëri të vazhduar punën e Joklit të plotësuar e të zhvilluar me origjinalitete të tij.

Fjalën përruese për veprën e Norbert Jokl-it *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip*, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, do ta thotë akademik Rexhep Ismajli.

NË PROMOVIMIN E VEPRËS SË KOLEC TOPALLIT¹

I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zoti Gudar Beqiraj, i nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës zoti Hivzi Islami, zonja e zotërinj të nderuar,

sot kemi kënaqësi të veçantë që në Akademinë tonë po përurojmë një vepër madhore albanistike, veprën voluminoze *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* të anëtarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të kolegut dhe mikut tonë Kolec Topalli. Në këtë vepër çështjet e zhvillimeve morfosintaksore të shqipes janë trajtuar në një vëllim prej 1400 faqesh, ndjekur nga një prezantim prej 350 faqesh në gjuhën angleze.

Kjo vepër, bashkë me të tjerat para saj, e zbulon autorin si personalitet të fuqishëm, që e ngre vullnetin në realizues të arritjeve hulumtuese kulmore, që arrin në mënyrë të pashmangshme të realizojë synimet e tij krijuese. Pengesat e kohës për ta shmangur si gjuhëtar për Kolecin nuk patën efekt demoralizues, sepse ai pati forcën morale, durimin dhe besimin se kualitetet e punës së tij shkencore do të marrin vlerësimin publik të merituar.

Mbasi kishte përfunduar punën e nisur para 30 vjetësh në trajtimin e të gjitha çështjeve të fonetikës historike në tetë vëllime dhe sintezën e këtyre arritjeve në veprën *Fonetika historike e gjuhës shqipe* në 700 faqe, vepër që u nderua me çmime të larta: “Ekselencia Shqiptare 2007” dhe Çmimi i Albanologjisë 2008”, akademik Kolec Topalli filloi punën në trajtimin e çështjeve të gramatikës historike. Edhe këtu ai, para kësaj vepre sintetizuese, që po promovojmë, kishte botuar këto monografi: “*Evolucioni historik i përemrave të shqipes* (2008)”, “*Nyjat e shqipes* (2009)”, “*Sistemi rasor i emrave të shqipes* (2009)”, “*Sistemi foljor i gjuhës shqipe* (2010)”, “*Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe* (2011)”. Botimi i këtyre veprave një në 2008, dy në 2009, një në 2010 dhe një në 2011 e po në këtë

¹ “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”.

vit edhe libri gati 2000 faqesh që e kemi në shqyrtim, flet për një energji të fuqishme krijuese me një produktivitet të pashoq në studimet albanistike.

Akademik Kolec Topalli në studimet e shqipes ka arritur të jetë i veçantë bashkë me akademik Shaban Demirajn edhe për trajtimin e gjithanshëm të strukturës së shqipes në zhvillim, për begatinë e tematikave studimore të zhvillimit të shqipes në fonetikë, morfologji, sintaksë dhe me arritje në zbulimet e korrelacioneve të zhvillimeve të tyre paralele si transformime të strukturës së tërësishme të shqipes përmes një procedimi sintetik që nuk i lë ato, siç thuhet, provinca të pavarura gjuhësore.

Me këtë *Gramatikë historike të shqipes* ashtu si dhe me *Fonetikën historike të shqipes* akademik Kolec Topalli ka aktualizuar rishqyrtimin e të gjitha çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe deri në thellësitë e saj parahistorike. Këtë aktualizim ai e ka sjellë me tone trajtuese origjinale në çështjet qendrore të strukturës së gjuhës sonë: në krijimin dhe zhvillimin e nyjës shquese e të përparme, në zhvillimin e sistemit të rasave te emrat, te mbiemrat e te përemrat, në trajtimin e përemrave pronorë dhe të çështjeve të kohëve, të mënyrave e të diatezës në sistemin foljor.

Kualitetet shkencore të veprës *Gramatikë historike e shqipes* autori i ka arritur me argumentime plotësuese të rezultateve të hulumtimeve nga studiues pararendës dhe me risi të shumta në trajtim e në rezultate. Kështu, duke problematizuar saktësinë e mjaft rezultateve të gjertanishme albanistike, kjo vepër e objektivizon dhe e nxit nevojën e hulumtimeve të reja të problemeve evolutive të shqipes nga studiues të rinj të sotëm e të ardhshëm. Kjo e bën këtë vepër shumë komunikuese me studiuesin e këtyre çështjeve dhe nxitëse e sugjeruese për hulumtime të reja, nxitëse për zhvillimin e studimeve historike të shqipes.

Akademik Kolec Topalli e ka filluar punën në realizimin e kësaj vepre pasi ka konsultuar me vlerësim kritik tërë literaturën përkatëse, duke e bërë të mbështetur rigorozitetin e trajtimeve shkencore të tij.

Ne përfundim të kësaj fjale për këtë vepër, që qëndron krenarisht e veçantë, ne kemi kënaqësi kolegiale që ta përgëzojmë akademik Kolec Topallin që ka arritur me tërësinë e veprave të veta të jetë zotërues kreativ i

tërë problematikës së diakronisë së shqipes e ta shohë me mburrje këtë arritje të madhe krijuese.

Dëshiroj që me këtë rast t'i uroj sukses zotit Topalli në punën e nisur për hartimin e fjalorit etimologjik të shqipes, vepër kjo që do ta ngrejë edhe më lart prestigjin e tij si studiues i shqipes.

FJALË PËRSHËNDETËSE NË SHKUP

Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ju përshëndes dhe ju përgëzoj për organizimin e këtij Simpoziumi në nderim të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në 600-vjetorin e lindjes.

Ky Simpozium, që i bashkohet Simpoziumit të mbajtur në Prishtinë dhe Simpoziumit që do të organizohet në Tiranë, bashkë me shtatoren e Skënderbeut që po ngrihet në Shkup, rrezaton përmbajtje pozitive në zhvillimet shoqërore e politike në Maqedoni, zhvillime që i gjeneron subjekti shqiptar tok me subjektin maqedonas të vizioneve demokratike për të krijuar një Maqedoni moderne me të drejta të barabarta të të dy popujve përbërës të saj e të të tjerëve, një Maqedoni të begatuar me shpërthimin e energjisë krijuese të tyre dhe me shkëlqimin e dy kulturave kombëtare.

Figura e Skënderbeut, që zë një vend qendror në historinë e shqiptarëve, është njëherazi edhe një nga figurat shumë të rëndësishme të historisë evropiane të shek. XV. Gjergj Kastrioti – Skënderbeu e vuri popullin shqiptar në ballë të luftës kundër së keqes që iu kanos e po i kanosej fatalisht Evropës. Në luftën me karakter tërësisht vetëm çlirimtar kundër një armiku tepër të fuqishëm në çerekshekullin e madh të historisë sonë, populli shqiptar gëzoi famën e mbrojtësit të qytetërimit evropian. Kjo luftë e tij u bë objekt studimesh shkencore në vijimësi gjer në ditët tona dhe frymëzim me pietet për vepra të ndryshme artistike në mbarë Evropën. Brenda nesh në shekujt gjithnjë të trazuar të popullit tonë kjo luftë mbajti gjallë krenarinë kombëtare dhe funksionoi si ndërgjegje kolektive për qëndresë e për sakrificim për liri, gjithnjë në përkrahje edhe të lirisë së të tjerëve.

Simpoziumit i dëshiroj rezultate të shënueshme shkencore në ndriçimin e mëtejme të figurës së Skënderbeut e të shoqërisë shqiptare të epokës së tij.

NË PROMOVIMIN E VEPRËS SË GËZIM QËNDROS PËR REXHEP FERRIN

Të nderuar pjesëmarrës në promovimin e librit të dr. Gëzim Qëndros për piktorin tonë, akademikun dhe mikun tonë të dashur e të respektuar Rexhep Ferri. Duke ndejur përditë me të e me modestinë e tij, harrojmë që pranë nesh është një krijues i niveleve të larta në artin e pikturës, i çmuar si tillë edhe nga studiues të pikturës evropiane.

Zonja e zotërinj, qëndrojmë para një rrafshi të bardhë, nën të cilin ne nuk shohim asgjë. Vjen brusha e Rexhep Ferrit dhe i nxjerr në sipërfaqe lëvizjet e hijeve homoide nëpër dramën e tyre, nëpër shqetësimet, nëpër synimet, nëpër frikën e nëpër shpresën për të ecur kah njeriu. Dhe vijnë nga bota e tyre e na shqetësojnë për fatet e tona e na sugjerojnë veprime për të ecur në jetë. Nga nivele të dashurisë e të shqetësimeve për njeriun piktura e Rexhep Ferrit qëndron njerëzisht e ndritur.

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e përgëzoj dr. Gëzim Qëndron që me kompetencë e me objektivitet ka përcaktuar gjithanshmërisht vlerat dhe nivelin artistik të pikturës së Rexhep Ferrit, që ka arritur të përcaktojë realisht vendin e lartë të pikturës së tij në zhvillimin e pikturës kambëtare dhe në pjesëmarrjen e saj të denjë në ecjet moderne të pikturës evropiane të kohës. Në këtë vepër zoti Qëndro na e sjell pikturën e Ferrit edhe si shpërthim të një energjie të veçantë me hijeshinë e origjinalitetit dhe e të qenit e ndryshme, si vepër të realizuar me një pasqyrim metaforik mjesh të fateve të rënda të qenies njerëzore në pankroni. E çmojmë impenjimin e përgjegjshëm të zotit Gëzim Qëndro për të krijuar këtë vepër me vlera analizuuese e çmuese, i motivuar nga dëshira për të nxjerrë në pah me dashuri nivelin e lartë të veprës së piktorëve kosovarë.

Mendoj se kjo vepër e zotit Qëndro do të mbetet në kohë vepër respekti të denjë ndaj personalitetit krijues të Rexhep Ferrit e ndaj vlerave të pikturës së tij dhe dëshmi e një trajtimi të qëndrueshëm shkencor.

NË TRYEZËN SHKENCORE “TRAJTIMI I PERANDORISË OSMANE DHE I RAPORTEVE TURKO-SHQIPTARE NË TEKSTET TONA TË HISTORISË

Kryesi e nderuar, të nderuar zonja e zotërinj,

Kam nderin që në emër të organizuesve të kësaj Tryeze: të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të Institutit të Historisë të përshëndes e të falënderoj historianët tanë nga Prishtina e nga Tirana që iu përgjigjën ftesës sonë për të marrë pjesë në punimet e kësaj Tryeze, për të ofruar kompetencën e tyre të lartë në sqarimet shkencore të çështjeve që shtron tema: *Trajtimi i Perandorisë Osmane dhe i raporteve turko-shqiptare në tekstet tona të historisë*. Përgëzoj Akademik Pajazit Nushin, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë dhe dr. Jusuf Bajraktarin, drejtor i Institutit të Historisë, që e bënë të mundur mbajtjen e kësaj Tryeze.

Në gjendjen e sotme marrëdhëniet e dy shteteve tona dhe Republikës së Turqisë janë marrëdhënie miqësore shembullore, me veprime dobiprurëse për popullin tonë e për dy shtetet tona. Edhe mirënjohja jonë për këtë qëndrim dhe gatishmëria jonë për ta kultivuar e përforcuar këtë miqësi është realitet dhe synim i qëndrueshëm.

Por kjo miqësi, që karakterizon kohën moderne të marrëdhënieve tona, nuk mund të lëndohet nga trajtimet e bëra shkencore për periudhat e rënda të historisë nën sundimin e Perandorisë Osmane, për efektet e rënda shtypëse që i solli popullit shqiptar e për qëndresën dhe kundërshtimin krenues ndaj asaj shtypjeje nëpër kryengritje të shumta e fljime me lavdin e dëshirës për liri. Mendoj që edhe kjo Tryezë do të nxjerrë në pah se historiografia shqiptare kurrë nuk ka rrëshqitur në pozicione shoveniste e fyese për popullin turk dhe se edhe këtu nuk ka pse të korrigojohet.

Kërkesa e dy ministrave të nderuar të Qeverisë së Turqisë gjatë vizitës në Kosovë për të bërë korrigjime të teksteve tona të historisë me një qasje lehtësuese mirëkuptimi ndaj sundimit të Perandorisë Osmane ishte e papritur dhe solli reagime të shumta në opinion. Ne nuk dimë nëse në

bisedime me qeveritarë tanë është bërë ndonjë propozim konkret për ndryshime, por mund të themi se do të prisnim që këtë ta thoshin historianët e Turqisë, po të kishin argumente që t'i shtronin para historianëve shqiptarë, sepse çështja nuk është politike, që ta trajtojnë politikanët, as qeveritare që të trajtohet nga qeveritarët. Po të ishte çështje, do të ishte çështje që do të zgjidhej vetëm nga trajtimi shkencor i historianëve.

Do të më lejohet të rikujtoj se asnjë zaptues nuk vjen pa deklaruar se vjen për të sjellë të mirën, për të krijuar rend, siç u tha edhe tash për ardhjen e Perandorisë Osmane, për të sjellë civilizim e qytetërim a për të të tuajtur nga sundues të tjerë. Historiografia shqiptare i ka trajtuar ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike, kulturore etj. që ka sjellë Perandoria Osmane, por ajo si shkencë nuk mund të pranojë si të vërtetë arsyetimin e tillë të zaptimit për asnjë hatër. Kështu, ajo që është jashtë trajtimit shkencor nuk mund të jetë arsye për ndryshim në tekstet tona të historisë.

Akademia dhe Instituti i Historisë e panë të nevojshme ta organizojnë këtë Tryezë me fjalën shkencore të historianëve tanë, në mënyrë që opinioni ta ketë të përsëritur përgjigjen e historiografisë shqiptare për relacionet e Perandorisë Osmane me shqiptarët dhe përgjigjen ndaj kërkesës për ndryshime të teksteve të historisë me shmangie nga trajtimi shkencor.

Tani vjen fjala juaj e respektuar, të nderuar historianë.

Ju faleminderit!

**NË HAPJEN E SEMINARIT XXVIII NDËRKOMBËTAR PËR
GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE
– 17. 08. 2009**

Zonja e zotërinj, kolegë e miq të nderuar, i nderuar rektor i Universitetit të Prishtinës, zoti Mujë Rugova, i nderuar kryetar nderi i Seminarit, akademik Idriz Ajeti, të nderuar bashkëdrejtorë të Seminarit, të nderuara personalitete shoqërore, arsimore e shkencore, të nderuar seminaristë,

në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizuesit e këtij Seminari, kolegët e Fakultetit Filologjik të Prishtinës e të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë të Tiranës i përgëzoj dhe u uroj sukses të dëshiruar të punimeve dhe të aktiviteteve të parapara për Seminarin e sivjetshëm të XXVIII, duke qenë i sigurt se puna dhe zelli i pakursyer i kolegëve tanë të drejtorisë së Seminarit do të na sjellë kënaqësinë e një niveli të denjë të organizimit bashkë me rezultatet e shënueshme në trajtimin e temave nga studimet gjuhësore, letrare e kulturore. Urojmë që në kurset e gjuhës seminaristët të thellojnë njohjen aktive të gjuhës shqipe, për t'u aftësuar që ta njohin edhe më shumë popullin shqiptar, të kaluarën dhe kulturën e tij.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është tash sa kohë institucion albanologjik i njohur në përmasa ndërkombëtare. Që nga themelimi ai realizoi qëllimin që të afrojë albanologët e vendeve të ndryshme dhe të ndikojë që ta intensifikojë punën e tyre shkencore albanologjike. Ai u bë tribunë e dëshirueshme dhe nxitëse për të shprehur rezultatet e punës hulumtuese në sferat e kulturës shqiptare. Nëpër vitet e Seminareve kjo përbën vlerën e parë e shumë të veçantë të Seminarit në kulturën shqiptare. Mund të thuhet se nuk pati albanologë deri te më të njohurit që nuk morën pjesë aktive në disa nga Seminaret. Në kohën kur ishte mjaft i mbyllur komunikimi ynë kulturor me jashtë, Seminari u bë hapësirë e dëshiruar mikpritëse e respektimit të punës së dijetarëve albanologë, të respektimit të dëshirës për njohje më të thella të kulturës së popullit tonë nga studiuesit e rinj të jashtëm dhe i vuri para një pune më ambicioze shkencore studiuesit tanë të rinj. Me vlerën e tij

integruese të të tërë potencialit shkencor albanologjik e me krijimin e lidhjeve me kulturat e tjera Seminari është bërë institucion që na nderon e që i lartëson themeluesit largpamës të tij.

Gjatë këtyre viteve Seminari ka shtruar në trajtim shkencor një numër të madh temash nga gjuha, letërsia e kultura shqiptare, duke begatuar fondin e qëndrueshëm të rezultateve të studimeve albanologjike. Seminar, përmes ngritjes së gjuhës shqipe në nivelet më të larta trajtimesh shkencore, realizoi funksionin e tij ndriçues të çështjeve të kulturës shqiptare dhe u vlerësua lart në këtë funksion të tij kulturor e shoqëror. Seminari është ngritur për të na mbajtur në nivele të nevojshme komunikimi me botën e studimeve shqiptare e si i tillë ai është bërë shprehës i këtij shpirti afrues. Ai është bërë i pashmangshëm nga jeta jonë shkencore e kulturore dhe identifikues i ndritshëm i Prishtinës e i Kosovës. Dhe meriton të jetë i vijueshëm në këtë mision, vijimisht i respektuar e i përkrahur, duke vazhduar të qëndrojë i veçantë me vlerat e tij në sferat e aktiviteteve tona të dalluara shkencore e kulturore.

Seminaristëve nga vendet e ndryshme, juve miqve dhe dashamirëve të popullit shqiptar dhe çmuesve të kulturës së tij, ju dëshiroj qëndrim të këndshëm, miqësime të reja dhe njohje më të thella për Kosovën, që e çmon lart përkushtimin tuaj për të studiuar me respekt kulturën e popullit shqiptar.

Ju faleminderit !

.

NË CEREMONINË E SHPALLJES “NDERI I QYTETIT TË GJAKOVËS”

I nderuar Kryetar i Komunës zoti Pal Lekaj, i nderuar nënkryetar i ASHAK zoti Hivzi Islami, të nderuara autoritete shoqërore, arsimore, kulturore, fetare, autoritete të pushtetit, miq e kolegë, zonja e zotërinj,

falënderoj Kryetarin e Komunës zotin Pal Lekaj, që në emër të Komunës, më nderoi në shkallë kaq të lartë, duke më shpallur Nderi i qytetit të Gjakovës. E falënderoj dhe mikun tim akademik Rexhep Ismajli për fjalët e pëlqyeshme që tha për mua.

Në këtë vlerësim kaq të lartë shoqëror që po më bëhet nga qyteti i lindjes sot në 80-vjetorin e lindjes e kanë pjesën e tyre edhe shokët e mi të njohur në Gjakovë e në Prishtinë, të gjallë e të ndarë nga jeta, që punuam bashkë, ëndërruam bashkë e synuam bashkë një ecje përpara.

Gjakova ka pasur pa ndërprerë dhe ka personalitete (disa janë të pranishëm edhe në këtë solemnitet), që e kanë ngritur prestigjin e këtij qyteti në përmasa kombëtare, që e kanë ndarë nga nivelet provinciale e lokaliste, personalitete që fjalën e këtij qyteti e kanë bërë fjalë të politikës kombëtare, të shkencës kombëtare, të letërsisë, të pikturës e të muzikës kombëtare, personalitete që janë sakrifikuar për dinjitetin kombëtar, për një jetë të lirë të dinjitetshme njerëzore e që e kanë mbajtur Gjakovën vazhdimisht aktive në veprimet patriotike. Të gjithë kanë lëvizur nga krenaria e qytetit kah krenaria e kombit. Energjia e tyre krijuese u kthye në energji të traditës, mbi të cilën qyteti hedh hapa të pandalshëm kah jeta e civilizuar. Ata e bënë Gjakovën të jetë krenaria jonë.

Në kohë të rinisë kisha shkruar një poezi, në të cilën dolën limitimet e vendosjes së jetës sime në kushtet e kohës. Vjersha thoshte:

“Unë due pikën kur gurin shpon
edhe borën kur ruen tokën nga acarimi
unë due djellin kur lëkurën përvelon
dhe rrëfenë kur çan qiellin nga hidhërimi /”.

Shpërthimi i rrëfësë ishte në atë kohë shpresë tepër e largët, ndërsa veprimi sillej rreth simbolikës së veprimit të pikës kundër gurit. Shpresa se ajo dita e madhe, që s'mund t'i përmendej emri, do të vinte me të gjallë timin kishte marrë formën e një artikulimi poetik që në atë kohë: "Kur të vijë, ndoshta do të më gjejë të plakun e s'do të muj me qesh si filladi i pranverës, me vdekë, porse, nga gëzimi, do të mundem". Dhe liria erdhi në moshën time 78-vjeçare. Me madhështinë e saj ajo solli porosinë për çlirim të mëtejme të njeriut tonë.

Është thënë se nëse sot, përballë nevojave e kërkesave të përgjithshme do të sillemi njerëzisht, edhe e ardhmja mund të jetë njerëzore. Dhe është detyrë e gjeneratave të tashme të punës që ta tipizojnë këtë qëndrim si qëndrim të kohës së tyre e të veprojnë për krijimin e kushteve që qytetari të mund të realizojë aftësitë e veta krijuese.

Ndodhi ndryshim i madh i jetës: jeta ndërroi lis, siç ka thënë De Rada për një kohë të lashtë para tij. Jeta ka frymëmarrje të reja, ka synime të reja integruese kombëtare e ndërkombëtare, synime kah krijimi e begatimi i mirëqenies njerëzore. Do të vijnë personalitete që i nevojiten kohës për të ndihmuar zhvillimet moderne të jetës. Në ecjet e saj ne të brezit tim mbesim në të kaluarën tonë, në krenarinë e kohës së rezistencës kundër së keqes.

Edhe njëherë: ju faleminderit, zoti Kryetar! Ju dëshiroj punë të mbarë në drejtimin e zhvillimeve të Komunës.

Uroj që ky nderim që m'u bë mua, të jetë nismë nderimi edhe për individë të tjerë të merituar.

NË 80-VJETORIN E LINDJES

Ju falënderoj kolegë e miq për nderimin që më bëtë me pjesëmarrjen tuaj në këtë ditëlindje time të tetëdhjetë e për urimet tuaja. E çmoj lart praninë e Kryetarit të Komunës së Gjakovës zotit Pal Lekaj. Falënderoj Komisionin për organizimin e këtij solemniteti: nënkryetarin e ASHAK zotit Hivzi Islami, sekretarin e Seksionit të Gjuhësisë e të Letërsisë zotit Mehmet Kraja dhe akademik Rexhep Ismajli. U jam shumë mirënjohës miqve të mi Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kolec Topalli, Ethem Lika, Seit Mansaku dhe Imri Badallaj për trajtimet e veprës sime shkencore e letrare me dashamirësi e me kompetencë shkencore që është më e larta për kohën. Natyrisht në këto raste solemne të jetës së një krijuesi lejohet një shkallë më e lartë lavdërimi, të cilën vepra e sjell vetë në përmasa reale.

Si studiues të shqipes ne jemi formuar nga kontributet e albanologëve pararendës, nga rezultatet e punës së tyre, kështu që edhe në veprat tona, të studiuesve të sotëm të shqipes, është edhe energjia krijuese e tyre. Siç jam shprehur edhe një herë tjetër “Mbasi përgjegjësinë për një ecje përpara të shkencës sonë, në kohën tonë, e kemi të gjithë së bashku, çdo kontribut të tjetrit kemi arsye ta konsiderojmë të përbashkët”. Me llojllojshmërinë e temave në degët e ndryshme gjuhësore, me diversitetin e trajtimit të tyre e me mundësitë tona krijuese mendoj se i kemi begatuar rezultatet e albanistikës së kohës sonë, se kemi zbuluar ndonjë të vërtetë, se kemi avancuar një mënyrë trajtimi, që na sjellin qaste gëzimi e krenarie e na e lehtësojnë ndjenjën e dyshimit për saktësinë e ndonjë përfundimi tonë studimor.

Si çdo vepër tjetër edhe vepra ime shkencore do të shtyhet në kohë të shkuar e do të zërë vendin e saj në zhvillimin e mendimit albanistik. Ajo do të imponojë që veprat e reja nga morfologjia historike t’i tejkalojnë rezultatet e saj me nivele më të larta shkencore. Kështu ajo do të përmbushë edhe funksionin e saj nxitës për arritje të reja shkencore.

Siç u tha edhe këtu, fillimi i krijimtarisë sime ishte në poezi. Më vonë m’u dha mundësia të shoh se edhe studimet e gjuhës japin kënaqësinë

e krijimit në shkallë po aq të lartë sa edhe krijimi poetik. Dhe u binda se në trajtimin e temave nga morfosintaksa historike e shqipes mund të arrija rezultate më të larta se në poezi, kështu që nuk besoj të kem gabuar që iu përkushtova më shumë gjuhësisë, me gjithë se disa miq poetë kanë menduar se kam gabuar. Pas një pauze të gjatë unë iu ktheva poezisë për disa vjet nga viti 1983, një poezie po ashtu kryesisht politike, por tani me një shprehje postmoderne, e dominuar nga poezia *Jubiletë e mia*. Një kohë u kushtova edhe aforizmave të tipit humoristiko-satirik.

Për punën time shkencore dua të falënderoj dy personalitete të shkençës sonë: profesor Idriz Ajetin dhe profesor Rexhep Ismajlin. Profesor Idriz Ajetin për vlerësimin e lartë të punimit tim të parë për zhvillimin e strukturës së temave emërore, mendim që bëri të mundur dhënien e temës së doktoratës pa magistruar dhe për kënaqësinë që ndjeu për nivelin shkencor të doktoratës, që si të tillë u angazhua ta botonte në ASHAK. Profesor Rexhep Ismajlin për vlerësim publik të pandërprerë të veprave të mia, me tone përkrahëse e dashamirëse të punës sime. Dua që në këtë ditë jubilarë të jetës sime para jush të falënderoj edhe bashkëshorten time Muhamedije për durimin ndaj punës sime, për krijimin e kushteve për punë, për përkrahjen e veprimeve të mia, për përballimin e shqetësimeve e për kurajon që më dha për të vazhduar veprimtarinë krijuese.

Kolegë e miq të dashur, vëllimi i veprave të krijuesve në Kosovë nuk mund të çmohet realisht pa e vështruar në relacion me kushtet e jetës që herë pas here ishin të pafavorshme për krijim, pa e vështruar në relacion me kohën e kaluar me aktivitet të nevojshëm shoqëror si detyrë intelektuale për të ndihmuar zhvillimin e proceseve pozitive shoqërore.

Në këtë moshë të shtyrë koha e humbur, duke u marrë me punë të parëndësishme jetësore, ardhka e u bëka dhembje e rëndë.

Në 80-vjetorin e lindjes jam i kapluar nga malli për shokët që s'janë më në jetë, për shokët që ma begatuan jetën me dashuri e më dhuruan gjithë atë dashamirësi kurajodhënëse.

Ju faleminderit.

INTERVISTË E GAZETARIT MEHMET EMËRLLAHU¹

Pyetja: Jeni profesor i gramatikës historike të shqipes dhe në këtë fushë keni dhënë kontributin tuaj me dy vepra e me ndonjë punim tjetër. Ç' mund të thuhet për gjendjen aktuale të këtyre studimeve?

B. Bokshi: Menoj se me librin vëllimmadh të Shaban Demirajt “Gramatika historike e gjuhës shqipe” (botuar edhe nga “Rilindja” më 1988) është përmbyllur një fazë e gjatë frytdhënëse e studimeve në fushë të gramatikës diakronike të shqipes. Në këtë vepër janë prezantuar gjerësisht tezat dhe rezultatet e gati të gjithë albanistëve që nga fillimet e studimit shkencor të këtyre çështjeve dhe është dhënë vlerësimi i validitetit të tyre nga autori që ka rezultate të shënueshme në këtë fushë. Në të njëjtën kohë “Gramatika historike” e Sh. Demirajt tregon në mënyrë të qartë se pikëvështrimet zotëruese të deritashme i kanë përfunduar rezultatet. Ato më duket se kanë arritur në shkallën e një pamundësie për të depërtuar më tutje në ndriçimin e fushave të errëta të zhvillimit të strukturë gramatikore të shqipes. Studimet e tilla me shterpësi rezultatesh do të ketë edhe më tutje, por ato do të jenë gjithnjë e më marginale, për shkak se studiuesit e rinj si jashtë ashtu edhe në Shqipëri kanë kaluar e kalojnë me guxim në pikëvështrime më të avancuara, me të cilat hapen horizonte të reja për ndriçimin e çështjeve të kësaj dege të vështirë të albanistikës. Me një fjalë: mendoj se studimet e gramatikës historike të shqipes po kalojnë në një fazë tjetër kualitative.

Pyetja: Si e shpjegoni Ju statusin e shqipes e të serbokroatishtes, veçmas kërkesat e kundërta rreth zgjidhjes së kësaj çështjeje?

B. Bokshi: Për statusin e gjertanishëm të këtyre gjuhëve ka shkruar Rexhep Ismajli. Se cila është perspektiva e zgjidhjes së kësaj çështjeje mund të shihet, mendoj, në karakterin e tekstit politik të këtyre gjuhëve. Teksti politik i serbishtes në raport me shqipen tregon se është vazhdim i tekstit të saj që nga fundi i shekullit të kaluar, i pasuruar në kohën e Luftave Ballkanike e të Luftës së Parë Botërore, për të arritur në kohën

¹ Botuar te *Rilindja*, më 16 qershor, 1990 dhe në veprën e tij *Nyja Kosovare*.

tonë shkallën e përsosjes së llojit. Kjo gjendje e këtij teksti sinjalizon pretendimet e afërta për të kaluar në një tekst krejt të kodifikuar e me precizitet ligjor të shprehjes, si e kishte në kohën e Jugosllavisë para Luftë së Dytë Botërore. Ky tekst i ka karakteristikat e diskursit të njohur shizofrenik, në të cilin është krejtësisht e shfrenuar liria e shprehjes, e gjykimit dhe e vlerësimit, që e bën të pakomunikueshëm me të folurit njerëzor, është një sistem i mbyllur gënjeshtresh e fyerjesh të vëna në sintaksë të absurdit e me thekse tragjike në fjalët e shtetit autoritar. Ai është pra edhe tip i tekstit policor, me të cilin funksioni i moçëm për “të drejtë e dhënë” që tekstet e serbishtes të jenë të vetmet në Kosovë, ka shkaktuar, si gjithmonë në këso rastesh, përmbajtjen represive të fjalëve “rend e qetësi” për shqipen. Teksti politik i serbishtes nuk e ka fare në kujtesë tekstin e Tucovoqit e të disa të tjerëve, sepse ai për të është tekst i huaj, i përkthyer nga gjuhë krejtësisht të tjera të njerëzimit. Teksti politik i shqipes është tekst i gjuhës popullore, nga i cili shpërthen kërkesa e së mirës për të gjithë, si realizim i së drejtës universale për barazi njerëzore të kolektiviteteve në bashkëjetesë. Ai është tekst me pak fjalë dhe, për shkak të lidhjeve me rregullat të gjuhës humane, është tekst i mbyllur e i pandryshueshëm. Memoria e tij është gjithënjëzore e kombëtare që nga koha e Rilindjes e më parë, ndërsa realizimin e kërkesave të veta ai e ka drejt civilizimit si proces që vjen e jo në të kaluarën si iluzion hegjemonist.

***Pyetja:** Meqenëse merreni me punë pedagogjiko-shkencore, na thoni çfarë janë mundësitë aktuale që merreni me problemet e mirëfillta shkencore të gjuhësisë shqiptare?*

B. Bokshi: Sot, në rrethana kaq të rënda e tragjike të Kosovës, çdo punim shkencor, që nuk korrespondon me problemet ekzistenciale të popullit, më duket shprehje e një indiferentizmi të pakuptueshëm. Tipi i shkencëtarit me indiferencë pitagoreske shoqërore sot, në mos qoftë potencialisht “shqiptar i ndershëm”, do të jetë egocentrik i sëmurë. Si mund të krijohet ndryshe ai koncentrim i fuqishëm psiko-intelektual që nevojitet për krijim shkencor, në këtë rast edhe për sqarim të çështjeve të gramatikës, qoftë edhe historike, pranë gjithë këtyre agenseve shqetësuese anticivilizuese e makjaveliste që veprojnë kundër të drejtave elementare të popullit tënd? Tjetër gjë është me disiplinat shkencore, në të cilat vepra e

hulumtuesit godet “të vërtetën” e trilluar serbocentrike për shqiptarët, në bazë të së cilës justifikohet dhuna, shpërngulja e terrori që është ushtruar e ushtrohet mbi ta. Shkencëtarëve të këtij profili koha, jo vetëm që u jep mundësi, por edhe i detyron t’i përvishen punës shkencore, të cilën interesi kolektiv e ka vënë në plan të parë. Fatmirësisht shkencëtarë të tillë me kurajë të theksuar qytetare, që e nderuan veten dhe popullin, kemi pasur dhe kemi. Motiv për punë shkencore mendoj se duhet të kenë në këto kushte edhe ata që me inovacione e zbulime të rëndësishme konfirmojnë gjenium krijues të popullit tonë. Nga sa u tha kuptohet se kushtet për angazhim shoqëror të intelektualëve të çfarëdo rangu kurrë s’ kanë qenë më nxitëse. Më duket se aktiviteti politik i intelektualit shqiptar duhet të jetë gjithsesi në përputhje me “vullnetin e Minervës”, d.m.th. me dije e pa kurrfarë intonacioni për afirmim personal “patriotik”.

***Pyetja:** Po në ç’ masë e kanë penguar këtë punë shkëputjet e lidhjeve dhe të qarkullimit me qendrat e tjera albanologjike jashtë vendit e sidomos me Shqipërinë që nga viti 1981?*

B. Bokshi: Lidhjet e qarkullimet me qendrat e tjera që merren me studime albanologjike janë reduktuar shumë për shkak, siç thuhet, të mungesës së mjeteve financiare, ndërsa me Tiranën ato u shkëputën, siç dihet, për arsye politike. Ndërprerja e të gjitha marrëdhënieve kulturore me RP të Shqipërisë, që u bë në vitin 1981, qe e njëanshme e arbitrare dhe u kualifikua paturpësisht si akt i depërtimit triumfal të shtetit “juridik” edhe në Kosovë.

Kjo ndërprerja e marrëdhënieve, përveç të tjerash, qe një goditje tepër e rëndë për studimet albanologjike te ne. E para: për arsye se në Tiranë, që është qendra më e madhe e këtyre studimeve, janë bibliotekat më të pasura me literaturë e me materiale albanologjike që nga fillimet e kësaj shkence, kështu që çdo punim me pretendime ca më serioze shkencore nuk mund të rrumbullakësohet pa konsultim të saj. Te ne vetëm Bibliotekës Krahinore dhe Institutit Albanologjik i vijnë me vonesë libra e revista të pakompletuara, por ato janë të lejueshme të shikohen vetëm nga një numër i vogël shkencëtarësh, kështu që të rinjtë që duan të merren me studime albanologjike, studentë të albanologjisë e të interesuar të tjerë nuk mund t’i konsultojnë. E dyta: mungesa e kontakteve me albanologët nga Shqipëria,

e konsultimeve personale, e punëve të përbashkëta grupore të institucioneve përkatëse, e pjesëmarrjeve nëpër simpoziume e sesione shkencore, shkaktoi rënien e hovit krijues e të ambiciesh për punë, me dyshim të përhershëm se çështja e trajtueshme mund të ishte shqyrtuar atje më parë. E treta: ndërprerja e këtyre lidhjeve u bë mbi bazë të akuzave të trilluara për gjoja rrezikun politik nacionalist që sillnin ato për marrëdhëniet ndërnacionale të ne e kjo më së shumti kishte të bënte me rezultatet në fushat e ndryshme të albanologjisë. Ndërkaq, në qarqet e gjera shkencore dihet mirëfilli se disiplinat albanologjike nuk kanë ngritur kurrë ndonjë teori nacionale, që do të thoshte edhe nacionaliste, çka nuk mund të thuhet për gjuhësinë serbe. Ky trajtim i albanologjisë s'ka dyshim se pasivizon shumë interesimin për studime në fusha të saj.

***Pyetja:** Universiteti u sulmua e po sulmohet pamëshirshëm. A mendoni se reagimet e punonjësve universitarë ndaj sulmeve, diferencimeve ideopolitike dhe ndaj masave të tjera administrative (fjalë e kam te suspendimet dhe përjashtimet e arsimtarëve dhe studentëve edhe nga procesi mësimor) kanë qenë adekuate dhe në nivel të përgjegjësisë dhe titujve që kanë?*

B. Bokshi: Universiteti u sulmua si kështjellë e rrezikshme për shtetin, si burim i separatizmit e nacionalizmit shqiptar, në mënyrë që të legalizohej e drejta për “spastrime”, përjashtime e dënime të studentëve, të pedagogëve e shkencëtarëve të dinjitetshëm, me qëllim që të shuhej çdo mendim për rezistencë e kundërshtim ndaj politikës zyrtare që po restaurohej e po vinte duke u formësuar gjithnjë e më haptazi si politikë shoviniste ndaj shqiptarëve. Kjo akuzë i bëhej edhe tërë arsimit në gjuhën shqipe. Dhe politika e tillë nuk e fshehte fare se të dijsimit ishin armiq të saj. Ju kujtohet se me sa simpati pat shkruar shtypi republikan për deklaratën e një analfabeti kosovar se paskemi qenë mirë e rehat kur nuk i paskemi pasur shkollat, tamam për të arritur në mbretërinë e Sulltan Sulejman Madhështorit të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, i cili e kishte lënë shtetin pa asnjë të dijsëm, sepse kishte menduar se “libri e dija u japin njerëzve, më tepër se çdo gjë tjetër, të kuptuarit e vetvetes dhe ua zhvillojnë urrejtjen ndaj tiranisë”.

Këto akuza të pabaza janë kundërshtuar nga kuadri arsimor shqiptar. U mbrojtën edhe kolegët e akuzuar pa të drejtë: asnjëri nuk u përjashtua nga njësia themelore e LK-së, por nga Komiteti Komunal edhe me shpartallim të ndonjë organizate partiake. Ndërkaq, përjashtimi i paligjshëm i tyre nga puna shikohej me keqardhje, po nuk kundërshtohej. Nuk organizohej asnjë formë e shprehjes kolektive të ndonjë mospajtimi kushtëzues si për ta ashtu edhe për shkelje të tjera të jetës, të punës e të autonomisë së Universitetit.

Kuptohet se këto reagime, ashtu siç i gjykon edhe pyetja juaj, nuk ishin reagime të njerëzve të lirë, por të intelektualëve gjysmëvullnetarisht të robëruar. Kjo gjendje duhet të jetë e determinueshme, jo nga ndonjë dobësi e veçantë e tyre, por nga pozita e përgjithshme, në të cilën i vë shteti “i socializmit real” intelektualët e kombësive a të pakicave kombëtare e të ne veçanërisht intelektualët shqiptarë. Thashë “gjysmë e vullnetshme”, sepse ishim bërë anëtarë të LK-së duke u manifestuar si forcë mbrojtëse e shtetit, duke pasur vërtet një siguri personale, por me pretekst se kështu mund të ndikonim edhe për një siguri kolektive ndaj së keqes; sepse ishim bërë njerëz të një “pseudo mendimi” në kuptim të Frommit, duke qenë mësuar me kohë që të mos e marrim të vërtetë manifestimin e qartë të ngjarjeve, akteve e fenomeneve që ndodhnin para nesh, por gjykimet e partisë e të shtetit për to: sepse e kishim pranuar si model të lartë në qoftë se nuk bëjmë të këqija. Bamirësinë e kishim lënë jashtë ambicieve të etikës sonë, pa çarë kokën se, si të tillë, Danteja na kishte vendosur me kohë në rrethin e dytë të Ferrit. Këtu natyrisht nuk hyjnë ata të paktë midis nesh që, duke qenë më të lirë e më pak të robëruar shpirtërisht, e nderuan emrin e pedagogut në Universitetin tonë dhe nuk hyjnë në asnjë mënyrë as studentët që për të vërtetën, për të drejtën e për dinjitetin kombëtar bënë gjithë ato sakrifica.

U desh të ndodhte gjithë ajo dhunë, që të bëheshin gjithë ato viktime të të rinjve, së paku që nga viti 1981, u desh që Lidhja e Komunistëve, anëtarë të së cilës ishim, të bëhej plotësisht instrument i shovinizmit e nacionalizmit serb si dhe aparati i shtetit të saj, u desh në të njëjtën kohë të ndodhte rënia sensacionale e pushteteve diktatoriale të shteteve të Lindjes e të arrijmë, pranë të së përditshmes animalisht të vrazhdë e kërcënuese, në

një çlirim kolektiv shpirtëror që s'e kishim pasur kurrë. E dobishme për këtë çështje do të ishte fjala e sociologut dhe e psikologut.

***Pyetja:** Në anën tjetër patëm shkencëtarin e shkrimtarin që u vunë në funksion aktiv të propagandës dhe të realizimit të politikës së ditës edhe pas vitit 1981. Si e kuptoni Ju këtë?*

B. Bokshi: Mbase është fjala veçanërisht për angazhim të tillë të tyre ndaj politikës pas vitit 1981, d.m.th. në kohën kur kjo politikë e bëri irracional gjithnjë e më tepër vlerësimin për ngjarjet e lëvizjet në shoqëri dhe si pasojë edhe masat për zgjidhjen e tyre në kurriz të shqiptarëve, besoj të jetë e pakontestueshme se kemi të bëjmë me tipa të theksuat sadomazohistë normalë, pra me tipa që kanë nevojë të papërmbajtshme për t'iu nënshtruar autoriteteve të pushtetit për të krijuar autoritet të tyre të pushtetshëm. Dhe është e njohur se të tillët realizimin e tyre më të plotë e kanë në sistemet shoqërore autoritare dhe se pushtetet e tilla bazohen në këta tipa. Për ta nuk ka rëndësi morali i politikës, por ka rëndësi besimi se ajo do të jetë nevojtare për ta në një kohë të gjatë. Ndaj tyre ishte krijuar një opozitë morale e në baza kombëtare, që i bënte të izoluar në qarqet intelektuale. Shkencëtarin e shkrimtarin e tillë dobësia e pasigurisë nuk i lë të mjaftojnë me autoritetin e krijuar nga puna. Tash që LK u shthur e që pushtetit të saj i kanë mbetur organe të suksesshme “propaganduese e bindëse” vetëm organet e sigurimit, sadomazohistët e tillë dolën të paefektshëm.

Mbase s' ka kuptim të mos përfillen fare në këtë bisedë ata sadomazohistë midis nesh në Universitet, që do të mund të quheshin “altruistë” e “modestë”, sepse nuk kërkojnë autoritet publik politik, mbase u mjafton autoriteti i msheftë që e kanë në organet e sigurimit.

***Pyetja:** Jeni ndër ata që, përkundër faktit se keni hequr dorë nga partia (LK), nuk jeni angazhuar në asnjë parti të re. Pse?*

B. Bokshi: Nuk jam anëtar i ndonjë partie të re, por jam për tërë alternativën demokratike kosovare. Ajo vepron që nga fillimi si tërësi unike politike me aktivitet identik. Partitë e formuara me kohë do të jenë të de-tyruara të krijojnë fizionomi më përcaktuara si parti të veçanta, në ç' bazë do t'i kenë edhe votuesit e tyre e do të japin kështu mundësi të qarta për

anëtarësim sipas bindjeve personale për zgjidhjen e çështjeve konkrete e për perspektivën e shoqërisë kosovare.

***Pyetja:** Më kujtohen vargjet e një poezie tuaj: “Për komunizëm aman se na doli shpirti”. Kjo poezi qe shpërblyer, por edhe qe sulmuar ashpër politikisht. A kërkoni ende komunizëm, qoftë “poetik” dhe a mund të presim shpejt ndonjë përmbledhje të re të poezisë?*

B. Bokshi: Komunizmi si cak i idealeve nuk ka dështuar, por ka dështuar rruga e përcaktuar për ta arritur. Në vjershën “Jubiletë e mia”, që e përmendët, jam përpjekur t’i ironizoj pasojat e rënda të kësaj rruge te ne shqiptarët në Kosovë e t’ia lë “fajin” Marksit që nuk kishte paraparë kalim të menjëhershëm në komunizëm, por nëpër purgatorin e tmerrshëm të diktaturës së proletarietit, nga i cili u pa se s’ mund të dilej. A kërkuj edhe më tutje “komunizëm poetik”? Sado që idealet komuniste për një shoqëri të begatshme, pa shtypje dhe vërtet të dinjitetshme njerëzore janë projektuar të arritshme përmes diktaturës së përmendur, ato janë ideale të largëta të çdo partia përparimtare demokratike dhe ideale gjithënjëzore, prandaj edhe pozitë fundamentale ideore e krijuesit artistik.

Në vitin 1988 kam dorëzuar për shtyp një libër aforizmash, ndërsa Teatri Popullor i Gjakovës po përgatit një tekst timin, një si komedi në dy akte. Për përmbledhje të poezive duhet të pres edhe ca kohë.

***Pyetja:** Meqë u përmendën aforizmat, bën t’i dalloni disa nga ato që sot janë aktuale?*

B. Bokshi: Po, mund t’i them disa: Pasi iu zbardhën flokët, mban shpresë se mos i zbardhet edhe fytyra. Njerëzit e merituar të botës nuk kanë hyrë drejtpërdrejt në histori: shoqëria është kujdesur t’i fusë njëherë nëpër burgje. “Druja mashë s’ bëhet”, Ku e ka zorin, kur si dajak ka gjithë këtë përdorim zyrtar. Lehtë ishte të rëzohej Ciușescu: atij nuk i qëlloi asnjë krahinë autonome.

V. PËR SHQIPEN STANDARDE

PËR SHQIPEN STANDARDE¹

Krijimi i shqipes standarde në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 është arritje e madhe epokale e gjuhësisë dhe e kulturës shqiptare.

Ky akt u bë i mundur me përpjekje të pareshtura të gjeneratave të gjuhëtarëve dhe të intelektualëve që nga Rilindja Kombëtare e nëpërmjet punës së Kristoforidhit, të Komisionit Letrar të Shkodrës, të shoqatave kombëtare në diasporë, të Kongresit të Lushnjës e të konferencave gjuhësore në Shqipëri e në Kosovë. Krijimi i gjuhës së njësuar të gegërishtes, siç ishte edhe ajo që u përdor në Kosovë, përballë toskërishtes që ishte formuar më herët si e tillë, përshpejtoi proceset e normimit të gjuhës unike të përbashkët shqipe. Konsulla Gjuhësore e Prishtinës më 1968, që doli me slloganin ‘Një popull – një gjuhë’ e që e pranoi si të zbatueshëm pa asnjë vërejtje Projektin e Drejtshkrimit të publikuar në Tiranë më 1967, e lehtësoi arritjen e rezultateve të Kongresit të Drejtshkrimit. Arsyet e pranimit të gjuhës së përbashkët me kodifikim që ka, qenë të ndryshme: në Tiranë - edhe nën presionin e mekanizmave shtetërorë, në Prishtinë - nën diktatin e dëshirës për integrim kombëtar.

Kjo gjuhë e njësuar shkrimore u përdor në të gjitha trevat e shqiptarëve dhe gjatë kësaj periudhe detyzuese e kreu funksionin e saj shoqëror e kulturor me efekte integruese gjithëkombëtare dhe ngriti shkallën e trajtimit të kulturës shqiptare si tërësi e pandarë. Ajo pati efekte të rëndësishme në përafrimin e varieteve të folura në drejtim të normave të saj.

Por, siç është thënë nga studiuesit e gjuhëve standarde, "krijimi i një forme të përbashkët të gjuhës, sado e përsosur që të jetë, nuk është tjetër veçse një moment në histori të një gjuhe... Ajo shënon një kohë të ndalur në zhvillimin e gjuhës, kështu që format e saj, duke qenë të qëndrueshme, vijnë e ngurosen dhe e humbin zhdërvjelltësinë natyrore të jetës".³ Gjuha e përbashkët nuk mund të qëndrojë e fiksuar po u desh që ajo të jetë viji-

¹ Dy tekstet pasuse po i shkruaj me ndryshimet që, siç jam shprehur, duhet të pranohen si përfundime të proceseve në zhvillim në shqipen standarde.

³ J. Vendryes, *Le langage – Introduction linguistique à l’histoire*, Paris, 1968, 302-3.

misht e përdorshme si e tillë. Ajo edhe spontanisht, duke e zgjeruar përdorimin, huazon elemente të varieteteve të folura. Është vlerësuar se gjuha standarde “është gjuhë që ka një lloj baraspeshe vijimisht të ndryshueshme midis fiksimit dhe evoluimit”, po që “është fatale nëse ajo u nënshtrohet goditjeve të rënda dhe transformohet ... në të njëjtën mënyrë si varietetet e folura”.⁴ Edhe Kongresi i Drejtshkrimit ka porositë që “duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr politika gjuhësore, Rregullave të drejtshkrimit t’u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura”. Nevoja për përmirësimet e plotësimeve u theksua në Konferencën gjuhësore që u mbajt në Tiranë në tridhjetëvjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit dhe për këtë qëllim, me kërkesën e kësaj konference, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës formuan Këshillin Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe.

Përmirësimet në drejtshkrim kanë të bëjnë me eliminimin e disa inkonsekuencave dhe nga nevoja e përafrimit të formës së shkruar me shqiptimin, që brenda këtyre dyzet vjetëve e ka shtuar më tej dallimin. Ndryshimet epokale politike e shoqërore që ndodhën në Shqipëri, në Kosovë e në trevat e tjera shqiptare bënë të mundur lidhjet intensive të gjithanshme të subjektit shqiptar në të gjitha nivelet dhe sollën kështu në kontakt më intensiv varietetet e folura të gjuhës së shkruar, të cilat në gërshetim bëjnë presion spontan për ndryshime dhe plotësime të disa elementeve morfologjike të normës. Tendenca të tilla po bëhen gjithnjë e më të dukshme dhe po identifikohen si elemente depërtuse në normë. Ato kanë filluar me u përdorë si të tilla në të folur të gjuhës standarde. Duhet të shënohet këtu edhe mendimi i Etëhem Likajt se “Morfologjia standarde, më shumë se fushat e tjera, duhet të kapë qysh në vigjilje të zhvillimeve formën e së ardhmes, jo forma të krijuara, të shpikura, por forma në përdorim, që kanë ndjekur vijën e prirjeve gjatë historisë dhe sot, forma që sot mund të jenë të rralla, por janë më përfaqësuese, më praktike, më pragmatike dhe më kujtesore. Pritja në zgjedhje në rrafshin e morfologjisë krijon probleme të vështira për të ardhmen”.⁵

⁴ Vep. e cit., f.299.

⁵ Në referatin e tij *Morfologjia e shqipes standard dhe zhvillimet e reja* në materialet e

I. Ndryshimet morfologjike⁶

Tirana si kryeqytet me popullsi të përzier dialektore po sjell disa largime nga normat e shqipes standarde në të folur me tendencë përgjithësimi. Disa nga këto përdorime janë goditje të rënda të sistemit morfologjik të gjuhës shqipe jo vetëm standarde, duke mos qenë as elemente sinjalizuese të ndonjë sistemi të ri:

1. Nga folësit e gjuhës standarde në Tiranë e më gjerë është përgjithësuar përdorimi i përemrit dëftor *ato, këto* edhe për gjininë mashkullore në vend të formës *ata, këta*, p.sh. djemtë u vonuan. *Ato* nuk arritën dot me kohë; *këto* persona, *këto* lojtarë, *ato* studentë etj.

2. Përdorim mjaft të përgjithësuar edhe nëpër mediat video- auditive të Shqipërisë kanë trajtat *nga mua, tek ty*, në vend të formave normë *nga unë, nga ti, tek unë, te ti* etj.

Të dyja këto janë devijime që nuk mund të përfshihen në normë, sepse janë forma çrregulluese të sistemit përemëror.

3. Një përgjithësim ka edhe përdorimi i formës **tre** edhe në vend të formës femërore **tri**: *tre gra, tre vajza, tre motra, tre ditë, tre ndeshje* etj. Forma **tri** ruhet vetëm në përbërje të numrit **tridhjetë**. Numërori **tre** nuk ka pengesa që të pranohet në normë si numëror për të dy gjinitë, siç janë edhe të tjerët, por, meqë pjesa më e madhe e folësve të standardit përdor formën **tri** në përputhje me normën, duhet pritë se ç'kahje do të marrë zhvillimi më tutje, d.m.th. se për tani norma duhet të qëndrojë e pandryshuar.

4. Folësit e shënuar të gjuhës standarde e përdorin formën *neve, juve* edhe në funksion të rasës emërore në vend të formave *ne, ju: kush jeni juve, juve folët mirë* etj., *neve duhet të jemi aty, neve jemi të brengosur* etj.

botuara të konferencës *Shqipja në etapën e sotme: sfidat e përmirësimit e të pasurimit të standardit*, f. 143, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.

⁶ E lexuar në mbledhjen e Këshillit në Prishtinë.

Përdorimi në vend të formës së kallëzores me parafjalët përkatëse është i shpeshtë edhe në Kosovë: *në/nën/për/me/ mbi* | *neve / juve*. Kjo e ka bazën te përdorimi i formës së dhanores gjithnjë e më shpesh edhe si kallëzore jashtë sintagmës parafjalore, por, mbasi kjo formë e dy vetave të para të vetorit si dhanore nuk ka përdorim me parafjalë (në vend të saj përdoret forma e rrjedhores: *prej/ afër/ pranë/ larg* | *nesh, jush*, ashtu si dhe: *afër meje/ teje* etj.), përjashtohet mundësia që këto forma të vetorit të përdoren me vlerë të kallëzores me parafjalët përkatëse. Prandaj duhet të respektohet norma, duke e përdorë formën *ne, ju* në vlerë të kallëzores me parafjalë: *në/për/me/ mbi ne/ju*.

5. Gjithnjë e më shumë po përdoret forma e futurit *do punoj, do laj, do bluaj, do vij* etj. në vend të formave *do të punoj, do të laj, do të bluaj, do të vij* etj. Vërtetë se mospërdorimi i pjesëzës **të** të lidhores në bashkëvajtje me pjesëzën **do**: *do gaboja, do kisha thënë, do jenë marrë* etj. e ruan të njëjtin kuptim, por për përdorimin e **të**-së edhe në këtë rast bën presion forma e lidhores së plotë në përdorime të tjera pa lidhje me pjesëzën **do**, në të cilat segmenti **të** e dallon formën e lidhores nga forma e dëftores: të nise-mi, *dua të shkoj, të përpiqemi, duhet të pajtohem, mendoj të shkoj* etj. Në funksionimin e saj si mënyrë në sistemin foljor të shqipes lidhja kërkon ruajtjen e një forme unike. Meqë forma pa **të** nuk mund të përgjithësohet edhe në përdorime jashtë bashkëvajtjes me pjesëzën **do**, ajo është një formë, që, e krijuar për ekonomizim të shprehjes, mbetet jashtë kërkesës për formë të unifikuar të lidhores, formë, që, si deformuese e lidhores, nuk mund të përvetësohet nga standardi.

6. Po keqpërdoret përdorimi i përemrit *kush*. Në shqipen në tërësi dhe në shqipen standarde ky përemër përdoret për të pyetur për njerëz dhe nuk del në bashkëvajtje me ndonjë emër, ndërsa po përdoret me emra sendesh e në bashkëvajtje me një emër: *kush libër të pëlqen? Kë libër ke lexuar? etj. kush erdhi? - etj.* Përemri *cili, cila* ka përdorim për të gjithë emrat, prandaj s'është nevoja që të bëhet i tillë edhe përemri *kush*.

7. Është për t'u cekur se në komunikim publik toskërishtja, me prestigjin e saj si bazë e shqipes standarde, po përdoret me elementet e saj të veçanta në vend të standardit, duke shënuar tendencën për dominim të saj mbi të. Natyrisht ky përdorim është i kufizuar vetëm te folësit e

toskërishtes, që domethënë se nuk e cenon shqipen standarde në përgjithësi edhe pse ka tendenca imitimi.

Ne mbështesim këto ndryshime morfologjike që shënojnë tendenca përgjithësimi në gjuhën e folur standarde, e që janë në kuadër të proceseve të natyrshme zhvillimore në shqipen standarde:

1. Format origjinalisht të rasë dhanore: *neve, juve* janë përgjithësuar edhe si forma të rasës kallëzore: *na tha neve, ju tha juve* dhe *na pa neve, ju pa juve* në vend të *na pa ne, ju pa ju*. Kjo vlerë sinkretike për dhanore e kallëzore e formave *neve, juve*, që ka mbështetje në sinkretizmin e formave të njëjësit: *më tha mua, të tha ty, më pa mua, të pa ty*, është imponuar tanimë që të jetë brenda shqipes standarde, duke i lënë trajtat *ne, ju* në vlerë të rasë emërore e, siç shënuam, edhe në vlerë të kallëzores brenda sintagmës parafjalore.

2. Format e emrave të vepruesit, që kanë hyrë në shqipen standarde nga gegërishtja: *tregues, dëgjues, mësues, përfaqësues* etj., ashtu si dhe format e pjesores brenda mbiemrave me prapashtesën **-shëm**: *e punueshme, e papërtueshme, i lavdueshëm, i kushtueshëm* etj. janë me dyzanorshin **-ue**, i cili në pjesën më të madhe të gegërishtes ka kalu në **-u-**: *tregus, dëgjus, mësus, përfaqsus* etj.; *e pranushme, i papërtushëm, i kushtushëm* etj., kështu që format me **-ue-** janë thuajse të paqena e me synim që të bëhen plotësisht të tilla, prandaj nuk kanë si të qëndrojnë në gjuhën standarde si forma të gegërishtes. Për të qenë forma të gegërishtes ato duhet të pranohen në normë si forma me **-u-**. Kjo i bën më të pranueshme këto forma nga folësit toskë të standardit.

3. Nga folësit e shqipes standarde gjithnjë e më shpesh po përdoret trajta e pjesores së gegërishtes: *(ka) pritë, (ka) ardhë, (ka) folë, (është) prekë* etj. Ky synim i përgjithësimit shfaqet vetëm me pjesoret e temës në bashkëtingëllore si në shembujt e shënuar. Kjo bën që mbiemri prejpjesor i nyjshëm të formohet nga pjesorja dhe prapashtesa **-ur**: *e prit-ur, i ardh-ur, e fol-ur, e prek-ur* etj., siç e formon gegërishtja: *i prit-un, i ardh-un* etj. Toskërishtja (dhe gjuha standarde) e gegërishtja kanë formë të njëjtë të pjesores me temë në **-në** e në likuide me apofoni: *ka thënë, ka lënë* – *ka thanë, ka lanë*; (si dhe *ka marrë, ka nxjerrë, ka bjerrë* etj.) *ka mbjellë, ka*

sjellë, ka mjelë etj. si dhe e ka formimin e mbiemrit nga këto pjesore pa prapashtesë: *e lënë, e thënë, i marrë, e mbjellë, e vjelë* etj. Me këto dy formime të përbashkëta të pjesores po hapet rruga për ndikim të gegërishtes në formim të pjesores dhe mbiemrit prejpjesor edhe me temat në zanore e në dyzanorsh: *ka la - e la-rë, ka pre - i pre-rë, ka bë - i bë-rë, ka thye - i thye-r, ka mbulu - i mbulu-ar* (geg.: *i la-m, i pre-m, i mbulu-m* etj.). Kështu prapashtesat e pjesores së toskërishtes bëhen prapashtesa të mbiemrit prejpjesor (**-ur, -r, -rë, -ar**). Nuk shënohet asnjë përdorim i unifikimit të mbiemrit me pjesoren e këtyre tipave në zanore si në Shqipri të mesme e jugore: *i la, i thye, i mbulu* etj. Trajtën gege të pjesores e ka toskërishtja dhe gjuha standarde brenda formës së habitores: *la-kam, thye-kam, prit-kam, ardh-kam* etj. që është një e kryer e përmbysur (*kam la* etj.) Në shqipen standarde, siç u tha, është pranuar forma gege e pjesores edhe në mbiemrin me **-shëm**: *e punue-shme, i thye-shëm, i pa-shëm, i përtri-shëm, i prit-shëm, i bind-shëm* etj., në emrat e vepruesit: *mësue-s, ndërtue-s, shikue-s, pritë-s, humbë-s, ardhë-s, djegë-s, thye-s, prekë-s* etj., si dhe te disa emra të prejardhur me prapashtesën **-je**, e cila figuron e shtuar mbi formën e pjesores së gegërishtes: *ardh-je, mbet-je, vërejt-je, prit-je, humb-je, fal-je* etj. Nga kjo kuptohet se gjuha standarde është toleruse ndaj formës gege të pjesores, në përbërje të formave të shënuara, kështu që është e hapur mundësia e përgjithësimit të formave të pjesores në zanore brenda formave analitike të së shkuarës: *kam la – jam la, kisha pi – isha pi, pata kritiku – qesh kritiku* etj.

4. Të mbetet siç është forma e mbiemrit prejpjesor: *e prit-ur, e ardh-ur, i la-rë, i ble-rë, e rhye-r, e shkru-ar* etj.

5. Në Konferencën shkencore “*Shqipja në etapën e sotme: sfidat e përmirësimit dhe të pasurimit të stanardit*” mbajtur në Durrës më 15-17 dhjetor 2010 (Materialet u botuan nga Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës më 2011) në kumtesën *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe* pata rikujtu se paskajorja *me + forma e pjesores të së kryerës* ishte e tërë shqipes, e krijuar para përfutimit të mbiemrit të nyjshëm e me funksion të variantit të lirë me lidhoren e krijuar më herët. Në toskërishte ajo nuk u nxor vetiu nga përdorimi, por u nxor nën ndikimin e huaj, nën ndikimin e greqishtes aty nga shek. XIII si në gjuhët e tjera ballkanike dhe se për këtë

arsye shqipja standarde e ka të zbrazët vendin e paskajores me funksion të tillë. Kjo domethënë se standardi nuk e kundërshton praninë e një paskajoreje. “E meqë një paskajore e tillë ekziston në gjuhën shqipe dhe është shumë e përdorshme në dialektin gegë, në kushtet e bashkëjetesës së intensifikuar të të folmeve të dy dialekteve tona, kjo paskajore ushtron presion për ta përgjithësuar përdorimin e për të hyrë në standard. Ajo po shfaqet e përdorur te folësit e gjuhës standarde gjithnjë e më tepër, sidomos në të folurit e shpejtë, për shkak se, duke qenë formë foljore pa vetë e pa numër, është e seleksionueshme më me lehtësi se lidhorja e ngarkuar me këto kuptime”.⁷ Kjo paskajore mund të hyjë në gjuhën standarde vetëm me format geqe të pjesores edhe pa imponuar ndryshimin e pjesores së standardit në përdorime të tjera, ashtu siç nuk është imponuar ndryshimi nga format e shënuara emërore e mbiemërore me **-shëm**, të formuar nga pjesorja e gegërishte.⁸ Pjesoret e përbashkëta të dy dialekteve e lehtësojnë përdorimin e paskajores: *me thënë, me lënë, me marrë, me nxjerrë, me vjelë, me mbjellë, me pasë* etj. Duke hyrë në standard paskajorja në përballje me pjesoren krijojnë mundësinë e begatimit stilistik të shprehjes që nuk e ka shqipja standarde.⁹

6. Shumsi i emrave me **-nj** të bëhet me **-j**: *mullij, ftoj, pej, brij, të rij* etj., në përputhje me zhvillimin më të hershëm **-nj** > **-j** në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores: *punonj* > *punoj, lanj* > *laj* etj. dhe në të pakryerën: *shkonja* > *shkoja, rrinja* > *rrija* etj.

7. Të mos pranohet ambigjenia te emrat me shumës në *-ra*: *fshatra të eletrizuara, ujëra të ftohta, leshra të dredhura* etj., d.m.th. të qëndrojnë në gjininë mashkullore: *fshatra të elektrizuar, ujëra të ftohtë, leshra të dredhur* etj.

⁷ Vep. e cit.,f. 159-60.

⁸ Shih më detajisht në vep. e cit.

⁹ Rexhep Ismajli në veprën *Standarde dhe identitete*, Pejë, 2003 e ka arsyetuar nevojën dhe mundësinë e përfshirjes së paskajores së gegërishtes në gjuhën standarde (f. 56-63) ‘në konkurrencë të lirë’. Ai preferon dy mundësi të përvetësimit të paskajores në standard: ‘a) duke e ruajtur të plotë formën e pjesores geqe në ato funksione, ndërsa te mbiemrat - formën aktuale standarde; b) duke kërkuar rrugë të tjera përmes formave të ndërmjeme – me të pjesores së shkurtër (si lënë, ardhë), por prapë me formë aktuale të mbiemrave...’.

8. Të mos shënohen me **-ë** fundore emrat lëndorë që kanë kaluar nga gjinia asnjëse në gjininë mashkullore: *brumë, dyllë, grurë, mjaltë, djathë* etj. si dhe nga emrat *lumë, ballë, djalë, burrë*.¹⁰ Emrat asnjës, duke kaluar në gjininë mashkullore, i takojnë temës emërore oksitone në bashkëtingëllore, që është temë e emrave të gjinisë mashkullore, siç janë emrat *mal, mineral, shkop, nip, gjak, fshat, qytet* etj.

Nga sa u tha mendoj se duhet të pranohen në normë të shqipes standarde të shkruar këto risi që tanimë kanë pësuar një përgjithësim në standardin e folur.

¹⁰ Për fjalën *djalë* e *ballë* si emra origjinalisht asnjës shih E. Çabej, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1976. I tillë do të ketë qenë edhe emri lumë. Për **-ë-në** e emrit burrë Çabej mendon se ajo mund të jetë se ka shënuar një femërore të lashtë.

NGA DISKUTIMET E MIA NË KËSHILLIN NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

I

Mendoj se për zëvendësimin e mbaresës -nj të shumësit me -j së pari duhet shikuar lidhjen e mbaresës së shumësit me tipin e temës.

1. Tema në zanore të theksuar e mbi të gjitha me zanoren -i, që është neutrale në gjini, te emrat e gjinisë femërore e ka ruajtur formimin origjinal të shumësit pa mbaresë, d.m.th. një me njëjësi: qershi, shtëpi, rini etj. krahas emrave të tjerë të këtij tipi: re, fe, be, kala etj. Emrat e gjinisë mashkullore e kanë ruajtur këtë formim në pak raste: thi, që domethënë se edhe emri mi nuk ka arsye ta bëjë shumësin me -nj, emri sy, i cili tregon se forma e njëjësit sy-ri nuk është primare, sepse do të kërkonte që shumësi të ishte me mbaresën -nj (sy-nj). Mbaresa -nj e shumësit te emrave të gjinisë mashkullore nuk është përfutur brenda kësaj teme, sepse kjo temë nuk ka përfunduar në -n që të dilte shumësi me -nj. Për këtë arsye ne mendojmë se te emrat mashkullore të kësaj teme të shënuar në paragrafin 29 të Drejtshkrimit të mos zëvendësohet mbaresa -nj me -j, por të mos përdoret fare, d.m.th. shumësi të dalë një me njëjësin: bari, ari, batakçi, çilimi, kallajxhi, sharrëxhi, e të tjerë si komshi, dajrexhi, jabanxhi, axhami, të zi, të ri. Të gjithë këta emra në njëjësin e shquar dalin me nyjën -u.

2. Mbaresa -nj e shumësit është përfutur te emrat e temës oksitone në -n: mulli(n) - shum. mullinj, ble – blenj, pe – penj, gju – gjunj, kalli – kallinj, gji - gjinj, kushëri – kushërinj, turi – turinj, ulli – ullinj, hu - hunj, kërcu – kërcunj etj. Kësaj teme i kanë takuar edhe emrat ftua – ftoi - ftonj, dragua - dragoi – dragonj, patkua - patkoi - patkonj, përdua - përroi - përrenj etj. Për të gjithë këta emra propozimi që ta kenë shumësin me -j është i arsyeshëm.

Mbaresa e shumësit -nj përdoret edhe me emra të temës në -a të theksuar ku nuk është përfutur në rrugë fonetike, por është e paevitueshme dhe duhet të zëvendësohet me -j: fukara - fukarej, kalama - kalamaj, budalla - budallej etj. si dhe lumej, lëmej, të këqij, të mëdhej.

Mbaresa e shumësit -inj me i-në e theksuar tregon se ishte sufiks i lashtë kolektivi: *-inio (Jokli), kështu që te emrat shkëmbinj, shkopinj, thelbinj etj., mbasi -nj-ja nuk është mbaresë shumësi, po pjesë e saj, duhet shikuar a duhet zëvendësuar me mbaresën -j, duke pasur parasysh dhe shembujt si: drapër-inj (drapër-ij), priftër-inj (priftër-ij), gjarpër-inj (gjarpër-ij) etj.

Për raste kur fjalori i lë në përdorim dy mbaresa të shumësit: gjarpinj e gjarpërinj, drapinj e drapërinj, propozoj që të ruhet vetëm forma gjarpër-inj e drapër-inj, që e mban të pandryshuar formën e njëjësit. Për emrin gisht mendoj se duhet të përdoret vetëm shumësi me -a: gishta, d.m.th. të përjashtohet forma me dy mbaresa: gisht-ër-inj, ashtu si dhe nip - nipa e jo nip-ër. Emri prift duhet të dalë me mbaresën e shumësit -ër: prift - prift-ër, si mbret - mbret-ër, drejt - drejt-ër, prind-ër.

Mendoj se ndërrimi i mbaresës -nj me -j në rastet e shënuara nuk ka arsye të mos realizohet edhe në rrjedhjet që e kanë temë shumësin me -nj: drujëzim, i drujtë, i florijtë, gjujas, gjujzor etj. Lënia e -nj-së këtu nuk figuron si mbaresë shumësi, mbasi jashtë fjalës së prejardhur shumësi i fjalës përkatëse është me -j.

3. Për foljet që në vetën e parë njëjës të dëftores lejohet të dalin me -t e me -s : avit - avis, bezdit - bezdis, dremit - dremis, përgatit - përgatis, korit - koris, padit - padis etj. mendoj se, meqë forma me fundoren -s ka hyrë **në rrugën** e një përgjithësimi në përdorim, nuk mund të pritet që ajo të dominohet nga fundori -t, prandaj nuk ka pse të lejojmë që të qëndrojë edhe forma me -t. Kështu këto folje bashkohen me foljet flas, godas, bërtas, pres etj.

II

Komisionet e çështjeve të drejtshkrimit në vijim të punës së gjer-tanishme na kanë paraqitur një material të trajtuar me kujdes e me përgjegjësi profesionale.

1. Më duket se është e nevojshme të realizohet shkrimi me -e fundore i emrave të shënuar si foshnje, vishnje, Lushnje etj.

2. Për propozimet në pikën e dytë kam disa vërejtje. Aty bëhet fjalë për emra trerrokësh të gjinisë femërore me -ë fundore e me theks në rrokje të pare, që si të tillë nuk i takojnë asnjë teme emërore të shqipes së sotme, prandaj është me vend përpjekja për ta ndryshuar këtë strukturë në favor të inkuadrimit të këtyre emrave në njërën nga temat ekzistuese. Komisionet propozojnë të hiqet -ë-ja fundore nga emrat operë, kamerë, ulqerë, teserë, gondolë, mbështetur në krahasimin me emra femërorë të tipit flutur, kumbull, tjegull, mjegull etj., që janë pa -ë fundore. Krahasimi nuk është i saktë, për arsyes se këta emra femërorë i takojnë të njëjtës temë që i takojnë edhe emrat mashkullorë si lepur, kungull, shekull, shembull etj., që domethënë se i takojnë temës neutrale në gjini, prandaj nuk e dallojnë gjininë femërore nga gjinia mashkullore. Tek autorët tanë të vjetër tipi i kësaj teme shënohej me -ë fundore pa dallim gjinie të emrave. Emrat e shënuar pa -ë oper, kamer, ulqer, teser, gondol nuk do t i takonin asnjë teme emërore të shqipes. Mendoj se zgjidhja është që të shkruhen me -ë e të shqiptohen me theks paroksiton, duke i takuar kështu temës femërore në -ë. Shqiptimi me theks në rrokjen e parë opera, kamera etj. janë shqiptime intelektualësh, janë shqiptime të huaja jashtë normave të shqipes, e cila në huazimet postlatine nuk e respekton vendin e theksi kur nuk përputhet me atë të shqipes. Për arsyet e shënuara mendoj se është propozim i drejtë që emrat bombol, tombol të shkruhen me -ë fundorë e të shqiptohen me theksim paroksiton. Emri fabul me theks nistor të imponuar nga latinishtja, ka shkaktuar që ky emër femëror të kalojë në temë neutrale në gjini, pa pasur nevojë të marrë -ë fundore për ta dalluar gjininë. Mendoj se ky trajtim duhet të vlejë edhe për emrat tumul, valvul për shkak të së njëjtës strukture. Edhe emrat laurë, pauze, kauzë, traumë me -ë fundore e me theks në zanoren -a- nuk i takojnë asnjë teme emërore. Edhe po t'u hiqej -ë-ja fundore, prapë do të mbeteshin jashtë çdo teme, kështu që zgjidhja do të ishte që të ruhet -ë-ja e të theksohet -u-ja, zgjidhje që përshtatet me atë që thashë për emrat operë, kamerë etj. Në këtë pike do të duhej të hynte edhe trajtimi i mbiemrit i.e sigurt, që komisionet propozojnë me arsye që të shënohet me -ë fundore e me theksim në -u.

.....

3. Pajtohem që fjalët thyesë e thyez të shkruhen njësoj, por në këtë

pike na thuhet se emri thyesë si fjalë e ritmit daktilik, meqë theksi bie mbi -y-, është jashtë sistemit të temave emërore, prandaj jepen tri propozime për ta futur brenda ndonjë teme. Kështu propozohet që të shkruhet pa -ë, me ç'rast pandehet se barazohet me emrat si kumbull, flutur etj. Për këtë zgjidhje si të papranueshme u shpreha më lart. Pastaj propozohet që të mbetet -ë-ja, por theksimi të zhvendoset në -e-: thyesë, që do të ishte zgjidhje unike tërësisht e papërvetësueshme dhe propozimi i tretë është që fjala të shkruhet me -y- në vend të dyzanorshit -ye- thyesë. Mendoj se ky propozimi është në vijë të perspektives së dukshme të kalimit të dyzanorshit të theksuar -ye- në -y-, por i realizuar nga ne vetëm në këtë shembull, do të mbetej i paarsyetueshëm qëndrimi i pandryshuar i dyzanorshit -ye- në shembujt e tjerë. A jemi ne në gjendje që këtë thjeshtim, që është në proces, ta bëjmë të përfunduar, duke i shënuar të gjithë shembujt me -y- kur e kanë të theksuar pytje, pys, i kthyshëm, i thyshëm, përktys, mbërthys, i ndyrë, i thyrë, ka thyrë, shtyj etj., duke e lënë këtë dyzanorësh të pathjeshtuar kur është i patheksuar kryesi, kryetar, kryezi, kryeplak, kryesor, kryeqytet, kryemadh, pyetësor, arsyetim etj., për arsye se këtu mungon theksi që do ta hiqte -e-në. Në qoftë se këtë është herët ta bëjmë, atëherë si zgjidhje imponohet që emri thyesë të mbetet siç është, me interpretim të dyzanorshit -ye- të mbërthyer nën një theks e të pandashëm në dy zanore të veçanta, gjë që e vërteton edhe heqja e elementit të dytë -e nga theksi.

4. Komisionet nuk na kanë sjellë ndonjë trajtim të zhvillimit të dyzanorësit ue, që është edhe në shqipen standarde në përdorim të kufizuar. Në qoftë se mund ta trajtojmë pa pasur mendimin e komisioneve, unë do të thosha disa fjalë.

Nëse është e saktë se dyzanorshi ue në pjesën më të madhe të gegërishtes ka kaluar në -u- e me synim që të bëhet plotësisht i tillë, format e emrave të vepruesit dhe mbiemrat me prapashtesën -shëm në gjuhën standarde nuk kanë pse të qëndrojnë me -ue- inekzistente në gegërishte, por do të dalin duke respektuar kalimin në -u- që është arritur në këtë dialekt: dëgjus, tregus, mësus, përfaqësues etj. dhe e pranushme, i papërtushëm, i kushtushëm etj.

...

5. Mendoj se është arsyetuar mire që shumësi barna të përdoret në gjuhën standard e të futet në fjalor. Pranë fjalës burrnor, që është pranuar në standard, mund të pranohet edhe burrni .

...

6. .Vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Shqipërisë që fjalët që kanë shqiptim të veçuar të tingujve g, j e n, j , për t iu shmangur shqiptimit si dyshkronjësh të shkruhen me -i- në vend të -j-së: djegia, biologjia albanologjia etj. Kjo zgjidhje ka dale mjaft e papëlqyeshme -i-ja para nyjës -a të tërheq kah theksimi si në rastet e tjera, ku është vetëm e theksuar dhe si e tillë të orienton kah prishja e kuptimit dhe e formës së fjalës: biología, albanología, djegía etj. Edhe pse Komisioni A i Kongresit ka vendosur që në rast kur tingujt e dyshkronjëshave me -h- shqiptohen të veçuar, të ndahen me apostrof apo me vizë, mbeti e porealizuar, pa zgjidhje për një shqiptim të papërzier. Komisionet kanë preferuar ndarjen me apostrof ndaj ndarjes me vizë. Mendoj se Këshilli ynë duhet të përcaktohet për një zgjidhje. Propozoj që të shikohet edhe mundësia që si element ndarjeje të jetë tingulli -ë- si ndërhyrës djegëje – djegëja, shmangëje - shmangëja, kësaj biologëje - biologëja, kësaj albanologëje - albanologëja etj dhe mesëhollë, brezëhumbur, Etëhem, Mitëhat etj. Propozoj që edhe midis tingujve n-, -j të ndërhuje zanorja -ë- rënëje, rënëja, thënëje, thënëjen,erj.

...

7. Për shkrimin e emrave të popujve e të fiseve e konsideroj më të drejtë mendimin e atyre anëtarëve të komisioneve që të vijohet tradita e shkrimit të tyre me shkronja të vogla, me të cilat është i unifikuar shkrimi i tyre edhe si mbiemra. Për emrat e përveçëm të botës fetare, që kanë mbetur të shkruar me shkronja të vogla për arsye ideologjike, nuk ka dyshim se duhet të shkruhen me shkronjë të madhe si Zot, Perëndi, Allah, Pejgamer e të tjera të shënuara kështu në këtë material.

...

III

Formimi i shumësit të emrave në gjuhën shqipe është i komplikuar

sa në shumë raste nuk mund të përcaktohet forma e përdorshme e shumësit të një emri. Edhe te Buzuku ka raste të përdorimit të një emri me dy forma shumësi: klisja, udha, majëna dhe klishtë, udhë, majë etj. Për këtë gjendje Cimochowski me të drejtë ka sugjeruar që forma e shumësit të çdo emri të shënohet në fjalor, siç shënohet forma e gjinorës së latinishtes.

Kuptohet se ky Këshill e as tjetërkush jashtë tij nuk mund të ketë propozime që do ta ndryshonin këtë gjendje në drejtim të përcaktimit të saktë të formës së mbaresës së shumësit për të gjithë emrat. Mirëpo formimi i shumësit të emrave nuk është krejt pa rregulla. Ato duhet të diktohen e të respektohen si vijimësi tradicionale. Duhet të diktohen tipizimet e emrave që i kanë arsyet për të pasur një mbaresë të përbashkët të numrit shumësi. Kështu janë:

1. Emrat mashkullorë të gjallesave të temës oksitone në bashkëtingëllore, që vihen në opozicion me ata të seksit femëror që dalin me -e, e bëjnë shumësin me -ë që në kohën e rënies e shkrirjes së mbaresës -i të shumësi. Mbarësa -ë ishte fillimisht e emrave të gjinisë asnjane të kësaj teme dhe kaloi tek emrat e shënuar të gjallesave që i patën të papatalizueshëm tingujt fundorë të temës e që ishin kështu edhe fjalë bikategoriale emër-mbiemër: fshatar-ë (fshatare), punëtor-ë (punëtore), student-ë (studente), shofer-ë (shofere), traktorist-ë (traktoriste), artist-ë (artiste), shkurtabiq-ë (shkurtabiqe), sekretar-ë (sekretare), mjek-ë (mjekje), shkencëtar-ë (shkencëtare) etj.

Prapashtesat e emrave të tillë, që përdoren edhe me emra të jogjallesave, mbesin të lidhura me shumësin me -ë si te emrat e seksit mashkullor të këtij tipi: koftor-ë, lter-ë, taftar-ë, lakror-ë, uror-ë etj.

2. Mbarësa -a e shumësit u krijua nga -e e shumësit në kontakt me -ë: të mira, plaka, pela, kunata, princesha, arusha, shqiponja, emëna, dimëna, pjepëna, lakëna, motëra, vepëra, votëra etj. Në tipin e temës neutrale në gjini (me, -ën, -ër) duke u përdorur me emra të gjinisë mashkullore si mbarësa -e më parë, kaloi në përdorim edhe me emrat mashkullorë brenda temës oksitone në bashkëtingëllore. Emrat e gjallesave të seksit mashkullor, që nuk ishin edhe mbiemërorë e që nuk kishin opozicion seksi, apo që ky opozicion realizohej me fjalë të ndryshme, apo

me prapashtesën femërorizuese -eshë, u ndanë nga ata që shënuam duke marrë mbaresën -a të shumësit në vend të mbaresës -ë: a) karkalec-a, bilbil-a, buf-a, krimb-a, dem-a, derr-a, korb-a etj., b) burr-a, çun-a,, nip-a. gjel-a etj. c) princ-a, luan-a, sokol-a, doktor-a, profesor-a etj.

Kur asnjanesit e kësaj kohe kalon në mashkullor, merr mbaresën -a të shumësit: plis-a, plep-a, zan-a (zëra),shenj-a etj. Me këtë mbaresë e bënë shumësin edhe disa emra mashkullorë të jogjallesave që kishin të njëjtët tinguj fundorë si disa emra të seksit mashkullorë: karkalec-a – kastravec-a,spec-a etj. Ata që qëndruar asnjanes mbetën me mbaresën -ë të shumësit:vesh-ë, gur-ë,,vjet-ë, fren-ë etj.

Të dy këto formime të shumësit me mbaresën -ë dhe me mbaresën -a te emrat e seksit mashkullorë të temës oksitone në bashkëtingëllore, që nuk e pësuan palatalizimin e tingullit fundor e metafonizim, kanë mbetur të përcaktuar brenda rregullave të shënuara më lart që nga një kohë mjaft e moçme deri më sot, prandaj këto formime të shumësit s'kanë pse të ndryshohen, që do të thotë se nuk ka arsye të pranohen propozimet që disa emra që dalin me mbaresën -ë të shumësit të marrin mbaresën -a\; studenta, shofera etj. dhe disa emra me mbaresën -a ta formojnë shumësin me -ë: profesorë, doktorë, drejtorë etj.

II. NDRYSHIMET NË DREJTSHKRIM

Në Parimet e përgjithshme të Kongresit të Drejtshkrimit është shënuar se “Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe ...çel rrugë për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës e të kulturës sonë kombëtare (f. 36)” dhe se “Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik”, i cili “synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare”.

Për ta zhvillu më tej këtë lidhje të ngushtë të nevojshme, mendoj se parimi fonetik duhet të realizohet në funksion të ruajtjes së zëshmerisë së bashkëtingëlloreve. Përynjatimet e pakta nga ky parim do të arsyetohen.

Realizimi i këtij parimi bën të mundur përafrimin e mëtejme të shkrimit me shqiptimin dhe shënon një thjeshtim të rregullave.

A. Për -ë-në paratheksore:

1. Të hiqet -ë-ja në rastet kur bashkëtingëllorja del në kontakt me një sonante a kur takohen dy sonante, mbasi sonantet nuk ndikojnë më në ndryshimin e zëshmërisë së bashkëtingëlloreve:

besnikri, djallzi, fajsi, shfajsoj, malsi, malsor, mbrettri, plehrim, pleqri, pleqroj, qytetrim, robri, shkrifroj, shqiproj, shtetror, trimri, vazhdimsi, picrroj, vegjli, voglimë, zvogloj, breshri, dimroj, emroj, emrore, femrore, misrishte, numroj, numror, zemrim, zotri, nëpunsi, puntor, njerzor, mirsi, përmirsohet, trimri, dorzim, sipri, siprore, motri, antarsi, atror, botror, botrisht, flakroj, frymzoj, gojtar, gjelltore, hollsi, mbarsi, pentore, shkallzim, thellsi, valzgj, vallzim, kallzore, vështirsi, dorzan, ngatrrësë, shkatrroj, besnikri, djallzi, fshatarsi, zgjuarsi, cofrimë, gjallri, flakrim, gjelbrohet, çfardo, mijshe, gegri etj. (Përrjashtim: burror).

Në drejtshkrim janë lejuar të shkruhen pa -ë fjalët: *amtar, besnik, furratar, lojtar, nevojtar, nevojtore, ngatrrëstar, rojtar, zyrtar*. Është thënë se mosshënimi i -ë në këta shembuj është “Për shkak të ngulitjes prej kohësh të shqiptimit dhe të shkrimit në gjuhën letrare”.¹¹ Ndërkaq këta shembuj tregojnë se ekzistonte me kohë kahja e zhvillimit kah heqja e -ë-së përshkak të kriterit të shënuar.

Brenda kësaj pike -ë-ja nuk hiqet kur është në rrokje të parë, për arsye se është vijimisht e shqiptueshme nga të gjithë folësit e gjuhës standarde:

dënesë, dënim, fëlliq, fëmijë, gëmushë, gërryej, këlysh, këmishë, kënaq, kënetë, kërrabë, kërrusem, lëkurë, lëpij, lëpushkë, lëshoj, mëkat, mënyrë, lëmoshë, mësim, mëshoj, pëllumb, pëllëmbë, pëllet, përrallë, rrëfanë, thërret, thërrimë, lëfyty, lëmekem, dërrasë, dëlir, lëkund, mësyj, mësysh, vë-

¹¹ Shih shënimin 1 në f. 44 në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973

rej, vërejtje etj. (Fjala *gjerësi* duhet të shkruhet *gjërësi*, sepse e tillë imponohet përball gegërishtes *gjansi*).

2. Të hiqet **-ë**-ja kur bien në kontakt dy bashkëtingëllore të një zëshmerie:

a) *kpucë, kpushë, kpus, kshill, atsi, coptoj, friksoj, gjatsi, gjuhsi, gjuhsor, gjuhtar, pjestim, plotsoj, plotsisht, qetsi, toksor, trashsi, thatsi, armiqsi, gjaksi, gjaksor, hapsirë, hapsinor, keqsim, miqsor, miqsisht, mjeksi, mjeksore, paksoj, pleqsi, shëndetsi* (shetit e jo shëtit) etj.

Përrjashtim: *tëhu, tëholloj, shkretëtirë, vetëtimë, pesëshe, atëherë, të këqij* dhe përemrat e ndajfoljet me elementin deiktik **kë**:- *këta, këto, kësi, këso, kësisoji, kësodore, kështu, këtu, këtej*.

b) *gzoj, gzim, dboj, dbim, dborë, gzhojë, pagzoi, pagzim, degzoi, degzim, bzaj* etj. (Përrjashtim: *dëgjoj*).

3. Të ruhet **-ë**-ja:

a) kur është në mes dy bashkëtingëlloresh me zëshmeri të ndryshme, për të mos lejuar ndryshimin e zëshmerisë, d.m.th. procesin e asimilimit:

argëtim, bagëti, dëshirë, dëfrim, gogësimë, kryqëzim, kryqëzor, ligësi, madhësi, shfrytëzoi, trashëgoj, rëndësi, rrogëtar, humbëtirë, vështroj, shtungëtar etj. Përrjashtim: *tregtar, tregti, tradhtar, tradhti, tradhtoj, tradhtisht*, që janë pranuar në drejtshkrim.

b) që të mos bashkohen katër apo tri bashkëtingëllore që do të formonin grup të paqëndrueshëm:

shndërrim, pështjelloj, lundëtar, misërnike, misërishte, ëmbëlsi, ëmbëlsirë, poshtërsi, ashpërsi, egërsi, epërsi, letërsi, afërsi, aftësi, saktësoj, shtrembëroj, zbehtësi, rreptësi, ftohtësi, këmbësor, luftëtar, lavdërim, zdrukthëtar, motërzim, vjetërsi, vogëlsi, priftërij, priftëreshë, pështymë, zëshmeri etj.

4. Të mos shënohet **-ë**-ja:

a) brenda grupit të bashkëtingëlloreve që fillon me sonantet r,l,j,n:

bujqsi, harktar, kalbzoj, krejtsisht, urdhroj, gjarproj, drejtsi, lartsi, ultsi, shpejtsi, shterpsi, urtsi, vjershtor, çiltri, dhëlpri, dhëlpushë, gjelbrim,

verbrisht, kordhtar, bashkëtingllore, ndrrim, shëndrrim etj. (në pajtim me shembujt në pikën c).

b) mbrenda grupit **shtr**, kur prapashtesa fillon me zanore: *poshtrim, eshtrore, eshtri, eshtrim, mjeshtri, mjeshtror* etj. siç nuk shënohet në shembujt: *mashtroj, mashtrim, përgënjeshtroj, ushtri* në rregullat e Drejtshkrimit dhe ashtu siç nuk shënohet edhe brenda grupit **str**: *kadastrim, lustrim, ministri, pastrim, regjistroj* etj.

c) te fjalët me përfundim në **ndër** e **ndërr**, kur prapashtesa fillon me zanore: *dhëndri, dhëndror, ëndrrim, ëndrroj, fundrri, ndrresë* etj. në përputhje me shembujt e pranuar në normë: *lundroj, cilimdrik, thundrak, qendror, qëndroj, qëndresë, kundroj* etj.

Përyqësim bën fjala **kundër**, që qëndron e pandryshuar në kompozita a fjalë të përngjitura: *kundërajror, kundërrargument, kundëroffensivë* etj.

5. Për fjalët e përngjitura a kompozitat të respektohen kriteret e shënuara kur pjesa e parë mbaron me **-ë**:

a) *udhrrëfytes, gojmjalt, mbarshtrim, armpushim, kokrruar, kokmadh, datlindje, ditlindje, mirbesim, mirseardhje, dorheqje, derbardhë, derzi, mbarvajtje, i mirfilltë, pulbardhë, shumfishoj, piknisje, pjesmarrje, gjellbërës, marrdhënie, marrzisht, vetmashtrim* etj.

b) *pikpamje, vetqeverisje, vetshërbim, vetkuptohet, i vetquajtur, dhjetfishoj, botkuptim, bukpjekës, drejtpeshim, koktrashë, degvarur, degdendur, rrugdaje* etj.

c) *udhëheqës, qafëgjatë, plangëprishës, grykëderdhje, grykëgjërë, kokëvogël, vetëvendosje* etj.

6. Kur pjesa e parë është fjalë që nuk përfundon me **-ë** të mos respektohet kriteri i zëshmërisë, por të shënohen siç janë në Drejtshkrim, sepse kanë përdorim të përgjithësuar prej kohësh:

keqbërës, frytdhënës, trupderdhur, vendkomandë, vendstrehim, gjakbutë, gjakdhënës, aktëdëshmi, shtatgjatë, shtatzënë, vendndalim, venddalje, gjakderdhje etj.

Të pranohen siç janë në Drejtshkrim grupet e bashkëtingëlloreve:

gjysmëhënë, gjysmëkoloni, harkmbajtje, bashkëtingllore, ushtëmbajtës, vendndalim, venddalje, vendbanim, vendgrumbullim etj.

7. Të mbetet siç është shkrimi i grupeve të bashkëtingëlloreve të mbiemrat me **-shëm**.

8. Për format foljore të shënuara në faqen 72 të Drejtshkrimit të zbatohen rregullat e shënuara më lart. Të shkruhen me **-ë**- format foljore *humbëte, humbëka, humbështa* etj.

B. Për **-ë**-në pastheksore

1. Në bazë të rregullit të shënuar të ruajtjes së zëshmërisë së bashkëtingëlloreve të shënohet **-ë**-ja si në Drejtshkrim:

fshikëz, fshikëza, fshikëze; gjuhëz, gjuhëza, gjuhëze., kryqëz, kryqëza, kryqëze; pjesëz, pjesëza, pjesëze, drejtëz, drejtëza, drejtëze etj., por të hiqet **-ë**-ja kur vjen pas një bashkëtingëlloreje të zëshme a pas një sonanteje: *lidhëz, lidhza, lidhze, drugëz, drugza, drugze, dredhëz, dredhza, dredhze, arrëz, arrza, arrze, lemëz, lemza, lemz* etj.

2. Për të gjithë emrat e vepruesit me **-ë**-s të respektohen rregullat e shënuar të ruajtjes së zëshmërisë në njëjës e në shumës:

a) në njëjës:

ardhës, ardhësi, ardhësin, ardhëse; mbledhës, mbledhësi, mbledhë-sit, mbledhësin, mbledhëse; zgjedhës, zgjedhësi, zgjedhëse etj., (kështu janë edhe në Drejtshkrim), *blerës – blersi, blerse; çelës – çelsi, nxënës - nxënsi, nxënse, folës – folsi, folse, grykës - gruksi, brykse, shpikës - shpiksi, shpikse* etj. Në përputhje me këtë duhet të shkruhen edhe *Durrës - Durrsi, Kukës - Kuksi, QukëS - Quksi, Lëkurës - Lëkursi*.

b) në shumës të shkruhen siç janë në Drejtshkrim

3. Te mbiemrat e nyjshëm me **-t** të ruhet **-ë**-ja në rastet e pengimit të kontaktit të dy bashkëtingëllore me zëshmëri të ndryshme: *i zbrazët, i dobët, i lagët, i largët, i verbët, i idhët* etj. Në rastet e tjera kur bien në kontakt bashkëtingëllore me zëshmëri të njëjtë apo me një sonant të shkruhen me **-ë**- në fund: *i cektë, i një të cektë, të cektët, të cektëve, të*

cektësh; i ngathtë; i përbashktë; i shkathtë; i ultë; i kthjelltë; i njelmtë; i errtë; i vrëntë etj.

4. Te foljet (pika c e paragrafit 6): trajta e vetës së' dytë njëjës e së tashmes së lidhores të shkruhen siç janë në Drejtshkrim (d.m.th. të mos përdoren rregullat e shënuara të zëshmërisë):

të dalësh, të flasësh, të marrësh, të mbyllësh, të presësh, ndezësh etj.

6. Edhe trajtat e habitores të shkruhen siç janë në Drejtshkrim (pika ç e paragrafit 7): *ardhkan, humbkam, marrkam, paskam, qenkam; pas-kështa, qenkështa etj.*

III. -ë-ja fundore:

Në paragrafin 8 pika b) të hiqet -ë-ja tek emrat lëndorë që kanë kaluar në mashkullorë nga gjinia asnjënjësore dhe nga disa emra të tjerë për të cilët u shprehëm në pjesën e ndryshimeve morfologjike.

Në paragrafin 8 pika c) disa ndajfolje që formojnë mbiemra të nyjshëm shkruhen me -ë si mbiemrat, disa të tjera shkruhen pa -ë, pa pasur ndonjë arsye për këtë dallim. Këshilli Ndërkademik për Gjuhën Shqipe ka sugjeruar unifikimin e shkrimit të këtyre ndajfoljeve, duke i shënuar të gjitha pa -ë :

i butë - but, i gjallë - gjall, i ftohtë - ftoht, i ngrohtë - groht, i gjatë - gjat, i shkretë - shkret, i lartë - lart, i shpejtë - shpejt, i bardhë - bardh etj. (përfshirë: i mirë - mirë, i vonë - vonë). Mbiemrat që nuk kanë -ë mbesin si dhe ndajfoljet përkatëse: i keq - keq, i kuq - kuq, ashtu si dhe mbiemri i madh, trupi i të cilit nuk është ndajfolje.

Kjo nuk vlen për pjesoret që krijojnë mbiemra të nyjshëm:

i marrë - (ka) marrë, e dhënë - (ka) dhënë, i mbjellë - (ka) mbjellë etj.

IV. Të tjera

1. Te numërorët nga 11 deri në 19 mendoj se duhet hequr bashkëtingëllojia -b- :

njëmbdhjetë, dymbdhjetë, pesmbdhjetë, tetmbdhjetë, nëntmbdhjetë etj. për arsye se parafjala *mbë* ka kohë që nuk përdoret, sepse ka kaluar në *më*.

2. Të shkruhen me -j- mbiemrat:

i florijtë, i drujtë, i grujtë, i pejtë, i shtrejtë, i shejtë etj.

3. Nuk ka arsye të shkruhet me apostrof t'ju. Kjo duhet të shkruhet të ju, siç shkruhen të më. të të, të na.

4. Nuk ka arsye që të mos shënohet shumësi me -ë i emrave: vat-ë, amperë etj.

**DISKUTIM NË MBLEDHJEN E DATËS 06. 10. 2010 TË
KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE, E
MBAJTUR NË PRISHTINË**

Konferenca Shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, që u mbajt në Tiranë më 2002, e pa të nevojshme që të ngrihet një komision a këshill që do të përcaktonte, ndër të tjera, ndryshimet tashmë të nevojshme në drejtshkrimin e gjuhës shqipe në drejtim të thjeshtimit e të përsosjes së tij. Akademia e Shkencave e Shqipërisë mori nismën e krijimit të Këshillit Ndërakademik që kemi, nismë që e konfirmoi edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Këshilli në parimet për veprimtarinë e tij, që u aprovuan unanimitisht, ndër të tjera është përcaktuar:

- për një politikë gjuhësore që synon krijimin e rrethanave sa më të përshtatshme për përdorimin dhe funksionimin e shllirshëm të shqipes standarde në të gjitha hapësirat e komunikimit;

- për zhvillimin dhe përsosjen e mëtejme të këtij mjeti të domosdoshëm të komunikimit në harmoni e në hap me zhvillimet e gjithmbarshme të kohës;

- për të ndërmarrë veprime drejt rrafshimit të dallimeve të krijuara si pasojë e ndarjeve politiko-administrative që sollën vështirësi të komunikimit kombëtar në shekullin e kaluar;

- për evidentimin e problemeve dhe vështirësive në funksionimin e gjuhës standarde dhe propozimin e zgjidhjeve;

- për shqyrtimin e mungesave e zgjidhjeve të tejkaluara dhe për propozim të plotësimeve dhe zgjidhjeve të reja normuese.

Këto parime përbëjnë përcaktimin konceptual obligues të secilit anëtar të Këshillit lidhur me trajtimin e çështjeve të shqipes standarde dhe kërkojnë kujdes të përkushtuar për të avancuar zhvillimin dhe vitalizimin e saj, kujdes të përkushtuar në përcaktimin e kahjeve zhvillimore që ajo i

synon apo që i ka realizuar tashmë në segmente të caktuara të strukturës së saj edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit.

Në çështjet e drejtshkrimit është i evidentueshëm largimi gjithnjë e më i theksuar i shqiptimit nga forma e shkruar e fjalës. Në Kongresin e Drejtshkrimit është shënuar se “Parimi fonetik synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare” dhe se “Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe ... çel rrugë për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejme të gjuhës e të kulturës sonë kombëtare”.

Nga Kongresi e këndej në shoqërinë shqiptare kanë ndodhur zhvillime e ndryshime tepër të mëdha me pasoja të favorshme të integritit kulturor kombëtar. Relacionet afruese të komunikimit të pjesëve të kombit ndikojnë krejt natyrshëm në ndryshimet e mundshme përafuese të segmenteve të normës së gjuhës standarde. Gjenerata e tashme e gjuhëtarëve brenda këtij Këshilli Ndërakademik, në kushtet e këtyre ndryshimeve epokale në shoqërinë shqiptare, ka para vetes një detyrë të ndritshme për përsosjen e mëtejme të gjuhës sonë standarde në përputhje me kërkesat e kohës, e ka rastin e rrallë për të lënë një vepër me vlerë të shënueshme në kulturën kombëtare.

Kështu, qëndrimi që të mos ndryshohet asgjë në drejtshkrimin e tanishëm është akt jashtë arsyes së krijimit të këtij Këshilli, jashtë arsyes për të qenë anëtar i këtij Këshilli. Duke pasur parasysh se vendimet Këshilli i merr me konsensus, ky qëndrim e bllokoi punën në Këshill.

TREGUESI I EMRAVE**A**

Agani, Fehmi 8, 151, 152, 153
 Ajeti, Idriz 7, 59, 60, 61, 63,
 64, 65, 66, 67, 68, 129, 139,
 146, 147, 148, 154, 183,
 196, 200, 201
 Aliu, Ali 159, 160, 200
 Altimari, Francesco 57

B

Badallaj, Imri 200
 Bajraktari, Jusuf 194
 Bally, Charle 121
 Barić, Henrik 59, 65
 Bejta, Murat 129
 Benveniste, Emil 97, 98, 148
 Beqiraj, Gudar 165, 166, 175,
 189
 Beqiri, Valton 142
 Berisha, Sali 142, 179
 Binaku 143
 Bogdani, Pjetër 113
 Bokshi, Besim 36, 38, 106,
 114, 116, 166, 202, 203,
 204, 205, 207, 208
 Bopp, Franz 111, 139
 Boshnjaku, Tahir Efendi 66,
 147
 Brøndal, Viggo 35
 Buzuku, Gjon 27, 28, 30, 31,
 225

C

Camaj, Martin 18, 19
 Cana, 89
 Ciușescu, Nicolae 209
 Cimochoowski, Wacław 7, 51,
 59, 60, 61, 65, 129, 130,
 131, 132, 133, 226

Ç

Çabej, Eqrem 8, 11, 13, 14, 15,
 17, 21, 36, 40, 62, 63, 64,
 70, 71, 78, 124, 132, 133,
 134, 135, 136, 139, 148,
 149, 150, 186, 187, 218
 Çausi, Bardhyl 8, 169, 170

D

Dante, 206
 Demiraj, Bardhyl 20
 Demiraj, Shaban 7, 48, 49, 76,
 97, 101, 109, 111, 112, 114,
 119, 121, 122, 134, 135,
 136, 137, 138, 148, 149,
 180, 183, 190, 202
 Domi, Mahir 134, 148, 149
 Dozon, Auguste 61, 129, 132
 Elezović, Gliša 63
 Emërllahu, Mehmet 6, 202
 Ferri, Rexhep 193, 206
 Fiedler, 101, 129, 186
 Frashëri, Mit'hat 180

- Fromm, Erich 206
 Gexha, Qamil 8, 171
 Hahn, Georg von 139
 Halimi, Kadri 147
 Hamp, Eric Pratt 13, 18, 95, 96,
 130, 186
 Havranek, Bohuslav 121
 Hesse, Hermann 137
 Hjelmslev, Louis 27, 37
 Humboldt, 146
 Ilievski, Petar 123
 Islami, Hivzi 61, 62, 165, 189,
 198, 200
 Ismajli, Rexhep 8, 105, 139,
 140, 141, 146, 166, 175,
 183, 185, 186, 187, 198,
 200, 201, 202, 217
 Jokl, Norbert 63, 64, 65, 70,
 73, 78, 96, 130, 133, 139,
 186, 187, 220
 Kaçori, Nikollë 180
 Kamarda, Dhimitër 13, 16, 17,
 77, 111, 139
 Koneski, Blaže 115
 Kraja, Mehmet 200
 Krasniqi, Mark 8, 147, 154,
 155, 156
 Kujundžić, Ljubomir 63
 La Piana, Marco 70, 129, 148
 Lafe, Emil 165, 166
 Lambertz, Maximillian 14, 15,
 65
 Likaj, Ethem 183, 198, 200,
 212
 Llunji, Ali 149
 Maliqi, Sheh Hilmi 66, 147
 Mansaku, Seit 183, 186, 200
 Martinet, André 76
 Matrënga, Lekë 27, 28, 29, 30
 Mehmeti, Din 8, 161, 162, 163,
 164
 Meje, Antoan (Meillet Antoine)
 114, 115
 Mekuli, Esat 159
 Meyer, Gustav 11, 71, 73, 75,
 78, 121, 132, 139, 186
 Meyer-Lübke, Wilhelm 75
 Mihăescu, Haralambie 99
 Miklošič, Franc (Miklosich) 65,
 109, 129, 186
 Miletić, Branko 63
 Mindak, Jolanda 129
 Mirčev, 115
 Mjeda, Ndre 12, 15, 17, 62
 Montei, Pierre 95
 Mulaku, Latif 129
 Nahtigal, Rajko (Nachtigal)
 129
 Nushi, Pajazit 8, 156, 167, 168,
 194
 Ölberg, Hermann 15
 Orel, Vladimir 20
 Oštir, Karel (Oštir, Karel) 14,
 17, 18, 19
 Otrębski, Jan 130
 Palloshi, Nexhibe 129
 Pedersen, Holger 18, 21, 51,
 65, 70, 71, 73, 129, 132,
 139, 178, 186
 Pekmezi, Gjergj 64

- Pellegrini, Giovan Battista 178
 Podrimja, Ali 8, 89, 159, 160
 Popa, Ylli 146
 Popović, Ivan 63
 Prifti, Kristaq 180
 Qëndro, Gëzim 193
 Rexhepagiq, Jashar 8, 157, 158
 Riza, Selman 7, 31, 32, 64, 69,
 70, 71, 72, 73, 96, 129, 134,
 142, 143, 144, 145, 148,
 175, 176
 Rossi, Ettore 16
 Rozwadowski, J. 130
 Rrota, Justin 64
 Rugova, Bardh 105
 Rugova, Ibrahim 105, 142, 155,
 197
 Rugova Mujë 209
 Sandfeld, Christian 96, 97,
 101, 102
 Sawicka, Irena 129, 130
 Sejdiu, Fatmir 142, 175, 176
 Sentari, Pasquale 19
 Shehu, Jahja 167
 Skënderbeu, 87, 191
 Skok, Petar 65
 Skubić, M. 13
 Tagliavini, Carlo 14, 63, 64, 66,
 147
 Tekavčić, Pavao 124
 Thomai, Jani 166
 Togeby, Knud 37, 38, 39, 42
 Topalli, Kolec 77, 183, 186,
 189, 190, 191, 200
 Treimer, Karl 14, 20
 Vendryes, Joseph 115, 212
 Voronjina, Irina 178
 Weigand, Gustav 35, 62, 63,
 64, 65, 109, 147
 Xhuvani, Aleksandër 29, 35,
 36, 40, 41, 52, 78, 134, 135,
 148

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	7
I. ÇËSHITJE ALBANISTIKE.....	9
EMRAT E DITËVE TË JAVËS, dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes	11
VËSHTRIM KRAHASUES I SISTEMIT RASOR TË “MESHARIT” ME TIPAT E TJERË TË SISTEMIT RASOR TË SHQIPES	27
NJË SISTEMIM I PARAFJALËVE TË SHQIPES	35
RRETH PROBLEMIT TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE	55
E FOLMJA E ARBNESHËVE TË ZARËS NË VEPRËN E IDRIZ AJETIT	59
TRAJTIMI I RELIKTEVE GJUHËSORE NGA SELMAN RIZA.....	69
PËR THEKSIN E SHQIPES DHE PËR LËVIZJEN E HERSHME TË TIJ	75
PËR PARASHTESAT E SHQIPES STANDARDE.....	81
POLITIKA GJUHËSORE NË DISA VISE TË JUGOSLLAVISË.....	83
NGA BISEDAT NË BEOGRAD.....	89
II. ÇËSHITJE BALLKANISTIKE.....	93
FORMAT E FUTURIT TË SHQIPES NË PËRQASJE ME ATO TË GJUHËVE BALLKANIKE.....	95
RASAT GJINORE-DHANORE NË GJUHËT BALLKANIKE.....	105
RIMARRJA E KUNDRINAVE NË GJUHËT BALLKANIKE	113
THEKSI DINAMIK DHE GJATËSIA E ZANOREVE NË GJUHËT BALLKANIKE	121
III. PËR DISA PERSONALITETE AKADEMIKE.....	127
PËR WACLAV CIMOCHOWSKIN	129
NË 80-VJETORIN E LINDJES SË SHABAN DEMIRAJT.....	134
PËR SELMAN RIZËN NË 100-VJETORIN E LINDJES	139
NË PROMOVIMIN E LIBRIT TË IDRIZ AJETIT	143
PËR EQREM ÇABEJN SHKURTIMISHT.....	146
PËR REXHEP ISMAJLIN.....	148
NË 70-VJETORIN E LINDJES SË FEHMI AGANIT	151
NË 90-VJETORIN E LINDJES SË MARK KRASNIQIT.....	154
PËR JASHAR REXHEPAGIQIN NË 80-VJETORIN E LINDJES.....	157
PËR ALI PODRIMJEN.....	159

PËR PAJAZIT NUSHIN.....	161
PËR DIN MEHMETIN.....	163
PËR BARDHYL ÇAUSHIN.....	166
PËR QAMIL GEXHËN.....	168
KRYETARIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË, ZOTIT GUDAR BEQIRAJ.....	169
IV. FJALË PËRSHËNDETËSE E FALËNDERUESE	171
NË KONFERENCËN SHKENCORE “SELMAN RIZA GJUHËTAR DHE ATDHETAR I SHQUAR”.....	173
NË KONFERENCËN SHKENCORE “STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE”	175
“KONGRESI I MANASTIRIT DHE NJËSIMI I ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE”	177
FJALË FALËNDERUESE.....	180
NË 50-VJETORIN E THEMELIMIT TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS	182
NË PËRURIMIN E VEPRËS SË NORBERT JOKL-IT	184
NË PROMOVIMIN E VEPRËS SË KOLEC TOPALLIT	186
FJALË PËRSHËNDETËSE NË SHKUP	189
NË PROMOVIMIN E VEPRËS SË GËZIM QËNDROS PËR REXHEP FERRIN.....	190
NË TRYEZËN SHKENCORE “TRAJTIMI I PERANDORISË OSMANE DHE I RAPORTEVE TURKO-SHQIPTARE NË TEKSTET TONA TË HISTORISË.....	191
NË HAPIJEN E SEMINARIT XXVIII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE – 17. 08. 2009.....	193
NË CEREMONINË E SHPALLJES “NDERI I QYTETIT TË GJAKOVËS”	195
NË 80-VJETORIN E LINDJES	197
INTERVISTË E GAZETARIT MEHMET EMËRLLAHU	199
V. PËR SHQIPEN STANDARDE	207
PËR SHQIPEN STANDARDE.....	209
NGA DISKUTIMET E MIA NË KËSHILLIN NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE	217
DISKUTIM NË MBLEDHJEN E DATËS 06. 10. 2010 TË KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE, E MBAJTUR NË PRISHTINË.....	230
TREGUESI I EMRAVE	232

Besim Bokshi
VARIA
2014

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektura:
ASHAK

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 14.93 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

811.18-26
811.18'373.6

Bokshi, Besim

Varia / Besim Bokshi. – Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2014. –236 f. ; 24 cm. - (ASHAK : Botime të Veçanta ; CXXXV : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ; Libri 50)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. - Parathënie : f. 7-8. –
Treguesi i emrave : f. 232-234

ISBN 978-9951-615-31-0